



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

944

026/1

Nr. .../...Prot.

Tiranë, më 10.4.2017

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv
Qendra "Res Publica"
Bulevardi, "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44 ✓

Për dijëni : Znj. Vitori Cipi
Rruga, "Frosina Plaku", nr.31

TIRANË

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr. 026/17, datë 08.03.2017, protokolluar pranë institucionit tonë në datë 10.11.2017 me lëndën, "Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni", ju sqarojmë sa më poshtë vijon :

Në lidhje me pikën e parë të kërkesës tuaj, ku kërkonte se cilat janë politikat e ndërmarra nga Ministria e Bujqësisë për Zhvillimin e Bujqësisë nga viti 1990 e deri më sot, ju mund ti referoheni:

- Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit (2007-2013). *Linku më poshtë.*
http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/strategjia_e_bujqesise_dhe_ushqimit.pdf
- Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural e Bujqësor (2014-2020). *Linku më poshtë.*
http://anrd.al/wp-content/uploads/2016/04/VKM_709_-29_10_2014-2.pdf

Në lidhje me pikën e dytë dhe të tretë , ku ju kërkonte numërin e ndërmarjeve bujqësore dhe vendndodhjen po ju sqarojmë sa më poshtë:

Të gjitha të dhënat për ndërmarjet bujqësore dhe agroindustrinë zyrtarisht janë të botuara prej INSTAT. Insitucioni ynë është furnizuesi me informacion ndaj tyre, por për arsye se statistikat

e bujqësisë me VKM në vitin 2012, u shkëputën nga MBZHRAU dhe ishte INSTAT që duhet të publikonte dhe ka publikuar të gjitha të dhënat e bujqësisë për vitet e kaluara, ku dhe institucioni jonë orientohet tek ato të dhëna. Kështu që, çdo informacion statistikor zyrtar gjendet në faqen e INSTAT. Aktualisht, statistikat i janë rikthyer MBZHRAU e cila po punon me vrojtimin vjetor në bujqësi, proces i cili do të gjenerojë të gjitha të dhënat në fushën e bujqësisë dhe të agropërpunimit. Këto të dhëna janë marrë nga terreni dhe në bashkëpunim me INSTAT.

Në lidhje me pikën e katërt, ku ju kërkonti marrëveshjet dhe projektet ndërkombëtare të ratifikuara në sektorin e bujqësisë, më poshtë gjeni listën e Marrëveshjeve Ndërkombëtare kryesore të zbatuara nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë.

1. Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Holandës për projektet “Mbështetje për fuqizimin e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve” dhe “Për shërbimin këshillimor kombëtar bujqësor”, nënshkruar më 15.10.1998.
2. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunim në fushën e veterinarisë, nënshkruar më 23.4.1998.
3. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së bimëve, nënshkruar më 15.1.1998
4. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi bashkëpunimin në fushën e mjekësisë veterinare, nënshkruar më 15.1.1998.
5. Marrëveshje mbi bashkëpunimin në fushën e bujqësisë ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë Ujore të Maqedonisë, nënshkruar më 22.1.1999.
6. Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe industrisë ushqimore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe ushqimit të Rumanisë, nënshkruar më 6.12.1999.
7. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së bimëve, nënshkruar më 18.8.1999.
8. Marrëveshje me shkëmbim notash ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë për financimin e projektit të grantit për rritjen e prodhimit bujqësor, nënshkruar më 16.6.1999, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
9. Marrëveshje me shkëmbim notash ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës mbi projektin e bashkëpunimit teknik “Mbështetje e Universitetit Bujqësor Tiranë”, nënshkruar nga pala gjermane më 7.7.1999, ndërsa nga pala shqiptare më 22.9.1999, hyrë në fuqi më 22.9.1999.

10. Kontratë ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë dhe Marubeni Cooperatin për mbështetjen në makineri dhe pajisje për rritjen e prodhimit ushqimor, nënshkruar më 2.11.1999, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
11. Marrëveshje me shkëmbim notash ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës mbi projektin e bashkëpunimit financiar "Mbështetja e institucioneve të vetëndihmës të bujqësisë private", nënshkruar nga pala Gjermane më 29.9.1999, ndërsa nga pala shqiptare më 11.2.2000, hyrë në fuqi më 11.2.2000.
12. Shkëmbimi i notave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë lidhur me dhënien e grantit nga Qeveria Japoneze për financimin e projektit "Për rritjen e prodhimit ushqimor në Shqipëri, 2KR", nënshkruar më 9.3.2001, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
13. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit në fushën e mjekësisë veterinare, nënshkruar më 8.1.2001.
14. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit mbi bashkëpunimin në fushën e karantinës dhe mbrojtjes së bimëve, nënshkruar më 8.1.2001.
15. Marrëveshje për financimin e projektit për rritjen e prodhimit shqiptar 2KR në Shqipëri ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë, nënshkruar më 24.3.2004, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
16. Marrëveshje grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Qeverisë së Austrisë përfaqësuar nga Agjencia Austriake e Zhvillimit për financimin e projektit, Zhvillimi rural i integruar i zonës së Kelmendit, veriu i Shqipërisë, nënshkruar më 20.12.2004.
17. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit mbi bashkëpunimin në fushën e bujqësisë, nënshkruar më 8.1.2001, hyrë në fuqi më 3.2.2004.
18. Marrëveshje e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Eksport Import të Koresë për projektin e elektrifikimit të zonave rurale, nënshkruar më 26.5.2004.
19. Marrëveshje e bashkëpunimit në fushën veterinare me Moldavinë, nënshkruar më 01.11.2004, hyrë në fuqi 1.5.2005.
20. Marrëveshje e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për financimin e Programit për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale malore, nënshkruar, më 20.6.2006, ratifikuar me ligjin nr.9605, datë 11.9.2006.

21. Marrëveshje me shkëmbim notash për projektet bazuar në protokollin e bisedimeve qeveritare 25 nëntor 2003 dhe në zbatim të Marrëveshjes datë 21 tetor 1988, "Fuqizimi i ekonomisë në rajonet Pogradec/Korçë dhe në rajonet veriore të Shqipërisë nëpërmjet kualifikimit profesional" "Modernizimi i ekonomisë agrare dhe ushqimore dhe afrimi i saj me Bashkimin Evropian", hyrë në fuqi më 14.9.2006.
22. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 1998, për projektin "Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla në zonat rurale dhe urbane", nënshkruar më 12.11.2006, hyrë në fuqi më 14.2.2007.
23. Memorandum mirëkuptimi mbi bashkëpunimin në fushën e Bujqësisë midis Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit të Republikës së Kroacisë, nënshkruar më 29.1.2007.
24. Marrëveshje bashkëpunimi midis Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë së Republikës Popullore të Kinës, nënshkruar më 10.9.2007, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
25. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë mbi Transportin ndërkombëtar rrugor të pasagjerëve dhe mallrave, nënshkruar më 17.7.2007.
26. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi bashkëpunimin financiar për furnizimin me ujë të zonës rurale, faza e I, nënshkruar më 27.12.2007, hyrë në fuqi më 26.6.2008.
27. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës për mbështetjen e bujqësisë së qëndrueshme në Shqipëri, nënshkruar më 21.1.2008, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
28. Marrëveshje e bujqësisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, nënshkruar më 17.12.2009.
29. Marrëveshje e bujqësisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Principatës së Lihtenshteinit, nënshkruar në Gjenevë, më 17.12.2009.
30. Marrëveshje e bujqësisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, nënshkruar më 17.12.2009.
31. Marrëveshje për financimin e programit "Mali drejt Tregut" ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor (IFAD), nënshkruar më 15.1.2009, ratifikuar me ligjin nr.10079, datë 23.2.2009.

32. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Çështjeve Rurale dhe Detare të Mbretërisë së Spanjës dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Republikës së Shqipërisë, në fushën e bujqësisë, nënshkruar më 20.5.2009, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
33. Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, për programin për furnizimin me ujë të zonave rurale (faza II), nënshkruar më 7.7.2010, hyrë në fuqi më 27.9.2010.
34. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, nënshkruar në Prishtinë, më 16.11.2012.
35. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Për projektin pilot për krijimin dhe eksperimentimin e një sistemi sigurimesh të lehtësuara për mbulimin e treziqueve në bujqësi”, nënshkruar më 8.3.2013.
36. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e programit “Për fuqizimin e Agjencisë së Pagesave Shqiptare (AZIIBR) për lëvrimin e kontributeve në bujqësi”, nënshkruar më 8.3.2013.
37. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës, për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, nënshkruar në Tiranë, më 2.4.2013, hyrë në fuqi më 1.7.2014.
38. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, nënshkruar në Beograd, më 27.4.2012, hyrë në fuqi më 29.11.2014.
39. Deklaratë e Përbashkët ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në Fushën e Zhvillimit Rajonal në Zonat Ndërkufitare Shqipëri-Kosovë, nënshkruar më 23.3.2015.
40. Memorandum ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nënshkruar më 23.3.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
41. Marrëveshje sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e

Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi rural” (IPARD), nënshkruar më 24.9.2015.

42. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Rindërtimit Produktiv, Mjedisit dhe Energjisë së Republikës së Greqisë mbi bashkëpunimin në fushën e bujqësisë, nënshkruar më 15.7.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.

Në lidhje me pikën e pestë ku ju kërkonti sektorët e bujqësisë që subvencionohen nga shteti dhe si ka ndryshuar ky raport gjatë viteve ,më poshtë gjeni të listuara të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave lidhur me skemat e Mbështetjes Kombëtare nga viti 2007- 2017, konkretisht:

- V.K.M Nr.3, date 10/01/2007
- V.K.M Nr. 10, date 4/01/2008
- V.K.M Nr. 18, date 7/01/2009
- V.K.M Nr. 1290, date 23/12/2009 (Udhëzimi në zbatim të vendimit është miratuar në datën 14/01/2010)
- V.K.M Nr. 27, date 12/01/2011
- V.K.M Nr.41, date 11/01/2012
- V.K.M Nr. 89, date 16/01/2013
- V.K.M Nr. 173, date 26/03/2014
- V.K.M Nr. 52, date 21/01/2015
- V.K.M Nr. 91, date 10/02/2016
- VKM Nr.137, date 22/02/2017

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

**Strategjia Sektoriale
e Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU)**

2007 - 2013

Tirane, 2007

<i>Përmbajtja</i>	i
Akronimet	iii
Lista e tabelave, grafikeve dhe kutive	iv
Grupi këshillimor dhe ai teknik për hartimin e Strategjisë	v
Lista e organizatave kontribuese kryesore	v
Lista e personave kontribues	vi
Përmbledhje ekzekutive	vii
HYRJE	vii
Kushtet aktuale	vii
Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike	xiv
Politikat	xv
Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese	xx
Rrjedhjet për burimet	xx
Çështje kritike të lidhura me buxhetin e bujqësisë	xxi
KAPITULLI 5: KUSHTET AKTUALE	1
1.1 Vendi i bujqësisë në ekonominë kombëtare	5
1.2 Toka bujqësore	5
1.3 Madhësia e fermave	7
1.4 Inputet bujqësore	7
1.5 Agroindustria	8
1.6 Tregtia dhe marketingu i produkteve bujqësore	10
1.7 Ujitja dhe kullimi	11
1.8 Siguria ushqimore dhe standartet	14
1.9 Këshillimi, kërkimi, transferimi i teknologjive dhe informacioni bujqësor	18
1.10 Tipare dhe tendenca zhvillimore kryesore	19
1.11 Mbështetja financiare për bujqësinë	22
1.11.1 Shpenzimet dhe investimet buxhetore për bujqësinë dhe ushqimin.....	22
1.11.2 Investimet dhe kreditimi në bujqësi dhe agroindustri.....	23
1.11.3 Politikat kryesore për bujqësinë dhe rezultatet e tyre.....	24
1.12 Analiza e rrjetit të aktorëve të sektorit	26
1.13 Analiza SWOT e sektorit	27
KAPITULLI 2: VIZIONI, PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE	30
2.1 Vizioni	30

2.2 Prioritetet strategjike.....	30
2.3 Sektorët strategjikë.....	31
2.4 Qëllimet strategjike.....	34
KAPITULLI 3: POLITIKAT	37
3.1 Koncept i përgjithshëm politik për zhvillimin e bujqësisë.....	37
3.2 Politikat e zhvillimit të bujqësisë.....	37
3.3 Përfaqset politike të zhvillimit të bujqësisë	39
3.4 Profili i politikave bujqësore.....	39
3.5 Politikat bujqësore sipas rezultateve të pritshme.....	40
3.6 Çështje “vertikale” të SSBU: zona malore.....	41
3.7 Çështje të politikave sektoriale.....	42
KAPITULLI 4: LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE	48
4.1 Parime të përgjithshme.....	48
4.2 Matricat e indikatorëve të monitorimit.....	48
4.3 Sinergjia midis komponentëve të zhvillimit.....	46
4.4 Raporti mes konvencionale dhe organikes.....	46
KAPITULLI 5: RRJEDHOJAT PËR BURIMET	48
5.1 Hyrje në kostimin e strategjisë.....	48
5.2 Metodatat e kostimit të strategjis.....	49
5.3 Kostimi për 4-5 % rritje vjetore.....	50
5.4 Çështje kritike të lidhura me buxhetin e bujqësisë.....	50
5.5 Kur IPA të jetë në Shqipëri.....	51
5.6 Kontributet financiare për bujqësinë: një shikim më i gjerë.....	51
5.7 Partneriteti publik-privat.....	52
<i>Referenca:</i>	57

Akronime

BE	Bashkimi European
CARDS	Community Assistance for Restructuring and Development Support
ESTAT	European Statistics
FAO	Food and Agriculture Organization
FFZM	Fondi i Financimit të Zonave Malore
GP	Grup prodhuesish
GTZ	Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
GVL	Grup Veprimi Lokal
HACCP	Hasard Assessment and Critical Control Points
IARA	Institute of Albanian Rural Alternativës
IKZ	Instituti i Kërkimeve të Zooteknisë
IMB	Instituti i Mbrojtjes së Bimeve
IPA	Instrument for Pre-accession Assistance
IPARD	Instrument of Pre-accession Assistance for Rural Development
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MIB	Menaxhimi i Integruar i Bimëve
MIF	Menaxhimi i Integruar i Fermës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kafshëve
MIP	Menaxhimi i Integruar i Pesteve
MIT	Menaxhim i Integruar i Tokës
MIUB	Menaxhim i Integruar i të Ushqyerit të Bimëve
MP	Marrëveshja e Përkohshme
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
NATO	North Atlantic Treaty Organization
NMM	Normat maksimale të mbetjeve
OECD	Organization for Economic Co-operation and Development
OIE	Office International des Epizooties
OP	Organizate prodhuesish
PBA	Programi Buxhetor Afatmesem
PBB	Produkti i Brëndshëm Bruto
PIP	Plani i Investimeve Publike
PIR	Platformë e Inovacionit Rural
PMB	Produkte për mbrojtjen e bimëve
PZHSM	Programi i Zhvillimit të Zonave Malore
QTTB	Qendër e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
SASA	Sustainable Agriculture Support in Albania
SHBO	Shoqata e Bujqësisë Organike
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik e Social
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SNJIF	Sistemi i Njohurive dhe informacionit Bujqësor
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SSBU	Strategjia Sektoriale Bujqësisë dhe Ushqimit
UNDP	United Nations Development Program
USAID	United States Agency for International Development
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZQRPP	Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZVRPP	Zyrat Vendorë të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Lista e tabelave

- Tabela 1: Bujqësia kundrejt GDP (%), faqe 1
- Tabela 2: Investimet private në agropërpunim (mln lekë), faqe 5
- Tabela 3: Trendi i eksporteve dhe importeve, ne mijra leke, faqe 7
- Tabela 4: Investimet private në bujqësi me sipas burimit, faqe 19
- Tabela 5: Treguesit për objektivin 1, faqe 44
- Tabela 6: Treguesit për objektivin 2, faqe 44
- Tabela 7: Treguesit për objektivin 3, faqe 45
- Tabela 8: Treguesit për objektivin 4, faqe 45
- Tabela 9: Treguesit për objektivin 5, faqe 45
- Tabela 10: Buxheti i SSBU

Lista e grafikëve

- Grafiku 1: Dinamika dhe struktura e PPB, faqe 1
- Grafiku 2. Madhësia e fermës sipas grupeve, faqe 3
- Grafiku 3: Rritja e prodhimit bujqësor dhe agroindustrial, faqe 4
- Grafiku 4: Tendenca e rendimenteve, faqe 16
- Grafiku 5: Tendenca e sipërfaqeve të mbjella dhe rrënjëve ose numrit të kafshëve, faqe 16
- Grafiku 6: Trendi i eksporteve, faqe 17
- Grafiku 7: Dinamika e raportit import/eksport, faqe 17
- Grafiku 8: Struktura e eksporteve në 2006
- Grafiku 9: Dinamika e investimeve publike në bujqësi, faqe 18

Lista e kutive:

- Kutia 1: Tregu i tokës, faqe 2
- Kutia 2 :Përdorimi i inputeve, faqe 4
- Kutia 3: Sa plotësohen nevojat e tregut me produkte vendi?, faqe 6
- Kutia 4: Bordet e kullimit, faqe 7
- Kutia 5: Një qasje e re e sigurisë ushqimore-HACCP, faqe 11
- Kutia 6: Frutikultura në fokusin e politikave, 19
- Kutia 7: Prioritetet strategjike, faqe 27
- Kutia 8: Sektorët strategjikë, faqe 27
- Kutia 9: Qëllimet strategjike, faqe 30
- Kutia 10:Politikat e cilësisë dhe konkurrueshmërisë, faqe 37
- Kutia 11:Nga plani i veprimit për bujqësinë organike, faqe 38
- Kutia 12:A do të ketë një “kiwi” shqiptar?, faqe 39
- Kutia 13:Mbështetja e bashkëveprimit midis fermerëve, faqe 40
- Kutia 14:SSBU dhe buxheti publik për bujqësinë, faqe 51

Grupi këshillimor për strategjinë e Bujqësisë dhe Ushqimit

Agron Sula
Ahmet Osja
Altin Ylli
Artan Belegu
Dhimo Velo
Edmond Ziso
Engjell Skreli
Enver Ferizaj
Enver Isufi
Gjergj Buxhuku
Isuf Demirxhiu
Lavdosh Feruni
Merita Uruci
Stefan Pinguli

Grupi teknik për Strategjinë e Bujqësisë dhe Ushqimit

Ndue Preka
Adrian Doko
Agron Vata
Brunhilda Stamo
Hajdar Kuci
Irfan Tarelli
Myslym Osmani
Valbona Paluka
Elma Vathi

Disa nga agjencitë dhe organizatat kontribuese

ACIT
AECI
BB
BioAdria
BE
Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë
GTZ
KASH
Konfindustria
Kooperacioni Italian
Kooperacioni Zvicëran
SNV
Universiteti Bujqësor i Tiranës
Universiteti i Korçës
USAID

Lista e personave kontribues në hartimin e draftit

Jemin Gjana
Nue Preka
Noc Faslia
Adrian Maho
Agron Vata
Ahmet Osja
Aleksander Kolaci
Andrea Zamara
Arben Muka
Astrit Balliu
Bahri Musabelliu
Brunhilda Stamo
Dali Oreshka
Dhimiter Papamihali
Engjell Skreli
Enver Ferizaj
Enver Isufi
Esat Hasani
Etleva Husi
Fatos Cocoli
Gertrud Buchenrieder
Hamza Hyka
Ilir Rrembeci
Irfan Tarelli
Isuf Demirxhiu
Kit Nicholson
Kristaq Kume
Lavdosh Feruni
Llazar Korra
Maksim Harullaj
Merita Petushi
Merita Uruci
Minever Rusi
Mira Allmuca
Myslym Osmani
Nazif Tivari
Nikollaq Roshanji
Osman Hoxha
Roland Cela
Sabah Sena
Selim Belortaja
Skender Tola
Shkelzen Marku
Tatjana Dishnica
Valbona Paluka
Vjollca Ibro
Zyhdi Teqja

Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Në kuadrin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), në Shqipëri është duke u hartuar **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)**. Kjo strategji do të jetë një reflektim koherent i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Një nga dokumentat më të rëndësishëm strategjikë në këtë kuadër është edhe **Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU)**.

Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit është pjesë e **Planit Kombëtar për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural**, së bashku me Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural. Ajo ka për qëllim të vendosë lidhjen midis objektivave strategjikë, me një perspektivë shtatë vjeçare, si dhe programeve të shpenzimeve të hartuara në kuadrin e PBA-së.

SSBU u konceptua si një projekt profesional, si një proces demokratik, ajo u konceptua dhe u realizua si një proces transparent, u konceptua dhe u realizua si një proces ekstra-politik. SSBU ka si pronar të gjithë aktorët kryesorë të zhvillimit dhe është një produkt shqiptar. SSBU ka frymëmarrje ndërsektoriale. Ajo është e lidhur me PBE, ose Politikën e Përbashkët Europiane e cila për bujqësinë përfshihet në kuadrin e zhvillimit rural, dhe me MSA-ne. Mes SSBU dhe MSA është organike dhe reflektohet në disa aspekte:

Në vizionin e SSBU: vizioni i SSBU është konkurrueshmëria dhe integrimi i Shqipërisë në BE. Konkurrueshmëria është e lidhur ngushtë me ndërtimin e një ekonomie tregu funksionale, që të përballojë trysninë e konkurrencës, si dhe me ndërtimin dhe zbatimin e një kuadri ligjor sipas standarteve europiane.

Në qëllimin dhe objektivat e SSBU: qëllimi i SSBU është garantimi i zhvillimit të qendrueshëm në sektorin bujqësor dhe agroindustri, ndërsa objektivat kanë të bëjnë me menaxhimin e qendrueshëm të tokës bujqësore, rritjen e standartit të jetësës së fermerëve, rritjen e sigurisë ushqimore, përmirësimin e marketingut agrar, etj. Të gjitha këto janë të refleksi i tre kriterëve të MSA.

Në politikat e përcaktuara në SSBU: Ndër politikat kryesore të SSBU janë përmirësimet ligjore sipas standarteve europiane, Përmirësimi i informacionit, mbështetja e teknologjive të prodhimit, mbështetja e metodave dhe teknikave të reja të prodhimit, forcimi i institucioneve të planifikimit, analizës dhe të monitorimit të zhvillimeve në bujqësi, etj. Të gjitha këto synojnë të kontrtibuojnë në përmbushjen e tre kriterëve të vëna Shqipërisë nga ana e BE për tu antarësuar në këtë organizatë.

Kushtet aktuale

Bujqësia në ekonominë shqiptare. Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë sonë, duke kontribuar me rreth 21 % të PBB-së (në vitin 2006). Familjet rurale vazhdojnë të mbizotërojnë me mbi 50% të popullsisë dhe bujqësia përbën alternativën kryesore të zënies me punë të njerëzve në zonat rurale. Rritja mesatare reale në bujqësi gjatë pesë viteve të fundit është vlerësuar të jetë me rreth 3-3.5%/vit.

Megjithatë, rritja e sektorit bujqësor është nën mesataren kombëtare dhe, njëherësh, larg potencialeve reale. Kjo vjen si rezultat i problemeve me të cilat përballlet sektori, ku mbizotërojnë ato të lidhura më eksodin rural, sipërfaqen e kufizuar të fermave dhe pronësinë mbi tokën, marketingun e produkteve, ujitjen dhe kullimin, nivelin e ulët të teknologjive të përdorura, organizimin e dobët të fermerëve, nivelin e ulët të zhvillimit të industrisë agro-ushqimore, etj. Këto kushte dhe probleme ndikojnë negativisht mbi interesin për investime serioze për prodhimin e produkteve të ndryshme me natyrë agroushqimore.

Reforma e tokës bujqësore. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore zë rreth 24% (ose rreth 699,000 hektarë) të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, nga e cila vetëm rreth 561 mijë hektarë janë tokë arë. Rreth 43% (ose 304 mijë hektarë) e sipërfaqes bujqësore ndodhet në zonën fushore me cilësi përgjithësisht të mira prodhuese, rreth 34% (ose 239 mijë hektarë) në

zonën fushore dhe mbetja prej rreth 23% (ose 159 mijë hektarë) është në zonën malore, e destinuar pothuajse tërësisht për kultivimin e pemëve frutore.

Ndarja e tokës ka arritur në 561 mijë hektarë, që përben 98.6% të fondit të tokës të parashikuar për ndarje prej 569 mijë hektarësh.

Procesi i dhënies së titujve të pronësisë, ose dhënia e "aktit të marrjes së tokës në pronësi", si sipërfaqe, ka arritur në 542 mijë hektarë ose 97.2% e të gjithë sipërfaqes që realisht është ndarë. Aktualisht janë rreth 15 mijë hektarë tokë bujqësore që përdoret (shfrytëzohet) nga familje bujqësore, por që nuk disponojnë tapi për shkaqe të ndryshme e të njohura. Kjo situatë ndeshet me shumë në qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Fierit. Pengese në dhënien e akteve të marrjes së tokës në pronësi janë edhe konfliktet me natyrë të ndryshme.

Procesi i regjistrimit fillestar të tokës bujqësore në cilësinë e saj si pasuri e paluajtshme dhe si produkt i regjistrimit përfundimtar të titujve të pronësisë në ZVRPP, ka arritur në 87.5% të të gjitha zonave kadastrale rurale të vendit.

Gjendja dhe përdorimi i tokës. Në të kaluarën, por edhe aktualisht, vërehen dëmtime të fondit të tokës bujqësore që pakësojnë kufijte fizike të saj, siç janë ndërtime të paligjshme, zgjerimi i pa argumentuar e hapësirave urbane në dëm të tokës bujqësore, dëmtimi i shtretërve të lumenjve, etj.

Bujqësia është e sunduar nga ferma me sipërfaqe të vogël (mesatarisht 1.13 hektarë) dhe të copezuara në mesatarisht 3.9 parcela për fermë, me një madhësi mesatare prej 0.25 hektarësh.

Parcelizimi i tokës bujqësore sjell një sërë vështirësish për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe ka bërë që përdorimi në shkallë të gjerë i mekanikës bujqësore të jetë i vështirë.

Mekanizimi dhe inputet bujqësore. Fermerët ndeshen me shumë probleme në kuadrin e përdorimit të mekanizimit. Gjatë viteve të fundit janë importuar një numër i konsiderueshem traktorësh dhe pajisjesh të tjera mekanikë. Megjithatë, paisjet moderne në llojet e duhura akoma nuk janë ende sa nevojitet në dispozicion të fermerëve. Zotëruesit e makinerive bujqësore u caktojnë fermerëve çmime shumë të larta për kryerjen e proceseve të mekanizuara bujqësore si plugime, mbjellje, korrje dhe shirje, transport, etj.

Vetëm 74% e familjeve që merren me bujqësi e kryejnë punimin bazë të tokës me mjete të mekanizuara. 23% e tyre punojnë tokën me kafshë dhe 59% me krahë dhe me mekanikë. Në punimin e tokës me krahë dominojnë fermat në zonat malore (75%) dhe fermat e vogla 0-1 hektarë dhe ato të mesme me 1-2 hektarë

Në nivel vendi fermerët që përdorin plehra kimike zenë rreth 93% të totalit të fermerëve. Plehrat kimike zenë rreth 23 % të shpenzimeve totale të fermës ose pjesën më të madhe të vlerës së inputeve që blejnë fermat, (rreth 50%).

Industria ushqimore. Në vitin 2006 ishin 2053 ndërmarrje të industrisë ushqimore, 46% e të cilave në industrinë e miellit dhe bukës. Mbi 20% e tyre janë të lokalizuara në prefekturën e Tiranës. Në sektorin e industrisë ushqimore janë të punësuar 9995 persona. Vlera e prodhimit të industrisë ushqimore rezulton të jetë 18% e vlerës së prodhimit të përgjithshëm agroushqimor (sipas INSTAT).

Përsa i perket numrit të bizneseve agropërpunuese, industria e bukës dhe embëlsirave është në vendin e parë me 966 fabrika, ose 47% e totalit, e ndjekur nga industria e përpunimit të qumështit me rreth 362 fabrika e baxho ose 18% dhe nga industria e miellit me 272 sipërmarrje ose 13% e totalit. Bazuar në disa tregues, sipërmarrjet agroushqimore janë shumë të vogla dhe pjesa dërrmuese e tyre nuk i arrijnë standartet e sigurisë së BE-së, si rrjedhim ato nuk kanë mundësi për tu paraqitur në tregun huaj, veçanërisht atë të BE-së. Në mënyrë që të rritet shkalla e konkurrueshmërisë së industrisë së përpunimit të ushqimeve në Shqipëri do të nevojiten investime për të mbështetur politikatat përkatëse të zhvillimit.

Industria ushqimore, si një degë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare ka shënuar zhvillim të dukshëm dhe të qëndrueshëm gjatë viteve të fundit. Prodhimi në vlerë ka shënuar nivelin më të lartë të viteve të fundit prej rreth 48 miliardë lekë, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 11.6%, duke filluar që nga viti 2000. Rritje më të ndjeshme vihen re në nëndegën e përpunimit të qumështit, atë të përpunimit të mishit, etj.

Niveli i investimeve është një tregues tjetër i rëndësishëm i zhvillimit të industrisë ushqimore. Investimet në përgjithësi kanë ardhur në rritje, duke shënuar një kulm në vitin 2005 me rreth

2.9 miliarde lekë. Duke analizuar këto investime janë për tu shënuar 2 fenomene: (1) nga viti në vit ka ardhur duke u rritur pjesa e investimeve që shkon për teknologji kundrejt asaj pjese që shkon për objektet ndërtimore, gjë e cila tregon se krahas përmirësimit sasior të investimeve, ka filluar edhe një përmirësim cilësor i tyre, duke rritur nivelin teknologjik të industrisë, me të gjitha rrjedhojat pozitive të këtij fenomeni. (2) gjithashtu, gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e burimeve të financimit të siguruara nga vetë investitorët dhe nga kreditë bankare të vendit.

Investimet më të mëdha janë duke u bërë në industrinë e përpunimit të qumështit, ndërsa investimet në prodhimin e miellit dhe bukës së bashku kanë pësuar rënie.

Të ardhurat dhe shitja e produkteve bujqësore. Bujqësia, duke qënë e karakterizuar nga një përmasë shumë e vogël e fermave, mbetet akoma mjaft e orientuar drejt plotësimit të nevojave të mbijetesës së familjeve fermere. Kështu, ndonëse në treg dalin mbi 90% e fermerëve, vetëm 30-40% e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale janë të destinuara për treg.

Të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore janë rreth 220 mijë lekë për fermë, nga e cila 58% nga produktet blegtorale. Rreth 43% e fermave marrin rreth 55 mijë lekë të ardhura dhe vetëm 13% e fermave marrin mesatarisht mbi 400 mijë lekë të ardhura. Dukshëm nën mesataren e vendit janë qarqet Kukës, Lezhë, Dibër dhe Korçë. Mbi mesataren janë qarqet Fier, Vlorë dhe Berat. Qarqet që ku fermerët e kanë pjesën më të madhe të të ardhurave nga bimët janë Fier, Korçë dhe Durrës, kurse nga begtoria janë Dibër, Kukës, Vlorë, Elbasan, etj.

Të ardhurat nga shitja e produkteve bimore për fermë janë rreth 92 mijë lekë në vit. 75% e fermerëve realizojnë të ardhura nën 44 mijë lekë në vit, kurse 35% realizojnë nga shitja më pak se 10 mijë lekë në vit. Nën mesataren e vendit janë fermerët e qarqeve Dibër, Kukës, Gjirokastrë dhe Lezhë, ndërsa dukshëm mbi mesataren janë qarqet Vlorë, Berat dhe Fier.

Eksporti. Aktualisht, mundësitë e eksportit në Shqipëri për produktet bujqësore janë shumë të kufizuara. Kjo është kryesisht rrjedhojë e: i) pamjaftueshmërisë dhe nivelit të ulët të prodhimit bujqësor dhe industrisë agro-përpunuese; ii) mungesës së lehtësirave të tregtimit (magazinit, përpunimit, paketimit të produkteve); iii) standarteve të ulëta lidhur me sigurinë ushqimore; iv) shkallës së ulët të konkurrueshmërisë në treg të produkteve bujqësore shqiptare për shkak të cilësisë së ulët dhe kostos relativisht të lartë të produkteve shqiptare.

Rëndësia e rritjes së eksporteve nuk shihet vetëm për të reduktuar bilancin tregtar, por edhe për të përmirësuar cilësinë e produkteve dhe rritjen e aftësive prodhuese, krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e mirëqenies dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Rritja e cilësisë së produkteve tona do të ndikojë pozitivisht në rritjen e eksporteve si dhe do të rrisë shkallën e zëvendësimit të importeve me produkte të prodhuara në vend.

Ujitja dhe kullimi i tokës. Sipërfaqja kulluese prej 200.000 hektarësh ka infrastrukturë që mund të kullohet, nga 280.000 hektarë që është aftësia kulluese e projektuar: (i) 200.000 hektarë janë rehabilituar, por që çdo tre vjet kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme (pra, nga mungesa e deritanishmë e mirëmbajtjes, mund të themi së kjo sipërfaqe tani është rikthyer në gjendjen para rehabilitimit); 80.000 hektarë kanë nevojë për rehabilitim fillestar dhe më tej do të kene nevojë për mirëmbajtje ciklike çdo 3 deri 4 vjet.

Në mbështetje të kullimit funksionojnë 28 hidrovore me 134 elektropompa në 10 rrethe të zonës së ulët (Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, etj.), por rreth 50% e elektropompave kanë një kohë përdorimi me shumë së 20 vjet. Rrjeti i kanaleve kulluese me vepra arti përfshin një gjatësi totale rreth 15.700 km.

Sipërfaqja e tokës bujqësore e rrezikuar vazhdimisht nga përmbytja arrin 130.000 hektarë (e mbrojtur aktualisht me argjinatura, kanale ujërash të larta e me hidrovorë), ndërsa gjatësia e argjinaturës mbrojtëse nga lumenjtë dhe deti arrin në gjithsej 850 km.

Sipërfaqja e ujitëshme në nivel vendi është 188.000 hektarë (sipërfaqe që kanë infrastrukturë të rehabilituar dhe që mund të ujitet) nga 423.000 hektarë gjithsej që është aftësia ujitëse e projektuar. Nga kjo shifer: (i) nga kjo rreth 70.000 hektarë mund të perjashtohen pasi kanë humbur funksionin e tyre si tokë bujqësore (janë kthyer në zona urbane, përfshirë këtu edhe abandonimin e shumë skemave ujitëse me ngritje mekanike që rezultojnë jo efikase dhe (ii) 173.000 hektarë kanë nevojë për rehabilitim, si proces ciklik i vazhdueshëm.

Nga 639 stacione pompimi për ujitje të ndërtuar, vetëm rreth 100 janë në gjendje pune, kurse pjesa tjetër janë stacione pompimi që, për tu rivënë në punë, kanë nevojë për investime. Në disa raste të tjera ata janë dëmtuar plotësisht dhe kanë humbur funksionin si stacione pompimi në skemat ujitëse përkatëse.

Mirëmbajtja dhe menaxhimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit bëhet: (i) nga bordet e kullimit, gjithsejt 16 borde kullimi me financim nga buxheti i shtetit; (ii) nga Shoqatat e Përdoruesve të Ujit - rreth 530 shoqata, dhe; (iii) ose nga Federatat e Ujit - 24 federata.

Nga analiza e situatës rezulton se si pasojë e akumulimeve disa vjeçare të dherave, nga sistemi i ujitjes e kullimit, si pasojë moskryerjes së punimeve të pastrimit, për të stabilizuar funksionimin e sistemit të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja nevojitet ndërhyrje urgjente dhe mbështetje financiare e konsiderueshme.

Urgjent është edhe rehabilitimi i argjinaturave të lumenjve. Rehabilitimi i argjinaturave mbrojtëse nga lumenjtë për mbrojtjen e tokës bujqësore nga gërryerjet dhe përmbytjet që llogaritet në një vlerë rreth 2500 milione lekë vetëm për ndërhyrjet emergjente.

Ka nevojë të dukshme për vazhdimin intensiv të procesit të rehabilitimit të sistemeve të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja deri në arritjen e konsolidimit të menaxhimit të ujitjes nga shpu-të dhe deri sa menaxhimi i sistemeve të kullimit e mbrojtjes nga përmbytja të kryhet nga bordet e kullimit me vetëfinancim. Për këtë duhen bërë edhe ndryshimet përkatëse të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen e kullimin". Kjo e fundit do të rritë përgjegjësinë e përfutuesve dhe do të zbutë ndërhyrjen e shtetit me buxhetin e tij në këtë infrastrukturë.

Siguria ushqimore. Ky kontroll ka për detyrë ruajtjen e territorit të vendit nga hyrja e infeksioneve në kafshë dhe e shëndetit të njerëzve nga sëmundje që rrjedhin nga produkte me origjinë shtazore, kjo nëpërmjet persosjes së procedurave të kontrollit në pikat kufitare të kontrollit veterinar. Shqipëria ka 14 pika të inspektimit veterinar kufitar të produkteve me origjinë shtazore. Në këto pika kufitare kontrollohen të gjitha ngarkesat me produkte shtazore të importuara. Vetëm pas këtij kontrolli në këto pika, të cilat janë barriera e parë e kontrollit veterinar të produkteve me origjinë shtazore, dhe pas kontrollit në doganat e brëndëshme këto produkte qarkullojnë lirshëm në tregun e brëndshëm. Infrastruktura e këtyre pikave të inspektimit le për të dëshiruar. Me përfundimin e projektit CARDS do të përmirësohet infrastruktura e 7 pikave të inspektimit veterinar kufitar. Përmirësimi i infrastrukturës të të gjitha pikave do të forcojë kontrollin veterinar në to.

Inspektoriati veterinar i bashkisë ka brenda juridiksionit të tij kontrollin e tregjeve për kushtet sanitare - veterinare të tregtimit të produkteve me origjinë shtazore. Në dyqane ka një përmirësim të dukshëm të plotësimin të kushteve sanitaro veterinare të tregtimit. Në tregjet masive, megjithëse bashkia ka inspektoriat veterinar Përmanënt, vihet re një nivel jo i kenaqshëm i plotësimin të kushteve sanitaro-veterinare. Me forcimin dhe organizimin e kontrolleve të përbashkëta ka përpjekje për plotësimin e këtyre kushteve.

Megjithatë, kontrolli i produkteve agroushqimore vazhdon të përballet me një sërë problemesh dhe nuk është akoma në efikasitet të plotë. Në inspektoriatet e sigurisë ushqimore në qarqe mungojnë databazat për evidentimin, kontrollin dhe ndjekjen e problemeve të ndryshme, si fallsifikimi, ambalazhimi, tregtimi dhe importimi i produkteve ushqimore si dhe shkëmbimi i informacionit ndërrajonal. Standardet kombëtare të cilësisë dhe sigurisë të produkteve ushqimore nuk janë të harmonizuara me ato të BE-së. Shkalla e implementimit të sistemeve ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë, si HACCP dhe ISO etj., është e pakët.

Shëndeti i kafshëve. Për momentin Shqipëria është e lirë nga infeksioni i aftës epizootike, lija e dhenve, pluropneumoonia kontagjioze e gjedhit, pesta e ruminanteve të vegjel, sëmundja vezikulare e derrave, si dhe ethet afrikane të derrave.

Disa sëmundje të listës së OIE janë prezente dhe shkaktojnë dëme ekonomike të konsiderueshme për blegtorinë e vendit si: Pseudopesti i shpendëve, Murtaja Klasike e Derrave., Anaplazmoza e gjedhit, Babezioza e gjedhit, Plasja, Tuberkulozi i gjedhit, Bruceloza e gjedhit, Bruceloza melitensis, Agalaksia kontagjioze, Varoatoza, etj. Po ashtu, prekmëria e njerëzve nga sëmundje zoonotike ka aritur: salmonelozë afro 400 raste, brucelozë deri 700 raste, leishmanozë afro 100 raste, antraks 60 raste.

Nga rezultatet e gjurmimeve në lidhje me infeksionet e mesipërme të kryera në më shumë se 1/3 e popullimit të kafshëve (të imta për brucelozë, gjedhë për tbc) rezultojnë një përhapje nga 0,64 %-5% për melitensin, dhe 0,19% për sëmundjen e tuberkulozit.

Mbrojtja e bimëve. Aktualisht kontrolli i prodhimeve të fermerëve për eksport mbështetet kryesisht në kontrollin vizual të tyre për të përcaktuar pastërtinë e tyre fitosanitare. Dergesa e tyre për në vendet e tjera, shoqërohet me çertifikate fitosanitare standarte, e njëjtë me atë të BE-së. Aktualisht lidhur me mbrojtjen e bimëve mund të nënvizohen këto çështje ose probleme:

Është vetëm në fillimet e saj puna për krijimin e zonave të mbrojtura si një kërkesë kryesore për sigurimin e një prodhimi brenda standarteve dhe kërkesave të BE-së për eksportin e mundshëm të prodhimeve bujqësore. Kjo ka filluar në zonën e Divjakës për kulturën e patates. Prej vitesh monitorohet situata fitosanitare në kulturat bujqësore dhe për luftimin e parazitëve të veçante (lista e të cilëve miratohet nga ministri) dhe fondi jepet nga buxheti i MBUMK. Përmendim luftimin e karkalecave, të minjve të arave, që kanë qenë dëmtues të rrezikshëm për kulturat bujqësore, si dhe të mizës ullirit, etj. Por, copezimi i sipërfaqes së mbjelljes të kulturave bujqësore shton së tepërmi edhe problematikën e situatës fitosanitare.

Në vendin tonë ekziston një rrjet i gjerë i subjekteve importuese dhe tregtuese të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB). Po kështu, dhe struktura e PMB-ve që janë të miratuara për t'u përdorur, mbulon gjithë aspektet e mbrojtjes së kulturave nga parazitët. Aktualisht, në treg nuk gjenden PMB të skaduara, pasi të gjitha PMB-të gjendje janë asgjësuar që para 6 vjetësh me fondet e dhëna nga BE (Programi PHARE). Problemet të kësaj natyre nuk ka patur gjatë kësaj periudhë pasi subjektet tregtuese, sidomos ata importues janë treguar të kujdesshëm në futjen në treg të PMB-ve.

Aktualisht nuk kryhen analizat cilësore të PMB-ve, për përcaktimin e lëndës vepruese dhe të përmbajtjes së saj në produkt, si dhe të mbetjeve të PMB-ve në bimë, produkte bimëre për arsye të mungesës së infrastrukturës laboratorike.

Shërbimi këshillimor. Sistemi i shërbimi këshillimor aktualisht përbëhet nga një mori ofruesish shërbimesh publike dhe private. Shërbimi publik është forma më e organizuar dhe dominuese e shtrire në të gjithë vendin. Ai është pjesë e strukturave të MBUMK-së në nivel qendror dhe rajonal, i mbështetur edhe nga një rrjet qendrash informacioni. Në shkallë vendi, në këtë shërbim janë të punësuar rreth 245 specialistë bujqësi. Ky shërbim jep asistencë teknike, njohuri dhe informacion për të gjithë fermerët dhe operatorë të tjerë të interesuar në fushën e bujqësisë.

Ndër problemet më të rëndësishme më të cilat përballet shërbimi këshillimor mund të përmendim: (i) numri i kufizuar i ekstensionistëve (mesatarisht një ekstensionist për 2000 fermerë) dhe angazhimi i tyre me detyra të shumta jashtë fushës së tyre; (ii) sigurimi i mbështetjes financiare të nevojshme në formën e investimeve për qendrat e informacionit bujqësor dhe shpenzimeve operative për realizimin e aktiviteteve këshillimore; (iii) mosha mesatare e lartë e ekstensionistëve dhe aftësitë e pakta të tyre në përdorimin e mjeteve kompjuterike dhe teknologjive të informacionit.

Tendenca. Prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e fermës kanë pasur prirje të dukshme në rritje. Prodhimi blegtoral zë rreth 46% të prodhimit të përgjithshëm të sektorit, i ndjekur nga bimët e arave me rreth 44% dhe pentaria me rreth 11%. Ritmet më të larta të rritjes së prodhimit vërehen në pentari.

Gjatë viteve të tranzicionit mund të identifikohen prirje të rëndësishme zhvillimore. Po t'i referohemi vitit 1992 si vit bazë, bazuar në të dhënat dhe studimet e kryera, si dhe në grafikët vijues, disa prej këtyre prirjeve janë:

Rënie e dukshme dhe e vazhdueshme, por graduale, e sipërfaqes së mbjellë me bimë arash, në veçanti me grurë dhe duhan. Kjo për shkak të leverdisë së ulët ekonomike të grurit dhe konkurrencës së jashtme, ndërsa për duhanin edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve përpunuese në vend.

Rritje e vazhdueshme, e dukshme dhe graduale e sipërfaqes së mbjellë me foragjere dhe me patate, rritje dhe pastaj një farë stabilizimi në sipërfaqen e mbjellë me perime. Kjo rritje i

përgjigjet emergjencës dhe pastaj rritjes së kërkesave për produkte blegtorale dhe për perime të freskëta.

Rritje të ndjeshme të sipërfaqeve të serrave për prodhim perimesh, në përgjigje të leverdisë së prodhimit të tyre dhe të deficitit të ndjeshëm të ofertës lokale së perimeve.

Rritje të ndjeshme të rendimenteve në foragjere, patate, qumësht lope e dhie, vezë dhe përgjithësisht në pemëtari dhe vreshta.

Rritje të shpejtë të numrit të drufrutoreve dhe sipërfaqes së mbjellë me vreshta (kjo e fundit sidomos pas vitit 1996). Për nga shpejtësia ky sektor ka realizuar rritjen më të madhe.

Vitet e fundit vihen re prirje të rritjes së numrit të fermave blegtorale të specializuara. Vihet re, gjithashtu, rritje e fermave me viça për majmëri me numër krerësh 5-10, por edhe lopë me 11-50 krerë, të fermave me dhi me numër nga 11-50 dhe dele mbi 500 krerë, çka flet për lindjen dhe përforcimin e prirjeve të specializimit bujqësor. Fermat blegtorale me mbi 5 krerë viça u rriten me gati 50% në vitin 2006 në krahasim me vitin 2004. Gjatë po kësaj periudhë pularitë me gjela deti u rritën me 10%, fermat me mbi 10 zgjoj bletë u rriten me 38%, fermat me mbi 6 krerë lopë u rritën me 22%, fermat me mbi 6 dosa u rritën me 4%, numri i pularive pe mish me mbi 5000 pula u rrit me 18%, ndërsa është pakesuar numri i fermave me gica për majmëri me mbi 50 krerë për gati 60% si dhe është rritur numri i pularive të mëdha me mbi 50 mijë krerë me 50%.

Vihet re kristalizimi i disa poleve të zhvillimit bujqësor, siç janë qarku i Korçës, Beratit dhe Dibrës për pemëtarinë, ai i Fierit për mbarështimin e lopës, Elbasani, Shkodra, Dibra dhe Vlora për të imtat, Shkodra dhe Lezha për derrat, Fieri Tirana dhe Durrësi për perimet, Fieri, Berati, dhe Vlora për rrushin, etj., të cilat flasin për hapa të rëndësishëm në specializimin rajonal në prodhimin e produkteve të ndryshme bujqësore.

Vihet re një tendencë e qartë e rritjes së eksporteve, por ato dominohen nga produktet e Përpunuara. Eksportet nga bujqësia kanë një prirje të lehtë rritjeje, që dominohet nga perimet, megjithatë bëhet fjalë për vëllime të kufizuara eksportesh. Produktet me origjinë nga blegtoria janë më pak të eksportuarat, bile ka një tendencë të paqartë që me shumë anon nga rënia e eksporteve me origjinë këtë degë të bujqësisë.

Produktet organike. Kohët e fundit vihet re një forcim i dukshëm i praktikave të bujqësisë organike. Sot janë 93 ferma organike, ndërsa sipërfaqja e çertifikuar për produkte organike është 1074 ha¹. Pjesa më e madhe e fermave dhe e sipërfaqes është e çertifikuar nga SHBO, ALBINSPEKT, ose trupa të huaja. Produktet kryesore organike janë bimët mjekësore, vaji i ullirit, frutat dhe rrushi, perimet dhe qumështi, disa prej të cilëve janë eksportuar edhe në vende të tjera si Zvicër, Hollandë, etj. Gjithashtu prodhohen sasi më të vogla vezësh, djathi, vere dhe mishi.

Financimet për bujqësinë. Pas një trendi pozitiv deri në vitin 2004, fondet për bujqësinë kanë ardhur në ulje, me uljen më të madhe të regjistruar në vitin 2005.

Ulja e investimeve, megjithë rritjen e lehtë të shpenzimeve, është një paralajmerim serioz për të ardhmen e mbështetjes financiare të bujqësisë. Këmbanat po bien fort dhe është mirë të merren masa sa më parë.

Në vazhdimësi, kontributi shtetëror për bujqësinë ka qenë mjaft i kufizuar, ai është sjellur në rreth 1-1.5% të buxhetit, dhe akoma më pak në raport me PBB. Përgjithësisht, investimet në bujqësi janë mbështetur me hua dhe grante të huaja. Siç e tregon edhe tabela e mëposhtme, komponenti i investimeve të brendshme nuk ka një prirje të qartë në rritje, ato paraqiten në nivele disi të stabilizuara, kurse investimet e huaja janë ato që paraqesin një dinamikë të paqartë dhe të pasigurtë, për të ardhur në një rënie të ndjeshme, gati përgjysmim, në vitin 2005.

Nëse do të bënim një analizë më të hollesishme, mund të identifikohet lehtë se investimet më të mëdha kanë shkuar dhe shkojnë në rehabilitimin ujitjes dhe të kullimit, pasuar nga investimet për tokën dhe shërbimet bujqësore.

Investimet private. Bujqësia dhe agro-industria, edhe pse degë të rëndësishme dhe me potencial të madh, sipas vlerësimeve më të fundit, duket se ende nuk janë në gjendje të bëjnë

¹ Po te përfshijme këtu edhe masivet me geshtenja, sipërfaqet me bime mjekësore dhe me kerpudha, atehere sipërfaqja totale arrin pothuaj ne 3000 ha.

investime private në shkallë të madhe. Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, investimet në të gjitha format private, publike dhe ato nëpërmjet kredive bankare duket se nuk arrijnë të kalojnë kufirin 0.3 për qind ndaj PBB-së

Pas një rritjeje të dukshme në raport me vitin 2000, niveli i investimeve në industrinë agropërpunuese është në nivele pak a shumë të stabilizuara.

Financat rurale. Krahas këtyre, mbështetje financiare për fermerët dhe bujqësinë ofrojnë edhe një numër agjencish dhe institucionesh të finances rurale. Financat rurale në Shqipëri, veçanërisht ato në mbështetje të fermerëve, aktualisht dhe në një të shkuar jo shumë të largët, mund të shihen përmes kontributeve të disa aktorëve, projekteve ose agjencive: Fondi i Financimit të Zonave Malore, Programi i Zhvillimit të Zonave Malore, projekti 2KR, Projekti i Shërbimeve Bujqësore, projekti Mbështetje për Prodhimin Bujqësor (FAO), projekti SBCA (USAID, mbyllur), Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit (USHKK), një numër projektesh ta pavarura të shoqatave të ndryshme ndërkombëtare, sistemit bankar dhe vetë fermerët. Mbështetja kumulative e tyre ka qënë e konsiderueshme, por gjithësesi e pamjaftueshme. Ata kanë mbështetur fermerë individuale, shoqata fermerësh, agrobiznese të ndryshme, me grante, hua dhe kredi për teknologji, farëra dhe fidana, raca, marketing, njohuri dhe asistencë teknike. Aktualisht janë me aktive Fondi i Financimit të Zonave Malore, Programi i Zhvillimit të Zonave Malore dhe USHKK. Nuk ka të dhëna të sakta se sa mund të jetë numri i përfituesve, por ata janë disa mijra.

Në të ardhmen pritet të injektohen me shumë financa në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit. Përveç dy projekteve në vazhdim, forcimi dhe shtrirja më e gjerë rajonale e USHKK mbetet si alternativë kryesore. Krahas kësaj sistemi bankar do të duhet të luajë me shumë rol, por për këtë duhet të nxitet tregu i tokës dhe kooperimi midis fermerëve, mbasi rreziku për moskthimin e kredive nga fermerët është i lartë dhe kostoja e transaksioneve të kredive për shkak të numrit të madh të fermerëve do të ishte e madhe dhe frenuese.

Eksperiencat e huaja (Gramen Bank-Bangladesh, Rumania, etj.) mund të jenë të vlefshme edhe për forcimin e sistemit të financave rurale të Shqipërisë.

Politikat për bujqësinë. Gjatë periudhës së kaluar e deri më sot, politika për bujqësinë mund të cilësohet si një mbështetje kryesisht indirekte dhe është fokusuar në këto aspekte kryesore: **rehabilitimi i infrastrukturave, krijimi i një mjedisi pro-biznes, mbështetja e shërbimeve ndaj fermerëve dhe forcimi institucional.**

Anë pozitive dhe negative, mundësi dhe rreziqe për bujqësinë shqiptare. Koha ka dëshmuar dhe studimet tashmë kanë evidentuar se sektori bujqësor dhe agropërpunës aktualisht karakterizohet nga disa tipare mjaft pozitive, që përbëjnë njëkohësisht anet e forta të tij. Këto anë janë themelore për tu marre parasysh në aktivitetet programuese zhvilluese, por edhe për të justifikuar atë optimizëm dinamik që mbështet progresin e sigurtë të bujqësisë shqiptare. Më kryesoret e këtyre anëve janë:

Bujqësia dhe agropërpunimi janë thujt një *sektor tërësisht privat*; Shqipëria ka kushte klimatike, mikroklimatike dhe tokësore të përshtatshme, resurse biologjike të pasura dhe të larmishme; vendi ynë ka një *traditë bujqësore të vjetër dhe me vlerë*; vendi ynë ka një *popullsi bujqësore të edukuar relativisht mirë*, gjë që premt për efektivitet dhe produktivitet të kënaqshëm në bujqësi, bujqësia jonë ka pasur një *mbështetje të konsiderueshme teknike dhe financiare* përgjatë tranzicionit të saj të vështirë, e cila jo vetëm ka zgjidhur probleme dhe situata të vështira, por ka krijuar edhe premisa të reja për zhvillime më efektive dhe më të qendrueshme.

Disa dobësi të sektorit janë: *ferma e vogël dhe e fragmentuar, një numër shumë i madh fermash dhe një popullsi e madhe bujqësore, brez i ri jo sa duhet i apasionuar pas bujqësisë*, mund të krijojë probleme të trashëgimisë së traditës, *diversifikimi i lartë i prodhimit në fermë, mungesa e ndjeshme e mbështetjes financiare shtetërore të drejtpërdrejtë.*

Sektori ka mundësi të përfitojë nga programi i qeverisë për rruget rurale, me efekte të ndjeshme në marketingun e produkteve, nga investimet mëdha rehabilituese të ujitjes dhe kullimit, nga potenciali i pashfrytëzuar i agropërpunimit (veçanërisht në zonat rurale), nga mbështetja për nxitjen e bashkëveprimit reciprok të fermerëve, nga investimet e kryera dhe ato

të programuara për tregjet me shumice dhe tregjet rurale, nga asistenca shtetërore këshilluese dhe orientuese dhe nga aktivitetet kontrolluese dhe çertifikuese të shtetit.

Në mënyrë të veçantë, sektori i bujqësisë ka mundësi të mëdha të përfitojë një mbështetje të madhe zhvilluese nga procesi i integritit evropian, kryesisht programi IPA.

Njëkohësisht, ka një sërë rreziqesh kërcënojnë që zhvillimet në sektorin bujqësor dhe atë agropërpunues të jenë më të ngadalta ose më të pasigurta: zvarritja e konflikteve pronësore dhe e kompensimit të ish-pronarëve, shterrja e projekteve dhe programeve të huaja për bujqësinë dhe ushqimin, mos kryerja në kohë e përputhjes së legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*, mos stafimi dhe rekrutimi i nënpunësve të rinj në moshë, të shkolluar së fundmi, sipas procedurave dhe rregullave plotësisht korrekte, si dhe mostrajtimi i bujqësisë si sektor prioritar. Kjo do të bënte që mbështetja shtetërore financiare për bujqësinë të ishte nën nivelin e kërkuar.

Vizioni, prioritetet dhe qëllimet strategjike

Vizioni. Sektori bujqësor dhe ai i agropërpunimit duhet të arrijnë një nivel më të lartë prodhueshmërie dhe konkurrueshmërie, si në tregun vendas edhe në atë ndërkombëtar, mbi bazën e përmirësimit të kushteve për veprimin e iniciativës private por edhe të një mbështetjeje zhvilluese më të plotë, në një mënyrë të qëndrueshme, që të garantohet nga institucione efçente.

Vizioni strategjik i SSBU e sheh zhvillimin bujqësor dhe agroindustrial nën prizmin e integritit evropian.

Prioritetet strategjike. SSBU ka këto prioritet:

- i. Të rritet mbështetja financiare për fermat, bizneset bujqësore dhe ato agropërpunuese
- ii. Të përmirësohet menaxhimi, ujitja dhe kullimi i tokës bujqësore
- iii. Të përmirësohet marketingu i produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara
- iv. Të rritet niveli dhe cilësia e teknologjive, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe agropërpunuesve
- v. Të rritet cilësia dhe siguria ushqimore e produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara

Sektorët strategjikë. SSBU ka këto sektorë prioritarë:

1. Prodhimi i pemëve frutore, ullirit dhe rrushit
2. Prodhimi perimeve
3. Prodhimi i produktet blegtorale
4. Përpunimi industrial i frutave dhe perimeve
5. Përpunimi industrial i rrushit
6. Përpunimi industrial i qumështit dhe mishit

Qëllimi kryesor i SSBU është: Të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit.

Zhvillimi i qëndrueshëm garanton përmbushjen e kërkesave ushqimore të brezit aktual pa rrezikuar brezat që do të vijnë, punësim të qëndrueshëm, të ardhura të mjaftueshme, jetesë të denje dhe kushte të përshtatshme punë për fermerët. Ai garanton ruajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese të burimeve natyrore, pa prishur ciklet ekologjike dhe ekuilibrat natyrorë, pa prishur zakonet social-kulturore të bashkësive rurale dhe pa ndotur mjedisin, si dhe redukton prekmërinë e sektorit bujqësor nga faktorët natyrorë dhe social ekonomikë.

Zhvillimi i qëndrueshëm siguron harmoni midis tre aspekte themelore: aspektit ekonomik të zhvillimit, aspektit social dhe atij mjedisor.

Qëllimet strategjike të SSBU janë:

1. Menaxhimi i qendrueshëm i tokës, si komponenti bazë i zhvillimit të qendrueshëm bujqësor, dhe në harmoni të plotë me të
2. Rritja e punëzënies, të ardhurave dhe nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre
3. Rritja e efikasitetit ekonomik të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues, e cila shprehet përmes rritjes së prodhueshmërisë dhe cilësisë së produkteve të tyre
4. Garantimi i një standarti të sigurisë ushqimore (food safety) më të lartë për të gjithë popullsinë
5. Përmirësimi i marketingut agrar

SSBU është në koherencë të plotë me **Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)**. Lidhja midis SSBU dhe OZHM-ve realizohet veçanërisht përmes dy prej OZHM-ve, objektivit 1 dhe objektivit 7, si dhe politikave përkatëse.

Politikat

Koncepti ynë politik. Strategjia dhe zhvillimi i bujqësisë ka nevojë për një bazë të qartë konceptuale politike. Ndonëse në planet strategjike (shumëvjeçare) dhe ato korrente (njëvjeçare) është përvijuar mjaft mirë mënyra, prioritetet dhe fushat e ndërhyrjes përmes politikave të ndryshme, publike ose private, në bujqësi është i nevojshëm një riformulim më i qartë dhe më i sistemuar konceptit mbi politikën bujqësore që duhet të zbatohet në Shqipëri.

Koncepti i ri mbi politikën bujqësore do të konsistojë në këto parime të rëndësishme:

- Rritjen e karakterit pjesëmarrës ose gjithëpërfshirës të procesit politik në tërë gjatësinë e ciklit të politikave: identifikim, hartim, miratim, zbatim, monitorim dhe vlerësim.
- Sigurimin e vazhdimësisë së ciklit të politikave, duke evituar pauzat dhe frakturat, për të siguruar vazhdimësi të mbështetjes së bujqësisë.
- Fokus më i madh në mbështetjen direkte, për të bërë të mundur „goditjen“ në pikat me kritike, në faktorët e drejtpërdrejtë, si për shëmbull teknologjia, të rritjes së prodhimit bujqësor dhe të cilësisë së tij.
- Kalimi në fazën e monitorimit dhe vlerësimit të detyruar dhe të standartizuar të efekteve të politikave dhe programeve, si kusht jo vetëm për të rritur angazhimin menaxherial, por edhe për të siguruar efektivitet të qendrueshëm të masave zhvilluese.
- Arritjet ose efektet e politikave të zhvillimit duhet të maten kundrejt indikatorëve të formuluar në mënyrë SMART.
- Fokusim më i plotë i vemendjes në politikat *për nga kërkesa*, ose politikat tregtare bujqësore. Në të ardhmen politikat që synojnë të menaxhojnë kërkesën konsumatorë do të duhet të zenë një vend të veçantë, nisur nga efektiviteti që kanë treguar ato në vende të tjera, por edhe tek ne.
- Integrimi i **Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)**, për të cilat është dakortësuar zyrtarisht edhe Shqipëria, në mënyrë të veçante objektivi për reduktimin e varfërisë. Ky objektivi megjithëse nuk del në mënyrë eksplicite, reflektohet në mënyrë implicite në parimet e mesipërme të politikës së re bujqësore dhe synohet të arrihet përmes rritjes së prodhimit dhe punëzënies në zonat rurale.

Ky riformulim, i bërë dhe pranuar kështu në mënyrë eksplicite, do të ishte kusht me rëndësi që strategjia e bujqësisë të ishte koherente, objektive dhe të kishte efekte të prekshme mbi rezultatet e zhvillimit të bujqësisë dhe ushqimit.

Në fund të fundit dhe në mënyrë të përmbledhur, objektivat qendrorë të SSBU do të ishin **rritja e prodhimit bujqësor dhe agrorshqimor dhe përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore**.

Nga pritet të vijë rritja e prodhimit. Rritja e prodhimit bujqësor do të vijë nga shtimi i sipërfaqes së tokës nën kulturë, duke mbjellë tokat e lëna djerrë, dhe nga rritja e produktivitetit të bimëve dhe kafshëve. Produktiviteti do të rritet nga përmirësimi i ujitjes së tokës, i teknologjive bujqësore (përfshirë inputet), dhe njohurive e aftësive bujqësore. Përmirësimi i ujitjes dhe teknologjive kërkon investime shtesë, por edhe rregulla të përmirësuar

dhe kapacitete për t'i bërë dhe zbatuar ato, ndërsa përmirësimi i njohurive dhe aftësive bujqësore kërkon edhe shpenzime shtesë, kapacitete dhe politika adekuatë.

Kështu, jo vetëm investimet por edhe asistencë teknike dhe këshillimi do të jenë dy nga shtyllat më të rëndësishme për të zhvilluar bujqësinë. Në funksion të implementimit të politikave të mësipërme për arritjen e objektivave strategjike, do të jetë e nevojshme të tentohen ose të përdoren një numër i madh edhe i larmishëm instrumentash politikë. Ndarja e tyre konkrete, në formë të grupuar sipas këtyre dy akteve, do të jenë :

Politika që lidhen kryesisht me investime në bujqësi ose agropërpunim :

- Pagesa direkte ose skemat e kredive për investime në teknologji prodhuese
- Pagesa direkte ose skemat e granteve për inpute ose agropërpunim
- Subvencioni i normës së interesit (ose garantimi) të kredive bankare private
- Pagesa direkte për nxitjen dhe mbështetja e iniciativave lokale

Politika që lidhen kryesisht me këshillimin dhe asistencën teknike ndaj fermerëve:

- Hartimi i platformave për inovacionin rural në shkallë zonale
- Partnershipet paralele (shoqatat apo grupet e prodhuesve ose të marketingut të fermerëve, grupet e veprimt lokal)
- Krijimi i partnershipeve vertikale (fermerë dhe tregtarë, ose agropërpunues, që kooperojnë në skema të përbashkëta të shitblerjes së inputeve, prodhimit dhe shitjes së produkteve)
- Vendosja e rregullave dhe forcimi i monitorimit për eliminimin e sindromave monopoliste potenciale në tregun e inputeve
- Lehtësimi i licencimit dhe barrës tatimore të tregtareve të produkteve për të shtuar konkurrencën në treg
- Ngritja e shkollave fushore të fermerëve
- Përmirësimi i teknikave dhe aftësive bujqësore
- Forcimi i kapaciteteve të monitorimit të cilësisë së farërave dhe fidanave
- Shkëmbimi i përvojave lokale në teknologji të prodhimit, tregtim dhe në organizimin e shoqatave
- Përmirësimi i sistemit NJIF² në zona të ndryshme në shkallë vendi
- Nxitja e lobingjeve të fermerëve në shkallë zonash e në shkallë vendi
- Diskutime në grup për identifikimin e rrugëve për nxitjen e agroturizmit dhe produkteve organike
- Futja e praktikave të mira bujqësore
- Studime tregu për identifikimin e tregjeve *niche*
- Asistencë teknike dhe/ose financiare për aktivitetet e shtimit të vlerës së produkteve të fermerit
- Fushata sensibilizuese
- Vendosja e standarteve për produktet bujqësore
- Përmirësimet e aktiviteteve të mbledhjes, shpërndarjes, përdorimit dhe publikimit të informacionit statistikor
- Përmirësimet e procedurave të planifikimit, monitorimit, vlerësimit dhe publikimit të rezultateve të tyre
- Përmirësimet ligjore dhe përputhja e legjislacionit shqiptar me atë të BE
- Përmirësimi i i sistemit të informacionit të tregut

Përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore do të varet nga shkalla e përmirësimit të nivelit të teknologjive të prodhimit dhe marketingut, përmirësimet e legjislacionit të sigurisë dhe shkalla e zbatimit të tij, qasjet e garantimit të sigurisë ushqimore dhe eficientia e kapaciteteve të monitorimit.

² Njohuri dhe informacion bujqësor

Për të realizuar standarte të përmirësuara të sigurisë ushqimore përgjithësisht do të duhet:

- Efektivitet në përjasjen e legjislacionit shqiptar me atë të BE, duke përfshirë edhe sistemet e garantimit të sigurisë.
- Përmirësim të burimeve njerëzore që menaxhojnë problemet e sigurisë
- Përmirësim të laboratorëve dhe të bazës laboratorike të sigurisë ushqimore

Përjasjet politike që do të implementohen në funksion të realizimit të objektivave të SSBU do të jenë:

- Mbështetja financiare publike direkte dhe indirekte
- Nxitja e burimeve të brendshme
- Të mësuarit dhe rrjetëzimi (angl.: learning and linking)
- Pjesëmarrja dhe dialogu i përfituesve dhe aktorëve
- Fuqizim i përfituesve nga programet
- Krijimi i një mjedisi konkurrues
- Nxitja e kooperimit

Produktet e pritshme dhe politikat sipas objektivave. Rezultatet ose produktet e pritshme për arritjen e çdo qëllimi, si dhe politikat përkatëse janë si më poshtë. Në përputhje me qëllimet e strategjisë dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj, politikat kryesore që do të siguronin arritjen e këtyre rezultateve dhe të vetë qëllimeve do të ishin:

Objektivi 1-Menaxhimi i qendrueshëm i tokës, si komponenti bazë i zhvillimit të qendrueshëm bujqësor, dhe në harmoni të plotë me të.

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

1. Kompletohet reforma e tokës
2. Ndalet dëmtimi dhe kufizohet tjetërsimi fizik i tokës
3. Përmirësohet menaxhimi i tokës
4. Përmirësohet vaditja, kullimi dhe mbrojtja e tokës nga përmytja

Politikat

Afatshkurtër (2008) e në vazhdimësi

- Përmirësime ligjore në drejtim të përdorimit dhe transferimit të tokës, duke përfshirë edhe politika fiskale adekuate
- Trainime për forcimin organizativ dhe institucional të shoqatave të ujitjes
- Forcimi institucional për menaxhimin e tokës (Inspektoriati i tokës, etj.)
- Ekstension për të përmirësuar menaxhimin e integruar të tokës
- Rehabilitim i ujitjes dhe kullimit, me fonde publike ose duke nxitur sektorin privat

Afatmesme (2009-2010) e në vazhdimësi

- Mobilizimi dhe ndërgjegjesimi i aktorëve të zhvillimit bujqësor për përmirësimin e menaxhimit të tokës bujqësore
- Sistem informimi për përdorimin e tokës
- Ekstension për të përmirësuar menaxhimin e integruar të tokës
- Rehabilitim i ujitjes dhe kullimit, me fonde publike ose duke nxitur sektorin privat
- Trainime për forcimin organizativ dhe institucional të shoqatave të ujitjes

Afatgjatë: (2011-2013)

- Rehabilitim i ujitjes dhe kullimit, me fonde publike ose duke nxitur sektorin privat
- Forcimi i rolit të pushtetit vendor në drejtim të ujitjes dhe kullimit
- Ekstension për të përmirësuar menaxhimin e integruar të tokës

- Trainime për forcimin organizativ dhe institucional të shoqatave të ujitjes

Objektivi 2-Rritja e punëzënies, të ardhurave dhe nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

1. Rritet punëzënia në fermë
2. Rriten të ardhurat në fermë
3. Përmirësohet niveli i jetesës së fermerëve

Politikat

(Afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë)

- Ekstension për transferim teknologjish, njohurish, aftësish dhe përvojash
- Kredi ose grante për fermerët
- Përmirësimi i përpunimit të produkteve në nivel ferme
- Përmirësimi i magazinimit të produkteve në nivel ferme
- Përmirësimi i operacioneve të pasvjeljes në nivel ferme
- Nxitja e aktiviteteve agroturistike dhe e diversifikimit në fermë, në përgjithësi

Objektivi 3-Rritja e efencës ekonomike të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues, e cila shprehet kryesisht Përmes rritjes së prodhueshmërisë dhe cilësisë së produkteve të tyre

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

1. Rriten rendimentet e kulturave dhe kafshëve prioritare
2. Ulet kostoja për njësi prodhimi në kulturat dhe kafshët prioritare
3. Rritet marzhi i fermerit (%)

(Afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë)

- Hartimi dhe zbatimi i projekteve specifike për shtimin e prodhimit, të përdorimit dhe cilësisë së inputeve bujqësore
- Investime në agropërpunim
- Ekstension bujqësor për teknologjitë, teknikat dhe metodat e reja, për shtimin e njohurive dhe aftësive bujqësore tek fermerët

Objektivi 4- Garantimi i një standarti të sigurisë ushqimore (food safety) më të lartë për të gjithë popullsinë

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

- 1-Përmirësohet legjislacioni i kontrollit
- 2-Forcohen institucionet e kontrollit
- 3-Përmirësohen teknologjite e prodhimit
- 4-Përmirësohen praktikat prodhuese dhe tregtare
- 5-Rritet cilësia e inputeve dhe lëndëve të para
- 6-Përmirësohet mbarështimi i kafshëve të prodhimit

Politikat

Afatshkurtër
(2008) e në vazhdimësi

- Përmirësime në labororet dhe instrumentat e kontrollit

- Përmirësime dhe forcim i sistemit të agjencive dhe organeve të kontrollit
- Nxitet përmirësimi i sistemeve dhe metodave të sigurisë ushqimore
- Ekstension për praktikën e mira bujqësore dhe tregtare
- Fushata sensibilizuese për sigurinë ushqimore
- Matrikullim i kafshëve bujqësore
- Ndërtim therrtoresh

Afatmesme (2009-2010) e në vazhdimësi

- Përmirësime në laboratorët dhe instrumentat e kontrollit
- Përmirësime dhe forcim i sistemit të agjencive dhe organeve të kontrollit
- Nxitet përmirësimi i sistemeve dhe metodave të sigurisë ushqimore
- Ekstension për praktikën e mira bujqësore dhe tregtare
- Fushata sensibilizuese për sigurinë ushqimore
- Matrikullimi i kafshëve bujqësore

Afatgjatë: (2011-2013)

- Përmirësime në laboratorët dhe instrumentat e kontrollit
- Përmirësime dhe forcim i sistemit të agjencive dhe organeve të kontrollit
- Nxitet përmirësimi i sistemeve dhe metodave të sigurisë ushqimore
- Ekstension për praktikën e mira bujqësore dhe tregtare
- Fushata sensibilizuese për sigurinë ushqimore

Objektivi 5-Përmirësimi i marketingut agrar

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

1. Përmirësimi i infrastrukturës tregtare
2. Rritja e fuqisë negociuese të fermerëve
3. Përmirësimi i monitorimit dhe analizës së tregjeve

Politikat:

Afatshkurtër (2008) e në vazhdimësi

- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të besueshëm, në vendin dhe kohën e duhur
- Ndërtimi i tregjeve të reja me shumice dhe pikave të reja të grumbullimit
- Promovimi i shoqatave dhe partnershipeve paralele dhe vertikale
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes
- Nxitja e lobingut për politikën tregtare të grupeve të fermerëve
- Lehtësi fiskale për agrobizneset që vendosen në zonat rurale
- Fuqizimi i strukturave publike të monitorimit dhe analizës së tregjeve
- Nxitja e praktikave të mira tregtare që rrisin cilësinë e produkteve

Afatmesme : (2009-2010) e në vazhdimësi

- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të besueshëm, në vendin dhe kohën e duhur
- Promovimi i shoqatave dhe partnershipeve paralele dhe vertikale
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes
- Nxitja e lobingut për politikën tregtare të grupeve të fermerëve
- Nxitja e praktikave të mira tregtare që rrisin cilësinë e produkteve

Afatgjatë: (2011-2013)

- Prodhimi dhe shpërndarja e informacionit të besueshëm, në vendin dhe kohën e duhur

- Promovimi i shoqatave dhe partnershipeve paralele dhe vertikale
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes
- Nxitja e lobingut për politikat tregtare të grupeve të fermerëve
- Ndërtimi i tregjeve të fermerëve
- Nxitja e praktikave të mira tregtare që rrisin cilësinë e produkteve

Politika të tjera të rëndësishme janë forcimi i kapaciteteve administrative të MBUMK dhe agjencive të saj, që të jenë të afta të menaxhojnë efektivisht sektorin e bujqësisë dhe agropërpunimit. Kjo përfshin përmirësimin e kapaciteteve planifikuese, implementuese, monitoruese dhe analizuese të MBUMK dhe agjencive në vartësi të saj, por edhe aftësimin për menaxhimin efektiv të MSA dhe, në përgjithësi, të procesit të integritimit me BE.

Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese

Indikatorët e SSBU. Indikatorët bazë të vlerësimit të arritjes së rezultateve nga politikat e parashikuara janë si në tabelën që vijon. Për të reduktuar ndjeshëm varfërinë dhe rritur mirëqënien do të duhen norma të larta rritjeje të prodhimit bujqësor.

Nr	Indikatorët	Njesia e Matjes	2006	2013
1	Produktiviteti në agropërpunim	000 lekë/1 të punësuar	4800	6000
2	Produktiviteti në bujqësi	000 lekë/1 të punësuar	2250	3200
3	Pjesa e produkteve të shitura	%	35	60

Rrjedhojat për burimet

Kostimi i SSBU është bërë duke u bazuar në tavanet e PBA për periudhën 2008-2010, me një rritje vjetore 4-5% në vit për vitet e tjera. Rritja e investimeve për bujqësinë do të vijë kryesisht nga identifikimi i projekteve të reja, nga fondet e IPARD, pjesërisht edhe direkt nga buxheti i qeverisë shqiptare.

Tabela e mëposhtme tregon koston indikative të SSBU sipas viteve:

Tabela 10: Buxheti i SSBU (mld leke)

Emërtimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kosto (mld leke)	5.80	4.70	5.00	5.3	5.6	5.85

Çështje kritike të lidhura me buxhetin e bujqësisë

Pavarësisht nga llogaritjet, realizimi i parashikimeve të strategjisë në nivele të kënaqshme, do të varet nga menaxhimi i disa çështjeve kyç, që mendohet të jenë çështje kritike të strategjisë. Midis tyre përmendim:

- Identifikimi dhe sigurimi i projekteve të reja
- Mbështetja financiare për bujqësinë
- Progresi për MSA (lidhet me financimet në kuadrin e IPA-s)
- Monitorimi dhe vlerësimi (efektiviteti i projekteve)
- Sigurimi i një procesi pjesëmarrës në tërë gjatësinë e ciklit të politikave
- Ristrukturimi dhe konsolidimi administrativ do të jetë një nga çështjet më kritike, sepse cilësia e burimeve njerëzore dhe e strukturave implementuese do të jetë e rëndësishme për arritjen e objektivave të politikës.

Kontributet financiare për bujqësinë dhe ushqimin pritet që të jenë më të gjera se sa parashikohen vetëm në buxhetin publik bujqësor.

Qëllimet e strategjisë

Në kuadrin e **Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)**, në Shqipëri është duke u hartuar **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)**. Kjo strategji do të jetë një reflektim koherent i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Një nga dokumentat më të rëndësishëm strategjikë në këtë kuadër është edhe **Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU)**.

Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit mbështetet në:

- Programin e qeverisë për zhvillimin ekonomik të vendit dhe në veçanti për zhvillimin e bujqësisë dhe ushqimit.
- Përpjekjet për integrimin evropian dhe euroatlantik, që do të thotë zbatimin e Marrëveshjes së Përkohshme (MP), marrëveshjes së stabilizim asociimit (MSA) dhe planit të anëtarësimit në NATO
- Programin e Investimeve Publike (PIP) dhe asistencën e huaj

Përveç kontributit për SKZHI-në, strategjia sektoriale ka për qëllim të vendosë lidhjen midis objektivave strategjike, me një perspektivë shtatë vjeçare, dhe programeve të shpenzimeve të hartuara në kuadrin e PBA-së.

Qëllimet e tjera të strategjisë janë:

- Të sigurojë koherencën e politikave dhe sensin e orientimit afatgjatë të zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe ushqimit
- Të krijojë qartësi në lidhje me reformat dhe proceset e zhvillimit që ndodhin në sektorin publik e privat.
- Tu paraprijë nevojave për mbështetje teknike dhe financiare të bujqësisë

Procesi i hartimit të strategjisë

SSBU u konceptua si një projekt profesional

Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit u hartua nga një grup teknik me bazë të lartë profesionale, i përbërë nga specialistë të njohur të fushave të ndryshme, si të ekonomisë, bujqësisë, agropërpunimit, veterinarisë, mbrojtjes së bimëve, etj. Përfshitja e tyre efektive dhe në mënyrë institucionale në procesin teknik të hartimit të SSBU ishte premisë e rëndësishme për një produkt me nivel të lartë shkencor.

SSBU u konceptua dhe u realizua si një proces demokratik

Drafti i strategjisë iu nënshtrua një procesi të gjerë këshillimi. Për këtë qëllim, u ngrit dhe funksionoi një grup këshillimor për strategjinë, i përbërë nga profesionistë të shquar dhe me përvojë nga terreni dhe nga fusha e drejtimit të problemeve të bujqësisë, me përfaqësues nga biznesi bujqësor dhe agroushqimor, organizatat dhe grupet e ndryshme të interesit. Këshillimi me këtë grup siguroi përfshirjen në strategji të ideve dhe këndvështrimeve realiste të problematikave dhe nevojave për politika zhvilluese efektive.

Përveç këtij procesi të vazhdueshëm këshillimi, drafti i SSBU iu nënshtrua edhe një procesi të gjerë konsultimi dhe përmirësimi demokratik. Ai u konsultua me aktorët rajonale të zhvillimit bujqësor dhe rural, si përfaqëues të biznesit, të fermerëve dhe shoqatave të tyre, të rrjeteve lokale të organizatave jofitimprurese, të universiteteve dhe agjencive të huaja të zhvillimit. SSBU u konsultua në mënyrë të veçantë me shoqërinë civile edhe në nivel qendror. Konsultimi me donatorët ishte hapi i fundit i konsultimit të SSBU, prej nga rezultuan ide dhe sugjerime të vlefshme për përmirësimin e mëtejshëm të draftit. Në mbështetje të zbatimit të strategjisë u realizuan një numër koncept-projektësh, të cilat iu paraqiten donatorëve dhe qeverisë shqiptare për shqyrtim dhe finalizim të mëtejshëm.

SSBU u konceptua dhe u realizua si një proces transparent

Hartimi i strategjisë nuk ishte aspak një proces i mbyllur. Gjatë procesit drafti i strategjisë qendroi i shpallur në internet për publikun e interesuar. Gjatë fazës së hartimit dhe diskutimeve drafti u bë i njohur dhe iu shpërnda një numri të madh specialistësh dhe personalitetesh të fushës, për komente dhe kontribute shtesë. Përgjatë diskutimit, u organizua edhe një debat “elektronik” përmes internetit, për çështje të veçanta dhe kritike për zhvillimin e bujqësisë dhe ushqimit, si ceshtja e mbështetjes më të mirë financiare të tyre, konceptimi i projekteve për zhvillimin e tyre në të ardhmen, etj. Të gjitha jo vetëm e bënë me transparent procesin e hartimit të strategjisë, por kontribuan edhe për përmirësimin e mëtejshëm të draftit të strategjisë.

SSBU u konceptua dhe u realizua si një proces ekstra-politik

Një nga aspektet më të rëndësishme të procesit të hartimit të SSBU ishte edhe karakteri jo-politik i tij. Kjo u konsiderua si një çështje kyce, në mënyrë që SSBU të ishte produkt i kontributeve dhe këndvështrimeve politike sa më të gjera e të ndryshme. Kjo u bë e mundur përmes fteses për t’ju bashkangjitur procesit edhe një numër eksponentësh të njohur të politikës bujqësore me prirje politike opozitare. Përmes angazhimit serioz të këtyre specialistëve dhe profesionistëve, baza e strategjisë u zgjerua dhe u konsolidua më tej. Ajo u bë më e qendrueshme dhe, për pasojë, më efektive.

SSBU ka si pronar të gjithë aktorët kryesorë të zhvillimit

I gjithë procesi i hartimit të SSBU, në konceptin dhe realizimin e tij, beri të mundur synimin tonë themelor, që të realizojmë një produkt që nuk ka pronar vetëm Ministrisë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, por të gjithë aktorët e zhvillimit bujqësor dhe agroindustrial duke filluar nga fermerët, agrobiznesi, shoqëria civile, agjencitë dhe grupet e ndryshme të interesit. Prandaj kemi besim se kemi në dorë një produkt strategjik që do t’i shërbejë zhvillimit të shpejtë dhe të qendrueshëm të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues.

SSBU është një produkt shqiptar

Strategjia është realizuar nga profesionistë shqiptarë, prandaj ajo është një produkt kryesisht shqiptar. Megjithatë, aty është përfshirë edhe kontributi i ekspertëve të huaj. Kjo është bërë qoftë në mënyrë direkte, përmes komenteve të bëra nga disa ekspertë të njohur të fushës së zhvillimit rural dhe bujqësisë, qoftë indirekt përmes konsultimit të një numri të madh dokumentesh, studimesh dhe analizash të kryera nga ekspertë të huaj, posaçërisht ose jo, për politikat e zhvillimit bujqësor e më gjerë në Shqipëri.

SSBU ka frymëmarrje ndërsektoriale

Strategjia nuk ishte një proces i mbyllur. Duke e parë atë si një pjesë integrale të një dokumenti më të gjerë strategjik, (SKZHI), si dhe duke pasur parasysh lidhjet e ndërsjella të sektorit të

bujqësisë dhe ushqimit me sektorë të tjerë të zhvillimit ekonomiko-social në vend, SSBU ka pika kontakti të rëndësishme me Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural, me Strategjinë e Zhvillimit Rajonal, atë të arsimit, të turizmit, mjedisit, etj. Kjo frymëmarrje ka lejuar që një sërë çështjesh dhe objektivash të zhvillimit bujqësor të trajtohen dhe formulohen në lidhje të ngushtë me çështjet afine dhe objektivat përkatës në strategjitë e tjera, si dhe ka rritur koherencën dhe integritetin e SSBU.

SSBU dhe Politika e Përbashkët Europiane (PBE)

SSBU është e lidhur me PBE, ose Politikën e Përbashkët Europiane. Politika e re europiane për bujqësinë përfshihet në kuadrin e zhvillimit rural.

Zhvillimi rural në BE përfshin katër boshte që janë:

Boshti 1: Përmirësimi i konkurrencës në bujqësi dhe pylltari

Boshti 2: Përmirësimi i mjedisit dhe fshatit

Boshti 3: Cilësia e jetës dhe diversifikimi i ekonomisë në zonat rurale

Boshti 4: Leader³, ose zhvillimi me pjesëmarrje

Po të kemi parasysh vizionin tonë për zhvillimin bujqësor (konkurrueshmëria) duket qartë që strategjia jonë e bujqësisë dhe ushqimit është në një linjë me të (boshti 1 më lart). Gjithashtu, në përqasjen tonë për zhvillimin bujqësor, pjesëmarrja e përfituesve dhe e tërë aktorëve të zhvillimit bujqësor, duke filluar më identifikimin e problemeve e deri tek monitorimi dhe vlerësimi i tij, parashihet të bëjë me një pjesëmarrje të gjerë dhe demokratike të tyre, cka përputhet me filozofinë e boshtit të katërt të politikës europiane. BE synon të nxisë konkurrencën dhe konkurrueshmërinë e produteve të prodhuara nga fermerët europianë duke e shkëputur subvencionin nga sasia e prodhimit (i ashtuquajtur i mekanizmi i shkëputjes, ose mekanizmi me një pagesë). Kjo do të bëjë që konkurrenca të forcohet, sepse tani fermerët do të orientohen me shumë nga kërkesat e tregut. Ky mekanizëm tashmë nuk inkurajon fermat e mëdha, kështu që edhe këto duhe të mendojnë me shumë për konkurrencën. Subvencioni për fermerët europianë lidhet edhe me kërkesa për sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e produkteve, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve, etj. (janë 18 standarte që duhet të plotësohen në këtë kuadër në mënyrë që fermerët të marrin ndihmë).

SSBU dhe MSA

MSA është marrëveshja për stabilizim dhe asociim e lidhur mes Republikës së Shqipërisë dhe BE me 12 qershor 2006. MSA do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga të gjitha vendet antare të BE një për një, gjë që mendohet të zgjatë rreth 2 vjet. MSA përcakton tre kritere kryesore për anëtarësimin e Shqipërisë në BE:

- **Demokracia dhe shteti i së drejtës, ose kriteri politik**
- **Krijimi i një ekonomie tregu funksionale, ose kriteri ekonomik**
- **Adoptimi i *acquis communautaire*, që ka 31 kapituj, ose standartet europiane**

Këta tre kritere, ose kapituj, siç quhen, ndahen në 31 fusha dhe 145 nënfusha.

Me VKM nr. 463 datë 5.07.2006 u miratua edhe Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA (PKZMSA). Ky plan u hartua në përgjigje të vendimit të janarit 2006 të BE "Për parimet, përparësitë dhe kushtet e përmbytura në Partneritetin Europian me Shqipërinë", ku jepen përparësitë

³ Fr.: Liaison Entre les Activitees de Development Economique et Rural

afatshkurtëra dhe afatmesme të Shqipërisë për integrim në BE. Në PKZMSA jepen për secilin kapitull, çdo fushë dhe nënfushë, iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese, për periudhën afatshkurter 2006-2007, për periudhën afatmesme 2008-2010 dhe atë afatgjatë 2011-2012. PKZMSA ka edhe 6 anekse: Lista e iniciativave ligjore, Kostoja e përgatitjes dhe përkthimit të legjislacionit, Vlerësimi i shtesave të numrit të punonjësve, Nevojat për training, Vlerësimi i nevojave për fonde në infrastrukturë, Teknologjia e informimit dhe konsulenca, Lista e aktiviteteve zbatuese.

Lidhja mes SSBU dhe MSA është organike dhe reflektohet në disa aspekte:

Në vizionin e SSBU: vizioni i SSBU është konkurrueshmëria dhe integrimi i Shqipërisë në BE. Konkurrueshmëria është e lidhur ngushtë me ndërtimin e një ekonomie tregu funksionale, që të përballojë trysninë e konkurrencës, dhe me ndërtimin dhe zbatimin e një kuadri ligjor sipas standarteve europiane.

Në qëllimin dhe objektivat e SSBU: qëllimi i SSBU është garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm në sektorin bujqësor dhe agroindustri, ndërsa objektivat kanë të bëjnë me menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, rritjen e standartit të jetësës së fermerëve, rritjen e sigurisë ushqimore, përmirësimin e marketingut agrar, etj. Të gjitha këto janë të refleksi i tre kriterëve të MSA.

Në politikat e përcaktuara në SSBU: Ndër politikat kryesore të SSBU janë përmirësimet ligjore sipas standarteve europiane, përmirësimi i informacionit, mbështetja e teknologjive të prodhimit, mbështetja e metodave dhe teknikave të reja të prodhimit, forcimi i institucioneve të planifikimit, analizës dhe të monitorimit të zhvillimeve në bujqësi, etj. Të gjitha këto synojnë të kontribuojnë në përmbushjen e tre kriterëve të vëna Shqipërisë nga ana e BE për tu antarësuar në këtë organizatë.

KAPITULLI 1

KUSHTET AKTUALE

1.1 Vendi i bujqësisë në ekonominë kombëtare


Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë sonë, duke kontribuar me rreth 21 % të PBB-së (në vitin 2006). Familjet rurale vazhdojnë të mbizotërojnë me mbi 50% të popullsisë dhe bujqësia përbën alternativën kryesore të zënies me punë të njerëzve në zonat rurale. Rritja mesatare reale në bujqësi gjatë pesë viteve të fundit është vlerësuar të jetë me rreth 3-3.5%/vit.

Tabela_1: Bujqësia kundrejt GDP (%)

Dega	1996	2000	2005
Bujqesia	36.1	25.5	20.5
Industria	9.7	7.6	9.7
Ndertimi	5	8.1	14.8
Sherbimet	49.2	58.8	55
Totali	100	100	100

Source: INSTAT, 2006

Grafiku 1: Dinamika dhe struktura e PBB



Megjithatë, rritja e sektorit bujqësor është nën mesataren kombëtare dhe, njëherësh, larg potencialeve reale. Kjo vjen si rezultat i problemeve më të cilat përballet sektori, ku mbizotërojnë ato të lidhura me eksodin rural, sipërfaqen e kufizuar të fermave dhe pronësinë mbi tokën, marketingun e produkteve, ujitjen dhe kullimin, nivelin e ulët të teknologjive të përdorura, organizimin e dobët të fermerëve, nivelin e ulët të zhvillimit të industrisë agro-shqimore, etj. Këto kushte dhe probleme ndikojnë negativisht mbi interesin për investime

serioze për prodhimin e produkteve të ndryshme me natyrë agroushqimore.

1.2 Toka bujqësore

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore zë rreth 24% (ose rreth 699,000 hektarë) të sipërfaqes së përgjithshme të vendit, nga e cila vetëm rreth 561 mijë hektarë janë tokë arë. Rreth 43% (ose 304 mijë hektarë) e sipërfaqes bujqësore ndodhet në zonën fushore me cilësi përgjithësisht të mira prodhuese, rreth 34% (ose 239 mijë hektarë) në zonën fushore dhe mbetja prej rreth 23% (ose 159 mijë hektarë) është në zonën malore, e destinuar pothuajse tërësisht në kultivimin e pemëve frutore.

Reforma e tokës. Në fund të vitit 2006, treguesit kryesorë të privatizimit të tokës bujqësore paraqiten si më poshtë:

- Ndarja e tokës ka arritur në 561 mijë hektarë, që përbën 98.6% të fondit të tokës të parashikuar për ndarje prej 569 mijë hektarësh.
- Janë pajisur me tokë rreth 445 mijë familje bujqësore, në të cilat përfshihen rreth 65% e të gjithë popullsisë së vendit.

Rreth 137 mijë hektarë tokë janë në pronësi shtetërore, nga të cilat 110 mijë hektarë administrohen sipas ligjit nr.8312, nga komunat dhe bashkitë, ndërsa 27 mijë hektarë përcaktohen si disponibël shtetërore.

Problemet kryesore me të cilat ndeshet aktualisht reforma e tokës kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve të evidentuara lidhur me pronësinë mbi tokën. "Gjeografia" e shtrirjes së konflikteve është kryesisht, por jo vetëm, periferia e qendrave të mëdha urbane dhe zona bregdetare.

Reforma e tokës. Procesi i dhënies së titujve të pronësisë, ose dhënia e "aktit të marrjes së tokës në pronësi", si sipërfaqe, ka arritur në 542 mijë hektarë ose 97.2% e të gjithë sipërfaqes që realisht është ndarë. Aktualisht janë rreth 15 mijë hektarë tokë bujqësore që përdoret (shfrytëzohet) nga familje bujqësore, por që nuk disponojnë tapi për shkaqe të ndryshme e të

njohura. Kjo situatë ndeshet me shumë në qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Fierit. Pengese në dhënien e akteve të marrjes së tokës në pronësi janë edhe konfliktet me natyrë të ndryshme.

Procesi i regjistrimit fillestar të tokës bujqësore në cilësinë e saj si pasuri e paluajtshme dhe si produkt i regjistrimit përfundimtar të titujve të pronësisë në ZVRPP, ka arritur në 87.5% të të gjitha zonave kadastrale rurale të vendit. Regjistrimi fillestar deri në fund të vitit 2005 është kryer nga Njësia e Menaxhimit të Regjistrimit të Tokës në MBUMK. Me

Kutia 1: Tregu i tokës

Tregu i tokës në Shqipëria mbetet shumë i pazhvilluar. Deri tani vetëm 2% e fermerëve i kanë shirur tokat dhe vetëm 3.5% i kanë dhene ato me qera. Megjithatë në vitin 2004 taksa për transaksionet e tokës u ul nga 2.5 në 0.5% perseri transaksionet e tokës bujqësore nuk ndrsyhuan dukshëm. Disa nga faktorët që e pengojnë zhvillimin e tregut të tokës janë: fragmentii i madh i tokës; prirja e të rinjve për tu mos u marre me bujqësi; lidhja e forte e fermerëve me tokën; prirja për të mos e shitur tokën e lene trashëgim nga të parët; zhgenjimi i fermerëve nga sistemi i meparshëm kooperativist; familja e madhe fermerë; pasiguria për pronën e marre; pronësia embivendosur në disa raste; ndarja dhe ndërtimet e paligjshme mbi tokën bujqësore, etj.

Analizat tregojnë së edhe qeradhënia do të oishte shumë e nevojshme. Eficenca e një fermeri që merr tokë me qera është 28%, krahasuar me 12% eficientën e një fermeri që jep tokë me qera dhe me 28% eficientën e një fermeri që as merr dhe as jep tokë me qera. Sidoqofte, tregu i tokës mbetet nga sfidat më të veshtira në sektorin e bujqësisë.

VKM nr. 159, datë 21.3.2006, kjo veprimtari ka kaluar në varësi të ZQRPP. Sipas të dhënave të ZQRPP, deri tani janë evidentuar si të realizuara mbi 20 mijë transaksione të pronave të paluajtshme në zonat rurale. Ritmi i transaksioneve është shtuar disi në 2-3 vitet e fundit, kryesisht në zonat periferike të qendrave të mëdha urbane.

Ekziston një mospërputhje midis së drejtës së përdorimit dhe shfrytëzimit të tokës me detyrimin që kanë pronaret e tokës për mbrojtjen e saj. Kjo edhe sepse ligji për mbrojtjen e tokës është miratuar shumë vite me vonë se sa ligji që sanksiononte të drejtën e pronësisë private mbi tokën. Ndërkohë, toka bujqësore i është nënshtruar faktorëve dëmtimit të vazhdueshëm nga veprimtaritë e njerëzve dhe nga faktorë natyrore.

Aktualisht rezulton të jenë dëmtuar disa mijë hektarë tokë, që nuk mund ti nënshtrohen procesit të rehabilitimit të saj. Ndonëse ligji parashikon dhe detyron krijimin e strukturave të mbrojtjes së tokës, ato ende nuk janë krijuar. Ndryshimi radikal i karakterit të pronësisë mbi tokën dhe i të drejtës së pronësisë mbi të, kushtëzon edhe ndryshimin radikal të mënyrës së administrimit të tokës.


Niveli aktual i administrimi i tokës nuk i përgjigjet kërkesës për menaxhim efektiv dhe të qendrueshëm të saj dhe as arritjes së objektivave të përcaktuar për integrimin evropian të vendit tonë. Sipas të dhënave të vlerësimeve të ndryshme, vitet e fundit ka arritur që sipërfaqja e tokës⁴ të shfrytëzohet në masën 80-85%. Ndonëse ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 rregullon drejt raportet ndërmjet së drejtës së pronësisë private mbi tokën me detyrimin për mbrojtjen e saj si një pasuri kombëtare, në periudhën e tranzicionit nuk është arritur të ndërtohen dhe të përcaktohen politika adekuate të përdorimit të tokës, të krahasueshme me politikat përkatëse në vendet e rajonit.

Në të kaluarën, por edhe aktualisht, vërehen dëmtime të fondit të tokës bujqësore që pakësojnë kufijte fizike të saj, siç janë ndërtimet e paligjshme, zgjerimi i pa argumentuar e hapësirave urbane në dëm të tokës bujqësore, dëmtimi i shtretërve të lumenjve, etj. Krahas tendencave për zvogëlim të sipërfaqes vihen re edhe dëmtime të vlerave agro-ekologjike të tokës si rezultat i mosaplikimit të praktikave të mira bujqësore. Tashmë është mjaft shqetësues edhe fenomeni i kripezimit, i kënetezimit dhe ndotjeve të natyrave të ndryshme në disa zona të vendit. Gjithashtu, mungon dhe një sistem i informacionit për tokën, që të jetë i ndërtuar mbi metodologji bashkëkohore dhe që të shërbëjë për mbrojtjen dhe manaxhimin më të mirë të saj.

1.3 Madhësia e fermave

Bujqësia është e dominuar nga ferma me sipërfaqe të vogël (mesatarisht 1.13 hektarë) dhe të copëzuara në mesatarisht 3.9 parcela për fermë, me një madhësi mesatare prej 0.25 hektarësh, gjë që përben një pengesë të rëndësishme për rritjen e produktivitetit të tokës dhe zhvillimin eficient të sektorit bujqësor. Fermat me madhësi të vogël janë më të përhapura në pjesën malore, si dhe në atë veriore të vendit. Ferma me madhësi më të vogël vërehen në prefekturat e Kukësit, Dibërës, Shkodrës dhe Lezhës (me mesatare respektivisht prej 0.52 hektarë, 0.58 hektarë, 0.93 hektarë dhe 1.00 hektarë).

Grafiku 2. Madhësia e fermës sipas grupeve



Burimi: Vjetari statistikor i MBUMK, 2006

Parcelizimi i tokës bujqësore sjell një sërë vështirësish për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe ka bërë që përdorimi në shkallë të gjerë i mekanikës bujqësore të jetë i vështirë. Nga ana tjetër, lëvizjet e parreshtura migruese nga zonat rurale në drejtim të qendrave të mëdha urbane, kanë bërë që sipërfaqe të konsiderueshme tokë bujqësore të lihen djerrë. Këto dhe faktorë të tjerë me natyrë prodhuese ose tregtare, kanë krijuar një mjedis të përshtatshëm për hyrjen në vend të një gamë të gjerë mallrash bujqësore të huaja (të papërpunuara), kryesisht nga vendet fqinjë.

1.4 Inputet bujqësore

Fermerët ndeshen me shumë probleme në kuadrin e përdorimit të mekanizimit. Gjatë viteve të fundit janë importuar një numër i konsiderueshëm traktorësh dhe pajisjesh të tjera mekanikë. Megjithatë, pajisjet moderne në llojet e duhura akoma nuk janë ende sa nevojitet në dispozicion të fermerëve. Zoteruesit e makinerive bujqësore u caktojnë fermerëve çmime shumë të larta për

⁴ Kjo i referohet tokës së ndarë nga reforma e të pranuar nga fermerët

kryerjen e proceseve të mekanizuara bujqësore si plugime, mbjellje, korrje dhe shirje, transport, etj. Kjo bën që niveli i mekanizimit bujqësor të rritet ngadalë dhe për një masë të madhe fermerësh shfrytëzimi i mënyrave tradicionale, si tërheqja me kafshë ose punimet me krahë, mbeten si alternativa të vetme.

Vetëm 74% e familjeve që merren me bujqësi e kryejnë punimin bazë të tokës me mjete të mekanizuara. 23% e tyre punojnë tokën me kafshë dhe 59% me krahë dhe me mekanikë. Në punimin e tokës me krahë sundojnë fermtat në zonat malore (75%) dhe fermtat e vogla 0-1 hektarë dhe ato të mesme me 1-2 hektarë. Punimi i tokës me kafshë është një fenomen jo vetëm në zonat malore dhe kodrinore, por edhe në zonat fushore. Por, siç thamë pak më lart, punimi manual i tokës është një praktike e cila nuk shkaktohet aq nga mungesa e traktorëve, pasi në Shqipëri ka 1 traktor për 70 hektarë. Ky fenomen nuk lidhet me mungesën e mjeteve të ndryshme mekanikës bujqësore, por ai lidhet kryesisht me tarifat e larta të punimeve, më eficientën e ulët të veprimtarisë bujqësore si dhe sipërfaqen e kufizuar dhe të copëzuar të fermave.

Kutia 2 :Përdorimi i inpueteve

Në vitin 2006 ka një rënie të ndjeshme të kimikateve të përdorura në bujqësi. Një ferme ka përdorur 17% më pak plehra kimike. Veçanërisht ka rënë përdorimi i diamonit, me 54% më pak dhe nitrati me 24%. Përpjesa e fermave që përdorin plehra kimike pothuajse nuk ka ndryshuar (99%), por është rritur mjaft numri i fermave që përdorin ure (27%) në një kohë që ka rënë shumë numri i fermave që përdorin nitratin (me 30%). Është mjaft pozitiv fakti që është rritur ndjeshëm numri i fermave që përdorin pleh organik me 33% dhe kjo është mjaft pozitive në kontekstin e praktikave të mira bujqësore. Në këtë kontekst do ta konsiderojmë negative ritjen e ndjeshmë të sasisë së pesticideve me 55% dhe të sasisë për ferme merreth 35% me shumë. Për sa i takon përdorimit të traktorëve, megjithëse numri i tyre ka rënë, numri i fermave që përdorin traktorë për të kryer punimet bazë të tokës ka mbetur në nivel thuhet të njëjtë, ndërsa është pakësuar mjaft numri i fermave që punojnë tokën me krahë me rreth 8%, cka flet për rritje të përdorimit të kafshëve të punës. Kjo mendohet së vjen nga tarifat e papërbalueshme të punimeve me traktor.


Në nivel vendi fermerët që përdorin plehra kimike zenë rreth 93% të totalit të fermerëve. Plehtrat kimike zenë rreth 23 % të shpenzimeve totale të fermës ose pjesën më të madhe të vlerës së inpueteve që blejnë fermtat, (rreth 50%).

Vetëm rreth 40-45% e fermerëve përdorin ushqimë të blera për blegtorinë. Numri i fermerëve që përdorin ushqime të blera për blegtorinë është më i lartë në zonat malore si rezultat i prodhimit më të ulët të foragjereve dhe nevojës për rezerva më të mëdha ushqimore gjatë stinës së dimrit.

1.5 Agroindustria

Agroindustria shqiptare është një sektor kompleks biznesesh të vogla private që janë krijuar nga privatizimi i ndërmarrjeve agroushqimore të mëparshme, si dhe nga iniciativa private më investime të reja. Privatizimi i këtyre ndërmarrjeve filloi në vitin 1992 me industrinë e bukës, miellit, përpunimit të qumështit, pijeve alkalike dhe atyre joalkolike.

Grafiku 3: Rritja e prodhimit bujqësor dhe agroindustrial



Burimi: Vjetari Statistikor i MBUMK, 2000-2006

Para vitit 1990, industria ushqimore grumbullonte dhe përpunonte 50-80 % të gjithë produkteve të bujqësisë. Ndërmarrejt agropërpunuese benin edhe marketingun e produkteve të tyre. Industria ushqimore siguronte rreth 42% të vlerës së përgjithshme të industrisë dhe punësonte rreth 47,000 vetë.

Në vitin 2006 ishin 2053 ndërmarrje të industrisë ushqimore, 46% e të cilave në industrinë e miellit dhe bukës. Mbi 20% e tyre janë të lokalizuara në prefekturën e Tiranës. Në sektorin e industrisë ushqimore janë të punësuar 9995 persona. Vlera e prodhimit të industrisë ushqimore rezulton të jetë 18% e vlerës së prodhimit të përgjithshëm agroushqimor (sipas INSTAT). Ecuria e këtij sektori krahasuar me bujqësinë duket edhe nga grafiku 3 më lart.

Përsa i përket numrit të bizneseve agropërpunuese, industria e bukës dhe ëmbëlsirave është në vendin e parë me 966 fabrika, ose 47% e totalit, e ndjekur nga industria e përpunimit të qumështit me rreth 362 fabrika e baxho ose 18% dhe nga industria e miellit me 272 sipërmarrje ose 13% e totalit. Bazuar në disa tregues, sipërmarrjet agro ushqimore janë shumë të vogla dhe pjesa dërrmuese e tyre nuk i arrijnë standartet e sigurisë së BE-së, si rrjedhim ato nuk kanë mundësi për tu paraqitur në tregun huaj, veçanërisht atë të BE-së. Në mënyrë që të rritet shkalla e konkurrueshmërisë së industrisë së përpunimit të ushqimeve në Shqipëri do të nevojiten investime për të mbështetur politikën përkatëse të zhvillimit.

Edhe në rastet e ekzistencës së bizneseve moderne me destinacion eksportin lënda e parë nuk sigurohet në vend, sepse burimet e furnizimit brenda vendit si në sasi, ashtu edhe cilësi dhe çmim të përshtatshëm, janë të kufizuara. (Për shëmbull, nga industria e përpunimit të perimeve me teknologji të ngrirjes së thellë prodhohen mbi 2000 ton perime në vit, por 90% e lëndës së parë vjen nga importi, si Greqia Italia dhe Maqedonia).

Industria ushqimore, si një degë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare ka shënuar zhvillim të dukshëm dhe të qëndrueshëm gjatë viteve të fundit. Prodhimi në vlerë ka shënuar nivelin më të lartë të viteve të fundit prej rreth 48 miliardë lekë, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 11.6%, duke filluar që nga viti 2000. Rritje më të ndjeshme vihen re në nëndegën e përpunimit të qumështit, atë të përpunimit të mishit, etj.

Niveli i investimeve është një tregues tjetër i rëndësishëm i zhvillimit të industrisë ushqimore. Siç shihet nga tabela 2, investimet në përgjithësi kanë ardhur në rritje, duke shënuar një kulm në vitin 2005 me rreth 2.9 miliardë lekë. Duke analizuar këto investime janë për tu shënuar 2 fenomene: (1) nga viti në vit ka ardhur duke u rritur pjesa e investimeve që shkon për teknologji kundrejt asaj pjese që shkon për objektet ndërtimore, gjë e cila tregon së krahas përmirësimit sasior të investimeve, ka filluar edhe një përmirësim cilësor i tyre, duke rritur nivelin teknologjik të industrisë, me të gjitha rrjedhojat pozitive të këtij fenomeni.(2) gjithashtu, gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e burimeve të financimit të siguruara nga vetë investitorët dhe nga kreditë bankare të vendit.

Tabela 2: Investimet private në agropërpunim (mln lekë)

Nëndega	2000	2004	2005	2006
Mish	120.7	92.4	425.6	170.3
Qumësht	51.5	790	624.3	1194.8
Miell	77.9	114.7	1124.5	79.6
Bukë dhe ëmbëlsira	67.4	96.9	203.4	295.8
Ujë mineral dhe pije të buta	394.7	271	62.8	47
Tjetër	141.1	932.7	475.9	258
Totali	853.3	2297.7	2916.5	2045.5

Burimi: Vjetari Statistikor, 2006, MBUMK

Investimet më të mëdha janë duke u bërë në industrinë e përpunimit të qumështit, ndërsa investimet në prodhimin e miellit dhe bukës së bashku kanë pësuar rënie.

1.6 Tregtia dhe marketingu i produkteve bujqësore

Bujqësia, duke qënë e karakterizuar nga një përmasë shumë e vogël e fermave, mbetet akoma mjaft e orientuar drejt plotësimit të nevojave të mbijetesës së familjeve fermerë. Kështu, ndonëse në treg dalin mbi 90% e fermerëve, vetëm 30% e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale janë të destinuara për treg.

Të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore janë rreth 220 mijë lekë për fermë, nga e cila 58% nga produktet blegtorale. Rreth 43% e fermave marrin rreth 55 mijë lekë të ardhura dhe vetëm 13% e fermave marrin mesatarisht mbi 400 mijë lekë të ardhura. Dukshëm nën mesataren e vendit janë qarqet Kukës, Lezhë, Dibër dhe Korçë. Mbi mesataren janë qarqet Fier, Vlorë dhe Berat. Qarqet që ku fermerët e kanë pjesën më të madhe të të ardhurave nga bimët janë Fier, Korçë dhe Durrës, kurse nga blegtoria janë Dibër, Kukës, Vlorë, Elbasan, etj.

Të ardhurat nga shitja e produkteve bimore për ferme janë rreth 92 mijë lekë në vit. 75% e fermerëve realizojnë të ardhura nën 44 mijë lekë në vit, kurse 35% realizojnë nga shitja më pak se 10 mijë lekë në vit. Nën mesataren e vendit janë fermerët e qarqeve Dibër, Kukës, Gjirokastër dhe Lezhë, ndërsa dukshëm mbi mesataren janë qarqet Vlorë, Berat, Fier.

Tregtia e produkteve bujqësore dhe ushqimore vendase është akoma e pazhvilluar. Nisur nga dominimi dermues i produkteve të importuara në treg, plotësimi më i mirë i nevojave të tregut shqiptar me produkte vendase duhet të jetë një objektiv i rëndësishëm strategjik, ndërkohë që përmirësimi i nivelit të eksportit është një anë tjetër, po aq e rëndësishme. Aktualisht, mundësitë e eksportit në Shqipëri për produktet bujqësore janë shumë të kufizuara. Kjo është kryesisht rrjedhojë e: i) pamjaftueshmërisë dhe nivelit të ulët të prodhimit bujqësor dhe industrisë agro-përpunuese; ii) mungesës së lehtësirave të tregtimit (magazinimit, përpunimit, paketimit të

produkteve); iii) standarteve të ulëta lidhur me sigurinë ushqimore; iv) shkallës së ulët të konkurrueshmërisë në treg të produkteve bujqësore shqiptare për shkak të cilësisë së ulët dhe kostos relativisht të lartë të produkteve shqiptare.

Bilanci i eksport-importit të produkteve ushqimore është tregues i rëndësishëm sintetik për ecurinë e zhvillimit bujqësor në vend. Sipas të dhënave të viteve të fundit, situata e eksportit dhe e importit paraqitet problematike. Bilanci tregtar i eksport importit tregon një raport prej rreth 1/7.4 (Tabela 3).

Bujqësia, e cila është një sektor potencialisht eksportues, po përballet edhe me problemë të organizimit të eksportuesve dhe strukturave përkatëse, si të tregjeve të grumbullimit, të magazinimit dhe të industrisë përpunuese; me probleme administrative të kontrollit të cilësisë nga

Kutia 3: Sa plotësohen nevojat e tregut me produkte vendi?

Importet bujqësore dhe agroindustriale janë shumë të mëdha, ato arrijnë rreth 400 milion €. Importet bujqësore zenë rreth 20% të importeve totale të vendit, kurse eksportet vetëm 8-9%. Kjo vjen edhe nga fakti që Shqipëria nuk plotëson nevojat me produkte vendi për një numër të konsiderueshëm produktesh agroushqimore. Shqipëria siguron vetë 40% të nevojave për grure (ose miell), 52% të nevojave për fruta, 25% të mishit të pulës, 80% të mishit të gjedhit, 60% të mishit të derrit, 90% të patateve, 95% të e perimeve dhe të qumështit. Këto shifra mund të shërbëjnë edhe si disa argumente për të zhvilluar degët e bujqësisë ku prodhimi është deficitar, por edhe si argumenta përse bujqësia ka nevojë për me shumë mbështetje.

strukturat shtetërore si dhe standartet apo me shkallën e pamjaftueshme të zbatimit të ligjit për kontrollin e ushqimeve.

Rritja e eksporteve do të vijë përmes politikave mbështetese nga qeveria si dhe përmes rritjes së konkurrueshmërisë së vetë bizneseve duke evidentuar ose siguruar: (i) çfarë kërkojnë tregjet nga

Tabela 3: Trendi i eksporteve dhe importeve ne mijra leke

	2004	2005	2006
Eksporte	5147000	5567089	7154416
Importe	42903000	42445000	53190000
Raporti	1:8.3	1:7.6	1:7.4

Burimi Vjetari Statistikor 2006, MBUMK

furnizuesit e tyre (llojin e produktit, cilësinë, paketimin, kanalet e shpërndarjes), (ii) çfarë kapacitete prodhimi nevojiten, (iii) si i plotësojnë konkurrentët këto kërkesa, e të tjera.

Rëndësia e rritjes së eksporteve nuk shihet vetëm për të reduktuar bilancin tregtar, por edhe për të Përmirësuar cilësinë e produkteve dhe rritjen e aftësive prodhuese, krijimin e vendeve të

reja të punës, rritjen e mirëqenies dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Rritja e cilësisë së produkteve tona do të ndikojë pozitivisht në rritjen e eksporteve si dhe do të rrisë shkallën e zëvendësimit të importeve me produkte të prodhuara në vend.

Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) me vendet e rajonit dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin europian ofrojnë shanse për ekonominë shqiptare që të rrisë eksportet për produkte të veçanta si fruta, perime, vaj ulliri, peshk, disa produkte të përpunuara, produkte blegtorale, etj.

Një pjesë të konsiderueshme të tregtisë ndërkombëtare Shqipëria e bën me vendet e BE dhe vende të tjera të rajonit, ku vend të veçantë zenë Italia, Greqia, Turqia, etj.

1.7 Ujitja dhe kullimi

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në zbatim të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin" është përgjegjëse për administrimin e ujitjes dhe kullimit si dhe për mbrojtjen nga përmbytja. Ajo realizon garantimin e shërbimeve të mëposhtme: (i) ujitjen

në rreth 360 000 hektarë nëpërmjet shoqatave të përdoruesve të ujit; (ii) kullimin në rreth 280 000 hektarë nëpërmjet 16 Bordeve të Kullimit; (iii) mbrojtjen nga përmbytja në 130 000 hektarë, gjithashtu nëpërmjet Bordeve të Kullimit.

Kutia 4: Bordet e kullimit

Për sistemet ujitëse të pa transferuara, ligji nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", në nënin 7 përcaktonte si përgjegjës për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve drejtoritë e ujrave në rrethe, që aktualisht nuk egzistojnë. Ato u eliminuan sepse ujitja u konsiderua si proces që duhet të menaxhohej nga shoqatat e federatat e përdoruesve të ujit. Kjo shpuri fillimisht në transformimin, e parakohshëm, të drejtorive të ujrave të rretheve në borde kullimi, duke lënë aktualisht të zbuluar shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen jo vetëm të sistemeve kryesore ujitëse, që nuk u janë transferuar akoma shoqatave dhe federatave të përdoruesve të ujit, por edhe të një pjesë të konsiderueshme të sistemeve kryesore ujitëse të transferuara tek shoqatat dhe federatat përkatëse. Këto të fundit janë akoma në procesin e konsolidimit, çka do të thotë që shoqatat e federatat e përdoruesve të ujit në të shumten e rasteve nuk mund të realizojnë vetë procesin e shfrytëzimit e të mirëmbajtjes.

Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e sistemit kullues dhe mbrojtjes nga përmbytja është përgjegjësi e Bordeve të Kullimit, me financim nga buxheti i shtetit, në zonat ku veprojnë dhe që janë në vartësi të Ministrisë së

Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Në sistemet e ujitjes që i janë transferuar shoqatave e federatave të përdoruesve të ujit, përgjegjësinë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kanë vetë shoqatat e federatat e përdoruesve të ujit (fermerët).

Aktualisht në përberje të sistemeve të ujitjes, kullimit dhe të mbrojtjes nga përmytja përfshihen:

Kullimi e mbrojtja nga përmytja. Sipërfaqja kulluese prej 200.000 hektarësh ka infrastrukturë që mund të kullohet, nga 280.000 hektarë që është aftësia kulluese e projektuar: (i) 200.000 hektarë janë rehabilituar, por që çdo tre vjet kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme (pra, nga mungesa e deritanishme e mirëmbajtjes, mund të themi së kjo sipërfaqe tani është rikthyer në gjendjen e para rehabilitimit); 80.000 hektarë kanë nevojë për rehabilitim fillestar dhe më tej do të kenë nevojë për mirëmbajtje ciklike çdo 3 deri 4 vjet.

Nga sipërfaqja e projektuar për kullim mund të arrihet kullimi: (i) vetë rrjedhje (gravitet) 205.000 hektarë; (ii) hidrovore 75.000 hektarë.

Në mbështetje të kullimit funksionojnë 28 hidrovore me 134 elektropompa në 10 rrethe të zonës së ulët (Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, etj.), por rreth 50% e elektropompave kanë një kohë përdorimi me shumë së 20 vjet. Rrjeti i kanaleve kulluese me vepra arti përfshin një gjatësi totale rreth 15.700 km.

Sipërfaqja e tokës bujqësore e rrezikuar vazhdimisht nga përmytja arrin 130.000 hektarë (e mbrojtur aktualisht me argjinatura, kanale ujërash të larta e me hidrovore), ndërsa gjatësia e argjinaturës mbrojtëse nga lumenjtë dhe deti arrin në gjithsej 850 km.

Ujitja: Sipërfaqja e ujitëshme në nivel vendi është 188.000 hektarë (sipërfaqe që kanë infrastrukturë të rehabilituar dhe që mund të ujitet) nga 423.000 hektarë gjithsej që është aftësia ujitëse e projektuar. Nga kjo shifer: (i) nga kjo rreth 70.000 hektarë mund të perjashtohen pasi kanë humbur funksionin e tyre si tokë bujqësore (janë kthyer në zona urbane, përfshirë këtu edhe abandonimin e shumë skemave ujitëse me ngritje mekanike që rezultojnë jo efikase dhe (ii) 173.000 hektarë kanë nevojë për rehabilitim, si proces ciklik i vazhdueshëm.

Nga 639 stacione pompimi për ujitje të ndërtuar, vetëm rreth 100 janë në gjendje punë, kurse pjesa tjetër janë stacione pompimi që për tu rivene në punë kanë nevojë për investime. Në disa raste të tjera ata janë dëmtuar plotësisht dhe kanë humbur funksionin si stacione pompimi në skemat ujitëse përkatëse.

Sot ekziston një rrjet kanalesh ujitëse dhe veprash arti me një gjatësi totale rreth 25.000 km, i klasifikuar si me poshtë: (i) kanale ujitëse të parë 2.000 km; (ii) kanale ujitëse të dyte 6.200 km; (iii) kanale ujitëse të treta 16.800 km.

Në fushën e ujitjes kanë vepruar disa nga projektet më të fuqishme të bujqësisë, kryesisht për rehabilitimin e sipërfaqes ujitëse. Me projektin e parë dhe të dytë të Bankës Botërore janë rehabilituar rreth 150.000 hektarë, ndërsa nga buxheti i shtetit rreth 30.000 hektarë, (gjithsej 180.000 hektarë).

Mirëmbajtja dhe menaxhimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit bëhet: (i) nga bordet e kullimit, gjithsej 16 borde kullimi me financim nga buxheti i shtetit; (ii) nga Shoqatat e Përdoruesve të Ujit - rreth 530 shoqata, dhe; (iii) nga Federatat e Ujit - 24 federata. Nisur nga gjendja e rënduar e sistemit të ujitjes e kullimit, rëndësia e madhe e këtij shërbimi si një nga faktorët përcaktues për rritjen e prodhimit dhe të të ardhurave në sektorin e bujqësisë, nga ana e

MBUMK është bërë vlerësimi për: (i) gjendjen e ujitjes, kullimit dhe të mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve; (ii) ecurinë e reformës për menxhimin e ujitjes nga SHPU-të dhe për kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja nga ana e bordeve të kullimit; (iii) me urdhër të Kryeministrit nr. 121, datë 19.5.2006 " Për miratimin e planit të veprimit për riaftësimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga Përmbytja", është miratuar një plan veprimi për të ndërhyrë në infrastrukturën e ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja për periudhën 2007-2009, i shoqëruar me llogaritjen e kostove përkatëse.

Sistemi i ujitjes e kullimit është një sistem me kanale të hapura dhe nga pikpamja e mirëfunksionimit, bazuar në përvojën 40 vjeçare të shfrytëzimit, kërkon mirëmbajtje të përvitshme dhe rehabilitim periodik të të gjithë infrastrukturës së përkrahur me sipër. Procesi i mirëmbajtjes dhe rehabilitimit është proces ciklik, duhet të kryhet çdo tre-katër vjet. Ai ka një kosto relativisht të lartë që varion: (i) në ujitje 40.000-60.000 lekë/hektarë; (ii) në kullim 15.000-20.000 lekë/hektarë (pa përfshirë mirëmbajtjen dhe energjinë elektrike të hidrovorëve).

Nga analiza e situatës rezulton së si pasojë e akumulimeve disa vjeçare të dherave, nga sistemi i ujitjes e kullimit, si pasojë moskryerjes së punimeve të pastrimit, për të stabilizuar funksionimin e sistemit të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga Përmbytja nevojiten ndërhyrje urgjente dhe mbështetje financiare të konsiderueshme.

Urgjent është edhe rehabilitimi i argjinaturave të lumenjve. Rehabilitimi i argjinaturave mbrojtëse nga lumenjtë për mbrojtjen e tokës bujqësore nga gërryerjet dhe përmbytjet që llogaritet në një vlerë rreth 2500 milione lekë vetëm për ndërhyrjet emergjente.

Rol të rëndësishëm në menaxhimin e ujitjes po luajnë shoqatat e përdoruesve të ujit. Përsa i përket menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja, kemi këto të dhëna:

- 362 shoqata mbulojnë rreth 234 010 hektarë, nga e cila në rreth 188 000 hektarë është kryer rehabilitimi i sistemit ujitës, por rreth 19 % e sipërfaqes së ujitëshme nuk kultivohet.
- Ujitja realizohet në 55 % të sipërfaqes së rehabilituar me rrjedhje të lirë (me gravitet), në 13 % me stacione pompash, por 32 % e kësaj sipërfaqe të rehabilituar nuk ujitet.

Problemet më të cilat përballen fusha. Gjendja aktuale e sistemit të ujitjes dhe e menaxhimit të saj nuk Përmbysh qëllimin bazë të ujitjes që është plotësimi i nevojave për ujitje të fermerëve në sasi dhe kohën e duhur. Kështu, nga difiçiti uhor nga 400-500 mm gjatë sezonit të veres me këtë gjendje të sistemit të ujitjes mund të plotësohen nevojat për ujë në rreth 200-250 mm. Nga analiza e kësaj situatë mund të arrihet në disa përfundime të thjeshta:

- Përpjekjet në drejtim të përmirësimit të treguesve të ujitjes e kullimit nuk janë shoqëruar në masën e duhur me rritjen e rendimenteve dhe të prodhimit bujqësor, me rrjedhojë rritjen e pamjaftueshme të të ardhurave të fermerëve.
- Garantimi i sigurisë së digave të rezervuarëve, si pasojë e mungesës së monitorimit permanent dhe ndërhyrjeve rehabilituese më investime, është në nivel të pamjaftueshëm. Rezulton së rreth 126 diga kanë nevojë për ndërhyrje të natyrës emergjente.
- Veprat e marrjes së ujit për ujitje nga lumenjtë janë të dëmtuara, si pasojë e marrjes së zhavorreve në shtratin e tyre.
- Monitorim i cilësisë së ujërave që përdorën për ujitje, me pasojë rritjen e kripësisë në disa zona të ulta bregdetare, është i dobët.
- Ka nevoja të dukshme për rritjen e kapaciteteve akumuluese të ujit për t'ju përgjigjur në perspektivë nevojave për ujë gjithmonë në rritje.

- Mungojnë teknologjitë moderne në ujitje, të cilat do të ndihmonin për përdorimin me më efektivitet të ujit.
- Mungon një plan i integruar i përdorimit të burimeve ujore brenda një pellgu ujor. Mungojnë programimet në vlerësimin dhe përdorimin e burimeve ujore për ujitje në funksion të kompleksit të faktorëve tokë-ujë-bimë-klimë dhe për parandalimin e përmbytjeve në skemat e kullimit.

Ka nevojë të dukshme për vazhdimin intensiv të procesit të rehabilitimit të sistemeve të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja deri në arritjen e konsolidimit të menaxhimit të ujitjes nga shpu-të dhe deri sa menaxhimi i sistemeve të kullimit e mbrojtjes nga përmbytja të kryhet nga bordet e kullimit me vetëfinancim. Për këtë duhen bërë edhe ndryshimet përkatëse të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen e kullimit". Kjo e fundit do të rrisë përgjegjësinë e përfituesve dhe do të zbusë ndërhyrjen e shtetit me buxhetin e tij në këtë infrastrukturë.

1.8 Siguria ushqimore dhe standartet

Kontrolli veterinar. Ky kontroll ka për detyrë ruajtjen e territorit të vendit nga hyrja e infeksioneve në kafshë dhe e shëndetit të njerëzve nga sëmundje që rrjedhin nga produkte me origjinë shtazore, kjo nëpërmjet persosjes së procedurave të kontrollit në pikat kufitare të kontrollit veterinar. Shqipëria ka 14 pika të inspektimit veterinar kufitar të produktet me origjinë shtazore. Në këto pika kufitare kontrollohen të gjitha ngarkesat me produkte shtazore të importuara. Vetëm pas këtij kontrolli në këto pika, të cilat janë barriera e parë e kontrollit veterinar të produkteve me origjinë shtazore, dhe pas kontrollit në doganat e brëndshme këto produkte qarkullojnë lirshëm në tregun e brëndshëm. Infrastruktura e këtyre pikave të inspektimit le për të dëshiruar. Me përfundimin e projektit CARDS do të përmirësohet infrastruktura e 7 pikave të inspektimit veterinar kufitar. Përmirësimi i infrastrukturës të të gjitha pikave do të forcojë kontrollin veterinar në to.

Janë gjithësejt 128 subjekte të miratuara nga inspektoriat i sigurisë ushqimore për importimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve me origjinë shtazore. Në bazë të një programi mujor inspektohen të gjitha subjektet që importojnë, ruajnë në frigoriferë dhe përpunojnë produkte ushqimore. Kontrolli është mujor dhe kryhet në bazë të protokolleve të inspektimit. Këto subjekte në masën 90% të tyre janë nën kontrollin permanent të inspektoriatit ushqimor

Kushtet e këtyre stabilimenteve janë në përmirësim, duke vepruar në përputhje me legjislacionin veterinar në fuqi dhe duke plotësuar detyrat e lena me akt-protokollet e inspektoreve veterinare. Një numër i vogël i këtyre stabilimenteve plotësojnë edhe kushte për eksport në BE. Me miratimin e Ligjit të ri për " Ushqimin" do jetë kusht për industrinë ushqimore futja e sistemit të HACCP-it pas dy vjetëve, implementimi i të cilit çon drejt produkteve të sigurta nga ana shëndetësore.

Inspektoriat veterinar i bashkisë ka brenda juridiksionit të tij kontrollin e tregjeve për kushtet sanitare - veterinare të tregtimit të produkteve me origjinë shtazore. Në dyqane ka një përmirësim të dukshëm të plotësimit të kushteve sanitaro veterinare të tregtimit. Në tregjet masive, megjithëse bashkia ka inspektoriat veterinar permanent, vihet re një nivel jo i kënaqshëm i plotësimit të kushteve sanitaro-veterinare. Me forcimin dhe organizimin e kontrolleve të përbashkëta ka përpjekje për plotësimin e këtyre kushteve.

Megjithatë, kontrolli i produkteve agroushqimore vazhdon të përballet me një sërë problemesh dhe nuk është akoma në efikasitet të plotë. Ndër problemet më të rëndësishme janë:

- Inspektorët e sigurisë ushqimore që kryejnë kontroll në dogana dhe në treg nuk janë të pajisur me mjetet e nevojshme për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave të shpejta.

- Kuadri ligjor për kryerjen e kontrollit zyrtar të produkteve ushqimore të prodhuara në vend dhe të importuara kërkon përmirësim duke e përafuar me legjislacionin e BE-së.
- Për kryerjen më efikasitet të kontrollit të produkteve ushqimore, inspektorët e sigurisë ushqimore kanë vështirësi për shkak të mungesës së mjeteve të komunikacionit.

Kutia 5: Një qasje e re e sigurisë ushqimore-HACCP

HACCP do të thotë **Hazard Assessment and Critical Control Points**, shqip, **Vlersim i Rrezikut dhe Pikat Kritike të Kontrollit** (VRPKK). HACCP është një metode e kontrollit të sigurisë ushqimore që konsiston në parandalimin e rrezikut ose të shkaqeve të sëmundjeve që mund të vijnë nga ushqimi. Kjo arrihet duke bërë që siguria e ushqimeve të garantohet duke marrë masa që të identifikohen dhe të eliminohen shkaqet që mund ta rrezikojnë atë që gjatë procesit të prodhimit të tyre, në ndryshim nga disa metoda të tjera që kontrollin e cilësisë e bëjnë duke shqyrtuar produktin përfundimtar.

HACCP bazohet në shtatë parime: analiza dhe identifikimi i rreziqeve të mundshme me karakter kimik, biologjik os emekanik; përcaktimi i pikave kritike të kontrollit që janë pikat gjatë procesit teknologjik të prodhimit ku siguria ushqimore mund të kontrollohet dhe eliminohet, përcaktimi i masave parandaluese për çdo pikë kontrolli; përcaktimi i procedurave për monitorimin në pikat e kontrollit; përcaktimi i veprimeve që duhet të kryhen për të eliminuar shkaqet e identifikuar; përcaktimi i procedurave për të verifikuar Nëse sistemi prodhues funksionon në mënyrë korrekte; përcaktimi i mënyrave dhe standarteve të regjistrimit dhe dokumentimit të sistemit HACCP.

Ideja e HACCP është zhvilluar që shumë vite me parë në SHBA, si mënyrë për të siguruar ushqimin e astronauteve gjatë fluturimit të tyre në hapësirë. Sot kjo qasje kontrolli është "certifikuar" nga shumë organizma ndërkombëtare të sigurisë ushqimore, si Administrata e Barnave dhe Ushqimeve në SHBA, Agjencia europiane e Sigurisë Ushqimore, Komisioni i Kodeksit Ushqimor, etj. HACCP tani përdoret gjerësisht si mënyrë e garantimit të sigurisë ushqimore nga kompani dhe biznese në shumë vende të botës. Edhe në Shqipëri ajo është pranuar dhe zbatuar nga një numër i kufizuar biznesesh agroushqimore. Sipas projektligjit të ri për ushqimin, pas dy viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, HACCP do të përdoret në mënyrë të detyrueshme nga të gjitha bizneset agroushqimore, kurse certifikimi i tij nuk është i detyrueshëm.

Vendosja e sistemit HACCP është jo e lehtë, sepse kërkon shpenzime të konsiderueshme, duke filluar me shpenzimet e konsulencës për vendosjen e tij e deri më investime në mjete dhe instrumenta.

- Në inspektoriatet e sigurisë ushqimore në qarqe mungojnë databazat për evidentimin, kontrollin dhe ndjekjen e problemeve të ndryshme, si fallsifikimi, ambalazhimi, tregtimi dhe importimi i produkteve ushqimore si dhe shkëmbimi i informacionit ndërrajonal.
- Standardet kombëtare të cilësisë dhe sigurisë të produkteve ushqimore nuk janë të harmonizuara me ato të BE-së.
- Shkalla e implementimit të sistemeve ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë si HACCP dhe ISO etj., është e pakët
- Vazhdon të jetë problem etiketimi edhe në gjuhën shqipe i produkteve ushqimore të importit, pasi subjektet importuese të tyre nuk zbatojnë VKM 554 "Për etiketimin e produkteve ushqimore të importit".
- Rreth 90 % e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë prodhuese në territorin e Shqipërisë inspektohen dhe monitorohen nga inspektoriatet e sigurisë ushqimore në drejtim të plotësishtimit

të kërkesave të legjislacionit në fuqi për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe interesave të konsumatorëve.

- Sipas VKM Nr. 604 "Për etiketimin e produkteve ushqimore", të gjithë subjektet prodhuese të produkteve ushqimore të licensuara nga inspektoriat i sigurisë ushqimore, bëjnë miratimin e etiketave të produkteve të tyre në MBUMK. Rreth 85% e subjekteve prodhuese ushqimore kanë të miratuara etiketat e produkteve të tyre dhe 10% janë në procedurë për miratim.
- Kontrollat e Inspektoriatit të Sigurisë Ushqimore janë pjesë e praktikave doganore, ku kryen kontrollin e produkteve ushqimore në drejtim të etiketimit dhe në gjuhën shqipe, si dhe marrëjn e mostrave dhe dërgimin e tyre për analize. Në drejtim të plotësimit të kërkesave të VKM Nr.554 "Për etiketimin e produkteve ushqimore të importit", kontrolli ka qënë i vazhdueshëm dhe rezultoi se rreth 70% e produkteve ushqimore të importuara janë të pajisura me etikete ose kundraetikete edhe në gjuhën shqipe. Në drejtim të nivelit të monitorimit të këtyre produkteve në doganë, vlerësohet se rreth 90% e tyre monitorohet nga Inspektoriatit i Sigurisë Ushqimore.
- Problem mbetet implementimi i sistemeve të cilësisë dhe sigurisë nga subjektet prodhuese të produkteve ushqimore, pasi për shkak të kostos së lartë vetëm 2% e tyre i kanë implementuar këto sisteme.

Shëndeti i kafshëve. Pas viteve 90, shpërberja e ekonomive të mëdha të përqendruara në ekonomi shtepiake krijoi premisa të favorshme për përhapjen dhe mbijetesën e patogjeneve të ndryshme dhe për ndryshimin e situatës epidemiologjike të vendit, duke rritur rrishtun e prekshmërisë së e shëndetit publik nga sëmundje zoonotike. Për më tëper, kontrolli i pamjaftueshëm i lëvizjes së kafshëve u shoqërua me përhapjen e shpejtë të sëmundjeve në të gjithë territorin. Për momentin Shqipëria është e lirë nga infeksioni i aftës epizootike, lija e dhurve, pluropneumonia kontagjioze e gjedhit, pesta e ruminanteve të vegjël, sëmundja vezikulare e derrave, si dhe ethet afrikane të derrave.

Disa sëmundje të listës së OIE janë prezente dhe shkaktojnë dëme ekonomike të konsiderueshme për blegtorinë e vendit si: Pseudopesti i shpendëve, Murtaja Klasike e Derrave., Anaplazmoza e gjedhit, Babezioza e gjedhit, Plasja, Tuberkulozi i gjedhit, Brucelozja e gjedhit, Brucelozja melitensis, Agalaksia kontagjioze, Varoatoza, etj. Po ashtu, prekshmëria e njerëzve nga sëmundje zoonotike ka aritur: salmonelozë afro 400 raste, brucelozë deri 700 raste, leishmanozë afro 100 raste, antraks 60 raste.

Nga rezultatet e gjurmimeve në lidhje me infeksionet e mësipërme të kryera në më shumë se 1/3 e popullimit të kafshëve (të imta për brucelozë, gjedhë për tbc) rezultoi një përhapje nga 0,64 %-5% për melitensin, dhe 0,19% për sëmundjen e tuberkulozit.

Për këtë arsye edhe kontrolli i këtyre infeksioneve tashmë është shumë i vështirë.

Aktualisht Shqipëria ka 322736 ferma blegtorale me kapacitete të ndryshme, ku mbarështohen 634000 krerë gjedhë, 2770000 krerë të imta, 152000 krerë derra, 6200000 shpendë. Kontrolli i sëmundjeve në kafshë, veçanërisht atyre zoonotike me rrezik dhe për njerëzit realizohet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve nga shërbimi veterinar.

Buxheti i profilaksisë veterinarë shërben për kontrollin e sëmundjeve të tuberkulozit, brucelozës, antraksit, murtajës klasike të derrit, realizimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve, monitorimit të ujrave dhe molusqeve si dhe realizimin e programit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale. Një sasi deri në 10% të buxhetit total shërben si rezervë vjetore e nevojshme për situatat emergjente (siç është shpërthimi dhe eliminimi i sëmundjeve, gripi i shpendëve).

Të gjitha sëmundjet e tjera prezente në Shqipëri, si infektive ashtu edhe parazitare me karakter jo endemik mbulohen nga vetë pronarët e kafshëve (fermerët).

Mbrojtja e Bimëve. Aktualisht kontrolli i prodhimeve të fermerëve për eksport mbështetet kryesisht në kontrollin vizual të tyre për të përcaktuar pastërtinë e tyre fitosanitare. Dërgimi i tyre

për në vendet e tjera, shoqërohet me certifikatë fitosanitare standarte, e njëjtë me atë të BE-së. Aktualisht lidhur me mbrojtjen e bimëve mund të nënvizohen këto çështje ose probleme:

- Është vetëm në fillimet e saj puna për krijimin e zonave të mbrojtura si një kërkesë kryesore për sigurimin e një prodhimi brenda standarteve dhe kërkesave të BE-së për eksportin e mundshëm të prodhimeve bujqësore. Kjo ka filluar në zonën e Divjakës për kulturën e patates.
- Prej vitesh monitorohet situata fitosanitare në kulturat bujqësore dhe për luftimin e parazitëve të veçantë (lista e të cilëve miratohet nga ministri) dhe fondi jepet nga buxheti i MBUMK. Përmendim luftimin e karkalecave, të minjve të arave, që kanë qenë dëmtues të rrezikshëm për kulturat bujqësore, si dhe të mizës së ullirit, etj. Por, copëzimi i sipërfaqes së mbjelljes të kulturave bujqësore shton së tepërmi edhe problematiken e situatës fitosanitare.
 1. Në vendin tonë ekziston një rrjet i gjerë i subjekteve importuese dhe tregtuese të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB). Po kështu, dhe struktura e PMB-ve që janë të miratuara për t'u përdorur, mbulon gjithë aspektet e mbrojtjes së kulturave nga parazitët. Aktualisht, në treg nuk gjenden PMB të skaduar, pasi të gjitha PMB-të gjendje janë asgjësuar që para 6 vjetësh me fondet e dhëna nga BE (Programi PHARE). Probleme të kësaj natyre nuk ka patur gjatë kësaj periudhe pasi subjektet tregtuese, sidomos ata importues janë treguar të kujdesshëm në futjen në treg të PMB-ve.
 2. Nuk kryhen analizat cilësore të PMB-ve, për përcaktimin e lëndës vepruese dhe të përmbajtjes së saj në produkt, si dhe të mbetjeve të PMB-ve në bimë, produkte bimore për arsye të mungesës së infrastrukturës laboratorike.
 3. Lëndët vepruese të PMB-ve të regjistruara në vendin tonë janë të përfshira në listën e BE-së si dhe heqjet nga qarkullimi të lëndëve aktive të caktuara nga BE janë pasqyruar dhe në vendimet që merren nga MBUMK për këtë problem.
 4. Gjithashtu, të gjithë PMB-të që tregtohen janë të regjistruara paraprakisht dhe me etiketa në shqip.

Krahas zhvillimeve pozitive të këtyre viteve, vërehen mangësi sidomos të aspektit cilësor, si:

- Në mjedisët shpesh të përshtatshme të magazinimit e të tregtimit të PMB-ve, që t'u përgjigjen parametrave dhe garantojnë shëndetin e njerëzve.
- Në mjetet spërkatëse të papërshtatshme që nuk u përgjigjen kërkesave të bujqësisë, pasi ka një raport shumë të zhdrejtë mes llojeve të tyre, ku mbizotërojnë pompat e shpinës. Kjo ka krijuar probleme sidomos në trajtimin me cilësi të pemëve frutore, vreshtave dhe serrave, pasi trajtimet kryhen thujse me pompa të thjeshta të shpinës.
- Në përdorimin pa kritere teknike të substancave kimike stimulantë të rritjes së bimëve dhe frutave, sidomos në perimet në serra dhe në pemëtari, ku niveli i përdorimit të tyre është akoma jo adekuat
- Në mungesën e këshillimit efikas për mbrojtjen e kulturave bujqësore nga parazitët, ku këshillimi kryhet kryesisht nga vetë tregtarët e PMB-ve. Difektet e këtij këshillimi kanë filluar të ndjehen kryesisht në serra, vreshta dhe në pemët frutore farore (molle), pasi dhe interesimi i fermerëve në këtë grup kulturash është më i madh.
- Në përdorimin e PMB-ve sipas rregullave, lidhur kjo me ruajtjen e shëndetit, asgjësimin e ambalazhit pas përfundimit të punës, etj. Veçanërisht ky problem qendron me përdorimin e PMB-ve të klases 1^a dhe ato fumigante, që shpesh përdoren nga persona që nuk kanë kualifikimin e duhur.
- Nuk realizohet monitorim i mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë bimore. Mungon kuadri normativ i nevojshëm për të rregulluar nivelet maksimale të mbetjeve (NMM), pasi implementimi i një pakete ligjore në këtë fushë kërkon investime të mëdha në ngritjen e laboratorëve të cilët do të kontrollojnë dhe përcaktojnë nivelin e mbetjeve të produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB-ve) në produktet bujqësore. Për këto arsye, ky kuadër ligjor mendohet që të fillojë të ndërtohet dhe aplikohet pas vitit 2010.

1.9 Këshillimi, kërkimi, transferimi i teknologjive dhe informacioni bujqësor

Shërbimi këshillimor. Sistemi i shërbimi këshillimor aktualisht përbëhet nga një mori ofruesish shërbimesh publike dhe private. Shërbimi publik është forma më e organizuar dhe dominuese e shtrirë në të gjithë vendin. Ai është pjesë e strukturave të MBUMK-së në nivel qendror dhe rajonal, i mbështetur edhe nga një rrjet qendrash informacioni. Në shkallë vendi, në këtë shërbim janë të punësuar rreth 245 specialistë bujqësie. Ky shërbim jep asistencë teknike, njohuri dhe informacion për të gjithë fermerët dhe operatorë të tjerë të interesuar në fushën e bujqësisë.

Stafi aktual i ekstensionit është përgjithësisht i ndërgjegjshëm dhe i aftësuar për detyrat e tij dhe zotëron një koncept dhe njohuri të mira mbi metodologjinë e ekstensionit. Ai mban kontakte të vazhdueshme me fermerët, nëpërmjet një programi të planifikuar aktiviteteve, si në bazë grupi ashtu edhe individuale. Në bashkëpunim me institucionet kërkimore shkencore përgatiten çdo vit dhe vihen në dispozicion të fermerëve 7-8 tituj broshurash me karakter teknik, si dhe shpërndahen një numër i konsiderueshëm fletëpalosjesh e materialeve të tjera informative.

Në përmbushje të nevojave dhe kërkesave të të interesuarve ekstensionit bujqësor publik zhvillon një program trajnimi i cili ka përfshirë kryesisht probleme të teknologjive të kultivimit të bimëve e mbarështimit të kafshëve, elemente të buxhetit të fermës, të menaxhimit financiar, të marketingut si dhe organizimit të fermave.

Në bashkëpunim me stafet kërkimore dhe fermerët ai ndjek dhe zbaton projekte të kërkimit në fermë, duke realizuar lidhjet ndërmjet punonjësve kërkimore, agjentëve të ekstensionit dhe fermerëve. Ai realizon, gjithashtu, një sërë aktiviteteve ekstensionit me fermerët, si demonstrime, dite-fushë, vizita, panairë dhe takime të tjera në grup, të strukturuar në planet vjetore të punës.

Kontaktet me fermerët realizohen me anë të qendrave të informacionit bujqësor të shtrira tashmë në të gjithë zonat më të rëndësishme bujqësore të vendit. Fokusi kryesor i këtyre qendrave është sigurimi (dhënia) e materialit informativ me cilësi të lartë. Aktualisht janë ngritur dhe funksionojnë 120 qendra të informacionit bujqësor. Fuqizimi dhe rritja e efektivitetit të punës së tyre do të mbetet fokus kryesor edhe për të ardhmen.

Kërkimi bujqësor dhe transferimi i teknologjive. Deri në mesin e vitit 2006 MBUMK ka pasur në vartesi 9 institute kërkimore. Objekti i punës në fushën e kërkimit bujqësor ka qenë rritja e rolit dhe efektivitetit të kërkimit bujqësor në zbatim të strategjisë dhe politikave për zhvillimin e bujqësisë në vend.

Me VKM Nr. 515, datë 19.07.2006 "*Për ristrukturimin e instituteve kërkimore - shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*", mbi bazën e shkrirjes së 6 prej instituteve kërkimore u krijuan pesë qendra të transferimit të teknologjive bujqësore (QTTB) në varësi të MBUMK-së: në Fushë Krujë, Vlorë, Shkodër, Lushnjë dhe Korçë. Nga ky ristrukturim, dy prej instituteve ekzistuese (Instituti i Kërkimeve të Zooteknisë-IKZ dhe Instituti i Perimeve dhe Patateve-IPP) u zhvendosen përkatësisht në QTTB Fushë-Krujë dhe Lushnjë.

Ky ristrukturim u shoqërua edhe me ndryshimin e objektivave të punës në të ardhmen, duke e vene theksin drejt transferimit të teknologjive në përputhje me nevojat, kushtet dhe prioritetet rajonale.

Ndër problemet më të rëndësishme më të cilat përballet shërbimi këshillimor mund të përmendim: (i) numri i kufizuar i ekstensionistëve (mesatarisht një ekstensionist për 2000 fermerë) dhe angazhimi i tyre me detyra të shumta jashtë fushës së tyre; (ii) sigurimi i mbështetjes financiare të nevojshme në formën e investimeve për qendrat e informacionit bujqësor dhe shpenzimeve operative për realizimin e aktiviteteve këshillimore; (iii) mosha mesatare e lartë e

ekstensionistëve dhe aftësitë e pakta të tyre në përdorimin e mjeteve kompjuterike dhe teknologjive të informacionit.

Shërbimi statistikor. Shërbimi statistikor në bujqësi është i organizuar në nivel qendror dhe rajonal. Sektori i Statistikës në MBUMK ka një përgjegjes dhe 3 specialistë. Në shkallë qarku funksionojnë 12 zyra rajonale statistikë me 47 punonjës, të cilat kanë në varësi 26 punonjësit e statistikës në çdo rreth. Pra, shërbimi statistikor aktualisht operon me 73 punonjës në shkallë vendi.

Çdo vit kryhen dy vrojtime në bujqësi me një zgjedhje prej 2800 fermerësh me aktivitete që përfaqësojnë rreth 375000 fermerët e vendit, një vrotim për aktivitetin e prodhimit në serra duke intervistuar rreth 600 fermerë që përfaqësojnë 5000 të tilla dhe një vrotim tjetër për aktivitetin e prodhimit në fermat e mëdha. Ndërsa për të vlerësuar agrobiznesin kryhen katër vrojtime monitoruese çdo vit. Deri tani janë bërë disa përparime në standardizimin e treguesve bujqësorë sipas EUROSTAT.

Ndër problemet më të rëndësishme me të cilat përballet shërbimi statistikor mund të përmendim: (i) adaptimi i gjithë sistemit statistikor sipas standarteve të vendeve të BE me synim sigurimin e statistikave të nevojshme për të monitoruar sa më afër zhvillimin bujqësor dhe rural të vendit; (ii) vëllimi i pakët i zgjedhjes që ndikon në shkallën e saktësisë së të dhënave në bazë qarku; (iii) mungesa e fondeve për të bërë vrojtime të veçanta për disa kultura si për vreshtin, për ullirin, për patatën etj.; (iv) mungesa e shërbimit nëpërmjet ngritjes së sistemit të internetit për të gjithë rrethet e vendit; (v) Përmirësimi i sistemit të raportimit duke kombinuar informacionin nga burime të ndryshme që kanë lidhje me të njëjtin tregues; (vi) mungesa e fondeve për hartimin e programeve kompjuterike të reja, për vrotimet që kryhen, në mënyrë që të përsoset informacioni që mund të merret prej tyre; (vii) numri i pamjaftueshëm punonjësve të statistikës bujqësore në nivel qendror, etj.

1.10 Tipare dhe tendenca zhvillimore kryesore

Prodhimi bujqësor dhe të ardhurat e fermës kanë pasur prirje të dukshme në rritje. Prodhimi blegtoral zë rreth 46% të prodhimit të përgjithshëm të sektorit, i ndjekur nga bimët e arave me rreth 44% dhe pemtaria me rreth 11%. Ritmet më të larta të rritjes së prodhimit vërehen në pemtari, ndjekur nga blegtoria, (Tabela 4).


Si rezultat i mungesës të disa faktorëve prodhues kryesorë, por edhe të efikasitetit të ulët të përdorimit të atyre ekzistues, produktiviteti, prodhimi dhe të ardhurat nga bujqësia mbeten akoma mjaft të ulta, krahasuar sidomos me vendet e BE-së. Bazuar në llogaritë kombëtare, vlera e shtuar e produkteve bujqësore dhe e zhvillimit rural është rreth 155 miliard lekë. Në bujqësi janë punësuar përafërsisht rreth 756,000 njerëz dhe vlera e shtuar vjetore për një të punësuar është afërsisht 200 mijë lekë ose 1,700 €. Kjo vlerë është mjaft e ulët, krahasuar me rreth 26,000 € për 15 vendet të BE-së (BE15) dhe 6,500 € për vendet e reja antare të BE-së. Vendin kryesor në të ardhurat nga ferma e zenë blegtoria me rreth 1.6 herë me shumë se të ardhurat nga kulturat e mbjella.

Pjesa dërrmuese e produkteve bujqësore përdoret kryesisht për nevojat vetiake të familjeve bujqësore, duke zhvilluar aktivitete bujqësore përgjithësisht të shumëllojshme dhe ekstensive. Ato vazhdojnë të vuajnë ende nga një sistem i pazhvilluar shërbimesh dhe infrastruktura fizike e dobët. Prioritet më të madh ata i japin plotësimin të kërkesave kryesore, ndërkohë që vërehen teprica të pakta produkteve bujqësore për treg. Prodhimet ushqimore kryesore janë drithrat (kryesisht gruri), perimet, patatet dhe fasulet. Si sipërfaqe, gruri zë vendin më të rëndësishëm, por

ai kontribuon pak në të ardhurat nga ferma. Dritherat janë pak të destinuar për treg, ndërsa perimet, patatet dhe frutat po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në sigurimin e të ardhurave monetare për fermat familjare. Kulturat foragjerë (misri foragjer dhe jonxha) zenë rreth 30-35% të sipërfaqes së fermës dhe po shtrihen akoma më shumë me zhvendosjen e interesit të fermerëve nga prodhimi kokërr drejt foragjereve.

Gjatë viteve të tranzicionit mund të identifikohën prirje të rëndësishme zhvillimore. Po t'i referohemi vitit 1992 si vit bazë, bazuar në të dhënat dhe studimet e kryera, dhe në grafikët vijues, disa prej këtyre prirjeve janë:

Grafiku 4: Tendenca e rendimenteve



grurit dhe konkurrencës së jashtme, ndërsa për duhanin edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve përpunuese në vend.

Rritje e vazhdueshme, e dukshme dhe graduale e sipërfaqes së mbjelle me foragjere dhe me patate, rritje dhe pastaj

një farë stabilizimi në sipërfaqen e mbjellë me perime. Kjo rritje i përgjigjet emergjencës dhe pastaj edhe rritjes së kërkesave për produkte blegtorale dhe për perime të freskëta.

Rritje të ndjeshme të sipërfaqeve të serrave për prodhim perimesh, në përgjigje të leverdisë së prodhimit të tyre dhe të deficitit të ndjeshëm të ofertës lokale së perimeve.


Rritje të ndjeshme të rendimenteve në foragjere, patate, qumësht lope e dhie, vezë dhe përgjithësisht në pemëtari dhe vreshta.

Rritje të shpejtë të numrit të drufrutorëve dhe sipërfaqes së mbjellë me vreshta (kjo e fundit sidomos pas vitit 1996). Për nga shpejtësia ky sektor ka realizuar rritjen më të madhe.

Vitet e fundit vihen re prirje të rritjes së numrit të fermave blegtorale të specializuara. Vihet re, gjithashtu, rritje e fermave me viça për majmëri me numër krerësh 5-10, por edhe lopë me 11-50 krerë, të fermave me dhi me numër nga 11-50 dhe dele mbi 500 krerë, çka flet për lindjen dhe përforcimin e prirjeve të specializimit bujqësor. Fermat blegtorale me mbi 5 krerë viça u rritën me gati 50% në vitin 2006 në krahasim me vitin 2004. Gjatë po kësaj periudhë pularitë me gjela deti u rritën me 10%, fermat me mbi 10 zgoj bletë u rritën me 38%, fermat me mbi 6 krerë lopë u rritën me 22%, fermat me mbi 6 dosa u rritën me 4%, numri i pularive pe mish me mbi 5000 pula u rrit me 18%, ndërsa është pakesuar numri i fermave me gica për majmëri me mbi 50 krerë për gati 60% si dhe është rritur numri i pularive të mëdha me mbi 50 mijë krerë me 50%.

Rënie e dukshme dhe e vazhdueshme, por graduale, e sipërfaqes së mbjellë me bimë arash, në veçanti me grurë dhe duhan. Kjo për shkak të leverdisë së ulët ekonomike të

Grafiku 5: Tendenca e sipërfaqeve të mbjella dhe rrënjëve ose numrit të kafshëve




Vihet re kristalizimi i disa poleve të zhvillimit bujqësor, siç janë qarku i Korçës, Beratit dhe Dibres për pemëtarinë, ai i Fierit për mbarështimin e lopës, Elbasani, Shkodra, Dibra dhe Vlora për të imtat, Shkodra dhe Lezha për derrat, Fieri Tirana dhe Durrresi për perimet, Fieri, Bërati, dhe Vlora për rrushin, etj., të cilat flasin për hapa të rëndësishëm në specializimin rajonal në prodhimin e produkteve të ndryshme bujqësore.


Vihet re një tendencë e qartë e rritjes së eksporteve, por ato dominohen nga produktet e përpunuara. Eksportet nga bujqësia kanë një prirje të lehtë rritjeje, që dominohet nga perimet, megjithatë bëhet fjale për volumë të kufizuara eksportesh. Produktet me origjinë nga blegtoaria janë më pak të eksportuarat, bile ka një tendencë të paqartë që me shumë anon nga rënia e eksporteve me origjinë këtë degë të bujqësisë.

Grafikët që vijojnë ilustrojnë këto prirje.

Grafiku 6: Trendi i eksporteve




Grafiku 8: Struktura e eksporteve në 2006



Burimi: Raporti Vjetor 2001-2006, MBUMK

Grafiku 7: Dinamika e raportit import/eksport



Burimi: Raporti Vjetor 2001-2006, MBUMK

Nga grafiku 7 vihet re një prirje pozitive përsa i takon zbutjes së raportit midis importeve dhe eksporteve, kryesisht për shkak të rritjes së ekpoteve. Ndërsa nga grafiku 8 duket qartë se eksportet ende sundohen nga produkte jo të mirëfillta bujqësore, si bimët medicinale, peshku i konservuar, lëkurët, ujë mineral, etj.

Konkurruesmeria e pakët e produkteve tona, që lidhet kryesisht me cilësinë e ulët, por edhe me pasigurinë ushqimore dhe koston e lartë të prodhimit, janë faktorët kryesorë të brendshëm që kufizojnë eksportet. Këtë e verteton edhe fakti që produktet që eksportohen më shumë kanë pak kërkesa për sigurinë ushqimore, ose i garantojnë ato në një shkallë më të lartë (peshku i konservuar, bimët medicinale, duhani, shalqini, etj.)


Kohët e fundit vihet re një forcim i dukshëm i praktikave të bujqësisë organike. Të pakten në pikëpamje formale bujqësia organike fillon me krijimin e Shoqates së Bujqësisë Organike në vitin 1997. Kjo shoqatë filloi të mbeshtesë produktet organike me ndihmën e projekteve me financime të huaja (FiBL, Avalon). Në Tiranë ka edhe një dyqan për produkte organike. Sot janë rreth 93 ferma organike, ndërsa sipërfaqja e destinuar për produkte organike

është gati 1074 ha. Pjesa më e madhe e fermave dhe e sipërfaqes është e çertifikuar nga SHBO, ALBINSPEKT, ose trupa të huaja. Produktet kryesore organike janë bimët mjekësore, vaji i ullirit, frutat dhe rrushi, perimet dhe qumështi, disa prej të cilëve janë eksportuar edhe në vende të tjera si Zvicër, Hollandë, etj.. Gjithashtu prodhohen sasi më të vogla vezësh, djathi, vere dhe mishi. Për të mbështetur bujqësinë organike në Shqipëri Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9199, datë 26.2.2004 "Për prodhimin, përpunimin, çertifikimin dhe marketingun e produkteve "bio". Lëvizja biologjike në Shqipëri është pasuruar edhe me aktorë dhe aktivitete të reja. Kështu kemi AlbInspekt, një shoqëri shqiptare që bën çertifikimin e produkteve organike, por edhe trupa të huaja çertifikimi, si BioInspecta, BCS Öko Garantie, CERES, SKAL, ICEA dhe Italian Codex. BCS, CERES, SKAL dhe Italian Codex kanë çertifikuar thuajse vetëm eksportuesit e mëdhenj të bimëve mjekësore dhe esencave, ndërsa BioInspecta ka çertifikuar dy raste eksporti të suksesshme, erëzat e freskëta dhe vajin e ullirit organik, që të dy këto produkte për tregun zvicerian. Kemi edhe BioAdria, një rrjet kërkimi dhe shërbimi këshillimor që përbëhet nga shumë ekspertë në teknikat e prodhimit organik është përqëndruar në kërkimin shkencor dhe shërbimin e këshillimit që i ofrohet fermerëve organikë. Të tjerë aktorë po hyjnë në lëvizjen organike, siç është rasti i Shoqatës Shqiptare për Hortikulturën Organike "BioPlant". Bujqësia organike në Shqipëri po përfiton edhe nga veprimtaritë e kryera nga të tjerë donatorë, si Oxfam, GTZ, SNV, FAO, etj. Në kuadrin e INTERREG IIIa, janë zhvilluar aktivitete për zgjerimin e njohurive të ekspertëve dhe fermerëve shqiptarë për teknikat e bujqësisë organike, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen biologjike dhe kompostimin, si dhe për trajnimin e punonjësve të shërbimit këshillimor publik. Aktualisht është në veprim edhe projekti SASA-Sustainable Agriculture Support to Albania, i financuar nga Kooperacioni Zvicerian për Zhvillim.

1.11 Mbështetja financiare për bujqësinë

1.11.1 Shpenzimet dhe investimet buxhetore për bujqësinë dhe ushqimin

Grafiku 9: Dinamika e investimeve publike në bujqësi



Burimi: Vjetari Statistikor, 2006, MBUMK

Siç tregon edhe grafiku 9, pas një trendi pozitiv deri në vitin 2004, fondet për bujqësinë kanë ardhur në ulje, me uljen më të madhe të regjistruar në vitin 2005.

Ulja e investimeve, megjithë rritjen e lehtë të shpenzimeve, është një paralajmërim serioz për të ardhmen e mbështetjes financiare të bujqësisë. Këmbanat po bien fort dhe është mirë të merren masa sa më parë.

Në vazhdimësi, kontributi shtetëror për bujqësinë ka qenë mjaft i kufizuar, ai është sjellur në rreth 1-1.5% të buxhetit, dhe akoma më pak në raport me PBB. Përgjithësisht, investimet në bujqësi janë mbështetur me hua dhe grante të huaja. Siç e tregon edhe tabela e mëposhtme, komponenti i investimeve të brendshme nuk ka një prirje të qartë në rritje, ato paraqiten në nivele disi të stabilizuara, kurse investimet e huaja janë ato që paraqesin një dinamikë të paqartë dhe të pasigurtë, për të ardhur në një rënie të ndjeshme, gati përgjysmim, në vitin 2005. Ky fakt thekson rrezikun që në të ardhmen bujqësia rrezikon të mbetet pa mbështetjen e duhur financiare të huaj, nëse nuk punohet me urgjencë dhe me program për të identifikuar projekte të reja, për t'i prezantuar ato para donatorëve, si dhe për të përmirësuar klimën e

biznesit, për të nxitur investimet private në kompensim të investimeve potencialisht munguese nga donatorët.

Nëse do të bënim një analizë më të hollësishme, mund të identifikohet lehtë se investimet më të mëdha kanë shkuar dhe shkojnë në rehabilitimin ujitjes dhe të kullimit, pasuar nga investimet për tokën dhe shërbimet bujqësore.

Tabela 4: Investimet private në bujqësi me sipas burimit

Burimet	2005	2006	% e rritjes
Kursimet e veta	1679585	1209351	72
Kredi bankare	48278	411932	853
Totali	1727863	2077251	120.2

Burimi: Vjetari Statistikor, 2006, MBUMK

sipas vlerësimeve më të fundit, duket se ende nuk janë në gjendje të bëjnë investime private në shkallë të madhe. Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, investimet në të gjitha format private, publike dhe ato në përmes kredive bankare duket se nuk arrijnë të kalojnë kufirin 0.3 për qind ndaj PBB-së, një shifër kjo shumë e vogël që nuk ka nevojë për koment. Largësia e biznesit bankar nga zonat rurale dhe gjithë problematika e përmendur gjatë kësaj analize të shkurtër, përbëjnë faktorët kryesorë që qëndrojnë prapa kësaj shifre të vogël.

1.11.2 Investimet dhe kreditimi në bujqësi dhe agroindustri

Bujqësia dhe agro-industria, edhe pse degë të rëndësishme dhe me potencial të madh,

Kutia 6: Frutikultura në fokusin e politikave

Në vitin 1997 filloi për herë të parë në bujqësinë shqiptare pos-komuniste një skemë mbështetje direkte për fermerët. Kjo është skema për nxitjen e zhvillimit të vreshtarisë, pemëtarisë dhe ullirit, e sanksionuar me VKM nr. 3 datë 10.1.2007. Sipas këtij vendimi. Fermerët shqiptare që mbjellin jo më pak se 3 dynym vreshta ose pemëtore të reja dhe ata që mbjellin jo më pak se 2 dynym ullishte të reja përfitojnë falas 50 mijle lekë për dynym (për vreshta) dhe 35 mijle lekë për dynym (pemë frutore ose ullishta). E drejta e përfitimit të mbështetjes fitohet pas një gare ose konkurrimi mbi bazën e gjashtë kriterëve të vlerësuar me pikë:

- ✓ Vendndodhja, 15 pikë
- ✓ Specia, 10 pikë
- ✓ Kultivari, 10 pikë
- ✓ Afati i ngritjes ose ndërtimit, 10 pikë
- ✓ Sipërfaqja, 35 pikë
- ✓ Teknologjia, 20 pikë

Fitues shpallen, me anën e një komisioni vlerësues, fermerët që sigurojnë 70 pikë e sipër. Kjo skemë mbështetje është pritur shumë mirë nga fermerët, por jo vetëm ata dhe pritet të ndikojë dukshëm mbi prodhimin mbas 3-4 viteve. Nuk është bërë ndonjë analizë paraprake kosto-përfitim, kështu që vetëm me vonë pritet të vlerësohet plotësisht efektiviteti i skemes. Në të ardhmen dhe Në raste të ngjashme duhet të shihet, sidomos, si mund të përmirësohen kriteret dhe pesha e tyre në seleksionimin e aplikimeve, duke inkluduar si të tilla ndoshta edhe përmirësimin e cilësisë dhe mbrojtjen e tokës, për të qënë sa me shumë në linjë me politikën e re europiane për bujqësinë.

Pas një rritjeje të dukshme në raport me vitin 2000, niveli i investimeve në industrinë agro-përpunuese është në nivele të stabilizuara, si rezultat i mungesës së kreditimit për investitorët vendas dhe interesit të pamjaftueshëm nga ana e investitorëve të huaj në këtë drejtim. Për më tepër, zhvillimi i industrisë agro-përpunuese është i kushtëzuar edhe nga oferta jocilësore ose në sasi të pamjaftueshme e prodhimeve bujqësore që përdoren si lëndë të para, si dhe nga konkurrenca me çmime të ulëta e produkteve të importuara dhe me cilësi të diskutueshme.

Krahas këtyre, mbështetje financiare për fermerët dhe bujqësinë ofrojnë edhe një numër agjencish dhe institucioneve të financës rurale. Financat rurale në Shqipëri, veçanërisht ato në mbështetje të fermerëve, aktualisht dhe në një të shkuar jo shumë të largët, mund të shihen përmes kontributeve të disa aktorëve, projekteve ose agjencive si: Fondi i Financimit të Zonave Malore, Programi i Zhvillimit të Zonave Malore, projekti 2KR, Projekti i Shërbimeve Bujqësore, projekti Mbështetje për Prodhimin Bujqësor (FAO), projekti SBCA (USAID, mbyllur), Unioni i Shoqërive të Kursim Kreditit (USHKK), SASA (Mbështetja e Zhvillimit të Qendrueshëm Bujqësor në Shqipëri, një numër projektesh të tjera të pavarura të shoqatave të ndryshme ndërkombëtare, si edhe të sistemit bankar dhe vetë fermerëve. Mbështetja totale e tyre ka qenë e konsiderueshme, por gjithësesi e pamjaftueshme. Ata kanë mbështetur fermerë individuale, shoqata fermerësh, agrobiznese të ndryshme, me grante, hua dhe kredi për teknologji, farëra dhe fidana, raca, marketing, njohuri dhe asistencë teknike. Aktualisht janë më aktivë Fondi i Financimit të Zonave Malore, Programi i Zhvillimit të Zonave Malore dhe USHKK. Nuk ka të dhëna të sakta se sa mund të jetë numri i përfituesve, por ata janë disa mijra.

Në të ardhmen pritet të injektohen me shumë financa në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit. Përveç dy projekteve në vazhdim, forcimi dhe shtrirja më e gjerë rajonale e USHKK mbetet si alternativë kryesore. Krahas kësaj sistemi bankar do të duhet të luajë më shumë rol, por për këtë duhet të nxitet tregu i tokës dhe kooperimi midis fermerëve, mbasi rreziku për moskthimin e kredive nga fermerët është i lartë dhe kostoja e transaksioneve të kredive për shkak të numrit të madh të fermerëve do të ishte e madhe dhe frenuese. Garantimi i konkurrencës së lirë, për shëmbull duke zbatuar pa mëdyshje legjislacionin mbi sigurinë ushqimore, sidomos në sektorin e agropërpunimit, do të nxishte investimet në këtë sektor edhe përmes huamarrjes. Përmirësimi i cilësisë së informacionit për tregun dhe ndihma për të identifikuar aktivitete të reja fitimprurëse dhe për të hartuar plane të mira biznesi do të ndikonte në rritjen e huamarrjes nga burime private. Mund të diskutohet edhe alternativa e kanalizimit të ndihmës shtetërore përmes sektorit bankar, për të siguruar një efikasitet dhe normë kthimi më të lartë të huave.

Ndërkohë, duhet të gjenden mënyra për të bërë aktive kursimet e fermerëve, që mendohet se janë disa qindra milione €. Ndiha direkte, si Në rastin e skemes së vreshtarisë dhe pemtarisë, është efektive edhe në këtë drejtim, sepse krahas parave të marra falas, fermerët do të duhet të investojnë edhe nga kapitali i tyre, për të kompletuar investimin ose për ta shfrytëzuar atë.

Përvojat e huaja (Rasti *Grameen Bank*-Bangladesh, vende si Rumania, etj.) mund të jenë të vlefshme edhe për forcimin e sistemit të financave rurale të Shqipërisë. Reformat në sistemin bankar mund të jenë gjithashtu të vlefshme. Rregullimi i portofoleve të huas bankare (duke fiksuar një minimum kontributi të detyrueshëm për bujqësinë, duke vendosur tavane për madhësinë e huas në mënyrë që të ketë me shumë hua të vogla dhe të përfitojnë me shumë fermerë të vegjël. Ka sugjerime që nxitja e huajtjes dhe kursimit në grup fermerësh mund të japë rezultate në mobilizimin e financave të lira. Në këtë rast është e rëndësishme që grupet të formohen mbi bazën e interesave të përbashkëta ose të përfshijë individë të përafërt (Në rastin e **Grameen Bank** deri 5 fermerë me deri 0.5 ha tokë). Po ashtu, shoqërimi i huas me shërbime të tjera të nevojshme për fermerin mund të ketë efekte në rritjen e huamarrjes bankare nga fermerët e vegjël.

1.11.3 Politikat kryesore për bujqësinë dhe rezultatet e tyre

Gjatë periudhës së kaluar e deri me sot, politika për bujqësinë mund të cilësohet si një mbështetje kryesisht indirekte dhe është fokusuar në këto aspekte kryesore:

i-Rehabilitimi i infrastrukturave

ii-Krijimi i një mjedisi pro-biznes

iii-Mbështetja e shërbimeve ndaj fermerëve

iv-Forcimi institucional

Mbështetja indirekte nënkupton mungesën relative të kredive dhe granteve që u shkojnë fermerëve Përmes qeverisë. Kryesisht mbështetja indirekte është fokusuar në reabilitimin e infrastrukturës ujitëse dhe kulluese, por edhe asaj tregtare si dhe të laboratorëve të kontrollit. Të dhënat e periudhës 2000-2005 tregojnë se rreth 37% e financimeve të huaja i përkasin infrastrukturës ujitëse, ndërsa po të përfshijme aty edhe tregjet dhe laboratorët financimi e kalon shifren 40% të totalit.

Programi PHARE dhe 2KR janë dy komponentet e tjerë të rëndësishëm të investimeve të huaja të kësaj periudhë, me rreth 25% të totalit, që kanë kontribuar mjaft dhe në furnizimin me inpute bujqësore (makineri, pesticide, farëra, etj.).

Në sajë të këtyre politikave, është arritur të përmirësohet potenciali ujitës i bujqësisë dhe të garantohet në nivele të mira edhe kullimi i tokave. Këto politika konsiderohen si më të domosdoshmet në këtë periudhë.

Krijimi i një mjedisi pro-biznes ka synuar kryesisht në privatizimin dhe liberalizimin e ekonomisë dhe të bujqësisë në veçanti. Ndarja dhe privatizimi i tokave dhe pasurive të ish-kooperativave dhe ish-fermave bujqësore, si dhe të aseteve të ndërmarrjeve të agroPërpunimit, së bashku me liberalizimin e vendimmarrjes biznesore përbëjnë shtyllat e politikës pro-biznes. Këtu një rol të veçantë kanë pasur edhe përjashtimet ose lehtësirat fiskale për bujqit, si dhe regjistrimi dhe kadastrimi i tokave bujqësore që pritet të marre fund së shpejti. Në këtë kuadër mund të citojmë dhe politikën për zhvillimin e sistemeve të informacionit, ku janë anagazhuar një numër donatorësh, si BB, USAID, BE, GTZ, etj.

Mbështetja e shërbimeve ndaj fermerëve ka pasur të bëjë kryesisht me këshillimet teknike, si kundër mund të Përmendim projektin hollandez, por jo vetëm, për ekstensionin bujqësor, Përmes të cilave u aftësuan dhe u trainuan me mijra femere dhe specialistë të bujqësisë dhe u arrit të ristrukturohet dhe konceptohet një politikë dhe sistem i ri për shërbimin këshillimor bujqësor në vendin tonë.

Forcimi institucional ka konsistuar në paisjen me dijë dhe përvoja të reja teknike dhe administrative Përmes trainimit dhe kualifikimit të stafeve teknike dhe administrative të Ministrisë dhe strukturave të saj. Në këtë kuadër një mbështetje të veçantë ka përfituar bujqësia jonë në drejtim të hartimit të politikave dhe programeve të zhvillimit me asistencë të huaj, paisjen me mjete dhe instrumenta punë, ngritjen dhe modernizimin e laboratorëve të kontrollit dhe analizës së sëmundjeve dhe ushqimeve, hartimin e ligjeve të ekonomisë së tregut, dhe së fundmi edhe për përafrimin e legjisllacionit tonë bujqësor me atë të BE.

Në vitin 2007, për herë të parë, bujqit shqiptarë përfituan nga një skeme granti, siç ishte skema e mbështetjes së pemëtarisë dhe vreshtarisë, cila pritet të këtë efekte të ndjeshme në rritjen e prodhimit të frutave, ullirit dhe të rrushit, po ashtu edhe të ardhurave të fermerëve.

Politikat bujqësore të deritanishme kanë dhënë rezultate pozitive të ndjeshme. Rendimentet e kulturave bujqësore janë rritur dukshëm, shpesh herë edhe në mënyrë spektakolare, bujqësia është një sektor i hapur për investime, iniciativa e lirë është zoteruese në bujqësi, mentaliteti dhe aftësitë biznesore të fermerëve dhe agropërpunuesve janë zhvilluar në masë të konsiderueshme, disponibiliteti i ujit për vaditje dhe inputeve të tjera bujqësore është rritur, resurset bujqësore

tentojnë të përdoren në drejtimet më eficiente dhe tregu jep sinjale të rëndësishme për orientimin e strukturave prodhuese dhe marrjen e vendimeve të biznesit.

1.12 Analiza e rrjetit të aktorëve të sektorit

Në rrafshin planifikues, zbatues dhe teknik, Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ka luajtur rol kyç për zhvillimin e bujqësisë. Qeveria dhe institucione të tjera të larta të shtetit kanë siguruar mbështetje politike dhe strategjike. Edhe ministri të tjera të linjës kanë luajtur rol të spikatur, ku veçohen Ministria e Financës dhe ajo e Ekonomisë.

MBUMK ka treguar performancë të kënaqshme, me një staf me nivel teknik të mirë dhe të motivuar mjaftueshëm përmes mekanizmave financiarë. Përgjithësisht, në të ardhmen performanca ka nevojë të përmirësohet, në prizmin e angazhimeve të reja integruese, hartimin dhe zbatimin e politikave më efektive zhvilluese. MBUMK duhet të tregojë në të ardhmen një angazhim më të lartë në zbatimin më efektivitet më të mirë të detyrave të veta. Për këtë gjykojmë së do të ishte i nevojshëm edhe një plotësim fleksibël, gradual, i kapaciteteve ekzistuese me njohuritë më të reja dhe me aftësi me dinamike. Kjo mund të bëhet përmes rekrutimeve të studiara shtesë ose programimeve trainuese të targetuara mirë për të përballuar më efektivitet angazhimet kritike aktuale dhe perspektive. Në këtë kuadër, po thellohet dhe në të ardhmen do të thellohet akoma më shumë karakteri pjesëmarrës i aktiviteteve planifikuese, monitoruese, zbatuese dhe vlerësuese të MBUMK, si shprehje e dialogut demokratik më të gjithë aktorët e zhvillimit, me fermerët dhe grupimet e tyre në rradhe të parë. Roli lehtësues i zhvillimit i MBUMK do të forcohet më shumë edhe përmes strukturave të saj periferike, edhe qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore, të cilat pritet të marrin anagazhime më të fuqishme në të ardhmen.

MBUMK ka pasur mbështetje konstante dhe efektive nga një numër shumë i madh aktorësh dhe partnerësh të tjerë për zhvillim, si BB, USAID, BE, FAO, GTZ, Kooperacioni italian, ai zviceran, SNV, Kooperacioni Spanjoll, Qeveria Japoneze, etj. Këta dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm kanë siguruar që bujqësia shqiptare të zhvillohet dhe strukturohet në mënyrë të qëndrueshme në kuadrin e një tregu dinamik dhe në një sistem rregullash të reja. Ajo ndan me to me shumë realizëm dhe mirënjohje çdo progres që ka bërë deri sot bujqësia shqiptare në rrugën e saj drejt ekonomisë së tregut dhe, tashmë, edhe drejt integritimit evropian.

Në kuadrin e zhvillimeve të reja po përmirësohen, dhe do të duhet që të përmirësohen akoma më tej komunikimi, bashkërendimi dhe shpërndarja e informacionit midis MBUMK dhe ministrive të tjera të linjës, por edhe me partnerët ndërkombëtarë. Ky komunikim do të duhet të thellohet në të ardhmen jo vetëm në rrafshin programues, por sidomos atë operativ dhe implementues. Kjo do të garantonte mbështetje të vazhdueshme të bujqësisë më ide dhe projekte zhvilluese, të cilat mbeten kritike për bujqësinë tonë edhe për një kohë relativisht të gjatë. Kjo do t'i shërbente, gjithashtu, ristrukturimit më të mirë të totalit të mbështetjes, fokusimit më të mirë të saj në prioritetet e zhvillimit, shmangjes të mbivendosjes së kontributeve dhe përpjekjeve të secilit prej aktorëve. Që në vitin 2006 MBUMK ka filluar aktivitetet e saj për realizimin e këtyre pikësnyimeve, me ndihmën edhe të disa aktorëve të spikatur, që ndihma e donatorëve të bëhet edhe më efektive në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, MBUMK po bën përpjekje që të evidentojë, lehtësojë dhe skedojë të gjitha kontributet e tjera të panjohura ose të paevidentuara deri sot, që parashikohet të jenë të konsiderueshme, me qëllim që t'i bëjë ato pjesë të strategjisë së zhvillimit të bujqësisë në të ardhmen.

1.13 Analiza SWOT e sektorit

Koha ka dëshmuar dhe studimet tashmë kanë evidentuar se sektori bujqësor dhe agropërpunës aktualisht karakterizohet nga disa tipare mjaft pozitive, që përbëjnë njëkohësisht anët e forta të tij. Këto anë janë bazike për tu marre parasysh në aktivitetet programuese zhvilluese, por edhe për të justifikuar atë optimizëm dinamik që mbështet progresin e sigurtë të bujqësisë shqiptare. Më kryesoret e këtyre anëve janë:

i-Bujqësia dhe agropërpunimi janë thujse një *sektor tërësisht privat*, gjë që përben garancinë bazë për iniciativën e lirë zhvilluese. Sipërmarrja e lirë ka krijuar dhe do të krijojë edhe në të ardhmen shanse të mëdha për inovacion, mbështetje konstante nga partnerët ndërkombëtare dhe operatorët e ndryshëm të tregut financiar në zhvillim. Sipërmarrja e lirë është garancia më e madhe për zhvillim të qendrueshëm të bujqësisë shqiptare.

ii-Shqipëria ka kushte klimatike, mikroklimatike dhe tokësore të përshtatshme, resurse biologjike të pasura dhe të larmishme, të cilat janë bazë për aktivitete bujqësore të shëndetshme dhe produktive.

iii-Vendi ynë ka një *traditë bujqësore të vjetër dhe me vlerë*, e cila ndihmon efektivisht në planifikimet strategjike zhvilluese dhe premtan që bujqësia do të jetë zeje e rëndësishme edhe në të ardhmen.

iv-Vendi ynë ka një *popullsi bujqësore të edukuar relativisht mirë*, gjë që premtan për efektivitet dhe produktivitet të kënaqshëm në bujqësi.

v-Bujqësia jonë ka pasur një *mbështetje të konsiderueshme teknike dhe financiare* përgjatë tranzicionit të saj të vështirë, e cila jo vetëm ka zgjidhur probleme dhe situata të vështira, por ka krijuar edhe premisa të reja për zhvillime më efektive dhe më të qendrueshme.

Një strategji realiste duhet të identifikojë dhe vlerësojë objektivisht edhe dobësitë e sektorit. Sektori duket se vuan edhe nga disa dobësi të brendshme, ose të krijuara me kalimin e kohës, të cilat mendohet se jo vetëm luajnë një rol negativ në ritmet e zhvillimit, por edhe i japin atij disa tipare karakteristike. Këto dobësi të sektorit janë:

i-Ferma e vogël dhe e fragmentizuar. Dihet se kjo e ka burimin tek potenciali i pakët i tokës bujqësore në Shqipëri, por edhe në tiparet e reformës së tokës që u krye pas vitit 1990. Kjo dobësi ka luajtur dhe pritet të luajë rol kyç frenues në zhvillimin e tregut të kredive për fermerët, të marketingut agrar dhe të industrisë përpunuese, por edhe për investimet e huaja direkte në bujqësi. E rëndësishme është që strategjia e bujqësisë duhet të integrojë politika dhe përpjekje që të reduktohen sa me shumë efektet negative të kësaj dobësie.

ii-Një numër shumë i madh fermash dhe një popullsi e madhe bujqësore, janë padyshim një dobësi e sektorit. Për pasojë, menaxhimi i sektorit është më i vështirë, punësimi efektiv bëhet me problematik, administrimi i mbështetjes është më i kushtueshëm, rregullimi i sektorit vështirësohet së tepërmi.

iii-Një *brez i ri jo sa duhet i apasionuar pas bujqësisë*, mund të krijojë probleme të trashëgimisë së traditës, e cila mund të ketë efekte mbi zhvillimin e qendrueshëm të burimeve prodhuese, kryesisht të tokës bujqësore.

iv-*Diversifikimi i lartë i prodhimit në fermë*, është tipari më themelor që bie në sy në fermën e vogël shqiptare. Kjo vjen për shkak të pasigurisë ushqimore, por edhe për shkak të rrishtit të tregtar të konsiderueshëm dhe vështirësive të ndryshme të marketingut agrar.

v-*Mungesa e ndjeshme e mbështetjes financiare shtetërore të drejtpërdrejtë.* Në këto vite fermeri shqiptar ka pasur më shumë mbështetje indirekte: privatizimi, liberalizimi, infrastruktura, këshillimi, kredi për mjete, grante, zakonisht në masë dhe numër të kufizuar dhe jo nga shteti, etj. Nuk ka pasur kredi apo subvencione të drejtpërdrejta, jo politika të drejtpërdrejta të produkteve, të inpueteve bujqësore, të tokës, të eksporteve, etj.

Megjithatë, sektori ka mundësi të përfitojë nga programi i qeverisë për rruget rurale, me efekte të ndjeshme në marketingun e produkteve, nga investimet e mëdha rehabilituese të ujitjes dhe kullimit, nga potenciali i pashfrytëzuar i agropërpunimit (veçanërisht në zonat rurale), nga mbështetja për nxitjen e bashkëveprimit reciprok të fermerëve, nga investimet e kryera dhe ato të programuara për tregjet me shumicë dhe tregjet rurale, nga asistenca shtetërore këshilluese dhe orientuese dhe nga aktivitetet kontrolluese dhe çertifikuese të shtetit.

Në mënyrë të veçantë, sektori i bujqësisë ka mundësi të mëdha të përfitojë një mbështetje të madhe zhvilluese nga procesi i integritit evropian, nga zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme dhe nga zbatimi i MSA pas ratifikimit të plotë të saj. Si vend potencial për antarësim në BE aktualisht ekonomia jonë, përfshirë edhe bujqësinë dhe agropërpunimin, mund të përfitojë nga dy komponentët e parë të programit **IPA**. Me ngritjen e statusit të Shqipërisë nga vend potencial në vend kandidat të BE përfitimet priten të jenë akoma më të mëdha, mbasi atëherë **IPA** kompletohet dhe vendi ynë mund të përfitojë në të tërë komponentet e këtij programi paraadherues. E rëndësishme është që të përmbushen hapat e nevojshëm dhe kritike për këtë përfitim potencial, siç është **Agjencia e Pagesave** (edhe një numër kushtesh të tjera), e cila ndonëse do të aktivizohet në kuadrin e zhvillimit rural, do të mbështesë fuqishëm edhe bujqësinë.

Njëkohësisht, një sërë rreziqesh kërcënojnë që zhvillimet në sektorin bujqësor dhe atë agropërpunues të jenë më të ngadalta ose më të pasigurta:

a-Zvarritja e konflikteve pronësore dhe e kompensimit të ish-pronarëve. Kjo tenton ta mbajë të lartë tensionin dhe pasigurinë pronësore, pra të pengojë përmirësimin e klimës së biznesit, dhe të vështirësojë zhvillimin e tregut të tokës, etj.

b-Shterrja e projekteve dhe programeve të huaja për bujqësinë dhe ushqimin. Programet aktuale mbyllen pothuaj të gjitha deri në vitin 2009 dhe nëse nuk identifikohen programë të reja, bujqësia rrezikon që në vitin 2010 të mbetet pa mbështetje me projekte të rëndësishme që financohen nga donatorët. Kjo do të thotë që është emergjente të punohet në nivel strategjik, por edhe në nivele të tjera për të identifikuar, përpunuar dhe propozuar projekte të reja, për të cilat bujqësia dhe ushqimi kanë nevojë ende.

c-Mos kryerja në kohë e përputhjes së legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire*. Kjo sepse ekspertiza lokale për ta bërë këtë është jo vetëm e pamjaftueshme, por edhe kostoja dhe volumet e punës janë të konsiderueshme. Kjo ve para përgjegjësisë së programimit, implementimit dhe monitorimit konstant dhe korrekt të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me këtë anë të procesit të integritit.

d-Mos stafimi dhe rekrutimi i nënpunësve të rinj në moshë, të shkolluar së fundmi, sipas procedurave dhe rregullave plotësisht korrekte, më energji dhe potenciale dinamike dhe bashkëkohore, që është e domosdoshme jo vetëm për të ruajtur përvojat dhe kulturat e vlefshme të punës në administratën civile, por edhe për të sjelle frymë të re, dinamizem të ri, qëndrimë të reja dhe angazhimë të reja në tërë punën zhvilluese dhe integruese të bujqësisë.

e-Mostrajtimi i bujqësisë si sektor prioritar. Kjo do të bënte që mbështetja shtetërore financiare për bujqësinë të ishte nën nivelin e kërkuar. Bujqësia dhe agropërpunimi mbeten motori kryesor i zhvillimit ekonomik të vendit dhe mbështetja e pamjaftueshme e saj do të ndikonte në shpejtësinë e rritjes ekonomike dhe, njëherësh, atë të reduktimit të varfërisë në vend.

Natyrisht këto janë vetëm disa rreziqe në potencë, por që mund të shmagen, po të kihen parasysh mirë dhe të merren masat e duhura. Në kuadrin e SSBU, shmangja e këtyre rreziqeve do të ishte jetike për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit.

KAPITULLI 2:

VIZIONI, PRIORITETET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

2.1 Vizioni

Sektori bujqësor dhe ai i agropërpunimit duhet të arrijnë një nivel më të lartë prodhueshmërie dhe konkurrueshmërie, si në tregun vendas edhe në atë ndërkombëtar, mbi bazën e përmirësimit të kushteve për veprimin e iniciativës private, por edhe të një mbështetjeje zhvilluese më të plotë, në një mënyrë të qendrueshme, që të garantohet nga institucione efikente. Ato janë të varura tërësisht nga niveli i teknologjive dhe njohurive, si dhe nga eficienta e përdorimit të tokës, punës dhe inputeve të tjera. Prodhueshmëria dhe konkurrueshmëria më e lartë janë themelet e rritjes së prodhimit, të përmirësimit të daljes në treg për fermerët dhe biznesin agropërpunues, të rritjes së të ardhurave dhe të përmirësimit të nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre.

Rritja e cilësisë së produkteve agroushqimore është faktori bazë për rritjen e konkurrueshmërisë. Rritja e cilësisë do të vijë nga përmirësimi teknologjik, por edhe nga metodat dhe teknikat e reja të menazhimit të integruar të sistemeve të prodhimit dhe reduktimi i kimikateve, që do të nxitin shtimin e produkteve organike.

Vizioni strategjik i SSBU e sheh zhvillimin bujqësor dhe agroindustrial nën prizmin e integritit europian, që zhvillon vizionin e qeverisë për këta sektorë dhe që premtion të plotësojë sa më mirë standartet dhe kërkesat për një integrim sa më të shpejtë të Shqipërisë në BE, në përgjithësi, dhe të Marrëveshjes për Asociim dhe Stabilizim (MSA), në veçanti.

2.2 Prioritetet strategjike

Tashmë është e konsoliduar ideja se pa një përshkallëzim progresiv të mbështetjes financiare për fermerët dhe agropërpunuesit, në formën e kredive apo të granteve për zhvillim, me qëllim që të bëhet e mundur dhe të përshpejtohet modernizimi i fermave dhe bizneseve, të rritet produktiviteti dhe konkurrueshmëria e produkteve tona, progresi do të jetë me ritme të pamjaftueshme. E gjithë mbështetja teknike, që fermerët dhe agrobizneset kanë përfituar deri tani në mënyra të ndryshme, duke filluar me trainimet e duke përfunduar me këshillimet, e kanë përmirësuar "softin" e zhvillimit. Tashmë efektiviteti dhe shpejtësia e këtij zhvillimi do të varen edhe nga ndërhyrjet dhe përmirësimet në sistemin "hard", pra në përmirësimin e nivelit teknologjik të prodhimit, gjë që kërkon me shumë investime të drejtpërdrejta. Kjo është edhe arsyeja që një nga prioritetet strategjike parashikohet dhe duhet të jetë mbështetja financiare më e madhe për sektorin e fermave dhe të agrobizneseve në tërësi.

Ujitja dhe kullimi kanë marre deri tani "pjesën e luanit" të fondeve të bujqësisë, pasi uji përben inputin kryesor për rritjen e prodhimit bujqësor. Duke parë gjendjen e deritanishme, ku një pjesë e mirë e sistemit të ujitjes dhe kullimit mbetet ende e parehabilituar ose joeficiente, si dhe rolin e këtij faktori, do të jetë e domosdoshme që ky proces të kompletohet dhe përmirësohet.

Tregu përben faktorin kyç, prej nga marrin impulse zhvilluese sektorët e prodhimit. Siç u identifikua në pjesën e parë, marketingu i produkteve bujqësore është në gjendje të prapambetur.

Në vitet e mëparshme janë implemnetuar dhe janë ende në proces inicitiva zhvilluese, të cilat kanë rezultuar të pamjaftueshme për ta ngritur marketingun agrar në nivel ferme apo në nivel tregu në standartet e kërkuara. Kjo e përcakton atë si një prioritet të veçantë.

Kutia 7: Prioritetet strategjike

- i. Të rritet mbështetja financiare për fermat, bizneset bujqësore dhe ato agropërpunuese
- ii. Të përmirësohet menaxhimi, ujitja dhe kullimi i tokës bujqësore
- iii. Të përmirësohet marketingu i produkteve bujqësore dhe atyre të Përpunuara
- iv. Të rritet niveli dhe cilësia e teknologjive, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe agropërpunuesve
- v. Të rritet cilësia dhe siguria ushqimore e produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara

Niveli i teknologjive dhe njohurive, pa përjashtuar informacionin, mbetet faktor kyç për rritjen e prodhueshmërisë, vetë prodhimit, të cilësisë së produkteve dhe prej këtej edhe të konkurrueshmërisë dhe shkallës së daljes në treg të fermerëve dhe agrobiznesit. Megjthëse niveli teknologjik në fermë dhe agrobiznes është përmirësuar dukshëm në krahasim me fillimet e tranzicionit, ai ende është dukshëm i ulët krahasuar me vende të tjera. Kjo e bën atë një prioritet të rëndësishëm strategjik.

Siguria ushqimore e produkteve bujqësore dhe të përpunuara është një çështje jetike, që ka të bëjë me cilësinë

dhe sigurinë e jetesës së njerëzve. Aspektet e sigurisë ushqimore janë kritike, tepër të ndjeshme dhe shumë të nënvizuara edhe në dialogun integruar të vendit tonë me BE. Ndërkaq, me gjithë përparimet, siç u identifikua, ka mjaft aspekte dhe çështje të sigurisë ushqimore mjaft kritike, ende të pakonsoliduara, që presin trajtim të mëtejshëm. Për këtë arsye garantimi i një sigurie ushqimore më të lartë për popullsinë do të jetë një prioritet absolut. Siguria ushqimore do të garantohet nga përmirësimi teknologjik, por edhe nga aplikimi i metodave dhe sistemeve të reja të kontrollit të sigurisë ushqimore, nga përdorimi i metodave të menaxhimit të integruar të pesteve, menaxhimi i integruar i ushqimit të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve, përdorimi i metodave të mira bujqësore, të cilat së bashku do të shtojnë rëndësinë dhe peshën e produkteve organike në prodhimin bujqësor dhe shportën e konsumatorit.

Bazuar në argumentat e mësipërm, Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU) përcakton pesë prioritetet, si në kutinë nr.7.

2.3 Sektorët strategjikë

Sektorë strategjikë janë ata që do të zhvillohen në mënyrë prioritare. Faktorët bazë të marre parasysh për të përcaktuar prioritetet janë: i) tendencat e deritanishme të zhvillimit, ii) potenciali për tu zhvilluar në të ardhmen bazuar edhe në kushtet agroklimatike dhe traditën, iii) efektet në të ardhurat e fermerëve dhe iv) kushtet e tregut dhe në përgjithësi konkurrenca, v) potencialet për eksport.

Kutia 8: Sektorët strategjikë

1. Prodhimi i pemëve frutore, ullirit dhe rrushit
2. Prodhimi perimeve
3. Produktet blegtorale
4. Përpunimi industrial i frutave dhe perimeve
5. Përpunimi industrial i rrushit
6. Përpunimi industrial i qumështit dhe mishit

Sektorët strategjikë për periudhën 2007-2013 janë si në kutinë nr. 8.

Pemtaria dhe vreshtaria

Pemtaria dhe vreshtaria do të jenë një prioritet i rëndësishëm i zhvillimit të bujqësisë. Argumentat në favor të këtij prioriteti janë të shumtë, por më kryesorët do të ishin:

i-Shqipëria ka pasur një pemtari dhe vreshtari mjaft të zhvilluar dhe, në terma të prodhimit, produktivitetit dhe numrit të rrënjëve; ende vendi nuk ka arritur nivelet e paratranzicionit; ii-prirjet e viteve të fundit tregojnë rritje të shpejtë të prodhimit dhe numrit të rrënjëve, ndonëse jo aq të produktivitetit; iii-marzhi i fermerëve është relativisht më i lartë; në disa zona të Korçës fermerët pohojnë së kostoja e prodhimit të molles është rreth tre herë më e vogël së çmimi i shitjes nga ata, ndërsa për rrushin raporti është edhe më i madh; iv-diversiteti dhe potenciali agroklumatik i Shqipërisë lejon që në vendin tonë të prodhohen fruta në një llojshmëri të gjerë; v-mundësitë për të gjeneruar vlerë të shtuar (operacionet pas vjeljes) në fruta dhe rrush janë të mëdha, gjë që do të ndikonte dukshëm në rritjen e marzheve të fermerit; vi-vendi ynë importon sasira të mëdha frutash dhe rrushi, duke harxhuar një pjesë të konsiderueshme të valutës për këtë qëllim. Prandaj rritja e prodhimit të frutave me prioritet do të ndikonte në zbutjen e deficitit tregtar, të kursimit të valutës dhe të investimit të saj në ekonominë kombëtare; vii-së fundi, konsumi i frutave si pjesë e menysë së shqiptarëve po shtohet dhe duhet të shtohet edhe me shumë, prandaj edhe kërkesa për fruta do të jetë në rritje.

Ky nënsektor ka mundësi të zhvillohet edhe në drejtime të reja, jotradicionale, ndoshta luleshtrydhet, etj., kryesisht për treg të huaj por edhe atë vendas.

Megjithatë, në mbështetjen e këtij nënsektori, do të merren parasysh veçoritë rajonale, klimatike dhe mikrozonale, që ajo të mund të gjenerojë efekte maksimale dhe të jetë në koherencë të plotë me karakteristikat e mjedisit, kulturën dhe traditën e kultivimit. Ka tashmë studime mbi rajonizimin e llojeve dhe varieteteve të pemëve dhe hardhisë, të cilët do të përdoren ose përmirësohen paraprakisht po që se është e nevojshme.

Perimikultura

Prodhimi i perimeve, gjithashtu, do të jetë prioritet. Në Shqipëri prodhohen një gamë e gjerë perimesh. Perimet si prioritet mbështeten nga disa argumenta: i-megjithëse prodhimi vendas ka ardhur duke u rritur, ai është ende shumë deficitar; pjesa më e madhe e perimeve që konsumohen vijnë nga importi, për të cilat gjithashtu harxhohet valutë e konsiderueshme; ii- Shqipëria ka potenciale të mira prodhuese, me pritshmeri të lartë edhe për kosto prodhimi të ulët; në shumë zona ka toka pjellore dhe të përshtashme, ujë të mjaftueshëm dhe përvojë; iii-kërkesa konsumatorë për produkte vendi të freskëta jo vetëm nuk është e plotësuar asnjëherë, por ajo është mjaft selektive ndaj perimeve të prodhuara në vend në krahasim me ato të importuara; iv-marzhet e fitimit të fermerëve edhe në perime janë të konsiderueshme.

Blegtoria

Edhe blegtoria përben një prioritet të madh. Faktikisht blegtoria është sektori me zhvillimin më të shpejtë gjatë viteve të tranzicionit. Produktet blegtorale përbëjnë bazën e menysë të të ushqyerit, prandaj ky zhvillim u shkaktua nga kërkesa për të përmbushur nevoja jetike të ushqimit të popullsisë. Fillimisht ajo synoi të rimbushë nevojat e familjeve fshatare, kurse tani blegtoria është sektori që kontribuon me shumë në përmbushjen e kërkesës konsumatorë në tërësi, përfshirë edhe atë urbane. Megjithatë, blegtoria mbetet sektor prioritar për një sërë arsesh: i-vendi ka kushte optimale për rritjen e deleve, dhive në zonat malore dhe kodrinore, por edhe të lopës në disa zona fushore; ii-popullsia ka traditë të vjetër në mbarëshkrimin e blegtorisë; iii-prodhueshmëria dhe efica në blegtori janë problematike, gjë që dikton nevojën e politikave rristrukturuese, orientuese, rajonizuese, etj.iv-produktet e blegtorisë janë mjaft delikate dhe shumë

të ndjeshme nga pikëpamja e sigurisë ushqimore, prandaj politikat në drejtim të përmirësimit të menaxhimit dhe shëndetit të kafshëve janë të domosdoshme.

Mbështetja e blegtorisë do të jetë, megjithatë, e diferencuar, selektive, sipas zonave, llojeve, zonave, produkteve dhe problematikës.

Përpunimi industrial i frutave dhe perimeve

Përpunimi industrial i frutave dhe perimeve lidhet ngushtë me prioritetin e prodhimit të perimeve dhe frutave, por nuk është kjo arsyeja e vetme që e bën atë prioritet. Shqipëria nuk ka kapacitete financiare dhe teknike të atilla që të ngrejë industri të mëdha; ajo nuk mund të krijojë avantazhe të krahasuara, për shëmbull në industrinë elektroteknike, edhe për arsye se është një treg i vogël.

Vendi ynë duhet të zhvillojë me prioritet përpunimin e frutave dhe perimeve sepse: i-frutat dhe perimet e përpunuara në vend janë të pakta dhe tregu dominohet nga produkte të huaja; ii-me zhvillimin e perimtarisë dhe frutikulturës lënda e parë vendase do të jetë gjithnjë e me pranishme; iii-zhvillimi i kësaj industrie do të lehtësonte edhe problemet e tregut të frutave dhe perimeve që prodhojnë fermerët; duhet thënë se ky treg do të vijë duke u bërë kompleks dhe oferta bujqësore do të rritet shpejt edhe në sajë të mbështetjes parësore të frutave dhe perimeve; iv-përpunimi industrial i tyre do të rriste mundësitë e punësimit jobujqësor në zonat urbane, por edhe në ato rurale; v-rritja e kapaciteteve industriale të përpunimit do të thotë automatikisht rritje të kërkesës tregtare për produktet e fermës, pra një stimul të fuqishëm suplementar për nxitjen e prioriteteve bujqësore; kështu, këto tre prioritete bashkëveprojnë në mënyrë dinamike, si në një cikël të mbyllur, duke përforcuar dhe zhvilluar njëri-tjetrin.

Përpunimi industrial i rrushit

Prodhimit të rrushit si prioritet duhet t'i përgjigjet edhe përpunimi i tij si prioritet. Mbështetja e kapaciteteve përpunuese industriale të rrushit do ta zhvendoste epiqendrën e përpunimit nga shtëpite e fermës në fabrikat e përpunimit, që mund të jenë edhe në territorin e fermës dhe të zotëruara nga fermerët që prodhojnë rrrush. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë së verës shqiptare dhe aftësisë së saj konkurruese, të paktën në tregun vendas. Efektet në reduktimin e deficitit tregtar dhe, më tej, atë të pagesave do të ishin të ndjeshme.

Përpunimi industrial i qumështit dhe mishit

Përpunimi industrial i qumështit dhe mishit është, aktualisht, nga industrite më të përparuara në Shqipëri. Janë bërë investime private të rëndësishme dhe më teknologji edhe të kohës së fundit. Por përgjithësisht sektori vuan nga deficienca strukturore, ndërsa kushtet shëndetësore dhe siguria ushqimore, megjithë ndërhyrjet zhvilluese të deritanishme, që ofron sistemi, lë për të dëshiruar. Mbështetja në mënyrë prioritare e këtij nënsektori mund të argumentohet me: i-nevojën për të promovuar dhe garantuar standartet e sigurisë ushqimore në këtë sektor, të cilat janë shumë të lidhura edhe me kërkesat për anëtarësim në BE; ii-nevojën për t'ju përgjigjur më mirë potencialit aktual prodhues të fermës, por edhe rritjes së ofertës së pritshme të produkteve blegtorale; iii-mbështetja e Përpunimit industrial të qumështit dhe mishit do të gjenerojë stimuj të fortë nga pikëpamja e kërkesës dhe standarteve për produktet blegtorale, pra do të nxisë zhvillime ristrukturuese dhe inovatore në fermat blegtorale e, në tërësi, në të gjithë sistemin e prodhimit blegtoral e me gjerë.

Megjithatë, sektorët strategjikë do të zhvillohen në bazë të studimeve që identifikojnë zonat më të favorshme dhe politikave mbështetëse adekuate, nga pikëpamja ekonomike, sociale dhe

mjedisore, pra që efektiviteti ekonomik dhe prodhueshmeria të jenë më të larta, të rritet shkalla e punësimit, të mbrohet mjedisi dhe burimet prodhuese të mos keqpërdoren.

2.4 Qëllimet strategjike

Qëllimet strategjike janë objektivat afatgjatë që do të arrihen përmes zbatimit të SSBU, e cila është garante që bujqësia dhe ushqimi të zhvillohen nën vizionin e përcaktuar dhe duke u bazuar në prioritetet dhe sektorët strategjike të përcaktuar më lart.

Qëllimi kryesor i SSBU është:

Të mbështesë zhvillimin e qendrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit.

Zhvillimi i qendrueshëm garanton përmbushjen e kërkesave ushqimore të brezit aktual pa rrezikuar brezat që do të vijnë, punësim të qendrueshëm, të ardhura të mjaftueshme, jetesë të denje dhe kushte të përshtatshme punë për fermerët. Ai garanton ruajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve prodhuese të burimeve natyrore, pa prishur ciklet ekologjike dhe ekuilibrat natyrorë, pa prishur zakonet social-kulturore të bashkësive rurale dhe pa ndotur mjedisin, si dhe redukton prekshmërinë e sektorit bujqësor nga faktorët natyrorë dhe social ekonomikë.

Zhvillimi i qendrueshëm siguron harmoni midis tre aspekte themelore: aspektit ekonomik të zhvillimit, aspektit social dhe atij mjedisor.

Aspekti ekonomik ka të bëjë me sigurimin e një rritje ekonomike të mjaftueshme për të ulur varfërinë dhe rritur standartin e jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre; me rritjen e efikasitetit ekonomik të prodhimit dhe me stabilitetin e zhvillimit.

Aspekti social ka të bëjë me reduktimin e varfërisë në fshat, me ruajtjen e traditave dhe trashëgimisë kulturore të popullsisë rurale dhe me rritjen e karakterit pjesëmarrës të zhvillimit.

Aspekti mjedisor ka të bëjë me garantimin e biodiversitetit, ruajtjen e burimeve natyrore dhe shmangjen e ndotjes së mjedisit.

Në pajtim me qëllimin e përgjithshëm, SSBU ka edhe disa qëllime specifike. Qëllimet specifike të SSBU janë si në kutinë nr. 9.

Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit duhet të sigurojë një zhvillim të qendrueshëm të tokës si burimi kryesor bujqësor, dhe të bujqësisë. Kjo nënkupton që toka duhet të menaxhohet në mënyrë racionale, prodhimi bujqësor dhe mirëqenia e fermerëve duhet të rritet në

Kutia 9: Qëllimet strategjike

1. Menaxhimi i qendrueshëm i tokës, si komponenti bazë i zhvillimit të qendrueshëm bujqësor, dhe në harmoni të plotë me të
2. Rritja e punëzënisë, të ardhurave dhe nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre
3. Rritja e efikasitetit ekonomik të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues, e cila shprehet përmes rritjes së prodhueshmerisë dhe cilësisë së produkteve të tyre
4. Garantimi i një standarti të sigurisë ushqimore (food safety) më të lartë për të gjithë popullsinë
5. Përmirësimi i marketingut agrar

mënyrë të vazhdueshme. Kjo nënkupton, gjithashtu, që burimet prodhuese si toka bujqësore, ujrat, resurset gjenetike, kafshët e prodhimit, pemët frutore, mjedisi agrar, etj., do të menaxhohen me mirë, do të përdorën në mënyrë efektive dhe nuk do të shpërdorohen, në mënyrë që të garantohet ruajtja e aftësive prodhuese dhe gjeneruese të tyre dhe jetesa e brezave të tjerë të shqiptarëve. Në një plan më të gjerë, zhvillimi i qendrueshëm bujqësor mbështet edhe zhvillimin e qendrueshëm ekonomik të vendit, qendrueshmërinë dhe kohezionin social, mbrojtjen e biodiversitetit dhe të cilësisë së jetës në zonat rurale. Prandaj nuk ka se si zhvillimi i qendrueshëm bujqësor të mos jetë qëllim strategjik i SSBU.

Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit në thelbin e vet është, gjithashtu, strategji zhvillimi ekonomik. Asnje strategji nuk do të kishte kuptim po që se ajo nuk do të ndihmonte që të gjenerohen vende të reja punë dhe nuk do të garantonte që niveli i jetesës i fermerëve do të rritej si rezultat i zbatimit të saj. Në mënyrë specifike për Shqipërinë, punëzënia në sektorin bujqësor është sa e limituar aq edhe problematike. Bujqësia është sektori që kontribuon me shumë në punësimin e shqiptarëve, por ku njëkohësisht, punëzënia karakterizohet nga lekundje të forta sezonale dhe numri i të punësuarve për një hektarë tokë është me i larti në Evropë. Mjafton kaq për të thënë që produktiviteti i punës në bujqësi, dhe të ardhurat për një të punësuar, janë tepër të ulta. Prandaj edhe rritja e punësimit dhe të ardhurave është pjesa esenciale e SSBU.

Eficienta ekonomike ka të bëjë me rritjen e produktivitetit të përdorimit të faktorëve prodhues dhe me cilësinë e produkteve të prodhuara, pra edhe me nivelin e kostos dhe të çmimeve të shitjes. Këta janë faktorë bazë të konkurrueshmërisë në treg dhe në shitshmërinë e produkteve të fermerit. Që të rritet eficienta, jo vetëm do të rritet disponibiliteti i faktorëve prodhues, por edhe do të realizohet një harmonizim në proporcionet e duhura të tyre. Ndryshe prodhueshmëria dhe cilësia nuk do të rriten. Për këtë arsye, një nga qëllimet e SSBU është të shtohet përdorimi i faktorëve prodhues në bujqësi (plehrat, mekanika, racat, farërat dhe fidanat me potencial të lartë, dhe të pastër, teknologjitë e përparuara, njohuritë, etj., të cilat garantojnë rritjen e prodhueshmërisë dhe cilësisë si baza për rritjen e prodhimit, të ardhurave dhe mirëqenies.

Standartet e larta ushqimore të produkteve të fermës dhe atyre të përpunuara janë imperativ i padiskutuueshëm i SSBU. Siguria shëndetësore është jetike, prioritet absolut i konsumatorit, kërkesë parësore në negociatat dhe marrëveshjet që synojnë ta integrojnë Shqipërinë në BE, prandaj edhe garantimi i sigurisë ushqimore-shëndetësore të SSBU është një qëllim strategjik.

Përmirësimi i marketingut agrar është mjaft i rëndësishëm, sepse përmirësimi i tij shpreh vemendjen publike ndaj stimujve mbi prodhimin, që vijnë nga kërkesa. Për pasojë, politikat për nga kërkesa, ose politikat tregtare do të duhet të zenë një vend të posaçëm në angazhimet politike të vendit në periudhën që mbulon SSBU.

Qëllimet e mësipërme do të ndihmojnë edhe për një sigurim ushqimor më të mirë të vendit. Sigurimi ushqimor (food security) është një çështje sa e thjeshtë në dukje, aq edhe e rëndësishme në përmbajtje. Megjithë ngjyrimet dhe reminishencat ideologjike të së kaluarës, sigurimi i një bilanci kritik ushqimor me burime të vendit është gjithmonë një çështje strategjike. Vendi nuk mund të bazohet tërësisht mbi tregun për të zgjidhur edhe problemin e sigurisë ushqimore. Garantimi i sigurisë ushqimore përben një nga dështimet spektakolare të tregut, të pranuar jo vetëm në rrafshin teorik. Në këtë kontekst, është detyrë e strategjisë që të zhvillojë bujqësinë në mënyrë të harmonizuar dhe të diversifikuar që në çdo kohë vendi të këtë mundësi të përballojë nevoja emergjente për produkte bazë, për një kohë të caktuar.

2.5 SSBU dhe Objektivat për Zhvillimin e Mijëvjecarit, (OZHM)-të

SSBU është në koherencë të plotë me **Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)**. Lidhja midis SSBU dhe OZHM-ve realizohet veçanërisht përmes dy prej OZHM-ve, objektivit 1 dhe objektivit 7 dhe politikave përkatëse. Këto objektiva janë:

Objektivi 1: Eliminimi i varfërisë ekstreme, urisë dhe dimensioneve të tjera të varfërisë

Objektivi 7: Sigurimi i zhvillimit të qendrueshëm të mjedisit

Përmes objektivit për rritjen e prodhimit, punëzënies dhe të ardhurave të fermerëve SSBU ndikon direkt në arritjen e OZHM nr. 1, duke kontribuar kështu në arritjen e një mirëqenieje të qendrueshme për fermerët dhe familjet e tyre. Duke u mbështetur në sistemet e integruara të prodhimit (menaxhimi i integruar i pesteve, menaxhimi i integruar i të ushqyerit të bimëve apo kafshëve bujqësore, menaxhimi i integruar i tokës, menaxhimi i integruar i fermës, etj.), SSBU ndikon në arritjen e objektivit nr. 7 të Mijëvjeçarit, atë për zhvillimin e qendrueshëm të mjedisit.

2.6 SSBU dhe Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rural, SNZHR

Midis SSBU dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural (SNZHR) ka një lidhje organike. Së pari kjo lidhje reflektohet në qëllimin e përgjithshëm të dy strategjive. Qëllimi i SNZHR është:

Të kontribuojë për një zhvillim të barabartë të të gjitha zonave rurale në Shqipëri, të Përmirësojë cilësinë e jetës në to dhe të reduktojë varfërinë.

Siç shihet, objektivi kryesor që është rritja e të ardhurave si rruga kryesore për reduktimin e varfërisë (monetare) është i njëjtë për të dyja strategjitë.

Së dyti, koherenca ndërmjet dy strategjive duket edhe në qëllimet e veçanta të dy strategjive. Dy nga qëllimet e veçanta të SNZHR janë rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe agropërpunimit, si dhe mbrojtja e mjedisit. Këto dy qëllime të saj janë të integruara në vizionin e SSBU dhe objektivat e saj, si ai për menaxhimin e qendrueshëm të tokës bujqësore, si një nga burimet kryesore të natyrës dhe aspektet themelore të mbrojtjes së mjedisit.

Së treti, pjesa kryesore e mjedisit rural është bujqësia, prandaj SNZHR dhe SSBU kanë fokus të ngjashëm, zhvillimin e bujqësisë dhe përgjithësisht të zonave rurale.

Së katërti, koherenca në mes dy strategjive reflektohet edhe në prioritetet dhe politikat e zhvillimit. Në kuadrin e rritjes së konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor modernizimi i fermës shprehet si një nga prioritetet kryesore në SNZHR. E njëjta gjë shprehet edhe në SSBU, ku mbështetja e fermave më teknologji të reja, përmirësimi i metodave dhe teknikave të kultivimit të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve, Përmirësimi i menaxhimit të fermave, mbështetja e agropërpunimit dhe ruajtjes së produkteve në nivel ferme ose grupi fermerësh, etj., shihen si drejtime kryesore të modernizimit të fermave shqiptare.

Natyrisht, fusha e SHNR është më e gjerë, sepse veç bujqësisë ajo përfshin edhe sektorë të tjerë, si pyjet, infrastrukturën rurale, energjinë dhe shëndetësinë, arsimin dhe shërbimet sociale në zonat rurale.

KAPITULLI 3

POLITIKAT

3.1 Koncept i përgjithshëm politik për zhvillimin e bujqësisë

Strategjia dhe zhvillimi i bujqësisë ka nevojë për një bazë të qartë konceptuale politike. Ndonëse në planet strategjike (shumëvjeçare) dhe ato korrente (njëvjeçare) është përvijuar mjaft mirë mënyra, prioritetet dhe fushat e ndërhyrjes përmes politikave të ndryshme, publike ose private, në bujqësi është i nevojshëm një riformulim më i qartë dhe më i sistemuar konceptit mbi politikën bujqësore që duhet të zbatohet në Shqipëri.

Koncepti i ri mbi politikën bujqësore do të konsistojë në këto parime të rëndësishme:

- Rritjen e karakterit pjesëmarrës ose gjithëpërfshirës të procesit politik në tërë gjatësinë e ciklit të politikave: identifikim, hartim, miratim, zbatim, monitorim dhe vlerësim.
- Sigurimin e vazhdimësisë së ciklit të politikave, duke evituar pauzat dhe frakturat, për të siguruar vazhdimësi të mbështetjes së bujqësisë.
- Fokus më i madh në mbështetjen direkte, për të bërë të mundur „goditjen” në pikat më kritike, në faktorët e drejtpërdrejtë, si për shëmbull teknologjia, të rritjes së prodhimit bujqësor dhe të cilësisë së tij.
- Kalimi në fazën e monitorimit dhe vlerësimit të detyruar dhe të standartizuar të efekteve të politikave dhe programeve, si kusht jo vetëm për të rritur angazhimin menaxherial, por edhe për të siguruar efektivitet të masave zhvilluese.
- Arritjet ose efektet e politikave të zhvillimit duhet të maten kundrejt indikatorëve të formuluar në mënyrë SMART.
- Fokusim më i plotë i vemendjes në politikat *për nga kërkesa*, ose politikat tregtare bujqësore. Në të ardhmen politikat që synojnë të menaxhojnë kërkesën konsumatorë do të duhet të zenë një vend të veçantë, nisur nga efektiviteti që kanë treguar ato në vende të tjera, por edhe tek në.
- Integrimi i **Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM)**, për të cilat është dakortësuar zyrtarisht edhe Shqipëria, në mënyrë të veçantë objektivi për reduktimin e varfërisë. Ky objektivi megjithëse nuk del në mënyrë eksplicite, reflektohet në mënyrë implicite në parimet e mësipërme të politikës së re bujqësore dhe synohet të arrihet përmes rritjes së prodhimit dhe punëzënies në zonat rurale.

Ky riformulim, i bërë dhe pranuar kështu në mënyrë eksplicite, do të ishte kusht me rëndësi që strategjia e bujqësisë të ishte koherente, objektive dhe të kishte efekte të prekshme mbi rezultatet e zhvillimit të bujqësisë dhe ushqimit.

3.2 Politikat e zhvillimit të bujqësisë

Në fund të fundit dhe në mënyrë të përmbledhur, objektivat qendrorë të SSBU do të ishin **rritja e prodhimit bujqësor dhe agroushqimor dhe përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore**.

Rritja e prodhimit do të vijë nga shtimi i sipërfaqes së tokës nën kulturë, duke mbjellë tokat e lëna djerrë, dhe nga rritja e produktivitetit të bimëve dhe kafshëve. Produktiviteti do të rritet nga përmirësimi i ujitjes së tokës, i teknologjive bujqësore (përfshirë inputet), dhe njohurive e aftësi

bujqësore. Përmirësimi i uitjes dhe teknologjive kërkon investime shtesë, por edhe rregulla të përmirësuara dhe kapacitete për t'i bërë dhe zbatuar ato, ndërsa përmirësimi i njohurive dhe aftësive bujqësore kërkon edhe shpenzime shtesë, kapacitete dhe politika adekuate.

Kështu, jo vetëm **investimet** por edhe **asistenca teknike dhe këshillimi** do të jenë dy shtyllat të rëndësishme për të zhvilluar bujqësinë. Në funksion të implementimit të politikave të mësipërme për arritjen e objektivave strategjike, do të jetë e nevojshme të tentohen ose të përdoren një numër i madh edhe i larmishëm instrumentash politikë. Ndarja e tyre konkrete, në formë të grupuar sipas këtyre dy akteve, do të jenë :

Politika që lidhen kryesisht me investime në bujqësi ose agropërpunim :

- Pagesa direkte në formë granti, ose kredi, për investime në teknologji prodhuese
- Pagesa direkte në formë granti, ose kredi, për shtimin e inventarit të pemëve frutore ose kafshëve prodhuese, paisjeve, mekanikën bujqësore dhe të kapaciteteve magazinuese të fermës
- Pagesa direkte në formë granti për inpute bujqësore ose agropërpunim
- Subvencioni i normës së interesit (ose garantimi i kredive) të kredive bankare private
- Pagesa direkte ose kredi për nxitjen dhe mbështetjen e iniciativave lokale
- Investime për infrastrukturën e tregut dhe organizatat e prodhuesve

Politika që lidhen kryesisht me këshillimin dhe asistencën teknike ndaj fermerëve:

- Hartimi i platformave për inovacionin rural në shkallë zonale
- Partnershipet paralele (shoqatat apo grupet e prodhuesve ose të marketingut të fermerëve, grupet e veprimt lokal)
- Krijimi i partneshipeve vertikale (fermerë dhe tregtarë, ose agropërpunues, që kooperojnë në skema të përbashkëta të shitblerjes së inputeve, prodhimit dhe shitjes së produkteve)
- Vendorsja e rregullave dhe forcimi i monitorimit për eliminimin e sindromave monopoliste potenciale në tregun e inputeve
- Lehtësimi i liçencimit dhe barrës tatimore të tregtareve të produkteve për të shtuar konkurrencën në treg
- Ngritja e shkollave fushore të fermerëve
- Përmirësimi i teknikave dhe aftësive bujqësore
- Forcimi i kapaciteteve të monitorimit të cilësisë së farërave dhe fidanave
- Shkëmbimi i përvojave lokale në teknologjite e prodhimit, tregtim dhe në organizimin e shoqatave
- Përmirësimi i sistemit NJIF⁵ në zona të ndryshme e shkallë vendi
- Nxitja e lobingjeve të fermerëve në shkallë zonash e në shkallë vendi
- Diskutime në grup për identifikimin e rrugëve për nxitjen e agroturizmit dhe produkteve organike
- Zgjerimi i praktikave të mira bujqësore dhe të mbrojtjes së integruar të bimëve
- Studime tregu për identifikimin e tregjeve *niche*
- Asistencë teknike dhe ose financiare për aktivitetet e shtimi të vlerës së produkteve të fermerit
- Fushata sensibilizuese
- Vendorsja dhe zbatimi i standarteve për produktet bujqësore
- Përmirësimet e aktiviteteve të mbledhjes, shpërndarjes, përdorimit dhe publikimit të informacionit statistikor
- Përmirësimet e procedurave të planifikimit, monitorimit, vlerësimit dhe publikimit të rezultateve të tyre
- Përmirësimet ligjore dhe përputhja e legjisllacionit shqiptar me atë të BE
- Përmirësimi i i sistemit të informacionit të tregut

⁵ Njohuri dhe informacion bujqësor

- Futja e formës së shërbimeve me pagesë për këshillimin bujqësor privat
- Trainime të adminmistratës, fermerëve dhe grupeve të prodhuesve

Përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore do të varet nga shkalla e përmirësimit të nivelit të teknologjive të prodhimit dhe marketingut, përmirësimet e legjislacionit të sigurisë dhe shkalla e zbatimit të tij, qasjet e garantimit të sigurisë ushqimore dhe efienca e kapaciteteve të monitorimit.

Për të realizuar standarte të përmirësuara të sigurisë ushqimore përgjithësisht do të duhet:

- Efektivitet në përjasjen e legjislacionit shqiptar me atë të BE, duke përfshirë edhe sistemet e garantimit të sigurisë.
- Përmirësim të burimeve njerëzore që menaxhojnë problemet e sigurisë
- Përmirësim të laboratorëve dhe të bazës laboratorike të sigurisë ushqimore

Tipi i mbështetjes që do siguria ushqimore është kryesisht asistenca dhe trainimi (dy pikat e para) dhe kryesisht investimi (pika e tretë).

3.3 Përjasjet politike të zhvillimit të bujqësisë

Përjasjet politike që do të implementohen në funksion të realizimit të objektivave të SSBU do të jenë:

- Mbështetja financiare publike direkte dhe indirekte
- Nxitja e burimeve të brendshme
- Të mësuarit dhe rrjetëzimi (angl.: learning and linking)
- Pjesëmarrja dhe dialogu i përfituesve dhe aktorëve
- Fuqizim i përfituesve nga programet
- Krijimi i një mjedisi konkurrues
- Nxitja e kooperimit

3.4 Profili i politikave bujqësore

Arritja e qëllimeve strategjike mund të identifikohet vetëm nëse arrihet të realizohen një numër rezultatesh ose produktesh. Këto rezulate mund të arrihen vetëm nëse ndërtohen dhe zbatohen politikat e duhura, gjë që do të thotë se politikat në kuadrin e SSBU do të jenë:

- a. Specifike**
- b. Në koherencë me qëllimet dhe me rezultatet**
- c. Të zbatueshme ose të mbështetura me burime**
- d. Të pranueshme, ose të gëzojnë mbështetje**
- e. Në koherencë me mekanizmat e tregut**

Sistemi i indikatorëve siguron Nëse një politikë e caktuar ka prodhuar rezultatet e duhura. Për këtë është e domosdoshme që sistemi i indikatorëve të jetë i kompletuar, çka do të thotë që indikatorët:

- a) Duhet të jenë specifike**
- b) Duhet të jenë të matshëm**
- c) Duhet të jenë të kufizuar në kohë**

Në periudhën që vjen, do të jetë e nevojshme, gjithashtu, të respektohen më mirë edhe disa kritere të rëndësishme të politikëbërjes, sepse kështu ky proces do të jetë më i shëndetshëm dhe

do të gjenerojë efekte më të mëdha në zhvillimin e sektorit. Kështu, zbatimi i një politike do të varet nga disa kushte si më poshtë:

- Nëse kontribuon apo konfliktin me objektivat e politikës ekonomike
- Nëse ndikon në rritjen e prodhimit dhe të ardhurave
- Nëse ka efekte sociale negative
- Nëse ka efekte mjedisore negative
- Nëse ka efekte negative mbi eficientësinë e prodhimit
- Nëse favorizon, ose jep mundësi për të përfituar pa të drejtë, grupe të caktuara
- Nëse ka efekte negative mbi barazinë në të ardhura dhe mirëqënie
- Nëse ka efekte disekuilibruese mbi zhvillimin bujqësor

3.5 Politikat bujqësore sipas rezultateve të pritshme

Rezultatet ose produktet e pritshme për arritjen e çdo qëllimi, si dhe politikat përkatëse janë si më poshtë. Në përputhje me qëllimet e strategjisë dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj, politikat kryesore që do të siguronin arritjen e këtyre rezultateve dhe të vetë qëllimeve do të ishin:

Objektivi 1-Menaxhimi i qendrueshëm i tokës, si komponenti bazë i zhvillimit të qendrueshëm bujqësor, dhe në harmoni të plotë me të.

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

1. Kompletohet reforma e tokës
2. Ndalet dëmtimi dhe kufizohet tjetërsimi fizik i tokës
3. Përmirësohet menaxhimi i tokës
4. Përmirësohet vaditja, kullimi dhe mbrojtja e tokës nga përmbytja

Politikat

Afatshkurtër (2008) e në vazhdimësi

- Përmirësime ligjore në drejtim të përdorimit dhe transferimit të tokës, duke përfshirë edhe politika fiskale adekuate
- Trainime për forcimin organizativ dhe institucional të shoqatave të ujitjes
- Forcimi institucional për menaxhimin e tokës (Inspektoriati i tokës)
- Ekstension për të përmirësuar menaxhimin e integruar të tokës
- Rehabilitim i ujitjes dhe kullimit, me fonde publike ose duke nxitur sektorin privat

Afatmesme (2009-2010) e në vazhdimësi

- Mobilizimi dhe ndërgjegjesimi i aktorëve të zhvillimit bujqësor për përmirësimin e menaxhimit të tokës bujqësore
- Sistem informimi për përdorimin e tokës
- Ekstension për të përmirësuar menaxhimin e integruar të tokës
- Rehabilitim i ujitjes dhe kullimit, me fonde publike ose duke nxitur sektorin privat
- Trainime për forcimin organizativ dhe institucional të shoqatave të ujitjes
-

Afatgjatë: (2011-2013)

- Rehabilitim i ujitjes dhe kullimit, me fonde publike ose duke nxitur sektorin privat
- Forcimi i rolit të pushtetit vendor në drejtim të ujitjes dhe kullimit
- Ekstension për të përmirësuar menaxhimin e integruar të tokës
- Trainime për forcimin organizativ dhe institucional të shoqatave të ujitjes

Objektivi 2-Rritja e punëzënies, të ardhurave dhe nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

4. Rritet punëzënia në fermë
5. Rriten të ardhurat në fermë
6. Përmirësohet niveli i jetesës së fermerëve

Politikat

(Afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë)

- Ekstension për transferim teknologjish, njohurish, aftësish dhe përvojash
- Kredi ose grante për fermerët
- Përmirësimi i përpunimit të produkteve në nivel ferme
- Përmirësimi i magazinimit të produkteve në nivel ferme
- Përmirësimi i operacioneve të pasvjeljes në nivel ferme
- Nxitja e aktiviteteve agroturistike dhe e diversifikimit në fermë, në përgjithësi

Kutia 10: Politikat e cilësisë dhe konkurrueshmërisë

Rritja e cilësisë së produkteve bujqësore është një nga faktorët bazë për rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor. Veç kësaj, politikat e cilësisë janë në fokus të veçantë edhe në negociatat e Shqipërisë për integrimin në BE. Për këto arsye, politikat e cilësisë do të jenë të rëndësishme dhe do të kene si fokus:

- Nxitjen e teknologjive të përparuara: farëra, fidana, plehra, pesticide, ujë dhe mekanikë cilësore.
- Nxitjen e teknikave dhe metodave të reja të kultivimit dhe mbarështimit të kafshëve, si: MIP, UIB, MIF, MIK, etj., që me një emer quhen praktika të mira bujqësore. Shqipëria nuk kan një koid të miratuar të PMB por duhet të mendojë epr ta apsur atë sa me shpejt.
- Hartimi i standarteve për produktet bujqësore ose të përpunuara në përputhje me normat e BE dhe rritja e efektivitetit në drejtim të zbatimi të tyre
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes: standratizim, paketim, logim
- Vendosjen e emërtimeve sipas origjinës gjeografike të produkteve bujqësore ose të përpunuara (appellations d'origine contrôlée), që parashikohet edhe nga MSA. Hapi i parë mund të jetë hartimi i listave dhe pastaj zbatimi.
- Nxitjen e sigurisë ushqimore të lartë të produkteve bujqësore ose të përpunuara.

Disa drejtime së si mund të realizohet kjo e fundit janë:

- Vendosja e kërkesave detyruese për të zbatuar sistemet e autokontrollit HACCP dhe adoptimi i standarteve ISO
- Përmirësimi i kontrollit të kushteve higjeno-sanitare të agrobizneseve
- Matrikullimi dhe mbikqyrja efektive e shëndetit të kafshëve bujqësore
- Përmirësimi i kushteve të mbarështimit të kafshëve

Objektivi 3-Rritja e efikasitetit ekonomik të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues, e cila shpreh kryesisht Përmes rritjes së prodhueshmërisë dhe cilësisë së produkteve të tyre

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

4. Rriten rendimentet e kulturave dhe kafshëve prioritare
5. Ulet kostoja për njësi prodhimi në kulturat dhe kafshët prioritare
6. Rritet marzhi i fermerit (%)

Politikat

(Afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë)

- Hartimi dhe zbatimi i projekteve specifike për shtimin e prodhimit, të përdorimit dhe cilësisë së inputeve bujqësore
- Investime në agropërpunim
- Ekstension bujqësor për teknologjitë, teknikat dhe metodat e reja, për shtimin e njohurive dhe aftësive bujqësore tek fermerët

Kutia 11: Nga plani i veprimit për bujqësinë organike

Bujqësia organike parashikohet të jetë në fokus të veçantë të politikave bujqësore, jo vetëm për shkak të efektit mbi cilësinë që zbatimi i koncepteve dhe praktikave organike, por edhe për efikasitetin ekonomik (të ardhurat) që mund të marrin fermerët prej produkteve organike. Për të mbështetur zhvillimin e produkteve organike, MBUMK ka hartuar një plan veprimi. Në kuadrin e planit të veprimit të bujqësisë organike në Shqipëri janë identifikuar pesë fusha me përparësi:

- Hartimi, konsolidimi dhe zbatimi i një politikë kombëtare për bujqësinë organike, e cila të mundësojë sinërgji me institucionet përkatëse dhe politikat e tjera zhvillimore
- Forcimi i legjislacionit kombëtar për bujqësinë organike dhe i strukturës së sistemit kombëtar organik
- Strukturimi i zinxhirit të ofertës organike duke lehtësuar konvertimin në bujqësinë organike (midis fermerëve dhe përpunuesve) dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, inkurajimin e zhvillimit të tregut për inputet dhe produktet organike
- Mbështetja e kërkimit shkencor, arsimit dhe shërbimit këshillimor në bujqësinë organike me qëllim që të zhvillohet dhe konsolidohet një sistem kombëtar njohurish për bujqësinë organike.
- Inkurajimi i integritetit të Shqipërisë në komunitetin organik ndërkombëtar dhe nxitja e rrjetëzimit kombëtar dhe ndërkombëtar

Objektivi 4- Garantimi i një standarti të sigurisë ushqimore (food safety) më të lartë për të gjithë popullsinë

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

- 1-Përmirësohet legjislacioni i kontrollit
- 2-Forcohen institucionet e kontrollit
- 3-Përmirësohen teknologjite e prodhimit
- 4-Përmirësohen praktikat prodhuese dhe tregtare
- 5-Rritet cilësia e inputeve dhe lëndëve të para
- 6-Përmirësohet mbarështimi i kafshëve të prodhimit

Politikat

Afatshkurtër (2008) e në vazhdimësi

- Përmirësime në laboratorët dhe instrumentat e kontrollit
- Përmirësime dhe forcim i sistemit të agjencive dhe organeve të kontrollit
- Nxitet përmirësimi i sistemeve dhe metodave të sigurisë ushqimore

- Ekstension për praktikat e mira bujqësore dhe tregtare
- Fushata sensibilizuese për sigurinë ushqimore
- Matrikullim i kafshëve bujqësore
- Ndërtim therrtoresh

Afatmesme (2009-2010) e në vazhdimësi

- Përmirësime në laboratorët dhe instrumentat e kontrollit
- Përmirësime dhe forcim i sistemit të agjencive dhe organeve të kontrollit
- Nxitet përmirësimi i sistemeve dhe metodave të sigurisë ushqimore
- Ekstension për praktikat e mira bujqësore dhe tregtare
- Një sistem prognozë-sinjalizimi për mbrojtjen e bimëve
- Fushata sensibilizuese për sigurinë ushqimore
- Matrikullimi i kafshëve bujqësore

Afatgjatë: (2011-2013)

- Përmirësime në laboratorët dhe instrumentat e kontrollit
- Përmirësime dhe forcim i sistemit të agjencive dhe organeve të kontrollit
- Nxitet përmirësimi i sistemeve dhe metodave të sigurisë ushqimore
- Ekstension për praktikat e mira bujqësore dhe tregtare
- Fushata sensibilizuese për sigurinë ushqimore

Objektivi 5-Përmirësimi i marketingut agrar

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv janë:

4. Përmirësimi i infrastrukturës tregtare
5. Rritja e fuqisë negociuese të fermerëve
6. Përmirësimi i monitorimit dhe analizës së tregjeve

Kutia 12: A do të ketë një "kiwi" shqiptar?

SSBU nuk mund të japë një përgjigje direkte për këtë pyetje, por ajo ofron shanse për ta gjetur një apo disa "kiwi". Këto shanse bazohen në analizen e avantazheve të mundshme të krahasuara të vendit dhe në përqasjen politike që ka në themel strategjia, përqasja pjesëmarrëse dhe dialogu me fermerët dhe aktorët e zhvillimit bujqësor. Vështirësia e identifikimit të produkteve të tilla për të depërtuar në tregjet e huaja rritet për shkak të globalizimit, si dhe potencialeve të vogla prodhuese të vendit tonë në raport me konkurrentët, të cilët edhe pse larg kufijve tane janë shumë të fuqishëm në tregun ndërkombëtar, bile edhe në tregun tonë këtu në Shqipëri. E qartë është së "kiwi" shqiptar mund të gjendet midis produkteve tipike shqiptare ose produkteve specifike që mund të rrisë toka dhe klima shqiptare. Dhe instrumenti që do të përdorim për këtë është dialogu demokratik, analiza e traditës dhe e kërkesave të tregut.

Politikat:

Afatshkurtër (2008) e në vazhdimësi

- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të besueshëm, në vendin dhe kohën e duhur
- Ndërtimi i tregjeve të reja me shumice dhe pikave të reja të grumbullimit
- Promovimi i shoqatave dhe partnershipeve paralele dhe vertikale
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes
- Nxitja e lobingut për politikat tregtare të grupeve të fermerëve
- Lehtësi fiskale për agrobizneset që vendosen në zonat rurale

- Fuqizimi i strukturave publike të monitorimit dhe analizës së tregjeve
- Nxitja e praktikave të mira tregtare që rrisin cilësinë e produkteve

Në kuadrin e përmirësimit të marketingut, përmirësimi i informacionit do të ishte nga gjërat më kryesore. Konsolidimi i qendrave tashmë të ngritura të informacionit, me mjete, aftësi dhe njohuri, si dhe mbështetja e tregjeve me shumicë për tu shndërruar në "bursa të informacionit bujqësor" do të ishin disa nga masat që do të ndihmonin në këtë drejtim. Ngritja e Agjencisë së Tregjeve me Shumicë, si një institucion menaxhues i këtyre tregjeve, mund të ndihmonte në përbushjen e këtij funksioni.

Kutia 13 : Mbështetja e bashkëveprimit midis fermerëve

Për shkak të fermës së vogël bujqësisë shqiptare i kanë humbur ekonomitë e shkallës. Prandaj nxitja e shoqatave të fermerëve do të jetë parësore për të rifituar këto ekonomi të humbura dhe për t'i bërë fermerët e vegjël me konkurrues në treg. Deri me sot përvoja shqiptare ka sjelle në jetë shoqata prodhuesish joefektive, ose pak efektive. Prandaj MBUMK është e bindur së vetëm ndihma për ndërtimin e modeleve të shoqatave do të ketë efekte. Për këtë qëllim ajo do të bashkëpunojë edhe me disa partnerë ndërkombëtarë si SNV dhe Kooperacioni Spanjoll, për të nxitur ndërtimin e shoqatave të tilla. Puna duhet filluar nga Përmirësimi i legjisllacionit. Përvoja europiane do të ishte shumë e vlefshme edhe në këtë drejtim. Kjo përvojë ofron organizatat e prodhuesve, grupet e prodhuesve organizatat ndërdegësore, si forma efektive të bashkëpunimit midis fermerëve që kanë nevojë edhe për mbështetje.

Organizatat e prodhuesve (OP). Janë bashkime vullnetare të prodhuesve, që bëhen për të përqendruar ofertën bujqësore, pra për të realizuar shitje të përbashkët të produkteve, si kundërpeshë e përqendrimit të kërkesës ose blerjeve të përbashkëta. Këto grupe duhet të kene aftësi që t'i përshatën ofertën ndryshimit të kërkesës. OP janë mënyra për të ulur edhe koston e prodhimit dhe stabilizuar çmimet. Ato duhet të jenë të afta të mbrojnë edhe mjedisin krahas kryerjes së aktiviteteve të tyre. Ato duhet të zotërojnë tërë infrastrukturën e nevojshme për të kryer këto detyra. Që të mund të krijohen ato duhet të kenë të paktën 5 antarë, një xhiro të paktën 100 mijë € në vit, stafin e duhur, etj.

OP mbështeten nga BE me plane veprimi deri 5-vjecare, ku ka masa për planifikimin e prodhimit dhe përqendrimin e ofertës, uljen e shpenzimeve dhe stabilizimin e çmimeve, mbrojtjen e mjedisit duke nxitur prodhimin organik dhe të integruar, përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e vlerës së produkteve, etj. Kjo ndihmë kanalizohet përmes **fondeve të veprimit (FV)**. Kontributi i antarëve në këtë fond, për perimet dhe frutat e freskëta, është 4.1% e vlerës së tregut të produkteve. Një shumë të paktën të barabartë me këtë e paguan BE.

Grupet e prodhuesve (GP). Janë një stad më pak i avancuar së OP. Quhen kështu entitetet e prodhuesve që nuk përbushin kriteret e OP (si për shëmbull nuk kanë infrastrukturën ose xhiron e duhur, kanë më pak së 5 antarë, etj. Për tu njohur si OP ato kanë një afat kohor prej 5 vjetësh, gjatë të cilit duhet të paraqesin një plan njohjeje me masat përkatëse. Ndihma që mund tu jeept këtyre grupeve është një ndihmë me normë të sheshtë. Kjo mund të jetë norme renëse në kohë nga 5 në 2%, reNëse në vlerë nga 2.5 në 1.5% të vlerës së tregut mbi 1 milion €, ose në kuotë fikse nga 100 mijë deri në 50 mijë përgjatë 5 viteve.

Organizatrat ndërdegësore (ON). Këto janë bashkime të përfaqësuesve të aktiviteteve të ndryshme prodhues dhe tregtare, ose agropërpunuese. Ato shërbejnë për të lehtësuar kryejën e veprimtarive që lidhen me përmirësimin e njohjes së tregut, përdorimin e kontratave standarte, realizimin e kërtimeve shkencore, etj., me interes të përbashkët.

Afatmesme : (2009-2010) e në vazhdimësi

- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të besueshëm, në vendin dhe kohën e duhur
- Promovim i shoqatave dhe partnershipeve paralele dhe vertikale
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes
- Nxitja e lobingut për politikat tregtare të grupeve të fermerëve
- Nxitja e praktikave të mira tregtare që rrisin cilësinë e produkteve

Afatgjatë: (2011-2013)

- Prodhimi dhe shpërndarja e informacionit të besueshëm, në vendin dhe kohën e duhur
- Promovimi i shoqatave dhe partnershipeve paralele dhe vertikale
- Nxitja e operacioneve të pasvjeljes
- Nxitja e lobingut për politikat tregtare të grupeve të fermerëve
- Ndërtimi i tregjeve të fermerëve dhe pikave të grumbullimit
- Nxitja e praktikave të mira tregtare që rrisin cilësinë e produkteve

3.6 Çështje “vertikale” të SSBU: zona malore

Bujqësia shqiptare në zonat malore ka specifikat e veta. Ato lidhen me kushtet e Veçanta tokësore, klimatike dhe natyrore, por edhe historike dhe sociale të tyre. Në sajë të këtyre kushteve, fermat në këto zona janë më të vogla, tregjet e produkteve dhe të inputeve janë me larg, infrastruktura rurale është më e dobët, kushtet për zhvillim janë më të kufizuara, zhvillimi ekonomik dhe social më i vonuar, shkollimi dhe arsimimi më pak i avancuar, varfëria në të tërë dimensionet e saj monetare dhe jomonetare më e thelle dhe më e përhapur, etj. për këto arsye, sfidat e zhvillimit janë më të veshtira dhe mënyrat e politikat trajtimit të problematikave të zhvillimit të bujqësisë mund të ndryshojnë nga ato që mund të përdoren në zonat fushore.

SSBU ndonëse përmban parimet, rregullat dhe politikat me kryesore të zhvillimit të bujqësisë, ka edhe fleksibilitetin e duhur që këto politika të mund të përshtaten sipas kushteve të zonave të Veçanta të vendit. Fermerët e zonave malore kanë nevojë edhe për teknika dhe teknologji specifike, për të lehtësuar punën dhe rritur rendimentin. Aktivitetet jobujqësore janë më të nevojshme për të rritur burimet e të ardhurave. Për këtë arsye, nevojat për training janë më të mëdha dhe specifike. Shpenzimet përmes projekteve për training, por edhe shpenzimeve publike për arsimim që duhet të bëjë shteti në këto zona janë të dorës së parë. Shkollat e mesme me profil bujqësor ose agroturistik do të ishin shumë të nevojshme në këto zona. Për shkak të fermës shumë të vogël, politikat për të ndikuar në rritjen e sipërfaqes së fermës dhe të numrit të kafshëve janë më emergjente.

Politikat për nxitjen e agroturizmit, ose turizmit malor, zejtarisë, tregtisë të shumëllojshme, përpunimit të produkteve bujqësore dhe përfundimit të një game të gjerë produktesh nga shfrytëzimi i qendrueshëm i pyjeve janë parësore në këto zona. Në këto politika mund të përfshijnë dhënien e njohurive përkatëse dhe mbështetjen e iniciativave lokale me fonde dhe projekte specifike.

Përmirësimi i infrastrukturës rurale në këto zona është më emergjent se në zonat e tjera rurale dhe në përgjithësi prania e shtetit duhet të jetë më e gjerë.

Kërkimi për të mbështetur bujqësinë malore duhet të këtë një profil disi të veçantë, duke u fokusuar në produktet, bimët dhe kafshët që janë më të përshtatshme për këto zona. Produktet autoktonë dhe produktet organike, si dhe bimët me kohë vegjetacioni të shkurtër duket se në këto

zona janë një rrugë e mirë për të rritur të ardhurat e fermerëve në kushtet e burimeve të kufizuara të tokës dhe kufizimeve klimatike e tokësore.

Informacioni për tregun dhe për teknologjitë në këto zona është me rëndësi esenciale. Këtu roli që duhet të luajnë strukturat publike të bujqësisë është më i rëndësishëm, mbasi operatorët privatë janë pak të zhvilluar.

Duke qenë se aktivitetet jobujqësore në disa nga zonat malore janë të kufizuara, edukimi i popullatës me njohuri bujqësore mund të jetë më i domosdoshëm dhe që në shkollat e ciklit më të ulët. Trainimi me njohuri mbi punët bujqësore dhe rritjen e kapaciteteve menaxhuese të fermës janë disa nga politikat më efektive për rritjen e të ardhurave nga bujqësia dhe reduktimin e varfërisë në këto zona.

Një rrugë e rëndësishme e rritjes së të ardhurave dhe mbrojtjes së mjedisit në këto zona është edhe pjesëmarrja e banorëve në skema publike të mbrojtjes së tokës nga erozioni dhe ato të pyllëzimit të tokave jopjellore, ose të papërshatshme për bujqësi.

Nxitja e veprimit të përbashkët në grup ose në bashkësi është esenciale për të përmirësuar prodhimin, shitjen e prodhimit por edhe për të përfituar nga ndihma dhe projekte zhvillimi.

Një ceshtje thelbësore e politikës strategjike bujqësore do të jetë marja e masave të rëndësishme që do të nxizin dhe sigurojnë një **profesionalizëm** të lartë të administratës shtetërore. Me janë forcimi i kapaciteteve administrative të MBUMK dhe agjencive të saj, që të jenë të afta të menaxhojnë efektivisht sektorin e bujqësisë dhe agropërpunimit. Kjo përfshin përmirësimin e kapaciteteve planifikuese, implementuese, monitoruese dhe analizuese të MBUMK dhe agjencive në vartësi të saj, por edhe aftësimin për menaxhimin efektiv të MSA dhe në përgjithësi të procesit të integritimit me BE.

3.7 Çështje të politikave ndërsektoriale

Arritja e objektivave në fushën e zhvillimit bujqësor dhe agroushqimor ndihmohet edhe nga strategjitë dhe politikat ndërsektoriale.

Strategjia e zhvillimit rajonal, me programin e zhvillimit të rrugëve rurale, do të ndikojë në mënyrë të ndjeshme në përmirësimin e aksesit të fermerëve në treg, pra në shitjen e produkteve të tyre dhe indirekt edhe në ristrukturimin dhe rritjen e prodhimit bujqësor, punësimin jobujqësor dhe të ardhurave të fermerëve.

Strategjia e turizmit, përmes nxitjes që synon t'i bëjë turizmit në zona të caktuara, do të nxitë prodhimin e produkteve bujqësore në sasi dhe cilësi përreth zonave turistike, produktet karakteristike, iniciativat për produkte dhe shërbime të reja, si edhe marketingun e tyre. Kjo është një nxitje për nga kërkesa e prodhimit bujqësor dhe rritje e të ardhurave të fermerëve, prandaj do të kontribuojë në arritjen e objektivave të SSBU.

Strategjia e arsimit, përmes përmirësimit të aksesit dhe të cilësisë në shkolla në zonat rurale, ose përmirësimit të "portofolit" të edukimit, sidomos në aspektin bujqësor, do të ndikojë në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të banorëve të zonave rurale. Kjo do të ndikojë në rritjen e nivelit të arsimit të fermerëve dhe familjeve të tyre dhe nga kjo në përmirësimin e produktivitetit bujqësor, rritjen e shanseve për punësim jobujqësor të fermerëve dhe të ardhurave të tyre.

Objektivat në fushën e energjisë do të përmirësojnë furnizimin me energji të zonave rurale, gjë që pritet t'i japë nxitje ruajtjes frigoriferike të produkteve bujqësore dhe agropërpunimit në zonat rurale.

Reforma rregullatore dhe fiskale që po ndërmerr qeveria për të përmirësuar mjedisin pro-biznes do të prekë edhe sektorin e buqësisë dhe të ushqimit. Kështu ulja e taksave dhe lehtësimi i procedurave të licencimit, si dy aspekte të rëndësishme të këtyre reformave, pritet të kenë ndikime në prodhimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara.

KAPITULLI 4:

LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

4.1 Parime të përgjithshme

Efektiviteti i zbatimit të strategjisë do të varet shumë nga sa efektive do të jetë mënyra e llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese për rezultatet e arritura në procesin e zbatimit të saj. Me qëllim që ky proces të japë rezultate, llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese:

- Do të shihen dhe realizohen për çdo nivel të menaxhimit publik si pjesë integrale e sistemit të planifikimit të integruar.
- Do të bëhen të detyrueshme përmes akteve normative sipërore
- Do të jenë të standartizuara për nga formati, metodat, koha e kryerjes, mënyra, koha dhe standartet e raportimit, si dhe natyra e politikave.
- Do të përfshijnë si pjesë të një procesi pjesëmarrës dhe demokratik përfituesit dhe aktorë të tjerë të involvuar, por jo strukturat zbatuese ose në konflikt interesi.
- Do të bazohen në një sistem rezultatesh dhe indiktoresh SMART, të bërë eksplisit, të miratuar paraprakisht, dhe të pandryshueshëm në proces.

4.2 Matricat e indikatorëve të monitorimit

Në vijim janë të formuluar indikatorët kryesorë të vlerësimit të arritjes së rezultateve nga politikat e parashikuara.

i-Menaxhimi i qendrueshëm i tokës, si komponenti bazë i zhvillimit të qendrueshëm bujqësor, dhe në harmoni të plotë me të

Tabela 5: Treguesit për objektivin 1

Nr	Treguesi	Njësia e matjes	2006	2013
1	Tapi të dhëna ⁶	%	97.2	100
2	Tokë e ujitur	000 Ha	188	250
3	Tokë e kulluar	000 Ha	200	250
4	Tokë e pakultivuar	%	Ne	2
5	Tokë për ferme	ha	1.1	1.2

ii-Rritja e punëzënies, të ardhurave dhe nivelit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre

Tabela 6: Treguesit për objektivin 2

Nr	Treguesi	Njësia e matjes	2006	2013
1	Të ardhurat bruto për ha	000 lekë	220	320
2	Të ardhura bruto për frymë		450	600
3	Tokë për ferme	ha	1.1	1.2

⁶ Perfundon nga fundi i vitit 2008

iii-Rritja e efencës ekonomike të sektorit bujqësor dhe atij agropërpunues, e cila shprehet përmes rritjes së prodhuesmerisë dhe cilësisë së produkteve të tyre

Tabela 7: Treguesit për objektivin 3

Nr	Treguesi	Njësia e matjes	2006	2013
1	Rendimenti perime	Ton/ha	223.3	250
2	Rendimenti fruta	Kg/rrënjë	18.8	25
3	Rendimenti rrush	Kg/rrënjë	96.6	110
4	Rendimenti ullinj	Kg/rrënjë	11.2	14
5	Rendimenti patate	Ton/ha	169.5	180
6	Rendimenti gumësht lopë	L/Krerë	2275	2700
7	Rendimenti gumësht dele	L/krerë	52.9	58
8	Rendimenti gumësht dhie	L/Krerë	100.4	110
9	Produktiviteti në agropërpunim	000 lekë/1 të punësuar	4800	6000
10	Produktiviteti për krah punë	000 lekë	2250	3200
11	% e frutikuturës në PBB	%	11	17
12	% e blegtorisë në PBB	%	45	50

iv- Garantimi i një standarti të sigurisë ushqimore (food safety) më të lartë për të gjithë popullsinë

Tabela 8: Treguesit për objektivin 4

Nr	Treguesi	Njësia e matjes	2006	2013
1	Gjedhë të matrikulluar	%	10	100
2	Të imta të matrikulluara	%	10	100
3	Ferma që zbatojnë PMB në bujqësi	%	Ne	20
4	Ferma që zbatojnë PMB në blegtori	%	Ne	20
5	Biznese të certifikuara për HACCP	%	Ne	30
6	Biznese me ISO	%	Ne	30
7	Tokë nën sistemin e bujqësisë së integruar	%	Ne	20
8	Tokë me bujqësi organike	%	Ne	5
9	Sistemi i bujqësisë me pak inpute	%	Ne	20

v-Përmirësimi i marketingut agrar

Tabela 9: Treguesit për objektivin 5

Nr	Treguesi	Njësia e matjes	2006	2013
1	Pjesa e fermerëve që shesin	%	93.4	98
2	Pjesa e produkteve të shitura	%	35	60
3	Raporti import/eksporte	Herë	7.5/1	5/1
4	Shitje për ferme	000 Lekë	219	320

Siç shihet nga tabelat, për një numër treguesish aktualisht është e pamundur të kemi vlerësime; kjo presupozon së i gjithe sistemi statistikor duhet ose do të pësojë përmirësimet dhe adaptimet e nevojshme në mënyrë që në vazhdimësi të bëhet i mundur monitorimi i shkallës së arritjes së

rezultateve ose produkteve të politikave dhe, përmes tyre, edhe shkalla e arritjes së qëllimeve të politikës bujqësore. Duke theksuar, gjithashtu, se një numër indikatorësh është e pamundur të parashikohen në mënyrë të saktë, për shkak të natyrës së tyre si dhe për shkak të pamundësisë ose mungesës së një vlerësimi objektiv të masës së ndryshimit të një rezultati çfarëdo me ndryshimin e një indikatorit çfarëdo me një njësi. Megjithatë, ky fakt vetëm mund ta kufizojë në një farë mase rëndësinë e këtyre lloj indikatorëve, por jo t'i zhvlerësojë ata.

4.3 Sinergjia midis komponentëve të zhvillimit

Sinergjia midis komponentëve të zhvillimit është një faktor i rëndësishëm i zhvillimit të bujqësisë. Kjo sinërgji është energjia që zhvillohet nga harmonizimi i këtyre komponenteve. Ky harmonizim duhet të realizohet në pakten në këto tre aspekte:

Harmonizimi brenda sektorit bujqësor

Brenda sektorit bujqësor nuk mund të fokusohemi tek teknologjitë dhe të lëmë mënjanë ujitjen ose anasjelltas; nuk mund të lëmë mënjanë teknikat e kultivimit ose të mbarështimit dhe të fokusohemi vetëm në teknologjitë ose anasjelltas; nuk mund të fokusohemi vetëm tek prodhimi dhe të lëmë mënjanë operacionet e pasvjeljes, ose anasjelltas.

Harmonizimi midis sektorëve

Nuk mund të fokusohemi vetëm tek bujqësia dhe të lëmë mënjanë agropërpunimin, ose anasjelltas. Nuk mund të fokusohemi të bujqësia ose agropërpunimi dhe të lëmë mënjanë marketingun agrar, ose anasjelltas. Po kështu, nuk mund të mos kihet parasysh edhe efektet e ndërsjella që kanë zhvillimi i sektorëve të ndryshëm, për shëmbull zhvillimi rajonal, si rruget rurale, mbi bujqësinë dhe tregtinë dhe anasjelltas. Nuk mund t'i lihet e tërë përgjegjësia e zhvillimit sektorit privat, por duhet të ndërgjegjësohemi që bujqësia ka shumë nevojë edhe për mbështetje publike.

Harmonizimi midis tipeve të politikave

Në këtë kuadër, nuk mund të lëmë mënjanë politikat nga kërkesa duke u fokusuar në ato nga oferta; nuk mund të lëmë mënjanë politikat tregtare dhe të fokusohemi vetëm në ato prodhuese; nuk mund të fokusohemi tek politikat e sektorit duke harruar ato ndërsektoriale ose mbisektoriale; nuk mund të harrojmë politikat fiskale dhe të përqëndrohemi vetëm në ato bujqësore, ose anasjelltas. Nuk mund të ndërtojmë politika të mira bujqësore duke harruar ato të arsimit, turizmit, mjedisit, etj.

Për këto arsye, politika bujqësore shqiptare duhet të ndërgjegjësohet përfundimisht së për shkak të sinërgjisë së ulët, normat e zhvillimit dhe eficienta e rritjes së bujqësisë kanë vuajtur. Në të kaluarën ekuilibrat midis komponentëve të ndryshëm të zhvillimit bujqësor ishin më të gjerë dhe më tolerantë, kurse sot dhe në të ardhmen këta ekuilibra janë më të ngushtë dhe më ekzigjentë, ndaj nuk mund të neglizhohen pa efekte negative të dukshme mbi zhvillimin e sektorit bujqësor. Prandaj, në SSBU gjejmë vend politika dhe këndvështrime të shumanshme që i shërbëjnë zhvillimit bujqësor.

4.4 Raporti mes konvencionale dhe organikes

Është e vështirë të thuhet se si duhet të jetë raporti midis produkteve bujqësore konvencionale dhe atyre organike në vitet që mbulon SSBU. Nga njëra anë nevojat për rritjen e ofertës së produkteve bujqësore lokale janë të mëdha dhe të shpejta, gjë që mund të arrihet më shpejt përmes përqasjes konvencionale. Por kjo është e shoqëruar me përdorimin relativisht të madh të

kimikateve artificiale, dhe pra edhe me ndotjen e tokës dhe më implikime mbi cilësinë dhe sigurinë ushqimore të produkteve të prodhuara. Nga ana tjetër, koncepti, njohuritë, kapacitetet dhe përgatitja e fermerëve, por edhe e konsumatorëve, për të ecur me shpejtësi në rrugën e prodhimit apo konsumit të produkteve organike, mungojnë dukshëm. Kjo na bën të gjykojmë se mund të ketë disa alternativa paralele zhvillimi: bujqësia me përdorim të metodave të trajtimit të integruar, bujqësia me përdorim të ulët të kimikateve, si dhe bujqësia organike. Rruga më e mirë për të ndihmuar arritjen e një raporti sa më të mirë mes këtyre orientimeve, sidomos mes produkteve konvencionale dhe atyre organike, është të planifikojmë dhe mbështesim aktivitete sa më efektive për shtimin e produkteve organike, duke filluar me identifikimin e projekteve specifike, me organizimin seminareve dhe shkëmbimit të përvojave, të fushatave sensibilizuese për fermerët dhe konsumatorët, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve mbi feramat dhe produktet organike, etj. Shërbimi këshillimor do të duhet të luajë një rol esencial në këtë proces. Dhe është e rëndësishme të mos kapemi vetëm pas produktivitetit të prodhimit për njësi të sipërfaqes, por edhe pas të ardhurave për njësi të sipërfaqes. Ky koncept do të na orientonte me shpejt drejt produkteve organike dhe do të ndihmonte në ngushtimin e hapësirave të bujqësisë konvencionale dhe zgjerimin e tyre të bujqësisë organike. Kjo e fundit do të mund të zhvillohej edhe më shpejt po të kemi parasysh dhe të identifikojmë zonat, mikrozonat, produktet më të mundshme për tu prodhuar në mënyrë organike, me destinacion qoftë tregun e vendit qoftë atë të jashtëm.

Sidoqoftë, theksojmë se në kuadrin e SSBU, në të ardhmen bujqësia organike do të ketë një mbështetje të veçantë përmes planeve të veprimit, me masa konkrete politike dhe aktivitete promovuese.⁷

⁷ Shih Planin e Veprimit të Bujqësisë Organike.

KAPITULLI 5

RRJEDHOJAT PËR BURIMET

5.1 Hyrje në kostimin e strategjisë

Zbatimi i SSBU varet në masë të konsiderueshme nga niveli i objektivave të vendosur dhe kostoja publike që do të mbështesë realizimin e tyre. Objektivi kryesor që lidh në një masë të konsiderueshme të gjithë objektivat e tjerë është rritja e prodhimit bujqësor dhe agrorshqimor, ose më mirë rritja e produktivitetit sepse ky tregues përfshin edhe problematikën e numrit të të punësuarve në bujqësi.

Shqipëria realizon sot gati 20 herë më pak prodhim për një të punësuar në bujqësi se sa vendet e vjetra të BE mesatarisht, ose gati 4 herë më pak se vendet e reja në momentin që këto iu bashkangjiten BE-së. Shqipëria është një vend i varfër, ku mbizotëron varfëria rurale. Shqipëria nuk mund të reduktojë sa duhet varfërinë nëse rritja e prodhimit ndodh me 3-4% çdo vit. Me këtë rritje fermerët shqiptarë në vitin 2013 do të jenë më mirë, por ende mjaft të varfër.

Nëse duhet të arrijmë nivelin 3000 € për të punësuar në bujqësi, nga 1800 sot, gjithësesi disa herë larg nivelit të vendeve të sapohyra në BE, rritja vjetore në bujqësi duhet të jetë rreth 8%. Dhe nëse në vitin 2013 ne duhet të kapim nivelin 5000 €, prapë larg nivelit të atëhershëm të këtyre vendeve, ne duhet të rritemi me 16% në vit.

A janë të mundshme këto rritje? Ato janë të mundshme. Studimet tregojnë se vetëm nga shtimi i tokës së ujitur me 10%, prodhimi rritet me të paktën 0.5%⁸. Nëse ne realizojmë objektivin në fushën e ujitjes, vetëm nga kjo pritjet të kemi rreth 5% rritje të prodhimit. Nëse arrijmë të fusim nën kulturë sipërfaqe të tëra toke të lëna djerrë dhe ndërpresim abuzimin me tokën, rritja e prodhimit do të ishte gati proporcionale me përmirësimin e arritur në këtë drejtim. Ka studime që i atribuojnë rritjes së madhësisë së fermës një % të rëndësishme të rritjes së prodhimit⁹. Nëse ne arrijmë të nxizim një rajonizim ose specializim të prodhimit, përmes politikave fiskale dhe skemave të mbështetjes direkte, eficaenca e tokës dhe investimeve do të ishte më e lartë, gjë që do të shoqërohej me produktivitet më të lartë të tokës. Ka studime që tregojnë se roli i ekstensionit bujqësor është po aq efektiv në drejtim të rritjes së prodhimit sa edhe teknologjitë përkatëse. Po të shtojmë këtu edhe përmirësimet e parapara në teknikat dhe teknologjitë e prodhimit, si dhe përmirësimin e konkurrencës përmes zbtimit korrekt të ligjeve dhe rregullave, si dhe përmirësimin e informacionit, mund të themi me bindje se në fushën e bujqësisë dhe ushqimit ka mundësi për të vendosur objektiva të lartë të rritjes së prodhimit. Këto mund të jenë edhe mbi 10% në vit.

Duhet pasur parasysh gjithashtu se mbështetja e bujqësisë duhet të jetë e vazhdueshme për të garantuar rritje të vazhdueshme, pra të qëndrueshme. Nëse do të mendonim për një rritje në afatshkurtër, për shëmbull për dy apo tre vjet, mbase nuk do të duheshin shumë investime edhe për të marrë 3-4% rritje në vit, kjo për shkak të inercisë së sistemeve ekonomike dhe të aktiviteteve mbështetëse jopublike dhe të faktit se investimet e viteve të kaluara e vazhdojnë efektin e tyre për disa vjet në të ardhmen. Rritja ekonomike e vazhdueshme edhe në afatgjatë do të garantohet me mbështetje të mjaftueshme dhe të përvitshme.

⁸ Albania: Strategic policies for a more competitive agriculture sector, Draft, f.26, WB, April 2007

⁹ Albania: Strategic policies for a more competitive agriculture sector, Draft, f.30, WB, April 2007

5.2 Metodatat e kostimit të strategjisë

Për shkak se mungon një metodologji e përpunuar qartë për kostimin e strategjive sektoriale, si edhe të studimeve relevante, kostimi përbën çështjen më të ndërlikuar të SSBU. Kjo vjen nga fakti që kemi të bëjmë me një plan shumëdimensional, një periudhë afatgjatë planifikimi, çka involvon mjaft pasiguri, një strategji që ngërthen një numër të konsiderueshëm degësh dhe nënsektorësh, rezultatesh, politikash dhe indikatorësh. Në shumicën e rasteve nuk është e mundur të dihet as kostoja për njësinë e indikatorit, për shëmbull sa para duhen harxhuar për të rritur rendimentin e frutave me 1 kg për rrënjë në shkallë vendi; ose sa para do të duheshin për të riparuar një digë, bile këto pyetje shpesh mund të jetë e vështirë edhe të bëhen.

Këto vështirësi bëjnë që kostimi i strategjisë të bazohet me shumë në një proces përlllogaritjesh indirekte se sa direkte.

Mënyra indirekte mund të aplikohet në tri metoda të ndryshme:

- **Në bazë të pritshmërisë së investimeve dhe shpenzimeve**
- **Në bazë të pritshmërisë së elasticitetit ose efektit të investimeve për indikatorët kyç**
- **Në bazë të niveleve përfundimtare (të vitit 2013), të paravendosura për targetet kryesore**
- **Tavanet e PBA-se**

Mënyra e parë është më e thjeshtë, por ajo ka si difekt kryesor se nuk lidh dot nivelin e indikatorëve që duhet të arrihen me nivelin e shpenzimeve ose investimeve që duhet të kryhen për të garantuar arritjen e niveleve të parashikuara të atyre indikatorëve. Gjithashtu, përlllogaritjet mbi pritshmerinë e investimeve janë zakonisht subjektive dhe rezultat i vlerësimeve kryesisht josasiore mbi normat e rritjes që pritet të ndodhin në të ardhmen, bazuar në cilësinë e klimës së biznesit, tiparet dhe normat e rritjes së investimeve dhe të prodhimit në të kaluarën, etj.

Mënyra e dytë mund të bazohet në pritshmerinë (në %) të rritjes së niveleve të elasticiteteve të investimeve të indikatorëve kyç. Në rastin e SSBU të tilla indikatorë mund të jenë rendimentet në produktet kryesore, dhe çmimet në porten e fermerit, sepse në nivelin e këtyre treguesve shprehet në një masë të konsiderueshme, direkt ose indirekt, edhe niveli i kostove të prodhimit për njësi produkti, cilësia e produkteve dhe pra edhe aftësia konkurruese, po ashtu edhe shkalla e aksesit në treg, niveli i teknologjive të zbatuara dhe niveli i të ardhurave për frymë, deri diku dhe siguria ushqimore.

Mënyra e tretë, do të kërkonte të ishin të përcaktuara niveli i targeteve kryesore për vitin 2013. Këto nivele nuk janë parashikimet së *ku pritet të jenë* këto tregues në vitin 2013, por parashikimet së *ku duam të jemi* në vitin 2013. Mbi këtë bazë, duke ecur mbrapsht, bëhet parashikimi i indikatorëve për çdo vit të strategjisë dhe kështu vazhdohet me kostimin. Problemi me këtë mënyrë është se mund të konkludohet në shifra jorealiste, të pamundshme për kostot e strategjisë, sepse targetimi nuk merr parasysh mundësitë reale për të gjeneruar zhvillim.

Bazuar në tavanet e PBA, të miratuara nga qeveria për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, kostimi thjeshtohet në mënyrë të dukshme. Në këtë rast e gjithë puna e kostimit të SSBU fokusohet në formulimin e :

- **Objektivave që duhet të arrihen në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit**
- **Indikatorët për matjen e shkallës së arritjes së objektivave të vendosur**
- **Politikat që duhet të ndiqen për të arritur objektivat e vendosur**

Objektivat e SSBU janë ata që janë paraqitur në kapitullin përkatës, por shkalla e arritjes së tyre do të varet mjaft edhe nga masa e mbështetjes financiare shtetërore. Edhe politikat përgjithësisht nuk lidhen me masën e mbështetjes buxhetore, por shkalla ose gjerësia e përdorimit të tyre nga pikëpamja territoriale, sektoriale dhe sipas objektivave do të varet nga madhësia e kësaj mbështetjeje. Indikatorët do të varen në masë të rëndësishme nga nga masa e mbështetjes buxhetore të SSBU.

5.3 Kostimi për 4-5 % rritje vjetore

Kostimi i SSBU është bërë duke u bazuar në tavanet e PBA për periudhën 2008-2010, me një rritje vjetore 4-5% në vit për vitet e tjera. Rritja e investimeve për bujqësinë do të vijë kryesisht nga identifikimi i projekteve të reja, nga fondet e IPARD, pjesërisht edhe direkt nga buxheti i qeverisë shqiptare.

Tabela e mëposhtme tregon koston e SSBU, përfshire koston administrative të MBUMK, sipas viteve:

Tabela 10: Buxheti i SSBU (mld leke)

Emërtimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Buxheti (mld leke)	5.80	4.70	5.00	5.3	5.6	5.85

5.4 Çështje kritike të lidhura me buxhetin e bujqësisë

Pavarësisht nga llogaritjet, realizimi i parashikimeve të strategjisë në nivele të kënqashme, do të varet nga menaxhimi i disa çështjeve kyç, që mendohet të jenë çështje kritike të strategjisë. Midis tyre përmendim:

Kutia 14: SSBU dhe buxheti publik për bujqësinë

Në programin buxhetor afatemesëm (PBA) për periudhën 2008-2010 bujqësia dhe ushqimi parashikohen të marrin nga 2 në 1.5% të buxhetit publik. Kjo shifër është mjaft e vogël krahasuar me disa sektorë të tjerë. Këto shifra duken akoma me kritike po të kemi parasysh se: në bujqësi punojnë 58% e fuqisë puntore të vendit; rreth 55% e popullsisë jeton në zonat rurale dhe rreth 80% e saj merret me bujqësi; bujqësia jep gati 21% të PBB ; varfëria është më e përhapur në zonat rurale, pra në familjet fermere; bujqësia është motori i zhvillimit ekonomik të vendit. Shifrat e PBA janë të vogla edhe në raport me atë çfarë shpenzojnë për bujqësinë vende të tjera. Kështu, Moldavia shpenzon për bujqësinë 3% të buxhetit, Serbia 2.5%, Azerbajxhani 6%, Armenia 9%, vendet në zhvillim në përgjithësi harxhojnë 6-8%, ndërsa vendet e zhvilluara industriale harxhojnë midis 3 dhe 5%, kur dihet që bujqësia në këto vende zë rreth 2-3%, bile edhe më pak të PBB dhe përqindja e të punësuarve në këtë sektor shpesh është edhe nën 2. Për t'u zhvilluar shpejt dhe për të reduktuar varfërinë në mënyrë të dukshme, veç kontributit në rritje të sektorit privat, edhe buxheti publik duhet të mbështesë me shumë

- Identifikimi dhe sigurimi i projekteve të reja
 - Mbështetja financiare epr bujqësinë
- Progresi për MSA (lidhet me financimet në kuadrin e IPA-s)
- Monitorimi dhe vlerësimi (efektiviteti i projekteve)
- Sigurimi i një procesi pjesëmarrës në tërë gjatësinë e ciklit të politikave
 - Ristrukturimi dhe konsolidimi administrativ mund të jetë një çështje kritike, sepse cilësia e

burimeve njerëzore dhe e strukturave implementuese do të jetë e rëndësishme për arritjen e objektivave të politikës.

Identifikimi i projekteve të reja është çështje kyç, sepse deficitet strategjike janë të konsiderueshme; në vitin 2009 shterrin thuajse të gjitha projektet aktuale dhe ky vit është shumë afër. Në të kundërt është i nevojshëm një kontribut më i madh publik në investimet për bujqësinë.

Investimet për teknologjitë, por edhe shpenzimet për informacion më të besueshëm dhe më të shumtë dhe këshillim do të duhet të luajnë rol kryesor në strukturën e shpenzimeve publike për bujqësinë, ndërkohë që nuk pritet ndonjë aktivizim i shpejtë dhe i konsiderueshëm i sektorit privat të huadhënies për bujqësinë.

Mobilizimi i kursimeve brenda në sektor do të marrë mbështetje të veçantë, dhe pritet të luajë rol të përmirësuar në financimin e zhvillimit bujqësor. Platformat e Inovacionit Rural (PIR) dhe partnerшипet, si për shëmbull ato të ngjashme me Grupet e Veprimet Lokal (GVL) në BE, pritet të marrin rol të veçantë edhe në këtë aspekt.

5.5 Kur IPA të jetë në Shqipëri

IPA (Instrument for Pre-Accession) do të thotë **Instrumenti i Para-Aderimit**. Tashmë ai do të jetë i vetmi instrument ndihmë i BE për vendet aspiruese, sepse instrumentet paraardhës, si PHARE, SAPARD, CARDS, ISPA, nuk do të jenë më të vlefshëm. IPA është instrumenti apo mekanizmi me anën e të cilit BE do të ndihmojë vendet që aspirojnë për integrim në këtë organizatë dhe që kanë marre statusin e vendit kandidat. Shqipëria është ende vend potencial. Në keto kushte Shqipëria mund të mbështetet nga IPARD. Ky mekanizëm mbulon pesë fusha ose komponentë:

1. **Ndihmë për tranzicionin dhe ndërtim kapacitetesh**
2. **Kooperim ndërkufitar**
3. **Zhvillimi rajonal**
4. **Zhvillimi i burimeve njerëzore**
5. **Zhvillim rural ose komponenti IPARD (Instrumenti i para-aderimit për zhvillimin rural)**

Si vend potencial Shqipëria mund të përfitojnë vetëm nga dy komponentët e parë, por një pjesë të fondeve të marra në këto dy komponente mund t'i shpenzojnë për komponentin e pestë. Për vitin 2007 Shqipëria mori nga BE 61 milion € për të dy komponentet e parë. Në vitin 2010 kjo shumë do të arrijë në 93.2 milion. Këto fonde menaxhohen nga Delegacioni i Komisionit europian në Tiranë.

Kur Shqipëria të bëhet vend kandidat i BE, do të përfitojë mbështetje për të 5 komponentët e IPA-s, pra edhe për zhvillimin rural, përfshirë aty edhe bujqësinë. Në bazë të përvojës së vendeve të tjera ajo do të marrë afërsisht 93 milion € në vit. Për zhvillimin rural në kuadrin e IPARD ose IPA-5, Shqipëria do të marre afërsisht midis 5 dhe 13 € ndihmë për hektar, ose rreth 5.6 deri 14.6 milion € në vit. Dy nga kushtet e rëndësishme për këtë do të jenë hartimi i strategjisë së zhvillimit rural sipas standardeve europiane dhe ngritja e një agjencia pagesash për të administruar ndihmën që do të jepet. Natyrisht, do të duhet të ngrihet edhe një sistem i përshtatshëm informacioni bujqësor që përbëhet nga regjistra dhe tregues të rëndësishëm, e cila ka një kosto të konsiderueshme.

5.6 Kontributet financiare për bujqësinë: një shikim më i gjerë

Kontributet financiare per bujqësinë dhe ushqimin pritet që të jenë më të gjera se sa parashikohen vetëm në buxhetin publik bujqësor.

Në rradhë të parë vetë fermerët dhe agrobizneset do të përballojnë një kosto shtesë për investime të drejtpërdrejta, ashtu si në vitin 2006 kur së bashku investuan rreth 36 milion €. Huatë bankare per bujqësinë, me përmirësimin e kuadrit ligjor të biznesit dhe veçanërisht atij bujqësor, pritet të shtohen. Fondi për Financimin e Zonave Malore, FFZM, gjithashtu është mjaft aktiv edhe ne bujqësi. Deri në fund të vitit 2006 ky fond kishte 5343 klientë ndërsa portofoli i kredisë së tij arriti në 1.3 miliardë lekë. Nga kjo shumë, huatë për bizneset agrourbimore dhe fermerët kishin një peshë të konsiderueshme. Me mbështetjen e IFAD dhe të Kooperacionit Zvicëran, ky fond do të vazhdojë aktivitetin e tij edhe për disa vite të tjerë.

Që nga viti 2002 është në aktivitet edhe Unioni i Shoqatave të Kursim-Kredisë (USHKK). Duke bashkuar financimet e disa donatorëve dhe kursimet e fermerëve, përmes shoqatave të kursim-kredisë, ky organizëm ka kontribuar ndjeshëm në financimet për bujqësinë. Me rreth 100 SHKK, 13000 antarë dhe një portofol kredie prej mbi 1.6 miliardë lekë ky fond ka mundur të ketë mbi 500 depozitues dhe 8700 klientë. Ai do të jetë një aktor i rëndësishëm i financimeve të bujqësisë përgjatë gjithë horizontit kohor të SSBU-së.

Fondi i Zhvillimit të Zonave Malore (FZHVM) ka qënë dhe do të vazhdojë të jetë për disa vite një tjetër bashkëkontributor i qeverisë për financimin e bujqësisë. Një pjesë të financimeve të tij ky program do ta alokojë në drejtim të teknologjive bujqësore, marketingut dhe tregjeve, asistencës teknike dhe këshillimit bujqësor.

Në Shqipëri veprojnë një rrjet mjaft i gjerë miniprojektsh me karakter bujqësor, apo me spektër më të gjerë. Ato kanë kontribuar gjerësisht në teknologji bujqësore, informacion dhe këshillim teknik për fermerët dhe agropërpunuesit. Përmendim Agrinas, Dorkas Aid, Oxfam, Plan Albania, CESVI, etj. Kontributet e tyre konkrete nuk janë të evidentuara saktë, por gjykohet se ato janë të rëndësishme dhe do të vazhdojnë. CESVI, për shëmbull, është në procesin e identifikimit të një projekti të ri prej 1.7 milion €. Këto kontribute do të vazhdojnë edhe për disa vite në të ardhmen dhe kjo do të ketë efekte shtesë në arritjen e objektivave të SSBU.

5.7 Partneriteti publik-privat

Një nga çështjet më të rëndësishme të SSBU është edhe nxitja e bashkëpunimit midis qeverisë dhe sektorit privat në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi në financimin e bujqësisë përmes huave dhe mbështetjes me projekte të vecanta tashmë është i njohur dhe realizohet natyrshëm në kuadrin e tregut. Ai realizohet natyrshëm dhe në një sërë shërbimesh, si ai këshillimor, informim, etj., ku sektori publik me atë privat japin kontribute të caktuara. Ajo që propozohet të jetë e theksuar në këtë strategji është forcimi i partneritetit në bashkëfinancimin e projekteve të zhvillimit. MBUMK ka përgatitur një numër koncept-projektsh, ku përveç kontributit të qeverisë dhe në rast zbatimi parashikohet që të kontribuojë edhe sektori privat me deri 30-40% të koston së tyre. Ky partneritet do të zhvillohet më tej edhe në fushën e këshillimit bujqësor. Natyrisht, për ta futur në një linjë të qendrueshme këtë partneritet do të duhet të hartohet apo përmirësohet edhe legjislacioni përkatës, që të përcaktojë ashtu si duhet kushtet, mënyrat, limitet, si dhe të gjitha çështjet e nevojshme që partneriteti privat-publik të institucionalizohet dhe forcohet më shumë.

Referenca:

1. A policy agenda for pro-poor agricultural growth, E. Dorward, Wye College, London, 2001
2. Acces for agricultural and food products from Albania to EU, A. Swinbank, FAO, 1994
3. Advancing participatory technology development, ETC-Holland, 2003
4. Agricultural information and communication in Albania, G. Tansey, FAO, 1994
5. Agricultural land protection policy for Albania-H. M. Jacobs, 1997
6. Agricultural Policies in less developed countries, F. Ellis, Cambridge University
7. Albania: Strategic Policies for a more competitive agriculture sector, Discussion draft, WB, 2007
8. Albanian agriculture in transition, Conference, UBT, 2001
9. An agricultural strategy for Albania, WB-EU, 1992
10. Biointensive IPM, Rex Dufour, NCAT, 2001
11. Bujqësia dhe shkencat bujqësore nga tranzicioni drejt integritit europian, Konfernce, UBT, 2002
12. Creation of land markets in transition countries, J.D. Standfield, 1999
13. Country report: Albania, ARCOTRASS Consortium, 2006
14. Ekstensioni bujqësor si një mjet zhvillimi, M. Osmani, 1999
15. Elements of agricultural trade policies, J.P.Houck, University of Minnesota, 1986
16. Fundamentals of land consolidation as an instrument to abolish fragmentation of agricultural holdings, Jan Sonnénberg, Delft University, Holland, 2002
17. Getting agriculture moving, A. Mosher, 1995
18. Good Agricultural Practices, Wikipedia, 2007
19. Harta e potencialeve prodhuese të fruta perimeve për treg në disa rrethe të vendit, MBU-GTZ, 2004
20. Institutions and economic policies for pro-poor agricultural growth, DFID report, 2004
21. Making agricultural trade liberalization work for the poor, Joahim von Braun etc., IFPRI, 2004
22. Marketing strategies for small farms, Emanuel I.S. Ajuzie, Lincoln University
23. Menaxhimi efektiv i zhvillimit bujqësor, M.Osmani-K.Pata, 2002
24. National strategy plan for rural development 2007-2013, Republik e Sllovenise
25. Networking for innovation, Solomon M., etc., 1997
26. Nxitja e eksporteve shqiptare-rekomandime perhartimin e një strategjie kombëtare, ME-GTZ, 2002
27. Opportunities for Korca- An agroeconomic study, ETC Holland-IARA Albania, 2004
28. Plani I zhvillimit të infrastrukturës së tregjeve publike, John Tracey White, FAO, 2005
29. Platforma e ristrukturimit të Shërbimit Këshillimor, MBU, 1998
30. Policy and politics for smallholder agriculture, Regina Birner, etc., IFPRI, USA, 2005
31. Policy issues for the agricultural sector of Albania, G. Christensen, FAO, 1995
32. Principles of agricultural economics, D. Colman-T.Young, Kambridge University, 1989
33. Pro-poor policies, Hafiz A. Pasha
34. Raporti vjetor 2005-Banka e Shqipërisë
35. Rural Strategy Albania-undërpinning growth and sustainable development, WB-2002
36. Së bashku për një SKZHES të bazuar në Objektivat e Mijëvjecarit, MF-UNDP, 2005
37. Shqipëria: një vlerësim i varfërisë, WB, 2003
38. Shqipëria: ruajtja e rritjes së qendrushme edhe pertej tranzicionit, WB, 2004
39. Sida dhe perspektiva të ekstensionit bujqësor, I.Tarelli, 2005
40. Social organization of innovation, Solomon M., etc., 1997
41. Strategjia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MBU-GTZ, 2003
42. Strategjia e Gjelbër, MBU, 1998
43. Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rural, MBUMK, 2007
44. Sustainable Agricultural and Rural development, UN, 2000
45. The impact on investment and production of different agricultural policy instruments, Carmel Cahill, OECD, 2005
46. Thinking about rural development, A. Mosher, 1976
47. Zhvillimi bujqësor i qendrushëm, vlerësime dhe probleme, M.Osmani- K.Pata, 2001



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri:169

Tiranë – E Mërkurë, 5 Nëntor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020..... 8483



VENDIM

Nr. 709, datë 29.10.2014

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE PËR ZHVILLIMIN
RURAL DHE BUJQËSOR 2014-2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
PËR ZHVILLIMIN RURAL DHE
BUJQËSOR NË SHQIPËRI**

SHKURTESAT

ADI	Sistemi i Kontrollit të Sëmundjeve të Kafshëve
AKP	Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AM	Autoriteti menaxhues
ASHZH	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BAM	Bimë aromatike dhe mjekësore
BE B	ashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi ndërkufitar
BRE	Burimet e rinovueshme të energjisë
C	Celcius
CAP (PPB)	Politika e përbashkët bujqësore
CMO	Organizimi i tregut të përbashkët
FCO ₂	Dioksid karboni
DBR	Drejtoria e Bujqësisë Rajonale
EOM	Emërtim origjine të mbrojtur
EUR	Euro, monedha zyrtare në eurozonë
EUROSTAT	Instituti Evropian i Statistikave
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
SHKF	Shërbimet këshillimore për fermat
FBKF	Formimi bruto i kapitalit fiks

FEBZHR	Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural
FNAP	Plani veprimi të ushqimit dhe të ushqyerit
FP	Formim profesional
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FTE	Ekuivalenti i kohës së plotë
GES	Gaz me efekt serrë
GG	Giga gram
GIS	Sistemi i informacionit gjeografik
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GJ	Giga xhaul
HA	Hektarë
HACCP	Analiza e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit
HEC	Hydrocentral
IACS	Sistemet e integruara të administrimit dhe kontrollit
ICK	Indeksi i çmimeve të konsumit
IHD	Investimet e huaja direkte
INSPIRE	Infrastruktura për informacion hapësinor në Evropë
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti për Asistencë i Paraaderimit
IPARD	Instrumenti për asistencë paraaderimit për zhvillimin rural
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
IT	Teknologji informacioni
K&ZH	Kërkim dhe zhvillim
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike
KM	Komuniteti Monitorues
KPMV	Kuadri i Përgjithshëm për Monitorimin dhe Vlerësimin
Ktoe	Kilo ton naftë ekuivalent
Lekë	Lekë shqiptarë
LIS	Sistemi i informacionit të tokës
LPIS	Sistemi i identifikimit të parcelave të tokës
M & E	Monitorimi dhe vlerësimi
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MZHETS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MIFF	Kuadri shumëvjeçar financiar
MM	Ministria e Mjedisit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MT	Milionë tonë
MZHP	Mekanizmi i zhvillimit të pastër
NJEB	Njësi ekonomike bujqësore



NJVP	Njësi vjetore e punës
NUTS3	Nomenklatura e Njësive Territoriale të Statistikave
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPU	Organizatat e Përdoruesve të Ujit
PAZA	Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorëve ndaj sëmundjeve zooteknike
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
PUT	Produkt ushqimor tradicional
QSH	Qeveria e Shqipërisë
QITB	Qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore
QIB	Qendrat e informacionit bujqësor
RUDA	Sistemi i identifikimit të bagëtive të imëta
SBP	Sipërfaqe bujqësore e përdorur
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SHBB	Shoqatat e Bashkëpunimit Bujqësor
SHPU	Shoqatat e Përdoruesve të Ujit
SHRA	Shtetet e Reja Anëtare
SNZHRB	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SME	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
SVSH	Shërbimet veterinarë shtetërore
TGJM	Treguesit gjeografikë të mbrojtur
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
TVSH	Tatim mbi vlerën e shtuar
UAA	Sipërfaqe toke e shfrytëzuar
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNJP	Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara
USAID	Ajencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VET	Veteriner
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VSHB	Vlera e shtuar bruto
Wh	Vat orë (kilovat orë, megavat orë, gigavat orë)

Kursi i këmbimit i përdorur = 1 euro = 139,1 lekë,
kursi i datës 18 mars 2013.

Përmbledhja ekzekutive

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (SNZHRB), e përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) nga tetori 2012 deri në prill 2013, është hartuar sipas kuadrit të strategjisë “Evropë 2020” për një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe përfshirëse¹ dhe objektivit të përgjithshëm strategjik të Shqipërisë për t’u anëtarësuar në BE.

Ajo është përgatitur në përputhje me qasjen për planifikim strategjik në BE për Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) 2014-2020, duke u përqendruar në të njëjtën kohë në nevojat specifike për zhvillimin e bujqësisë, të agropërpunimit dhe zonave rurale në Shqipëri. Këto nevoja dhe sfida janë bazuar dhe analizuar përmes disa studimeve sektoriale dhe analizave të kryera si pjesë e procesit të përgatitjes së strategjisë. Në fund duhet theksuar se strategjia është përgatitur përmes një procesi pjesëmarrës, duke përfshirë të gjitha departamentet teknike dhe drejtoritë përkatëse të MBZHRAU-së.

SNZHRB-ja është përgatitur gjithashtu si një pjesë integrale e përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), e koordinuar nga Njësia e Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pranë Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri. SNZHRB-ja është përgatitur në bazë të kërkesave të vendosura nga Këshilli i Ministrave dhe urdhrave përkatës të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Strategjia është përgatitur në konsultim me grupet e interesit, përfshirjen e donatorëve dhe koordinimin me grupin ndërmintor politik të punës të përfaqësuar në nivel zëvendës-ministrash.

Objektivi kryesor i SNZHRB-së është përcaktimi i kuadrit strategjik për trajtimin e sfidave me të cilat përballen sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit, si dhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale, duke propozuar instrumente politikash të ngjashme me instrumentet e CAP (PPB-së), duke i kushtuar vëmendje të veçantë përgatitjes së

¹ Komisioni Evropian (Shpjegim i Bashkimit Evropian: Evropë 2020 – Strategjia e rritjes evropiane, Luksemburg 2013)



sektorëve, instrumenteve të politikave dhe përshtatjes institucionale për anëtarësimin në BE, për të arritur një përmirësim të qëndrueshëm të konkurrencës së Shqipërisë.

Përveç kësaj hyrjeje dhe përmbledhjes, Strategjia përmban kapitujt e mëposhtëm:

Kapitulli 1 përshkruan dhe vlerëson zhvillimin bujqësor dhe zhvillimin në zonat rurale nga një këndvështrim ekonomik, mjedisor dhe social, duke ofruar informacion në lidhje me situatën në zonat rurale dhe që shërben si bazë për ndërhyrjet e propozuara në strategji.

Kapitulli 2 paraqet vizionin e MBZHRAU-së për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale, duke theksuar objektivat për të siguruar rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë, bazuar në rritjen e konkurrueshmërisë, shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe në rritjen gjithëpërfshirëse e të ekuilibruar territoriale në zonat rurale të Shqipërisë.

Kapitulli 3 përshkruan politikat e zgjedhura nga MBZHRAU-ja për periudhën 2014-2020, për 3 fusha kryesore politikash: 1) Zhvillim rural në përputhje me kërkesat e CAP (PPB) 2, 2) Mbështetjen direkte për fermerët në përputhje me kërkesat e CAP (PPB) 1, investime në infrastrukturën rurale për menaxhimin e ujërave dhe konsolidimin e tokës, si dhe veprime (aktivitete) që mbështetin mundësitë e barabarta, dhe së fundmi, 3) Zhvillimin institucional, legjislativ dhe zbatimin e tij.

Kapitulli 4 paraqet buxhetin e përgjithshëm për periudhën 2014-2020, bazuar në buxhetin aktual të MBZHRAU-së për vitin 2014, si dhe mbështetjen nga IPA e BE-së dhe mbështetje nga donatorë të tjerë gjatë kësaj periudhe.

Kapitulli 5 paraqet kuadrin e monitorimit dhe vlerësimit bazuar në sistemin e përcaktuar për monitorimin dhe vlerësimin e mbështetjes së programit IPARD.

Shtojca A paraqet treguesit e përzgjedhur për sistemin e monitorimit dhe të vlerësimit, duke paraqitur treguesit bazë për vitet 2007 dhe 2011 aty ku disponohen, dhe objektivat sasiorë të përcaktuar për vitin 2020.

MBZHRAU-ja do të përgatisë një plan veprimi që do të përshkruajë veprimet (aktivitetet) specifike që do të ndërmerren në periudhën afatshkurtër (2014 dhe 2015), në periudhën afatmesme (2016-2020) dhe në periudhën afatgjatë (pas vitit 2020)

dhe ky plan veprimi do t'i bashkëlidhet strategjisë.

1. Zhvillimi bujqësor dhe rural 2007 – 2013

Ky kapitull paraqet një përshkrim dhe një vlerësim të zhvillimit bujqësor, të përpunimit agrorshqimor dhe të zonave rurale nga 2007 deri në 2012 (ose 2013 bazuar në disponueshmërinë e të dhënave), të strukturuar në përputhje me qasjen e PPB-së së BE-së, që përshkruan dhe vlerëson prirjet ekonomike, mjedisore dhe sociale të sektorit.²

1.1 Zhvillimi social-ekonomik

Popullsia e Shqipërisë është rreth 2,8 milionë banorë në vitin 2013. Kjo shënon një ulje të konsiderueshme krahasuar me regjistrimin e popullsisë në vitin 2001, kur popullsia i kapërcente 3 milionë banorë. Ulja në numrin e popullsisë është rezultat i kombinimit të emigrimit dhe uljes së nivelit të lindshmërisë. Numri i fëmijëve të lindur për grua në vitin 2011 ishte 1,5. Kjo nënkupton një reduktim drastik krahasuar me 2,1 në vitin 2007 dhe 3,3 në vitin 2000 (shih tabelën 1).

Tabela 1: Treguesit kryesorë demografikë për Shqipërinë

Treguesit	2007	2012
Koeficienti bruto i lindjeve (për 1000 banorë)	10,49	12,7
Koeficienti bruto i vdekjeve (për 1000 banorë)	4,6	7,6
Ndryshimi natyror (për 1000 banorë)	5,89	5,1
Numri i fëmijëve të lindur për grua	2,1	1,8
Jetëgjatësia	78	78

Burimi: INSTAT, 2013

Sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë (2011), numri i banorëve në zonat urbane tani e tejkalon numrin e banorëve në zonat rurale (shih tabelën 2). Kjo tregon gjithashtu një ndryshim të konsiderueshëm krahasuar me fillimin e viteve '90, kur rreth 2/3 e popullsisë jetonte në zonat rurale.

Migrimi i brendshëm drejt zonave urbane i kombinuar me emigrimin ka ndikuar në këtë situatë të re. Për shembull, në vitin 2008 rreth 1 milion shtetas shqiptarë jetonin në vendet e BE-së, shumica e tyre në Greqi dhe Itali. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, 75% e emigrantëve janë

² Të gjitha të dhënat dhe statistikat kryesore në këtë dokument janë siguruar nga sektori i statistikave të MBZHRAU-së dhe INSTAT (përveç rasteve kur është specifikuar burimi) dhe janë të dhëna zyrtare.



meshkuj.³ Fluksi më i madh i emigrantëve (rreth dy të tretat) vjen nga zonat rurale dhe shumica e tyre janë të rinj. Kjo prirje demografike me migrim të rinjve për arsye pune ndikon negativisht në disponueshmërinë e forcës së punës në zonat rurale dhe përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen për zhvillimin bujqësor dhe rural.

Megjithatë, kohët e fundit është vënë re që disa emigrantë nga zona rurale po kthehen në Shqipëri duke sjellë, së bashku me kursimet, edhe njohuritë e tyre bujqësore. Kriza ekonomike dhe financiare që ka prekur Greqinë dhe Italinë, ku gjenden shumica e emigrantëve shqiptarë po detyron të kthehen në vend shumë emigrantë shqiptarë. Rreth 16,5% e emigrantëve shqiptarë e konsiderojnë kthimin në Shqipëri për shkak të krizës në Greqi dhe Itali, dhe 15% po marrin parasysh të investojnë në bujqësi⁴. Për këtë arsye, konfigurimi i popullsisë rurale në Shqipëri pritet të ndryshojë në vitet e ardhshme si rezultat i kësaj prirjeje.

Tabela 2: Struktura e popullsisë në Shqipëri, 2013

Treguesit	urbanë	ruralë	total	ruralë/ totali
Total	1 522 630	1 264 985	2 787 615	45,4%
Meshkuj	754 831	642 638	1 397 470	45,9%
Femra	767 698	622 347	1 390 145	44,7%
Femra/totali	50,4%	49,2%	49,8%	

Burimi: INSTAT

Gjatë dy dekadave të fundit, tregu shqiptar i punës i është nënshtruar ndryshimeve të mëdha strukturore. Periudha e tranzicionit është karakterizuar nga një rënie e shkallës së aktivitetit ekonomik. Gjatë vitit 2013 papunësia është rritur lehtë krahasuar me vitin 2007. Papunësia për femrat ka rënë në vitet e fundit duke mbyllur hendekun e papunësisë mes femrave e meshkujve – që nga viti 2013 papunësia e meshkujve është më e lartë.⁵

Bujqësia mbetet sektori kryesor i punësimit për fuqinë punëtore. Rreth 52% e të punësuarve ose 500 529 persona të punësuar me kohë të plotë, ishin të angazhuar në sektorin bujqësor (INSTAT, 2013). Në vitet e ardhshme kur sektori të modernizohet dhe produktiviteti të rritet, numri i personave të punësuar në sektorin e bujqësisë mund të ulet.

10 shtetet e reja anëtare të BE-së (SHRA)⁶ kanë përjetuar një ulje mesatare prej 4% në vit në punësimin në bujqësi nga viti 2005 deri në 2012, ku disa shtete kanë ulje më të larta se të tjerat. Bujqësia në Shqipëri pritet të përballet me të njëjtin zhvillim strukturor duke çuar në ulje të numrit të vendeve të punës, dhe nëse në Shqipëri do të realizohet i njëjti nivel uljeje (4% në vit), numri i vendeve të punës në vitin 2020 do të reduktohet në 336 000 (një pakësim prej 130 000 vendesh pune).

Ky trend do të balancohet me shtimin e aktiviteteve jobujqësore, ndërsa pritet që përmirësimi i përdorimit të tokës do mundësojë punësim shtesë. Kjo tendencë reflekton një sfidë politike shumë të madhe për qeverinë shqiptare. Megjithatë, bujqësia do të mbetet një sektor kryesor punësimi edhe në vitin 2020.

Punësimi i femrave në sektorin e bujqësisë është më i lartë krahasuar me meshkujt, por ende kishte vetëm 21 527 drejtuese femra të fermave në vitin 2012 krahasuar me 329 389 drejtues meshkuj, gjë që shënon një ndryshim të vogël krahasuar me vitin 2007.

Përqindja e drejtueseve femra të fermave në vitin 2012 ishte 6,5% krahasuar me 5,5% në vitin 2007 (55% e fuqisë totale punëtore në bujqësi përbëhet nga femrat), gjë që nënkupton se mund të shqyrtohen mundësitë e politikave të skemave mbështetëse me orientim gjinor.

³ Azzarri, C. dhe Carletto, C., 2009, Modelimi i dinamikave të migrimit në Shqipëri, Një qasje e funksionit të riskut

⁴ Gedeshi, I. dhe Zwwager, N. De, 2012, *Efektet e krizës globale në migrimin dhe dërgesat e emigrantëve në Shqipëri*. Migrimi dhe dërgesat e emigrantëve gjatë krizës globale financiare dhe më gjerë, botimi i In Sirkeci, I., J. H. Cohen dhe D. Ratha, Banka Botërore, 2012.

⁵ INSTAT 2013

⁶ Estonia, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Çeke, Hungaria, Sllovakia, Sllovenia, Rumania dhe Bullgaria (Malta dhe Qiproja nuk janë përfshirë)



Tabela 3: Treguesit kryesorë të fuqisë punëtore në Shqipëri, 2007 - 2013

Treguesi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Popullsia në moshë pune, e aftë për punë ('000)	1082	1114	1041	1059	1070	1100	1187
Numri i të punësuarve (000)	939	974	899	917	928	958	955
Numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë (000)	542	568	496	507	507	525	500
Përqindja e punësimit në bujqësi kundrejt numrit total të të punësuarve (%)	58	60	55	55	55	55	52
Numri i të papunëve (000)	143	140	142	143	142	142	143
Shkalla e papunësisë (%)	13,2	12,5	13,6	13,5	13,3	13,4	15,6
- Meshkuj	11,2	10,4	11,5	11,2	12,4	14,5	17,4
- Femra	16,3	15,9	16,7	16,7	14,3	12,1	13,2

Burimi: INSTAT

1.2 Zhvillimi ekonomik, bujqësor dhe rural

Vitet e fundit Shqipëria është karakterizuar nga stabiliteti makroekonomik. Rritja ekonomike është luhatur ndërmjet 3% dhe 4%, ndërsa inflacioni nuk e ka kaluar nivelin prej 3,6% gjatë viteve të fundit. PBB-ja për frymë në Shqipëri është rreth 447 000 lekë e barasvlershme me 3200 euro për frymë. Ekonomia shqiptare pritet të rritet me ritme më të ulëta në vitet në vijim, duke qenë se është prekur nga kriza ekonomike globale. Greqia dhe Italia, të cilat janë goditur rëndë nga kriza, kanë qenë burimi kryesor i dërgesave nga emigrantët (shumica e emigrantëve shqiptarë jetojnë në këto shtete), Investimeve të huaja direkte (IHD) dhe këto dy shtete janë destinacioni kryesor i eksporteve. Për rrjedhojë, kriza ndërkombëtare ka një efekt negativ në ekonominë shqiptare.

Vlera e prodhimit bujqësor e shprehur (kontributi në PBB) është rritur nga 122,9 miliardë lekë (878 milionë euro) në vitin 2000, në 165,6 miliardë lekë në vitin 2007 (1184 milionë euro) dhe në 248,8 miliardë lekë në vitin 2012 (1788 milionë euro) (shih tabelën 4). Norma e rritjes reale vjetore ekonomike e sektorit bujqësor ka qenë e konsiderueshme (5,4% në vitin 2012), por është karakterizuar nga luhatje. Një arsye ndër të tjera për këto luhatje është shpesh infrastruktura jofunksionale e ujitjes dhe kullimit që e ekspozojnë sektorin e bujqësisë ndaj kushteve të këqija të motit dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Rritja mesatare vjetore në ekonominë e sektorit bujqësor në shtetet e reja anëtare ka qenë 3,1% nga viti 2007 deri në vitin 2012, dhe kështu që Shqipëria ka pasur një rritje më të madhe sesa këto shtete⁷. Që sektori bujqësor në Shqipëri ta ruajë dhe përmirësojë pozicionin e tij në konkurrencën ndërkombëtare, duhet që rritja vjetore e sektorit bujqësor në vitet e ardhshme të jetë më e lartë se niveli i 10 vendeve të reja anëtare të BE, ose me një rritje vjetore më të lartë se 5%.

Megjithatë, produktiviteti i punës (vlera e shtuar bruto/punësuar)⁸ është i ulët krahasuar me mesataren e përgjithshme të BE-së dhe gjithashtu me 10 shtetet e reja anëtare të BE-së. Në vitin 2007, niveli i produktivitetit të punës në bujqësinë shqiptare ishte 2183 euro për të punësuar, ndërsa në 10 SHRA ishte 4000 euro. Në vitin 2012, niveli në Shqipëri u rrit në 3537 euro për të punësuar krahasuar me 6914 euro për të punësuar në 10 SHRA⁹. Produktiviteti në bujqësinë shqiptare në vitin 2012 ka treguar një rritje të konsiderueshme me më shumë se 60% krahasuar me vitin 2007, gjë e cila reflektohet gjithashtu në reduktimin e fuqisë punëtore në bujqësi, siç është përshkruar më sipër.

Rritja e sektorit bujqësor dhe në produktivitetin e punës është pjesërisht rezultat i

⁷ Burimi: EUROSTAT, 2013

⁸ Vlera e shtuar bruto për njësi vjetore pune. NJVP shpreh një punonjës të punësuar me kohë të plotë në sektor.

⁹ Burimi: EUROSTAT, 2013



investimeve. Niveli i investimeve bujqësore në Shqipëri është ende i ulët.¹⁰ Gjatë vitit 2011 në sektorin bujqësor janë investuar minimalisht 20 milionë euro (këtu përfshihen investime private si edhe financimi i skemave mbështetëse publike), shifër e cila është një koeficient ende i ulët investimesh. Raporti mesatar vjetor midis vlerës së prodhimit bujqësor në 10 SHRA dhe nivelit vjetor të investimeve (i shprehur me Formimin bruto të kapitalit fiks - FBKF) ka qenë 6,4 në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2011¹¹.

Nëse sektori bujqësor në Shqipëri do të duhet të konkurrojë në mënyrë të suksesshme, pritet që ai të rrisë investimet në vitet në vijim për të vazhduar me rritjen e sektorit dhe të produktivitetit të punës me të njëjtin ritëm ose me ritëm edhe më të shpejtë sesa ai i konkurrentëve të vetë kryesorë. Kjo gjë do të kërkojë një rritje të madhe në investimet vjetore nga niveli i kohëve të fundit prej 20 milionë euro,¹² deri në vitin 2020. Kjo strategji do të paraqesë kushtet e kuadrit të nevojshëm dhe mbështetjen për investime në sektor në mënyrë që aktorët ta arrijnë këtë objektiv.

E njëjta sfidë ekziston edhe për sektorin e përpunimit agror-investime të konsiderueshme janë të nevojshme për të bërë të mundur rritjen e konkurrueshmërisë.

Produktiviteti i punës midis viteve 2007 dhe 2011 në këtë sektor është rritur me 11,7%: nga 4,7 milionë lekë (33 600 euro) në vlerë prodhimi për të punësuar në vitin 2007, në 5,25 milionë lekë (37 500 euro) për të punësuar në vitin 2012, por edhe këtu niveli i investimeve është ende i ulët, edhe pse pësoi rritje në vitet 2012 dhe 2013. Investimet në përpunimin bujqësor gjatë vitit 2012 janë ishin 8,9 milionë euro¹³ dhe nevojat për investime në përpunimin bujqësor do të rriten me të njëjtin ritëm si në sektorin bujqësor. Kjo strategji ofron gjithashtu kuadrin e nevojshëm dhe mbështetjen e investimeve të operatorëve për të arritur objektivat.

Nësektorët kryesorë të bujqësisë tregojnë rritje të madhe (shih seksionin 1.2 më poshtë). Megjithatë, performanca ekonomike e sektorit bujqësor është ende e pamjaftueshme për shkak të fermave të vogla dhe të fragmentuara, nivelit të ulët të teknologjisë dhe produktivitetit total të faktorëve të prodhimit krahasuar me mesataret e BE-së. Për këtë arsye nevojiten përpjekje më të mëdha për të rritur edhe më tej konkurrueshmërinë e këtij sektori.

¹⁰ Sektori do të përballet me ulje të të ardhurave marxhinale për çdo euro shtesë të investuar me rritjen e sektorit, si dhe do të rriten edhe kostot e nevojshme për njësi të investimeve.

¹¹ Burimi: EUROSTAT, 2013: Një euro në investime krahasuar me 6,4 euro në vlerën e shtuar bruto.

¹² Sektori i statistikave të MBZHRAU-së, 2013

¹³ Burimi: MBZHRAU, 2013



Tabela 4: Dinamikat e vlerës së shtuar bruto në sektorin e bujqësisë dhe produktivitetit të punës në Shqipëri, 2007 - 2012

Treguesi	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011	2012
PBB	Lekë (miliardë) çmimet aktuale/ korrente	967,7	1089,3	1148,1	1222,5	1282,0	1326,0
Rritja reale e PBB-së	Përqindje	5,9	7,5	3,3	3,8	3,1	1,3
Kontributi i sektorit në PBB	Lekë (miliardë) çmimet aktuale/korrente	165,6	182,1	192,3	211,3	226,6	248,8
Niveli i rritjes ekonomike reale i sektorit të bujqësisë, %	Përqindje	2,7	7,1	1,9	7,9	3,9	7,2
Produktiviteti i punës në sektorin e bujqësisë	VSHB/të punësuar (000 lekë)	306	310	388	417	447	492

Burimi: INSTAT, 2013. Të dhënat për PBB-në dhe sektorin bujqësor për vitin 2012 raportohen nga Ministria e Financave.

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në ekonominë shqiptare Ajo zë 18.3 % të PBB-së në vitin 2012 – kjo vlerë është më e lartë krahasuar me vitin 2011 dhe 2010, por edhe krahasuar me vitin 2007. Kjo për arsye se gjatë viteve të fundit bujqësia është rritur me ritme më të larta krahasuar me pjesën tjetër të ekonomisë (tabela 5).

Importi i produkteve agrorshqimore është rritur me 39% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2007, ndërsa eksportet janë rritur me ritëm edhe më të lartë, përkatësisht 72% për periudhat përkatëse; kështu, deficitit tregtar po rritet me ritëm më të ulët, por disbalanca në raportin tregtar është ende një sfidë e madhe për sektorin.

Tabela 5: Kontributi i sektorit të bujqësisë në ekonominë shqiptare

Treguesi	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Kontributi (në përqindje) i sektorit të bujqësisë në PBB	Në % të PBB-së (çmimet aktuale)	17,1	16,7	16,7	17,3	17,7	18,3
Eksportet agrorshqimore	Lekë (milionë)	7522	7399	7536	9154	12 098	12 983
Importet agrorshqimore	Lekë (milionë)	62 896	73 087	69 217	80 293	84 794	87 493
Deficiti tregtar	Lekë (milionë)	55 374	65 688	61 681	71 139	72 696	74 510
Deficiti tregtar/volumi tregtar	Përqindje	79	82	80	80	75	74
Bilanci tregtar agrorshqimor	Eksporti: importi	1:8	1:10	1:9	1:8	1:7	1:6,7

Burimi: INSTAT, (PBB dhe punësimi) dhe MBZHRAU (shifra tregtare) 2013

Politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural kanë kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social të bujqësisë dhe komuniteteve rurale. Objektiv kryesor ka qenë rritja e konkurrueshmërisë së sektorit duke mbështetur sektorët prioritarë, rritja e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara, për të rritur madhësinë mesatare të fermave e në këtë mënyrë për të rritur prodhimtarinë e sektorit. Këto politika kanë dhënë rezultate të mira (shih

shtojcën A për detaje), megjithëse duhen përpjekje të mëtejshme për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit.

Sipërfaqja e tokës bujqësore të përdorur është rritur më shumë se 20 000 ha që nga viti 2007. Janë mbjellë plantacione të reja - thuajse 15 000 ha me pemë të reja frutore dhe agrume (3193 ha), ullinj (8565 ha) dhe arrorë (1268 ha), si edhe vreshta (1135 ha), vetëm nëpërmjet skemave mbështetëse gjatë periudhës 2007-2012. Sot



shfrytëzohet thuhetse 2/3 e totalit të tokës bujqësore, por nevojitet që në vitet e ardhshme të shfrytëzohen shumë më tepër hektarë. Numri i fermave/familjeve bujqësore ka rënë me 4% krahasuar me vitin 2007 duke arritur në 350 916 ferma në vitin 2012.

Prirja e zhvillimit strukturor të bujqësisë në 10 SHRA ka qenë dramatike nga viti 2005 deri në vitin 2011. Mesatarisht, të 10 shtetet e reja anëtare janë përballur me një reduktim prej 8% në vit të numrit të familjeve bujqësore dhe për disa shtete reduktimi ka qenë edhe më drastik - reduktim prej 66% në numrin e fermave¹⁴. Duke u bazuar mbi këto përvoja, zhvillimi i pritshëm i strukturës së fermave në Shqipëri do të jetë më i shpejtë sesa ka qenë deri tani. Efekti i kombinuar i ristrukturimit të pritshëm të sektorit, i modernizimit dhe i rritjes në produktivitetin e punës do ta vendosin sektorin rural nën presion të fortë. Strategjia aktuale siguron instrumentet e nevojshme që sektori rural të përballë me këto sfida.

Madhësia e fermës është rritur nga 1,14 ha në vitin 2007 në 1,20 ha në vitin 2012, ndërkohë që madhësia e parcelës ka mbetur e pandryshuar (0,27 ha), duke nënkuptuar jo vetëm madhësi të vogël të fermës, por edhe nivel të lartë të fragmentimit, i cili karakterizon sektorin bujqësor në Shqipëri. Konsolidimi i madhësisë së fermës përbën një prirje pozitive, por ende të ngadaltë dhe larg nivelit të nevojshëm që një familje të ketë të ardhura të mjaftueshme nga fermat, dhe larg nga mesatarja e BE-së. Ritmi më i shpejtë dhe më i lartë i rritjes së madhësisë së fermës është i nevojshëm për të përmirësuar eficientë ekonomike në prodhimin bujqësor në shumicën e nënsektorëve, për t'u bërë më konkurrues krahasuar me vendet e tjera në rajon.

Zhvillimi i sektorit po realizohet duke i kushtuar vëmendje të madhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve. Këtu përfshihet shfrytëzimi i tokës bujqësore dhe pyjeve (të përkrahuar në nënseksione të veçanta), që pasqyrojnë gjithashtu objektivat e ruajtjes së mjedisit dhe natyrës. Në këtë kontekst, vëmendje i duhet kushtuar përshtatjes së praktikave miqësore ndaj ambientit duke pasur parasysh se Shqipëria duhet të mbështesë nënsektorët

intensivë që shpesh kanë efekte negative ndaj ambientit, të tilla si blegtoaria, frutat, perimet dhe kultivimi i BAM-ve. Një zgjidhje e tillë strategjike justifikohet duke pasur parasysh madhësinë e vogël të fermave, procesin e ngadaltë të konsolidimit dhe raportin e lartë të punës ndaj tokës.

Zhvillimi bujqësor është gjithashtu i rëndësishëm edhe për sa i përket përmirësimit të standardit të jetesës dhe zbutjes së varfërisë. Përveç efekteve të drejtpërdrejta, rritja e të ardhurave dhe ushqimit për familjet bujqësore, do të ketë ndikim edhe në standardin e jetesës, si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale, përmes produkteve ushqimore me çmime më të ulëta. Në periudhën 2007-2012, niveli i përgjithshëm i çmimeve u rrit me 15% (IÇK, i llogaritur nga INSTAT), ndërsa çmimet e ushqimeve u rritën me 25%. Rritja më e madhe (44%) u shënua në kategorinë "bukë dhe drithëra", çmimet e së cilës përcaktohen gjerësisht nga prirjet botërore. Megjithatë, krahasuar me indeksin e përgjithshëm të çmimit të ushqimeve, çmimet e produkteve të mishit dhe të bulmetit shënuan një rritje më të vogël (përkatesisht 19% dhe 23%). Ndërsa çmimet e perimeve (njëri nga nënsektorët i cili shënoi një nga rritjet më të mëdha të prodhimit gjatë viteve të fundit, duke rezultuar në suficit tregtar strukturor dhe plotësim të nevojave të vendit) shënuan një rritje prej vetëm 2% gjatë periudhës së referencës, duke treguar që rritja e prodhimit kontribuon në çmime më të ulëta.

Sektori ka pasur zhvillim pozitiv nga mbështetja e dhënë për të nga MBZHRAU-ja. Buxheti vjetor total i MBZHRAU-së është rritur me 28%, nga 5264 milionë lekë (37,6 milionë euro) në vitin 2007 në 6781 milionë lekë (48,8 milionë euro) në vitin 2012 dhe 7899 milionë lekë (56 milionë euro) për vitin 2014.

Ndërsa mbështetja totale në bujqësi në vitin 2012 ishte 1014 milionë lekë (7,3 milionë euro), e cila është një rritje thelbësore në raport me vitin 2007, kur fondi ishte 449 milionë lekë (3,2 milionë euro). Skemat e mbështetjes financiare dhe mbështetja e teknologjive të reja kanë kontribuar në krijimin e plantacioneve të reja me drufrutorë dhe rritjen e prodhimit në disa nënsektorë. Sistemi i përmirësuar i ujitjes ka kontribuar në rritjen e produktivitetit dhe

¹⁴ Burimi: EUROSTAT, 2013



menaxhimin e burimeve. Mbështetja e investimeve është rritur edhe më shumë dhe në vitin 2014 ka arritur në 2520 milionë lekë (18 milionë euro).


Panorama e përgjithshme e zhvillimit të sektorit ndahet në nivel sektori në seksionin vijues, me qëllim që të shpjegohen luhatjet në performancë dhe në mjedisin e konkurrencës për secilin sektor.

1.2.1 Prirjet e përgjithshme të prodhimit bujqësor

Bujqësia dhe agroindustria janë rritur me një ritëm të ngjashëm gjatë periudhës nga viti 2007

deri në vitin 2012. Në vitin 2012, vlera e prodhimit bujqësor arriti 186,2 miliardë lekë, 24% më e lartë krahasuar me vitin 2007, ndërsa agroindustria arriti vlerën 60 miliardë lekë, 25% më e lartë krahasuar me vitin 2007 (figura 1). Këto ritme paralele të rritjes nxjerrin në pah rritjen e balancuar të sektorit bujqësor në përgjithësi. Megjithatë, ka nevojë për rritje më të shpejtë të agroindustrisë për të rritur vlerën e shtuar të sektorit.


Figura 1: Vlera e bujqësisë dhe prodhimit agroindustrial (milionë lekë, çmimet e vitit 2006)



Burimi: Sektori i statistikave i MBZHRAU-së

Nga 350 916 ferma bujqësore në vitin 2012, më shumë se 300 000 ferma (310 950) ishin të angazhuara në prodhimin e bimëve të arave dhe blegtori. Kishte 159 778 ferma me pemëtoje/frutikulturë, gjë që shënon rritje krahasuar me vitin 2007, kur kishte 148 660 ferma të tilla. Prodhimi i frutave ka qenë një nga nënsektorët me rritjen më të shpejtë për sa i përket si volumit, ashtu edhe vlerës së prodhimit. Vlera e prodhimit të frutave është rritur me 57% që nga viti 2007. Edhe prodhimi i bimëve të arave është rritur gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme, respektivisht me 37% gjatë së njëjtës periudhë reference, ndërsa sektori i blegtorisë ka treguar një rritje modeste prej 2% gjatë periudhës së referencës (figura 2).

Figura 2: Vlera e prodhimit të sektorëve kryesorë të bujqësisë (milionë lekë, çmimet e vitit 2006)



Burimi: INSTAT, 2013



Nësektorët kryesorë përshkruhen në seksionet e mëposhtme, duke përfshirë prirjet e tyre, mundësitë dhe sfidat.

1.2.2 Koordinimi i zinxhirit të vlerës dhe zhvillimet e tregut

Faktori kryesor që qëndron pas rritjes së prodhimit agroushqimor është rritja e kërkesës në tregun e brendshëm. Sektori agroushqimor shqiptar karakterizohet nga një zinxhir i shkurtër, fakt që paraqet një avantazh për prodhuesit vendas¹⁵. Nga ana tjetër, në disa sektorë dominon shitblerja në tregun e hapur, ndërsa kontratat përdoren shumë pak, duke rezultuar në gjurmueshmëri të kufizuar. Organizimi i zinxhirit të vlerës është në një fazë të hershme të zhvillimit. Lidërsipimi mungon edhe pse ka disa raste aktorësh që janë gati të marrin kontroll të pjesshëm të zinxhirit të vlerës. Faza fillestare e organizimit të zinxhirit të vlerës kërkon një qasje reale për sa i përket krijimit të marrëdhënieve ndërmjet aktorëve në zinxhirin e vlerës. Kjo do të thotë që në vend të mbështetjes së të gjithë aktorëve të zinxhirit, do të ishte e këshillueshme nxitja e interesit të bazuar në marrëdhëniet midis aktorëve kyçë të zinxhirit të vlerës, duke promovuar kështu bashkëpunimin. Për më tepër, me zgjerimin e supermarketeve, kërkesa për profesionalizëm, formalizimin dhe gjurmueshmërinë e zinxhirit agroushqimor vendas do të rritet.

Në tregun vendas është vënë re një kërkesë e lartë për produkte vendase, çka shndërron rritjen e kërkesës për produkte vendase në një mundësi për rritjen e prodhuesve vendas. Më specifikisht, shumica e konsumatorëve zgjedhin produktet e tyre bazuar tek origjina (vendase apo importi), duke preferuar zakonisht produktet vendase. Gjithashtu, vihet re se brenda grupit të produkteve vendase ka diferencë të mëdha në perceptim për sa i përket rajonit brenda vendit ku produkti është prodhuar – ka një trend të qartë të preferencave rajonale për disa produkte.

¹⁵ Shënim. Shpesh konsumatorët kanë tendencën të blejnë direkt nga prodhuesit për shkak të mungesës së besimit në sistemin e kontrollit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve – një shembull është rasti i vajit të ullirit (Imami, D., Zhllima, E., Canavari M., Merkaj, E., 2013, Segmentimi i konsumatorëve shqiptarë sipas perceptimit të cilësisë së vajit të ullirit dhe sjelljeve të blerjes, Rishikim i ekonomisë bujqësore, Vëll. 14 (1)

Bazuar në lidhjen e produkteve tipike me rajonet specifike, Emërtimi i Origjinës së Mbrojtur (EOM), Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur (TGJM) ose Garantimi i Specialiteteve Tradicionale (GST) mund të promovohen nëpërmjet partneritetit privat me atë publik¹⁶. Për sa i përket tregtisë ndërkombëtare, është regjistruar një rritje e eksporteve në sektorë të ndryshëm agroushqimorë, si për shembull rasti i frutave dhe perimeve të freskëta, mundësuar nga rritja e investimeve dhe avantazhi natyror që vendi ka në rajon (kushte të favorshme klimatike, mundësia e prodhimit të hershëm). Eksportet synojnë gjerësisht tregjet e vendeve fqinje jo të BE-së, ndërsa eksportet drejt vendeve të BE-së pothuajse nuk ekzistojnë ose janë të parëndësishme për disa kategori produktesh për shkak të kufizimeve në standarde dhe në sasi të ofruara.

1.2.3 Mishi dhe produktet e mishit

Prodhimi vendas i mishit zotërohet nga prodhimi i gjedhit, i cili zë rreth 46% të mishit të prodhuar në vend. Prodhimi është ende shumë i fragmentuar, ku shumica e fermave që merren me mbarëshkrimin e gjedhit, të imtave dhe derrave, janë të vogla ose shumë të vogla. Numri i fermave të gjedhit është 214 970 (2012). Fermat e gjedhit janë të orientuara në prodhimin e qumështit, ndërsa ato të orientuara në prodhimin e mishit janë të rralla. Ka 47 039 ferma me të leshta dhe 23 445 ferma me të dhirta (2012) dhe rreth 15% e tyre kanë më shumë se 50 krerë bagëti të imëta. Numri i fermave më të mëdha me bagëti të imëta ka shënuar një rritje të lehtë në vitet e fundit. Në disa zona fermat e bagëtive të imëta janë të orientuara kryesisht drejt prodhimit të qumështit, në disa të tjera kryesisht mbizotëron drejtimi i kombinuar mish-qumësht.

Shumica e fermave kanë shpendë, kryesisht për konsum familjar. Ka 59 prodhues (për mish edhe vezë) për rritjen intensive të shpendëve me më shumë se 1000 krerë dhe 40 prodhues me mbi 10 000 krerë, disa prej të cilëve (rreth 22) kanë rreth 40 000 apo më tepër (viti 2012), të cilët furnizojnë shumicën e tregut vendas me mish pule.

¹⁶ “Ndërgjegjësimi dhe preferencat e konsumatorëve për produkte organike në Shqipëri” kryer në vitin 2013 nga projekti i EU-FAO “Përgatitja e strategjisë ndërsëktoriale për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri”



Prodhimi i mishit të gjedhit është i përqendruar në qarqet e Fierit (16,2%), Elbasanit (14,8%), Tiranës (9,8%) dhe Korçës (9,4%), të cilat së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e prodhimit total. Prodhimi i mishit të bagëtive të imëta (dele dhe dhi) është i përqendruar në qarqet e Vlorës (17,8%), Korçës (15,8%), Elbasanit (12,4%) dhe Gjirokastrës (10,8%), të cilat së bashku përbëjnë 57% të prodhimit total. Prodhimi i mishit të derrit është i përqendruar në qarqet e Lezhës (29,1%), Shkodrës (26,7%) dhe Fierit (12,8%), të cilat së bashku përbëjnë 69% të prodhimit total. Ndërsa prodhimi i mishit të shpezëve është i përqendruar në qarqet e Fierit (28,1%), Tiranës (18%), Beratit (13,2%) dhe Korçës (12,3%), të cilat së bashku përbëjnë 72% të prodhimit total.

Numri i gjedhëve në vitin 2012 ishte 498 000, që nënkupton një rënie prej 13,7% krahasuar me vitin 2007. Ndërsa numri i bagëtive të imëta ka arritur në 2 619 000, shifër e cila përkon me një rënie prej 4% për të njëjtin periudhë. Prodhimi i mishit të pulës është rritur me 23%, ndërsa prodhimi i mishit të gjedhëve ka rënë me 17%.

Eksporti i mishit është i ulët, ndërsa importi mbetet ende i lartë dhe i qëndrueshëm përgjatë viteve të fundit duke arritur deri në rreth 36 319 MT në vitin 2012, që përkon me rreth 1/4 e furnizimit vendas. Përveç kësaj, ka rritje të importit të kafshëve të gjalla, sidomos të derrave dhe gjedhëve. Importi i mishit të shpendëve është ende i lartë duke arritur 23 881 tonë në vitin 2012 ose 65,7% të importit total të mishit, i ndjekur nga importi i mishit të derrit (10 901 tonë në vitin 2012 ose 30% të importit total të mishit). Njëra nga arsytet për nivelin relativisht të lartë të importit të mishit të pulës është kostoja e ulët e pulave të ngrira të importit.

Industria e përpunimit të mishit ka qenë sektori i parë agroindustrial, që është konsoliduar dhe zhvilluar. Ekzistojnë 63 përpunues të regjistruar të mishit (2011), por 5 përpunuesit më të mëdhenj mbizotërojnë industrinë. Industria e përpunimit të mishit është e përqendruar në tregun vendas dhe mbështetet në importin e mishit të ngrirë me çmim të lirë, i cili sigurohet nga disa importues të mëdhenj.

Potencialet për rritjen e prodhimit të mishit janë të mëdha, duke marrë parasysh që konsumi i mishit dhe nënprodukteve të tij është rritur dhe

pritet të rritet akoma më shumë si rezultat i burimeve të papërdorura tokësore që duke u përdorur favorizojnë prodhimin e mishit, si dhe si rezultat i rritjes së nivelit të të ardhurave të konsumatorëve. Në vend ka zona me dendësi të ulët të bagëtive të imëta dhe zona të pashfrytëzuara të tokës bujqësore, të cilat mund të prodhojnë shumë më tepër foragjere nëse do të kenë ujë. Nga ana tjetër, preferencat e konsumatorëve për produkte mishi të vendit ofrojnë një mundësi shtesë që prodhuesit vendas të rrisin prodhimin e tyre.

Megjithatë, zhvillimi i sektorit të mishit ka disa sfida. Përmasa e vogël e fermës rezulton në efikasitet të ulët. Kostot e foragjereve janë të larta dhe mbeten një pengesë kryesore për njësitë e mbarështimit dhe majmërisë, ndërkohë që prodhuesit shpesh nuk kanë njohuritë praktike për ushqimin optimal të gjedhit. Çmimi i lartë i blerjes së ushqimeve të blegtorisë ka një ndikim të rëndësishëm në çmimin e lartë të mishit. Mospërdorimi i mjaftueshëm i racave cilësore për prodhimin e mishit në një pjesë të fermave, mungesa e fermave të gjedhit të specializuara për prodhimin e mishit dhe kushtet e shëndetit të kafshëve përbëjnë kufizime të rëndësishme për zhvillimin e sektorit. Siguria e produkteve të freskëta që shiten në dyqane pakice nuk është gjithmonë e garantuar për shkak të moszbatimit të plotë të ligjit dhe mangësive në infrastrukturë, duke përfshirë mungesën e thertoreve që përmbushin standardet minimale kombëtare. Me gjithë përmirësimet e kohëve të fundit, thertoret kanë ende mangësi në infrastrukturë, çka mbetet një shkurajim për integrim të mëtejshëm në zinxhirin e vlerës së prodhimit vendas. Thertoret nevojitet të përmirësohen dhe të plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore. Aktualisht 11 thertore të reja plotësojnë standardet e kërkuara. Ka një lidhje të dobët midis industrisë së përpunimit dhe furnizimit vendas të mishit si lëndë e parë për sa kohë që çmimet e importit janë të ulëta dhe thertoret nuk janë gati në përputhje me kapacitetin dhe standardet e kërkuara. Industria e përpunimit do të përballë me kosto të konsiderueshme kur t'i kërkohej që të trajtojë mbetjet e kafshëve.

Prioritet për zhvillimin e këtij sektori do të jetë përmbushja e kërkesës së tregut të brendshëm. Në këtë sektor ka nevojë për



investime për të përmbushur standardet mjedisore dhe ato të sigurisë së ushqimit. Ka nevojë për investime në thertore, por mbështetja për investimet që respektojnë kërkesat e sigurisë ushqimore dhe të mjedisit, sidomos për thertoret, do të duhet të kombinohet me një përpjekje kombëtare për të përmirësuar zbatimin e ligjit.

1.2.4 Prodhimet e qumështit dhe nënproduktet e tij

Prodhimi vendas i qumështit arriti rreth 1,1 milion tonë në vitin 2012, duke shënuar një rritje prej 9% që nga viti 2007. Kjo rritje në prodhim, kur shihet në kontekstin e numrit të reduktuar të lopëve dhe bagëtive të imëta, nxjerr në pah përmirësimin cilësor të sektorit. Prodhimi i qumështit dominohet nga qumështi i lopës (87%), ndërsa pjesa tjetër ndahet në mënyrë pothuajse të barabartë ndërmjet deleve dhe dhive.

Shumica e qumështit prodhohet nga prodhues shumë të vegjël gjysmë të specializuar që kanë më pak se 50 dele apo dhi dhe ferma gjedhi me më pak se 5 lopë. Shumica e fermave të gjedhëve kanë 1-2 krerë gjedhë dhe rreth 2% e tyre kanë më shumë se 5 lopë. Sidoqoftë, vihet re një prirje drejt konsolidimit: numri i fermave me më shumë se 5 lopë është trefishuar në krahasim me vitin 2005, ndërkohë që numri i fermave me mbi 10 gjedhë (1390 në vitin 2012) është rritur më shumë se pesë herë krahasuar me vitin 2005. Aktualisht ka 1390 prodhues me mbi 10 krerë gjedhë; 8536 ferma me më shumë se 50 dele dhe 3646 ferma me më shumë se 50 dhi.

Prodhimi i qumështit të lopës vjen më së shumti nga zonat fushore dhe kodrinore; mbarështimi i deleve për qumësht është i përqendruar në jug, ku ndodhen gjithashtu edhe fabrika djathi të specializuara. Në mënyrë më të detajuar, del se prodhimi i qumështit të lopës është i përqendruar në qarqet e Fierit (20,7%), Elbasanit (13,4%), Tiranës (10,8%), Shkodrës (9,5%) dhe Korçës (8,9%), të cilat së bashku përbëjnë 63,3% të prodhimit total. Prodhimi i qumështit të deles është i përqendruar në qarqet e Vlorës (17,7%), Korçës (14,1%), Gjirokastrës (13,8%), Fierit (11,1%), dhe Elbasanit (9,6%), të cilat së bashku përbëjnë pothuajse 2/3 e prodhimit total. Ndërsa prodhimi i qumështit të dhisë është i përqendruar në qarqet e Elbasanit (18,7%), Gjirokastrës (12,5%), Vlorës (11,2%), Korçës (10,9%) dhe Beratit (9,4%), të cilat së

bashku përbëjnë 62,7% të prodhimit total.

Industria e përpunimit të qumështit kohët e fundit është përmirësuar dhe pasuruar me disa fabrika moderne, sidomos në zonat fushore, por megjithatë një pjesë e saj mbetet akoma e fragmentuar. Ka rreth 30 kompani moderne të përpunimit të qumështit që përdorin teknologji të avancuar, si: “Lufra”, “Ajka”, “Primalat”, “Fast”, “Soal”, “Ekstramilk”, “Erzen” etj. Këto kompani po zëvendësojnë gjithnjë e më shumë importin dhe po fitojnë tregun vendas. Veçori tjetër e tyre janë kapacitetet optimale të prodhimit dhe shumëllojshmëria e artikujve.

Aktorët e zinxhirit të vlerës (veçanërisht fermat dhe përpunuesit e vegjël) duhet të bëjnë më shumë për të arritur standardet mjedisore dhe ato të sigurisë ushqimore. Mbledhja dhe transporti i qumështit është një nga pikat më të dobëta në zinxhirin e vlerës. Mbledhja e qumështit të papërpunuar kryhet më së shumti direkt nga përpunues qumështi dhe nga grumbullues qumështi privatë të pavarur. Shpesh qumështi nuk ruhet në tank ftohës në fermë dhe as gjatë transportit për në fabrikën e bulmetit.

Eksporti i qumështit është i ulët, ndërsa importi i tij në vitin 2012 arriti 9300 tonë. Importi i djathit gjatë (2012) ka qenë rreth 1400 tonë. Prodhimi vendas mbizotëron furnizimit vendas: importet e produkteve të bulmetit mbulojnë më pak se 10% të furnizimit vendas.

Sektori i bulmetit karakterizohet nga disa potenciale. Për sa i përket prodhimit, ka një prirje për konsolidim në prodhim në nivel ferme (rritje të numrit të fermave të mëdha të bulmetit), e cila pritet të vazhdojë. Disa fabrika të përpunimit të qumështit kanë investuar për teknologji moderne dhe kanë përmirësuar ndërtesat dhe ambientet për të shmangur ndotjen etj. Për sa i përket kërkesës, produktet e bulmetit janë pjesë e rëndësishme e shportës ushqimore për konsumatorët shqiptarë dhe ka një preferencë të përgjithshme për produkte bulmeti të vendit. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave ka shkaktuar dhe pritet të shkaktojë rritje të mëtejshme në kërkesën për produkte bulmeti, për sa i përket sasisë dhe cilësisë.

Sektori përballet me **sfida** të ndryshme. Standardet e sigurisë ushqimore dhe të mjedisit duhet që të përmirësohen dhe të respektohen. Cilësia e qumështit të papërpunuar dhe gjendja



mikrobiologjike është problematike, ndërkohë që kushtet e transportit janë të papërshtatshme, shpesh pa përdorur tanke ftohës. Në shumicën e rasteve nuk ka trajtim të ujërave të përdorura dhe të mbetjeve të përpunimit të qumështit (p.sh. laktozës). Mungesa e specialistëve të kualifikuar (teknologjia e përpunimit të qumështit, laboratorit etj.) në zonat rurale është një nga faktorët që ka penguar dhe do të vazhdojë të pengojë, përveç zbatimit të dobët të ligjit, zbatimin e standardeve të sigurisë dhe të mjedisit. Për sa u përket aspekteve ekonomike të sektorit, ka disa kufizime, përfshirë përmasën e vogël të fermave, konkurrueshmërinë në rritje nga importet (pjesë e liberalizimit të tregtisë dhe zgjerimit të zinxhirëve të supermarketeve) dhe informalitetin fiskal. Informaliteti në lidhje me TVSH-në aktualisht është një disavantazh për sektorin formal (më të madh) të përpunimit të qumështit përkundër punishteve të vogla informale, të cilat nuk paguajnë TVSH dhe taksa të tjera dhe mund të konkurrojnë me çmime më të ulëta.

Prioritet për këtë sektor do të jetë prodhimi për plotësimin e kërkesës së tregut të brendshëm. Ka nevojë për investime në zinxhirin e ftohjes në fermë. Në nivel përpunimi, **mbështetja** do të synojë edhe përmbushjen e standardeve të sigurisë së ushqimit, edhe ato të mjedisit. Do të jepet gjithashtu **mbështetje** për përmirësimin e ambalazhimit dhe të etiketimit. Mbështetja për zbatimin e standardeve duhet të ecë paralelisht me ndërtimin e kapaciteteve të fermerëve e përpunuesve, si dhe me përmirësimin e zbatimit të ligjit.

1.2.5 Frutat dhe perimet

Prodhimi vendas i perimeve është rritur me afërsisht 1/3 krahasuar me vitin 2007, duke arritur 914 000 tonë në vitin 2012. Prodhimi vendas mbizotëron tregun e brendshëm, me përjashtim të muajve të dimrit. Prodhimi i serave diellore po shtohet dhe po bëhet gjithnjë e më konkurrues. Importet kanë vazhduar të ulen, ndërsa në vitin 2011 dhe 2012 u tejkaluan nga eksportet (në sasi).

Prodhimi i frutave të freskëta është rritur me 73,3% që nga viti 2007 duke arritur 210 000 tonë në vitin 2012. Importi i frutave të freskëta ka rënë duke mbuluar rreth 28% të tregut vendas në vitin 2012 krahasuar me 45% në vitin 2007. Në vitin 2012 eksportet arritën në më shumë se 10

000 tonë, një rritje e jashtëzakonshme krahasuar me vitin 2007, kur vendi eksportonte vetëm 1462 tonë fruta. Raporti eksport/import është rritur nga 1,5% në vitin 2007 në 14,1% në vitin 2012; megjithatë deficitin tregtar mbetet i lartë. Në rastin e mollëve (fruti kryesor i vendit), prodhimi pothuajse është dyfishuar krahasuar me vitin 2007 dhe prodhimi vendas tani dominon (më shumë se 3/4) tregun e brendshëm. Edhe agrumet kanë shënuar gjithashtu një rritje të konsiderueshme me pothuajse 3-fish krahasuar me vitin 2007. Prodhimi vendas i agrumeve gjithashtu dominon tregun e brendshëm. Eksportet e pjepave dhe të shalqinjve janë rritur me 22% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2007; ata janë një nga artikujt agroushqimorë ku Shqipëria ka eksporte neto.

Prodhimi i arrorëve është rritur gjithashtu ndjeshëm dhe pritjet të rritet ende si rezultat i mbjelljeve së fundmi, të nxitura nga skema e mbështetjes nga qeveria – që nga viti 2007 janë mbjellë rreth 1268 ha. Importet dhe eksportet janë të parëndësishme. Shqetësimet kryesore mbeten kapacitetet e kufizuara të shërbimeve agronomike, të pasvjeljes dhe ato përpunuese që janë shumë pak të zhvilluara.

Prodhimi i perimeve është i përqendruar në qarkun e Fierit (31,4% e prodhimit total), i ndjekur nga qarqet e Tiranës dhe Shkodrës, të cilët së bashku përbëjnë më shumë se 1/2 e prodhimit total në Shqipëri. Ndërsa prodhimi i frutave është i përqendruar në qarkun e Korçës (23,6% e prodhimit total), i ndjekur nga qarqet e Elbasanit, Beratit, Fierit dhe Dibrës; të gjitha këto qarqe së bashku përbëjnë më shumë se 2/3 e prodhimit total të frutave në Shqipëri. Prodhimi i agrumeve është i përqendruar në qarkun e Vlorës dhe Fierit; përkatësisht 35,7% dhe 29,1%.

Shumica e prodhimeve të freskëta mblidhen nga grumbullues/shitës shumice dhe shiten në tregjet e fruta-perimeve dhe dyqanet tradicionale të pakicës. Krijimi i një rrjeti tregjesh shumice ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e prodhuesve që ndodhen larg zonave kryesore urbane për të tregtuar produktet e tyre. Qarkullimi i produkteve të freskëta të vendit në zinxhirët e supermarketeve është relativisht i vogël.

Infrastruktura dhe shërbimet përkatëse të pasvjeljes (ambientet e dhomave frigoriferike, linjat e ambalazhimit/paketimit etj.), janë të



kufizuara, por megjithatë ka pasur rritje të numrit të tyre si rrjedhojë e mbështetjes së 52 njësive të reja. Ndërsa ambientet e kufizuara të dhomave frigoriferike dhe humbjet e mëdha të produkteve si rrjedhojë e mungesës së tyre kanë qenë për vite me radhë shkaku kryesor i deficitit të lartë në tregtinë e mollëve, kapacitetet e ruajtjes në dhoma frigoriferike janë rritur në vitet e fundit. Skemat e subvencionit të qeverisë dhe forcimi i konsoliduesve, një kategori tregtarësh më afër fermerëve (e përfshirë si në shitjen e inputeve bujqësore fermerëve, ashtu edhe në grumbullimin e produkteve nga fermerët), po kontribuon ngadalë në përmirësimin e situatës. Aktualisht, grumbulluesit janë aktorët më aktivë në zinxhirin e vlerës.

Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve përbëhet nga 28 ndërmarrje formale dhe disa punishte informale gjysmë industriale që ofrojnë një gamë të gjerë frutash dhe perimesh të përpunuara.

Sektori ka një fokus të qartë të plotësimin të kërkesës së brendshme dhe të zëvendësimit të importeve. Megjithatë, nisur nga mundësitë që ekzistojnë, prioritet duhet të marrë gjithashtu promovimi i eksporteve.

Sektori i frutave dhe perimeve karakterizohet nga kushte të përshtatshme klimatike që mundësojnë prodhimin e hershëm të disa lloje frutash dhe perimesh, të cilat përbëjnë gjithashtu një **potencial** të rëndësishëm për sa i përket mundësive të eksportit; ky është sot një realitet i prekshëm i provuar me eksporte në rritje të frutave dhe perimeve. Shqipëria ka burime të pasura ujore, megjithatë duhen bërë më tepër përmirësime në infrastrukturën e sistemit të ujitjes. Ka pasur rritje në investimet e fermave (p.sh. serra të reja dhe plantacione frutash) dhe investime në shërbimet e pasvjeljes, kryesisht dhoma frigoriferike të destinuara kryesisht për frutat. Përmirësimi i kapaciteteve dhe rritja e përvojës së fermave dhe tregtarëve ka ndikim pozitiv në zhvillimin e sektorit. Për sa i përket kërkesës, vihet re preferencë e fortë nga konsumatorët për fruta¹⁷ e perime të vendit, ndërkohë që ka gjithashtu një kërkesë në rritje për fruta dhe perime të freskëta. Zinxhiri i shkurtër i vlerës (pa shumë ndërmjetës)

ka qenë avantazh për prodhimin vendas.

Prodhimi i frutave dhe perimeve përballet ende me **sfida** të ndryshme, përfshi informalitetin e sektorit të materialit mbjellës, kostot e larta të inputeve të blera dhe lëndës djegëse (që prekin veçanërisht serrat me ngrohje), produktivitetin e ulët dhe humbjet e mëdha të pasvjeljes, sidomos në rastin e frutave. Standardet e sigurisë ushqimore të frutave dhe perimeve janë gjithashtu një sfidë për t'u adresuar që të rriten eksportet drejt tregjeve të shteteve anëtare dhe drejt atyre që pritet të bëhen anëtare të BE-së.

Zhvillimi i industrisë së përpunimit të frutave dhe perimeve është penguar nga vështirësitë për të siguruar lëndën e parë për industrinë e përpunimit në sasi të mjaftueshme dhe cilësinë e kërkuar. Me rritjen e ofertës nga ferma, kjo vështirësi është më pak e rëndësishme se në të kaluarën, por industrinë në këtë sektor po ndeshen akoma me mjaft vështirësi; menaxhimi i dobët i zinxhirit të vlerës - kontratat formale ose joformale mes industrisë dhe fermave - nuk ka ndihmuar për sa i përket sigurimit të ofertës së lëndës së parë nga ferma për industrinë e përpunimit. Çmimet e larta të energjisë dhe lëndës djegëse dhe të ambalazhimit (kryesisht i importuar) janë një shqetësim i madh për përpunuesit. Ndërkohë që zinxhirët e shkurtër të vlerës kanë qenë një avantazh deri tani, zgjerimi i zinxhirit të supermarketeve pritet të transformojë zinxhirin e vlerës duke shkaktuar konkurrencë më të drejtpërdrejtë nga furnizuesit e huaj, çfarë nënkupton se prodhimi vendas ka nevojë për mbështetje të mëtejshme.

Sektori ka nevojë për zbatimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit, për të cilat shumica e operatorëve nuk janë gati; kjo do të thotë kosto më të larta për ta, prandaj në këtë drejtim kohët e fundit Qeveria e Shqipërisë ka propozuar ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Me vendim të Këshillit të Ministrave përjashtohen nga TVSH “importimi kafshëve të racës dhe i lëndëve të para që përdoren në bujqësi, të tilla si: plehurat kimike, pesticidet, farërat, fidanët frutorë, mëshqerrat racë e pastër, të imëtat racë e pastër, materiali biologjik për ndërzim, ushqimet për kafshët, plastmasi për serra etj.

Duke pasur parasysh potencialet e nënsektorit të fruta-perimeve, prioritet duhet t'i jepet

¹⁷ Skreli, E. dhe Imami, D., 2012, Rishikimi ndërkombëtar i menaxhimit të ushqimit dhe agrobiznesit, Vëll. 15 (4) Faqe | 8496



plotësimin të nevojave vendase dhe promovimit të eksporteve (veçanërisht për perimet). Konsolidimi i madhësisë së fermave (rritja e madhësisë së fermave) është e nevojshme për të përmirësuar efikasitetin e sektorit. Prodhimi i frutave dhe perimeve pritet të rritet duke tejkaluar kërkesën në vend. Si rrjedhojë, promovimi i eksportit është i rëndësishëm për të ardhmen e afërt. Rishikimi i mbështetjes me politika fiskale në drejtim të inputeve bujqësore dhe lëndës djegëse për mekanizimin e bujqësisë është gjithashtu i rëndësishëm për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit - disa nga këto aspekte janë trajtuar së fundmi nga politikëbërësit.

1.2.6 Ullinjtë dhe vaji i ullirit

Prodhimi i ullinjeve është rritur ndjeshëm në vitet e fundit. Në vitin 2012 prodhimi ishte rreth 125 000 tonë, duke shënuar një rritje të madhe në krahasim me vitin 2007 kur prodhimi ishte 27 600 tonë. Rritja e prodhimit është nxitur nga subvencionet, të cilat fillimisht u dhanë për ngritjen e një industrie përpunimi moderne, aktualisht numri i prodhuesve të vajit është 164, shumica e të cilëve kanë linja moderne të përpunimit të vajit të ullirit. Pas vitit 2007, ka pasur një rritje të konsiderueshme të plantacioneve, të stimuluar nga skemat kombëtare të mbështetjes. Sipërfaqja e plantacioneve të ullinjeve është rritur me rreth 60% që nga viti 2007.

Prodhimi i ullinjeve është përqendruar në qarkun e Beratit (26,4% e prodhimit total), ndjekur nga Fieri (19,2%), Vlora (17%) dhe Elbasani (13,4%), të cilët të marrë së bashku zënë 76% të prodhimit total në Shqipëri. Në të gjitha këto qarqe ekziston një prodhim i përzier i ullinjeve për tavolinë dhe ullinjeve për vaj ulliri - në rastin e Beratit, është bërë një punë e madhe në drejtim të prodhimit të ullinjeve për tavolinë.

Prodhimi është ende i fragmentuar dhe prodhimtaria është relativisht e ulët, sepse fermerët nuk u bëjnë pemëve shërbimet e duhura agronomike, sidomos në plantacionet e vjetra ekzistuese, ndërkohë që më së shumti aplikojnë praktika të papërshtatshme për vjeljen e ullinjeve dhe kushte të papërshtatshme të ruajtjes së vajit.

Prodhimi vendas po përmirësohet për sa i përket cilësisë dhe sasisë, ndonëse çmimi i ullinjeve të papërpunuar është ende i lartë. Fermerët preferojnë t'i përdorin punishtet e vajit si ofrues shërbimi, duke paguar një tarifë për përpunimin e

ullinjeve të tyre. Shumica e prodhimit vendas shitet direkt te konsumatorët nga fermerët apo punishtet e vajit të ullirit.

Sektori karakterizohet nga disa **potenciale**. Ka pasur një rritje të konsiderueshme të prodhimit edhe për shkak të skemave mbështetëse për plantacionet e ullinjeve/ullishtat – kjo prirje pritet të vazhdojë të rritet. Kultivarët intensivë të mbjellë së fundmi pritet të arrijnë rendimente më të larta. Kapaciteti ekzistues përpunues i fabrikave moderne të vajit mund të mbajë një prodhim shumë më të madh pa pasur nevojë për investime shtesë. Disa punishte të vogla vaji kanë arritur standarde të larta të cilësisë, duke fituar çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Po ashtu përmirësimi është i dukshëm edhe në bazën e njohurive në përpunim dhe në disa shërbime teknike.

Megjithatë, sektori përballet me disa **sfida**. Një prej tyre është fragmentimi i tokës së mbjellë me ullinj. Fermat janë tepër të vogla për të qenë efikente, kanë kosto të larta dhe rendimentet janë të ulëta, gjë që bën që ullinjtë të shiten nga fermerët me çmime të larta. Prodhimi është i ulët kryesisht për shkak të mangësive në praktikën agronomike, veçanërisht në krasitje. Cilësia e ullinjeve nuk është ende ajo që kërkohet për shkak të mangësive në praktikën agronomike, të vjeljes dhe pasvjeljes. Njohuritë dhe ndërgjegjësimi i prodhuesve për kriteret e cilësisë së tregut janë të pamjaftueshme (krahasuar me kriteret tradicionale të cilësisë). Vaji i ullirit i cilësisë së lartë përbën një përqindje shumë të vogël të kërkesës dhe të ofertës.

Në një të ardhme, prodhimi vendas i vajit të ullirit do ta tejkalojë kërkesën në vend dhe prandaj për sasi të tepërta të vajit të ullirit **prioritet** do konsiderohet eksporti. Kostoja e prodhimit të vajit të ullirit shqiptar është e lartë krahasuar me vendet fqinje (prodhuesit më të mëdhenj në botë), prandaj një strategji sektoriale e ardhshme duhet të përqendrohet nga njëra anë në modernizimin e përgjithshëm të sektorit, dhe në anën tjetër në zhvillimin e një segmenti tregu, si p.sh. vaj ulliri organik ekstra i virgjër. Ndërsa në rastin e ullinjeve për tavolinë, eksporti ka shënuar progres dhe pritet të rritet me rritjen e prodhimit. Kultivimi i ullinjeve mund të kontribuojë në reduktimin/parandalimin e erozionit të tokës në zonat kodrinore.

Sektori ka nevojë për **mbështetje** për të përmirësuar procesin e vjeljes dhe të pasvjeljes në



nivel ferme (për të dy llojet e ullinjve) dhe në lidhje me cilësinë dhe prodhimin organik. Përveç kësaj, mbështetje nevojitet për marketingun, ambalazhimin, etiketimin, sidomos për kanalet e eksportit.

1.2.7 Vreshtat dhe vera

Prodhimi i rrushit (për të dyja qëllimet - prodhim vere e rakie dhe rrush për tavolinë) është rritur ndjeshëm (35%) në krahasim me vitin 2007. Prodhimi i verës pothuajse është dyfishuar që nga viti 2007, ndërsa edhe importi është gati dyfishuar për arsye të rritjes së konsumit.

Prodhimi i rrushit është përqendruar në qarkun e Fierit (20,3% e prodhimit total), Beratit (12,6%), Elbasanit (11,7%) dhe Vlorës (11,4%), të cilët të marrë së bashku zënë rreth 56% të prodhimit total në Shqipëri. Në të ardhmen vreshtat e reja do të përbëhen nga blloqe plantacionesh.

Shumica e kantineve të verës janë shumë të vogla krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe vetëm pak prej tyre kanë kapacitetin për të operuar në tregjet ndërkombëtare. Një pjesë e madhe e prodhimit të verës vjen nga ekonomia informale dhe tregtohet ilegalisht në tregje ose konsumohet nga vetë prodhuesit. Segmenti i verërave formale cilësore dhe shumë cilësore nuk është ende i zhvilluar mjaftueshëm, duke marrë parasysh përmasat e zinxhirit të vlerës. Kantinat lokale cilësore nuk janë ende konkurruese me konkurrentët kryesorë në rajon dhe me prodhuesit kryesorë të BE-së për sa i përket raportit çmim/cilësi. Prandaj, importi i verës cilësore është i lartë dhe është rritur gjatë dekadës së fundit, duke qenë se kërkesa për verë të cilësisë së lartë po rritet me rritjen e standardeve të jetesës dhe me ndryshimin e stilit të jetesës. Në të njëjtën kohë, sektori formal i verës përballet me konkurrencën e ashpër nga sektori informal dhe ka sfida të konsiderueshme për sa i përket rritjes së cilësisë për të justifikuar çmimet e larta.

Sektori i vreshtave dhe verës karakterizohet nga disa **potenciale**. Shqipëria ka kushte klimatike të favorshme, të cilat mundësojnë një prodhim të hershëm, gjë që hap një dritare mundësish për eksportin e rrushit për tavolinë. Prodhimi dhe cilësia janë në rritje si për rrushin për tavolinë, ashtu edhe për rrushin për përpunim. Ka një rritje të investimeve në kantinat cilësore të verës dhe fokus në shfrytëzimin e potencialeve në varietetet lokale të rrushit të tilla si Kallmet dhe Shesh i Zi (verëra të kuqe) dhe Shesh i Bardhë (verë e

bardhë). Për sa i përket kërkesës, kërkesa për verë është në rritje për shkak të ndryshimeve në stilin e jetesës së konsumatorëve.

Disa nga **sfidat** e sektorit përfshijnë përqindjen e madhe të prodhimit informal dhe kostot e larta të prodhimit. Konsolidimi i vazhdueshëm i tregtimit dhe shpërndarjes së pijeve dhe ushqimit favorizon prodhuesit e mëdhenj dhe verën e importit, ndërkohë që në segmentin e verës cilësore në shishe mbizotëron vera e importit dhe është duke u rritur konkurrenca nga prodhuesit në rajon. Një nga problemet kryesore për zhvillimin e zinxhirit të vlerës është mungesa e lidhjes/koordinimit midis kultivuesve dhe përpunuesve, kostoja e lartë e prodhimit dhe mungesa e standardizimit. Shumë kantina hasin vështirësi në koordinimin me fermerët (kultivarë të papërshtatshëm, ujti përpara vjeljes etj.). Për rrjedhojë, mjaft kantina krijojnë vreshtat e tyre për të ulur kostot e transaksionit të lidhura me koordinimin me fermerët.

Për sa i përket prodhimit të rrushit për tavolinë, **prioritet** do të ketë nxitja e eksportit, ndërsa për verën prioritet do të jetë përmirësimi i prodhimit dhe shpërndarjes së verërave me cilësi të lartë dhe zbatimi i legjislacionit që ndalon tregtimin e paligjshëm të produkteve. Ka nevojë për investime për të përmirësuar standardet në nivel ferme (përfshi pas-vjeljen, magazinimin, kategorizimin etj.). **Mbështetja** duhet orientuar kryesisht drejt plantacioneve në blloqe, ku investimet bazohen në vlerësime të mirëstudiuara. Për sa i përket kantineve të verës, ka nevojë për investime që synojnë përmirësimin e kantineve ekzistuese të verës, veçanërisht në pajisje të tilla si mjedise ruajtjeje dhe vjetrimi, fermentues, tankera dhe linja paketimi e vendosjeje në shishe. Investimet nga kantinat e verës që integrojnë edhe prodhimin e rrushit, të cilat kanë qenë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, mund të jenë gjithashtu të realizueshme - ky do të jetë trendi që duhet mbështetur në të ardhmen.

1.2.8 Bimët e arave, mielli dhe produktet e brumit

Vlera e bimëve të arave përbën 30% të vlerës së prodhimit bujqësor. Foragjeret zënë 51% të sipërfaqes së mbjellë me bimë arash, ndërkohë që drithërat përbëjnë 35% të sipërfaqes. Rreth 89% e sipërfaqes me drithëra është mbjellë me grurë dhe misër në vitin 2012. Bishtajoret përbëjnë 4%, ndërkohë që patatet përbëjnë vetëm 2% të



sipërfaqes së mbjellë. Duhani, luledielli dhe soja përbëjnë një pjesë të parëndësishme si për nga sipërfaqja e mbjellë ashtu edhe nga nivelet e prodhimit.

Vlera e prodhimit të bimëve të arave ka shënuar një rritje prej 39% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2007. Gjatë të njëjtës periudhë (2007-2012), prodhimi i grurit është rritur me 20% dhe prodhimi i misrit është rritur me 67%. Prodhimi i patateve është rritur më shumë se 50%, ndërkohë që prodhimi i foragjereve është rritur me 20%. Rritja e rendimentit ka qenë kontribuuesi kryesor në rritjen e prodhimit.

Prodhimi i drithërave nuk e përmbush kërkesën e vendit; ka një deficit tregtar strukturor që ka gjasa të vazhdojë. Pavarësisht rritjes midis viteve 2007 dhe 2012, prodhimi i drithërave, veçanërisht prodhimi i grurit, ka rënë në mënyrë drastike në më pak se gjysmën e prodhimit të vitit 1991, duke treguar një transferim të faktorëve të prodhimit nga produktet që kërkojnë më pak punë te produktet që kërkojnë më shumë punë për njësi të sipërfaqes (labor intensive), pra frutat dhe perimet. Në të njëjtën kohë, industria e përpunimit po rritet dhe tani një pjesë e madhe e miellit që nevojitet për tregun e brendshëm prodhohet në vend nga drithëra të importuara. Tregu dominohet nga 4-5 fabrika të mëdha mielli, të cilat kontrollojnë rreth 2/3 e tregut. Dy prej këtyre fabrikave të miellit janë të integruara me prodhimin e makaronave. Përgjatë zinxhirit të vlerës, kompanitë e përpunimit që përdorin miell janë kryesisht furra buke dhe dyqane ëmbëlsirash. Ekzistojnë vetëm pak prodhues të mëdhenj të produkteve të drithërave, më së shumti biskota, kruasanë dhe ëmbëlsira të tjera.

Prodhimi i grurit përqendrohet kryesisht në qarkun e Fierit (27,2%), Korçës (17,4%) dhe Elbasanit (17%), të cilët së bashku zënë 62% e prodhimit total në Shqipëri. Ndërsa prodhimi i misrit është i përqendruar në qarkun e Fierit (18,1%), Elbasanit (12,7%), Shkodrës (11,8%) dhe Vlorës (9,4%), të cilët së bashku përbëjnë 52% të prodhimit total.

Prodhimi i ushqimit të kafshëve (foragjeret, drithërat etj.) përfaqësojnë një **potencial**, duke pasur parasysh rritjen e sektorit blegtoral. Në nivel përpunimi, fabrikat e miellit janë të pozicionuara mirë dhe të pajisura me teknologjinë e duhur për përpunimin e miellit.

Ka potencial edhe për diversifikimin e prodhimit të bukës, makaronave dhe ëmbëlsirave.

Ky sektor ka disa **sfida**. Prodhimi i drithërave përballet me kostot e larta të prodhimit, veçanërisht kostot e punimeve me mjete mekanike. Prodhimi i drithit në Shqipëri mbetet i pamjaftueshëm krahasuar me kërkesën nga industria e përpunimit, duke rritur brishtësinë e industrisë (veçanërisht për operatorët e vegjël dhe të mesëm) nga luhatjet e çmimeve të grurit në tregun rajonal.

Në nivel përpunimi, industria e prodhimit të miellit është e qëndrueshme dhe ka teknologjinë e duhur për përpunimin e miellit. Ka shumë mundësi për diversifikimin e produktit në prodhimin e bukës dhe të makaronave, si dhe në prodhimin e ëmbëlsirave.

Në të ardhmen e afërt **prioritet** do të ketë prodhimi i bimëve të arave për ushqim për kafshët, gjë që duket e realizueshme dhe do të ofronte mbështetje edhe për rritjen e sektorit të blegtorisë, i cili has vështirësi për shkak të kostove të larta të ushqimit. Ka nevojë për investime në makineri bujqësore (mbjellje, korrije), paskorrije dhe magazinim të drithërave për të përmirësuar standardet dhe për të rritur efikasitetin.

1.2.9 Peshkimi, produktet ujore, produktet e peshkimit dhe akuakultura

Shqipëria zë një vend të rëndësishëm në rajon për prodhimin dhe tregtimin e peshkut, prodhimeve të detit dhe produkteve të peshkimit. Shqipëria është e pasur në ujëra, përfshirë ujërat bregdetare dhe tokësore, të cilat janë të përshtatshme për peshkim dhe akuakulturë. Ka rezerva të pasura peshku - veçanërisht nën 100 metra - e cilat shërbejnë si bazë për modernizimin e flotës së peshkimit. Struktura bregdetare është e përshtatshme për akuakulturë, veçanërisht në detin Jon. Lagunat, ndonëse përmirësimi i menaxhimit të integruar është i nevojshëm, mundësojnë vlera të shtuara ekologjike dhe ekonomike. Në anën tjetër, liqenet natyrore dhe artificiale, rezervuarët e ujitjes, dhe ujërat e lumenjve përfaqësojnë një potencial për akuakulturën tokësore.

Aktiviteti i peshkimit ka qenë i qëndrueshëm vitet e fundit - në vitin 2011 vlerësohet se janë kapur 4704 tonë peshk, duke shënuar një rritje të vogël me 2% krahasuar me vitin 2007. Nga viti 2007 deri në vitin 2011 peshkimi detar është rritur me 16% (2287 tonë në vitin 2011) dhe peshkimi në breg është rritur me 5% (506 tonë



në vitin 2012). Ndërsa peshkimi në lagunat bregdetare dhe pellgjet ujore ka rënë me 22% (229 tonë në vitin 2011) dhe 16% (1793 tonë në vitin 2011), përkatësisht për të njëjtën periudhë. Prodhimi i akuakulturës ka rënë me 9% në 1304 tonë, ndërsa prodhimi i midhjes është rritur me 25%, duke arritur në 1300 tonë në vitin 2011.

Peshkimi i jashtëligjshëm mbetet ende problem dhe stoqet e peshkimit reduktohen në mënyrë serioze. Duke marrë në konsideratë nevojat e vendit (ndalohet eksporti i molusqeve të gjalla bivalvore), kultivimi i produkteve të detit është i zhvilluar mirë, kryesisht në formën e kultivimit të midhjeve. Kultivimi i peshkut është rritur gjatë viteve të fundit dhe tashmë ka zëvendësuar thuajse plotësisht importin e peshkut të kultivuar.

Në kontekstin e ndryshimeve të fundit institucionale, sektori i peshkimit është transferuar në MBZHRAU – ky ndryshim mundëson koordinim më të mirë me departamentet përkatëse dhe dokumentet e politikave brenda MBZHRAU-së. Për shkak të kërkesave specifike të këtij sektori, në të ardhmen e afërt nevojitet një studim i detajuar sektorial dhe një strategji zhvillimi.

Ky sektor ka disa **potenciale**. Shqipëria është e pasur në burime natyrore të shumëllojshme (uji i detit, lumenjtë, liqenet), të cilat përbëjnë një mundësi për zhvillimin e sektorit. Është shtuar kultivimi i peshkut, duke zvogëluar nevojën për peshk deti dhe duke plotësuar kërkesën e brendshme të konsumatorëve të mesëm dhe gjatë sezonit turistik. Konsumi është dyfishuar si rezultat i rritjes së të ardhurave. Industria e përpunimit ka bërë investime të mëdha dhe zotëron teknologji mjaft të qëndrueshme. Konsolidimi i industrisë së përpunimit mund të luajë një rol të rëndësishëm në terma të garantimit të një tregu të qëndrueshëm për fermat e vogla të peshkimit pelagjik dhe sigurimit të investimeve për rindërtimin e flotës së peshkimit.

Sektori përballet me sfida të ndryshme. Ka dobësi në politikëbërje dhe zbatimin e saj. Ekzistojnë kapacitete të dobëta në mirëmbajtjen rutinë dhe jorutinë të mjeteve lundruese. Infrastruktura e portit në limanet ekzistuese është e dobët. Mungojnë tregjet e organizuara të shitjes me shumicë. Ka vështirësi në lidhje me standardet e higjienës, veçanërisht për midhjet dhe molusqet bivalvore, gjë që ka penguar edhe eksportin në këtë sektor. Çmimi i karburantit të përdorur për anijet e peshkimit është i lartë.

Prioritet i duhet dhënë si investimit në sektorin e peshkimit edhe forcimit institucional. Nevojat për investim në këtë sektor përfshijnë përmirësimin i infrastrukturës së mirëmbajtjes rutinë dhe jorutinë të mjeteve të lundrimit, zëvendësimin dhe rinovimin/përmirësimin e barkave të peshkimit, krijimin e tregjeve të shumicës me standarde higjienë dhe cilësie, mbështetjen e investimeve për fermat e peshkimit dhe kompanitë jolider të përpunimit (d.m.th. të mesme për tregun shqiptar). Mbështetja duhet dhënë në drejtim të përmbushjes së standardeve të sigurisë (p.sh. në rastin e midhjeve) me qëllim që të jenë në gjendje të eksportojnë. Për sa i përket ndërtimit të kapaciteteve institucionale, është i nevojshëm ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në funksion të zbatimit të reformave të politikave, përfshirë një plan kombëtar veprimi dhe monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrjeje të fortë, forcimin e kapaciteteve të inspektimit dhe zhvillimin e një sistemi të besueshëm dhe sistematik të mbledhjes së të dhënave.

1.3 Ekonomia rurale, cilësia e jetës dhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike

1.3.1 Ekonomia rurale dhe cilësia e jetës¹⁸

Zonat rurale në Shqipëri janë shumë të varura nga bujqësia. Bujqësia krijon shumicën e vendeve të punës në zonat rurale dhe është burimi kryesor i të ardhurave për familjet rurale. Rreth 55% e vendeve të punës në zonat kryesisht dhe mesatarisht rurale krijohen në bujqësi, krahasuar me 22% në zonat kryesisht urbane. Sektorë të tjerë të rëndësishëm të ekonomisë rurale janë industria dhe ndërtimi, të cilët kontribuojnë secili me 7-8% në punësim. Nga shërbimet, sektori i shitjes me shumicë dhe pakicë është më i rëndësishmi. Rreth 10% e vendeve të punës janë krijuar në administratën publike, arsim dhe shëndetësi.

Vetëm 15% e të gjitha grave sipërmarrëse ndodhen në zonat rurale. Aktivitetet ekonomike kryesore ku janë përqendruar gratë sipërmarrëse janë agrobizneset, tekstilet, shitjet me shumicë dhe pakicë, zëjtaria dhe shërbimet.

Turizmi ka filluar të ketë një kontribut të dukshëm në të ardhura dhe punësim në disa prej rajoneve NUTS 3 (që përfshihen në kategorinë e zonave kryesisht dhe mesatarisht rurale).

¹⁸ Burimi : Programi IPARD 2011-2013



Mbështetur në disa studime, përlogaritjet tregojnë se rreth 60% e rajoneve NUTS 3 kanë asete dhe burime natyrore të mjaftueshme për të zhvilluar turizmin rural dhe zbavitës. Disa prej tyre tashmë e kanë përfshirë zhvillimin e turizmit si një prioritet strategjik në planet e tyre të zhvillimit. Sidoqoftë, pavarësisht potencialit të disponueshëm për zhvillim, turizmi rural mbetet pak i zhvilluar dhe aktualisht gjeneron një pjesë shumë të vogël të të ardhurave nga turizmi në Shqipëri. Ai ende është i përqendruar në një numër të kufizuar rajonesh, kryesisht në (i) pjesën jugore të vendit (Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastrë); (ii) Alpet veriore (Vermosh, Theth dhe Valbonë në rajonet e Shkodrës dhe të Dibrës) dhe (iii) rajonin e Korçës (Dardhë, Voskopojë dhe Vithkuq).

Ndër pengesat më të mëdha për zhvillimin e turizmit në zonat rurale në Shqipëri janë: infrastruktura pak e zhvilluar (e cila vështirëson qasjen në bukuritë e vendit, parqet kombëtare dhe vendet turistike), zhvillimi i pamjaftueshëm i ambienteve dhe atraksioneve turistike, informacionet dhe shërbimet turistike të kufizuara si edhe numri i kufizuar i burimeve njerëzore të trajnuara.

Dërgesat e emigrantëve janë të rëndësishme për standardet e jetesës në Shqipëri, sidomos për familjet në zonat rurale. Zonat rurale thithin pothuajse 64% të volumit vjetor të dërgesave. Në zonat rurale dërgesat zënë një pjesë të madhe të të ardhurave mujore, deri në 40% në vitet e kaluara, megjithatë, tashmë vlera e dërgesave ka rënë me pothuajse 1/3 në të gjithë vendin. Dërgesat përdoren për të mbështetur nevojat e familjeve dhe kryesisht konsiderohen si një rritje e të ardhurave familjare. Rreth 20% e dërgesave përdoren për qëllime investimi dhe kursimi. Përdorimi i dërgesave për të financuar aktivitetet e biznesit dhe për të investuar në pasuritë e paluajtshme ka një përqindje relativisht të ulët, mesatarisht 1,7-5%. Familjet në zonat rurale duken të jenë më të interesuara në investime krahasuar me zonat urbane dhe bujqësia dhe bledet e pasurive të paluajtshme janë sektorët më të parapëlqyer për të investuar.

Shpërndarja e popullsisë shqiptare nëpër kuantilet e pasurisë tregon se rreth tetë në dhjetë persona që jetojnë në familjet urbane janë në dy kuantilet më të larta të pasurisë, ndërsa shtatë në

dhjetë persona që jetojnë në familjet rurale janë në dy kuantilet më të ulëta të pasurisë. Tiranë urbane ka proporcionin më të madh të popullsisë në kuantilin më të lartë të pasurisë (64%), ndërsa rajonet malore kanë proporcionin më të madh të popullsisë në kuantilin më të ulët të pasurisë (46%). Si rezultat, popullsia rurale ka një status pasurie inferior krahasuar me popullsinë urbane.

Konsumi për frymë në zonat rurale është rreth katër të pestat e niveleve të konsumit në zonat urbane. Ka dallime të mëdha në konsumin për frymë ndërmjet rajoneve. Rajonet malore në veri dhe verilindje janë më të varfrat. Banori mesatar në zonat malore në veri dhe verilindje ka 12% më pak konsum real për frymë se sa banori mesatar në Tiranë. Në krahun tjetër, banori mesatar në zonat bregdetare rurale ka konsum më të lartë për frymë se sa banori mesatar në zonat rurale malore dhe qendrore, përkatësisht me 17% dhe 34%.

Infrastruktura është një nga faktorët më të rëndësishëm për rritjen rurale. Ajo ndikon në kushtet e prodhimit dhe të jetesës, qasjen në treg, mundësitë e gjenerimit të të ardhurave jashtë fermës dhe tërheqjen e investimeve. Në përgjithësi, mangësitë infrastrukturore janë disi të larta në zonat rurale. Zonat rurale kanë infrastrukturë dhe shërbime publike pak të zhvilluara dhe me nivel të ulët mirëmbajtjeje (transporti, energjia elektrike dhe uji i rrjedhshëm, arsimiti, kujdesi shëndetësor etj.), si në lidhje me cilësinë, ashtu edhe me mbulimin. Banorët e zonave të thella rurale shpesh përmendin mungesën e infrastrukturës kryesore si faktorin kryesor të pafavorshëm dhe si një përcaktues kryesor në standardin e tyre të ulët të jetesës. Në dekadën e fundit, shërbimet e telefonisë celulare dhe fikse janë përmirësuar dukshëm në Shqipëri si në zonat urbane, dhe në ato rurale. Gjithashtu shërbimi i energjisë elektrike është përmirësuar që prej fundit të vitit 2000. Ndërprerjet e energjisë elektrike (të cilat ishin problem jo vetëm për jetën e përditshme të familjeve, por gjithashtu edhe për aktivitetet bujqësore dhe agropërpunuese) janë më të rralla në ditët e sotme në zonat rurale.

Shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm është rreth 2/3 në Tiranë, mbi 1/2 në zonat e tjera urbane, por rreth 1/4 në zonat rurale. Infrastruktura e shkollave, sidomos në zonat rurale dhe të thella, është e pamjaftueshme dhe e një cilësie të ulët. Gjithsesi, ka pasur përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës së arsimit -



gjatë viteve të fundit janë ndërtuar ose ristrukturuar rreth 1300 shkolla në Shqipëri.

Shërbimet shëndetësore në zonat rurale kanë mangësi dhe nevojë për përmirësim, sidomos në zonat malore/të disavantazuara. Për më tepër, niveli i mbulimit me sigurime shëndetësore mbetet ende i ulët, më pak se 1/2 e popullsisë, ku shifrat e sigurimeve janë edhe më të ulëta në zonat rurale dhe sidomos në familjet me të ardhura më të ulëta. Së fundi, duhet theksuar që Qeveria e Shqipërisë, nëpërmjet dy ministrive të saj (Ministria e Shëndetësisë dhe MBZHRAU) ka zbatuar Programin e Përbashkët të OKB-së (UNJP) për reduktimin e kequshqyerjes së fëmijëve në Shqipëri, prej nga u përgatit edhe Plani i Veprimit për Ushqimin dhe të Ushqyerit (FNAP) 2013 – 2020. Tre agjenci të OKB-së, FAO, OBSH dhe UNICEF ofruan asistencë teknike.

1.3.2 Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike

Sipas studimeve të mëparshme të përgatitura nga MBZHRAU-ja (më parë MBUMK)¹⁹, ekziston potencial për fushat e mëposhtme të diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale të Shqipërisë:

- Aktivitetet bujqësore jotipike në fermë, si për shembull bletaria dhe kultivimi i BAM-ve kanë traditë të gjatë dhe një rritje të pabesueshme gjatë viteve të fundit.

- Përpunimi/marketingu në shkallë të vogël i produkteve bujqësore të tilla si qumësht deleje dhe dhie, frutat/kërpudhat/bimët aromatike dhe mjekësore, duke përfshirë mbledhjen e bimëve të egra dhe produkteve të tjera tradicionale, me fokus përmirësimin e përpunimit të ushqimit në lidhje me standardet e higjienës dhe sipërmarrjes profesionale.

- Zhvillimi i turizmit rural dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me turizmin, si për shembull turizmi kulturor, turizmi natyror dhe malor, turizmi i verës etj., duke rikonstruktuar ndërtesat dhe shtëpitë tradicionale për qëllime biznesi, si akomodimi, ushqimi, koha e lirë, tregtia etj.

- Aktivitetet të tjera fitimprurëse brenda dhe jashtë fermës bazuar në ndërmarrjet mikro dhe të vogla në zonat rurale të tilla si i) aktivitete të cilat ofrojnë shërbimin e makinerive dhe pajisjeve që përndryshe do të ishin tepër të shtrenjta për t'u përballuar nga fermerët e vegjël, ii) krijimi i teknologjisë së energjisë së rinovueshme për prodhimin e energjisë për treg, iii) mbështetje për prodhimin dhe tregtimin e produkteve artizanale me fokus të veçantë ofrimin e punësimit dhe të të ardhurave për gratë në zonat rurale, iv) aktivitete që investojnë në ide novatore biznesi, e cila krijon vende të reja pune në zonat rurale (kujdesi shëndetësor, katering dhe shërbime të tjera familjare për të moshuarit dhe fëmijët).

BAM-të përfaqësojnë një sektor të rëndësishëm të diversifikimit rural, i cili kontribuon në zbutjen e varfërisë, sepse ai gjeneron të ardhura për mijëra familje në zonat rurale (malore). Shqipëria tradicionalisht është një eksportuese e fortë, dhe për disa produkte, si p.sh. sherbela, trumza dhe rigoni, është një aktore e nivelit botëror (p.sh. gjysma e sherbelës së importuar nga SHBA furnizohet nga Shqipëria). Baza e prodhimit përbëhet më së shumti nga BAM-të e egra që gjenden në të gjithë vendin, cilësia e të cilave është shumë e njohur dhe përfaqëson asetin më të vlefshëm të sektorit. Shumica e BAM-ve janë të destinuara për tregje eksporti. Eksporti është rritur vazhdimisht duke arritur në afro 20 milionë Euro në vitin 2013.

Në vitet e fundit, shpopullimi gradual i zonave rurale dhe malore po ushtron ndikim negativ në këtë sektor: ekzistojnë disa zona ku BAM-të e egra nuk mbledhen më, ndërsa zonat ku mbledhen ende janë të mbishfrytëzuara, për shkak se eksportuesit bëjnë çdo përpjekje për t'i mbajtur të larta nivelet e prodhimit të BAM-ve të egra siç kanë qenë në të kaluarën.

Për rrjedhojë, për të mbajtur dhe për të zgjeruar biznesin e tyre, eksportuesit kanë nxitur kultivimin e BAM-ve. Për më tepër, ata kanë filluar të prodhojnë vaj esencial. Në këto dy fusha janë bërë investime.

Ky është një nga sektorët agrorshqimorë më premtues për disa arsye. BAM-të shqiptare kanë një prani të konsoliduar në tregun e huaj dhe BAM-të shqiptare njihen për cilësinë e tyre të lartë në tregjet botërore. Ekziston një grup i

¹⁹ Studimet, përgatitur me ndihmën e donatorëve të ndryshëm, duke përfshirë Wehinger, T., Zhllima, E., 2013, Analiza e sektorit për diversifikimin e ekonomisë rurale në Shqipëri, dhe "Potenciali për diversifikimin e sektorëve ruralë në Shqipëri dhe Mal të Zi", Wehinger, T. dhe Schäfer, B., 2010, NACCON GbR, Gjermani.
Faqe | 8502



fuqishëm shitësish me shumicë/eksportuesish me eksperiencë, të cilët i kanë zhvilluar kapacitetet e tyre me kalimin e kohës. Nga ana tjetër, kërkesa në rritje për BAM të egra dhe të kultivuara dhe për vajra esenciale në tregun botëror është një tjetër faktor pozitiv për rritjen e sektorit. Sektori i BAM-ve pritet të zhvillohet më tej, kryesisht për shkak të kultivimit në rritje të BAM-ve. Kjo favorizohet nga fitimet e larta për biznesin, toka e përshtatshme, krahu i punës në zonat e prekura dhe kanalet e eksportit tashmë të krijuara. Së fundmi ky sektor ka përfituar nga skemat kombëtare mbështetëse.

Megjithatë, sektori i BAM-ve shqiptarë përballet me disa **sfida**. Praktikrat e këqija të vjeljes dhe të pasvjeljes shpesh e dëmtojnë cilësinë e produktit; kapacitetet e pamjaftueshme në ambientet e tharjes përbëjnë një pengesë të madhe, e cila çon në përkeqësim të cilësisë së produktit. Shpesh teknologjia e vjetër e përpunimit të BAM-ve shkakton cilësi të ulët prodhimi dhe probleme sigurie ushqimore (për BAM-të që përdoren për ushqim).

Prioriteti në sektorin e BAM-ve do të jetë nxitja e eksportit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit. Në një të ardhme të afërt, megjithëse kërkesa kryesore për investim mund të vijë nga eksportuesit që kanë dëshirë të përmirësojnë mjedisin dhe teknologjinë e tyre të përpunimit, **mbështetje** duhet të ofrohet edhe për mjediset e pasvjeljes në nivel ferme, veçanërisht për mjediset e tharjes në stade të ndryshme të zinxhirit, përmirësimin e teknologjinë e përpunimit të BAM-ve të thara, përmirësimin e industrinë e nxjerrjes së vajrave esenciale dhe futjen e teknologjisë së sterilizimit të BAM-ve.

Zhvillimi rural mbështetet nëpërmjet investimeve në diversifikimin e prodhimit në mënyra të ndryshme. Mbështetja me investime për prodhimin e mjaltit është një shembull i mirë, ndërkohë që së fundmi edhe BAM-të kanë qenë objekt i skemave të mbështetjes.

Në strategji do të përfshihen edhe sektorë të tjerë ku mbështetja do të realizohet në formën e ndërhyrjeve të përgjithshme dhe horizontale, për shembull mbështetja për sipërmarrjet dhe nisjen e biznesit, planifikimin e biznesit, menaxhimin e projekteve, marketingun dhe informacionin.

1.4 Mjedisi, toka, pyjet, menaxhimi i ujërave dhe infrastruktura rrugore

Zhvillimi i bujqësisë dhe i zonave rurale në Shqipëri do të duhet të bëhet duke i përdorur burimet në mënyrën më eficiente dhe të qëndrueshme të mundshme. Në këtë seksion të strategjisë, zonat rurale përshkruhen nga perspektiva e natyrës dhe mjedisit²⁰.

1.4.1 Menaxhimi i ujërave dhe infrastruktura rrugore

Ujitja, cilësia e ujërave dhe kanalizimet

Burimet ujore

Shqipëria është e pasur me burime ujore si liqene, lumenj, burime, laguna, ku sasia e ujit të disponueshëm është e madhe. Territori shqiptar mbulon rreth 65% të sipërfaqes totale të baseneve ujore prej 43 900 km². Ka më shumë se 152 përrrenj dhe lumenj të vegjël nga tetë lumenj të mëdhenj që rrjedhin nga juglindja në veriperëndim drejt bregdetit të Adriatikut. Lumenjtë shqiptarë karakterizohen nga prurje të mëdha. Prurjet totale mesatare vjetore janë 1308 m³/s, që korrespondon me një vëllim vjetor uji prej 42,25x10⁹ m³, 30% e të cilit i përket ujërave nëntokësore. Kjo përbën më shumë se 13 000 m³ për frymë në vit. Lumenjtë, të cilët ushqehen kryesisht nga reshjet (69%) kanë një regjim tipik mesdhetar, me luhajtje sezonale të prurjeve dhe prurje të mëdha gjatë periudhës tetor-maj. Në përgjithësi, rreth 80% e gjatësisë së lumenjve plotëson standardet kombëtare për cilësinë e ujit.

Ujitja dhe kullimi

Midis sektorëve kryesorë ekonomikë, bujqësia është pa dyshim përdoruesi më i madh i ujit, pas sektorit energjetik, duke përdorur kryesisht ujërat sipërfaqësore.

Ujitja dhe kullimi janë faktorë të rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor në vend. Megjithëse Shqipëria është e pasur me burime ujore dhe reshje mesatare vjetore, rreth 1485 mm, rreth 20% e totalit të reshjeve bie në periudhën e verës. Ky fakt e bën të domosdoshme nevojën për ujitje gjatë periudhës së verës dhe për kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet gjatë periudhës së dimrit.

²⁰ Seksioni bazohet në informacionin e marrë nga ministritë përkatëse të linjës, sektorët e MBZHRAU-së dhe nga programi IPARD i MBZHRAU-së (MBUMK) 2011-2013.



Infrastruktura ekzistuese e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet është e ndërtuar për të mundësuar ujitjen e rreth 360 000 ha, duke garantuar kullimin e 280 000 ha dhe për të ulur rrezikun nga përmbytjet lumore e detare të një sipërfaqeje detare potencialisht të rrezikuar prej 130 000 ha. Për ujitje përdoren 560 milionë m³ ujë nga 626 rezervuarë për ujitje dhe 450 milionë m³ ujë nga lumenjtë, ndërsa ujërat nëntokësore shfrytëzohen shumë pak për ujitje.

Pas viteve '90-të, një pjesë e konsiderueshme e sistemeve të ujitjes dhe të kullimit u shkatërruan për shkak të mungesës së investimeve, alokimeve të pamjaftueshme të buxhetit për operimin dhe mirëmbajtjen, si dhe të një kuadri institucional të papërshtatshëm për menaxhimin e ujitjes.

Nëpërmjet tri projekteve donatore (Banka Botërore nga 1994 deri në 2009) dhe burimeve nga buxheti i shtetit është bërë i mundur rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes për më shumë se 150 000 ha dhe të kullimit për rreth 180 000 ha tokë bujqësore, si dhe janë rehabilituar rreth 60 diga të rezervuarëve dhe dhjetëra kilometra argjinatura mbrojtëse lumore dhe detare.

Gjithashtu po në këtë periudhë, sipërfaqja e ujitjes e transferuar nga shteti te shoqatat e përdoruesve të ujit (SHPU) ka arritur në rreth 280 000 ha, që përbën teorikisht rreth 80% të sipërfaqes me mundësi ujitjeje në vend (360 000 ha).

Megjithatë, në praktikë, pjesëmarrja e fermerëve në menaxhimin e ujitjes nëpërmjet SHPU-ve të krijuara ishte larg rezultateve të pritshme, pasi kapaciteti i tyre në ofrimin e shërbimit të ujitjes ishte shumë i kufizuar dhe në shumë raste fermerët nuk arritën të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

Synimi i MBUMK-së ka qenë mbështetja e zhvillimit të bujqësisë nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja, rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve ujore për ujitje dhe zvogëlimi i rrezikut të prishjes së digave dhe përmbytjeve lumore e detare.

Kushtet aktuale dhe përvoja e deritanishme në fushën e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes veçanërisht të sistemeve të ujitjes diktojnë si domosdoshmëri decentralizimin e kompetencave dhe kalimin e një pjese të përgjegjësive të menaxhimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit te komunat dhe bashkitë. Këto procese kanë nisur dhe aktualisht janë transferuar në pronësi të komunave

dhe bashkive rreth 315 rezervuarë dhe 640 stacione pompimi që mbulojnë me ujitje rreth 100 000 ha tokë bujqësore.

Financimet në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja janë rritur gjatë viteve të fundit, duke arritur një mesatare prej 2,17 miliardë lekë (16 milionë euro) në vit. Së pari, kjo ka bërë që fermerët të kenë mundësi ujitjeje të rreth 200 000 ha nga sipërfaqja 360 000 ha tokë bujqësore me mundësi ujitjeje (që është 51% e totalit të tokës bujqësore), dhe së dyti, fermerëve u sigurohet kullimi në një sipërfaqe rreth 230 000 ha nga sipërfaqja 280 000 ha me mundësi kullimi. Së fundi, është dhënë mbështetje edhe për investimet në sistemin e ujitjes me pika në më shumë se 850 ha dhe për investimet në furnizimin me ujë nëpërmjet puseve të reja në 170 ferma.

Sistemi i ujitjes dhe kullimit karakterizohet nga një sërë sfidash dhe kufizimesh. Investimet në të kaluarën kanë qenë të pamjaftueshme, duke marrë parasysh nevojat për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e kufizuar e fermerëve në menaxhimin e ujërave ka qenë një problem madhor.

Në të ardhmen, qasja decentralizuese drejt ujitjes dhe kullimit duhet të përbëjë një prioritet dhe mundësi për zhvillimin e saj. Për më tepër, rritja e investimeve në sektor/sistem është e domosdoshme për të arritur përmirësime të mëdha.

Cilësia e ujit

Për sa i përket cilësisë së ujit, Shqipëria karakterizohet nga ekzistenca e rezervave të mjaftueshme me cilësi të mirë në njërin anë dhe, në anën tjetër, nga niveli i lartë i humbjeve të ujit, rreziku i ndotjes dhe përkeqësimit të cilësisë. Uji nëntokësor që përbën burimin kryesor të ujit të pijshëm, përkeqësohet për shkak të sistemit të vjetruar të furnizimit dhe bashkimit të tij me kanalizimet e ujërave të zeza. Burimi kryesor i ndotjes së ujërave sipërfaqësore lidhet me shkarkimin e ujërave të zeza të patrajtuara në lumenj dhe dete dhe hedhjen pa kriter të mbetjeve të ngurta urbane në brigjet e lumenjve. Mbetjet e ngurta urbane hidhen në zona të pakontrolluara dhe të pakufizuara, të cilat shpesh ndodhen pranë lumenjve, liqeneve ose bregut të detit. Ujërat e ndotura që kullojnë nga vendet e hedhjes janë një burim kryesor i ndotjes. Mbetjet



e ngurta të rrezikshme nga minierat dhe fabrikat industriale më parë hidheshin në landfillë të hapura pa stabilizim, shpesh në afërsi të lumenjve. Ujërat e zeza urbane dhe industriale vazhdojnë të shkarkohen të patrajtuara përmes kanaleve direkt në lumenj, liqene ose dete. Në zonat rurale, mbetjet nuk grumbullohen fare dhe hidhen të pakontrolluara.

Problemet kryesore në cilësinë e ujit lidhen me nivelin e ndotjes në vendbanime dhe ferma, të cilat nuk përmbushin kriteret e mbrojtjes së mjedisit, mungesën e vendeve të sigurta për magazinimin e plehut organik në ferma, mungesën e sistemeve të kanalizimeve në shumë vendbanime, etj. Zhvillimi i pamjaftueshëm i sistemit të kanalizimeve, përfshirë trajtimin e ujërave të zeza, veçanërisht në zonat rurale është një problem i madh për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Në anën tjetër, fermerët nuk kanë bërë investime në kapacitetet e magazinimit të plehut organik dhe infrastrukturat e tjera për mbrojtjen e mjedisit, si dhe për reduktimin e përdorimit të plehrave kimike.

Monitorimi në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit bën vlerësimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësorë në lumenj dhe liqene dhe kontrollojnë nivelin e ndotjes në to. Standardet e ujit si për ujin e pijshëm ashtu dhe për ujërat e zeza janë të përcaktuara qartë, por zbatimi i tyre është i dobët. Në Shqipëri mungon një sistem gjithëpërfshirës për monitorimin e cilësisë së ujit, gjë që rezulton në të dhëna jokonsistente dhe të pakta.

Ende nuk disponohet një bazë të dhënash me informacion gjithëpërfshirës për nivelet e azotit në liqene dhe në ujërat nëntokësore. Gjithashtu, cilësia e ujit sipërfaqësor dhe të pijshëm në Shqipëri vlerësohet duke përdorur më pak parametra se sa rekomandohet nga OBSH-ja ose konventat e nënshkruara. Sipas të dhënave shkencore, situata për amoniakun, nitratet, fosfatet dhe metalin e rëndë bakër tregon se në lumenjtë e Lanës, Ishmit, Gjanicës, Osunit, Semanit dhe Shkumbinit janë gjetur nivele të larta të nitriteve; ato i kalojnë vlerat udhëzuese të Komisionit Evropian (KE) për cilësinë e lartë të ujit të ëmbël. Në Shkumbin, lumin e Tiranës, Gjanicë dhe Seman nitratet e tejkalojnë edhe vlerën udhëzuese të KE-së për ujin sipërfaqësor.

Vitet e fundit është bërë progres për sa i përket cilësisë së ujit. Është përgatitur dhe është në pritje për miratim legjislativ kombëtar dhe planet e veprimit për përafrimin e legjislativimit me Direktivën Kuadër për Ujin dhe Direktivat për Nitratet dhe Ujërat e Zeza Urbane. Janë në funksion dy impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe ka përfunduar puna në një impiant tjetër dhe tre të tjerë janë në ndërtim. Megjithatë, për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit parakusht është rehabilitimi i nevojshëm i sistemeve të furnizimit me ujë, ndërtimi i infrastrukturës së kanalizimeve si dhe të gjitha objektive për trajtimin e ujërave të zeza.

Transmetimi i azotit, fosforit, pesticideve, sedimenteve dhe kripërave nga prodhimi bujqësor në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore është një burim i rëndësishëm i problemeve me cilësinë e ujit dhe një shqetësim në rritje në Shqipëri. Prioritet është investimi në trajtimin e mbetjeve dhe edukimin e fermerëve si dhe zbatimin e legjislativimit.

Rrugët rurale

Infrastruktura e rrugëve rurale, si një nga pengesat kryesore për aksesin në treg dhe zhvillimin ekonomik e social në zonat rurale, është përmirësuar në vitet e fundit. FSHZH-ja i ka dhënë përparësi ndërtimit të 1600 km rrugë nëpër komuna dhe rrejtet dytësor rrugor në vend, si dhe krijimit të një sistemi më të përshtatshëm për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të rrugëve dytësore. Nevoja sidoqoftë është ende e konsiderueshme. Infrastruktura e rrugëve rurale do të zgjerohet me 3500 km rrugë të reja ose të përmirësuara. Objektivi është gjithashtu zgjerimi i mirëmbajtjes për 1700 km të rrejtet të rrugëve rurale për periudhën 2013-2020.

1.4.2 Biodiversiteti

Shqipëria dallohet për diversitetin e saj të pasur biologjik dhe natyror. Ky diversitet i atribuohet pozitës gjeografike të vendit si edhe karakteristikave gjeologjike, hidrologjike, klimatike dhe atyre të tokës e relievit. Relievi malor, shtresat e ndryshme gjeologjike dhe llojet e dherave, si edhe gërshetimi i klimës së Evropës Qendrore dhe asaj mesdhetare, janë faktorët kryesorë për ekzistencën e një diversiteti ekosistemesh dhe biodiversiteti.

Shqipëria ka një florë shumë të pasur me 3250 lloje bimësh ose rreth 30% të florës evropiane²¹.

²¹ Flora e Shqipërisë, Nr.1 1994



Ka 30 lloje endemike dhe rreth 180 lloje nënendemike; nga gjithë ky diversitet bimësh më shumë se 300 lloje janë bimë aromatike dhe mjekësore, gjë që përbën një burim të rëndësishëm natyror dhe ekonomik, ende të pashfrytëzuar plotësisht²².

Shqipëria ka burimeve të pasura gjenetike të kafshëve të racës autoktone në ferma. Në Shqipëri aktualisht mbarështohen më shumë se 11 raca lokale të dhive, 8 të dhenve dhe 3 në gjedh.

Prioritetet strategjike të Planit Global të Veprimit për Ruajtjen dhe Përdorimin e Burimeve Gjenetike Shtazore të Fermës në Shqipëri janë: a) karakterizimi, inventarizimi dhe monitorimi i tendencave dhe rrezikut të zhdukjes së këtyre burimeve gjenetike autoktone; b) ruajtja, përdorimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tyre; c) mbështetja e zhvillimit të politikave dhe e kapaciteteve institucionale.

Kullotat dhe flora e egër janë me shumë interes sepse ato përbëjnë një sipërfaqe kalimtare midis ruajtjes "in-situ" dhe menaxhimit në fermë, për shkak të faktit se përmbajnë një sasi më të madhe specimesh²³.

Në pyjet malore të Shqipërisë jeton një bashkësi gjitarësh të mëdhenj, të tillë si ujç, arinj, rrëqebuj dhe dhi të egra, dhe gjithashtu edhe bashkësi shpendësh karakteristike. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj brenda vendit janë zona të rëndësishme, veçanërisht për shpendët që shtegtojnë gjatë dimrit. Rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180 000 individësh vërehen çdo vit gjatë dimrit në Shqipëri dhe vendi po ashtu është një kryqëzim i rëndësishëm për migrimin e zogjve, lakuriqëve të natës dhe insekteve. Në rastin e blegtorisë, në Shqipëri ka burime të pasura gjenetike, një shembull tipik për këtë janë racat e deleve të vendit.

Në Shqipëri gjenden rreth 91 specie të rrezikuara në të gjithë botën. Këto përfshijnë pelikanin dalmat (*Pelecanus crispus*), karabullakun e

vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*), dhe blinin (*Acipenser sturio*) për të cilët Shqipëria është vend me rëndësi veçanërisht të madhe.

*Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin*²⁴ është dokumenti kryesor i politikave për biodiversitetin për periudhën 2000-2015. Në strategji përcaktohen prioritetet kryesore për ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve, përmes identifikimit dhe shpalljes së tyre si zona të mbrojtura dhe përmes mbrojtjes së specieve brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura. Që nga viti 2000 janë zbatuar një sërë rekomandimesh strategjike, të tilla si: miratimi dhe zbatimi i ligjit "Për zonat e mbrojtura" (2002), ligjit "Për mbrojtjen e biodiversitetit" (2006), caktimi i zonave të reja të mbrojtura, rritja e mbulimit të zonave të mbrojtura nga 5% në 12,57%, në përputhje me projektin e rrjetit të propozuar në strategji, duke marrë parasysh elementet e rrjetit ekologjik evropian dhe udhëzimet ndërkombëtare, përfshirë ato evropiane. Pjesë të Strategjisë Ndërsektoriale dhe Sektoriale të Mjedisit 2007-2013 i kushtohen edhe problemeve specifike të biodiversitetit, si p.sh. zonat e mbrojtura, speciet e kërcënuara etj.

Përgatitja dhe zbatimi i planeve të veprimit për speciet e kërcënuara dhe endemike të faunës së egër janë pjesë e planeve për biodiversitetin. Në këtë kuadër janë hartuar pesë plane veprimi, duke përfshirë planet për speciet e rrezikuara të faunës dhe florës së egër. Strategjia dhe plani i veprimit për ligatinat, e miratuar në vitin 2006, është një tjetër dokument që plotëson kuadrin e planeve për biodiversitetin. Një tjetër dokument kombëtar është plani i veprimit për mjedisin global në lidhje me zbatimin e tre konventave të Kombeve të Bashkuara, të ashtuquajtura si Konventat e Rios (Biodiversiteti, Ndryshimet Klimatike dhe Shkretimi i Tokës).

Zonat e mbrojtura në Shqipëri mbulojnë 361 000 ha dhe përbëjnë 12,57% të territorit të vendit (tabela 6).

²² Libri i kuq i florës, 1995

²³ Alban Ibraliu, Fetah Elezi, Julian Shehu dhe Ndoc Faslia (2011), "Burimet gjenetike të bimëve mjekësore dhe aromatike të Shqipërisë". Konferenca evropiane për burimet gjenetike të bimëve, 2011 Wageningen, Holandë, 5-7 prill 2011

²⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 532, datë 5.10.2000, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 32, datë 23.10.2000.



Tabela 6: Zona të mbrojtura sipas llojit

Kategoria e zonës së mbrojtur	Nr. i zonave të mbrojtura	Sipërfaqja (ha)	% e sipërfaqes totale
Rezervat natyror strikt/rezervat shkencor	2	4800	0,17
Park kombëtar	14	176 517	6,14
Monument natyror	750	3490	0,12
Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror	22	62 530	2,18
Peizazh i mbrojtur	5	95 864	3,33
Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara /zonë e mbrojtur për shfrytëzim të shumëllojshëm	4	18 200	0,63
Total	797	361 401	12,57

Burimi: MM

Administrimi dhe menaxhimi i zonave të mbrojtura bazohet në ligjin “Për zonat e mbrojtura”²⁵. Ligji përcakton zonat e mbrojtura dhe rregullon ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore e biologjike; dhe lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor, për informimin dhe edukimin e publikut të gjerë dhe për përfitimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta ekonomike nga popullsia lokale dhe sektori publik e privat.

Ka disa iniciativa private që trajtojnë ruajtjen e diversitetit të varieteteve tradicionale, të cilat duhen mbështetur. Promovimi i ruajtjes dhe përdorimit të burimeve gjenetike dhe të bimëve për ushqimin dhe bujqësinë është i rëndësishëm jo vetëm për sa i përket agromjedisit, por edhe sepse ato mund të përbëjnë një mundësi ekonomike për promovimin e "produkteve tradicionale". Mbështetja për një konservim afatgjatë të diversitetit të burimeve gjenetike të bimëve të egra (bimët mjekësore dhe aromatike) dhe të kultivuara në fermë, promovimi i prodhimit të mbarështimit të gjësë së gjallë lokale në fermë, si dhe menaxhimi dhe përmirësimi i burimeve gjenetike për ushqimin dhe bujqësinë janë drejtime të rëndësishme investimi që duhen marrë parasysh.

1.4.3 Pyjet

Në vitin 2012, pyjet mbulonin 1 237 000 ha ose 43% e sipërfaqes së Shqipërisë dhe kullotat mbulonin 505 290 ha. Rreth 4/5 e sipërfaqeve pyjore mbulohet nga pyje gjysmë natyrore me përtëritje natyrore, duke ruajtur përbërjen origjinale të specieveve. Funkzioni prodhues i pyjeve lidhet me furnizimin me produkte druri dhe jo-druri të industrisë dhe shërbimeve, me kullotjen dhe

ofrimin e tokës bujqësore, me ushqimet në formën e frutave të pyllit, etj. Kontributi i pyjeve në ekonominë e vendit ka mbetur i vogël.

Produktet dhe shërbimet pyjore jodrusore janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave në Shqipërinë rurale (p.sh. bimët mjekësore dhe aromatike të analizuar në seksionin 1.3 në këtë strategji).

Shpyllëzimi konsiderohet një problem shumë i madh mjedisor në Shqipëri. Zonat pyjore janë pakësuar gjatë dekadave të kaluara për shkak të prerjes për lëndë djegëse dhe për të shtuar tokën e punueshme. Në përgjithësi, pyjet kanë regjistruar një rënie me rreth 10 pikë përqindje në 50 vitet e fundit.

Decentralizimi i menaxhimit të pyjeve nëpërmjet transferimit të pronësisë të rreth 50% të pyjeve dhe kullotave të qeveritë vendore, ka krijuar mundësi për mbrojtjen e burimeve natyrore, gjenerimin e të ardhurave, uljen e varfërisë dhe përmirësimin e standardeve/cilësisë së jetesës në zonat rurale. Megjithatë, shterimet e burimeve dhe problemet e erozionit vazhdojnë të paraqesin një sfidë.

1.4.4 Toka bujqësore

Toka bujqësore, ku përfshihen sipërfaqet e kadastruara dhe që synohen të mbillen me bimë arash, pemëtore, vreshta dhe ullishte, zë një sipërfaqe prej 695 500 ha ose 24% të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Kjo sipërfaqe përbëhet nga rreth 303 000 ha zonë fushore që shtrihet kryesisht në ultësitat bregdetare dhe rrafshnaltën e Korçës. Zona kodrinore përbën 239 000 ha, ndërsa zonat e larta malore rreth 153 000 ha.

Sistemi i vlerësimit të tokës bujqësore, i aplikuar në Shqipëri sipas studimit të bonitetit, dallon me sistemet kryesore ndërkombëtare të

²⁵ Ligji “Për zonat e mbrojtura” nr. 8906/qershor 2002



vlerësimi të tokës. Prej vitit 2003 ka filluar vlerësimi për përshtatshmërinë e tokës i mbështetur në skeletin/qasjen e FAO-s, në katër kategori të përshtatshme (S1-S4) dhe një kategori të papërshtatshme (N). Zbatimi i këtij klasifikimi është ende në proces në rrethet e Elbasanit, Korçës, Sarandës, Durrësit, Tiranës etj.

Bazuar në klasifikimin ekzistues të bonitetit, toka bujqësore klasifikohet në 10 kategori. Tokat e kategorisë së I-rë përfaqësojnë tokat më të mira për kultivimin e bimëve, ndërsa ato të kategorisë së X-të përfaqësojnë tokat më pak të përshtatshme për këtë qëllim.

Tokat e kategorisë së I-rë deri në të IV-t zënë një sipërfaqe prej 290 000 ha ose 41,6% të totalit të tokës bujqësore. Këto toka shtrihen kryesisht në zonën fushore dhe në luginat e lumenjve dhe identifikohen në përgjithësi si tokat me cilësi më të mira dhe me potencial të lartë për bujqësinë intensive.

Tokat e kategorisë së V-të deri në të X-të shtrihen kryesisht në zonat kodrinore dhe malore dhe karakterizohen nga terreni i pjerrët, horizonti i cekët, ekspozimi ndaj erozionit si dhe mungesa e infrastrukturës. Për këto arsye, gjatë procesit të privatizimit, rreth 100 000 ha e tyre u refuzuan të merren në pronësi nga familjet bujqësore. Si rrjedhojë, këto toka mbeten në pronësi shtetërore dhe përbëjnë një burim me vlerë për t'u përdorur sidomos për kultivimin e pemëve frutore, duke bërë investime suplementare.

Erozioni i tokës është i pranishëm, sidomos në tokat jopjellore që shtrihen në zonën kodrinore dhe malore. Ekzistojnë forma të ndryshme erozioni: (a) sipërfaqësor, (b) bregdetar, (c) i brigjeve të lumenjve, (d) në transportimin e materialeve të ngurta dhe (e) që ul pjellorinë e tokës si pasojë e largimit të elementeve ushqyese. Faktorët kryesorë që shkaktojnë erozionin janë faktorë klimatikë e tokësorë (reshjet, lartësia mbi nivelin e detit, pjerrësia e terrenit dhe mbulesa bimore) si dhe njerëzore (shpyllëzimi, menaxhimi jo i mirë hidroteknik i tokave të pjerrëta bujqësore, niveli i ulët i investimeve për mirëmbajtjen e tokës bujqësore si dhe zjarret në pyje dhe kullotat). Rreth 20% e territorit rrezikohet nga erozioni në një shkallë që llogaritet në rreth 5 t/ha tokë në vit, 70% e tij ka një humbje prej rreth 20 t/ha tokë në vit dhe vetëm 10% e sipërfaqes totale është pak e prekur nga erozioni.

Faqe | 8508

Zonat më të prekura nga fenomeni i erozionit janë faqet e kodrave që shtrihen në segmentin Përmet, Kolonjë, Malësi e Lekasit, Moglicë, Krabë, Mirditë, Pukë dhe Kukës. Erozioni masiv në këto toka lidhet me faktorët gjeologjikë dhe topografikë, mosmirëmbajtjen e tarracave, mbikullotjen dhe shpyllëzimin.

Tokat e kripura të Shqipërisë shtrihen kryesisht në ultësirën bregdetare perëndimore dhe janë nën ndikimin e klimës mesdhetare që karakterizohet nga vera e thatë dhe dimri i lagësht. Shkalla e lartë e avullimit gjatë verës shkakton rritjen e përqendrimit të kripës në sipërfaqen e tokës. Në dimër, në kushtet e një kullimi të pamjaftueshëm, niveli i lartë i reshjeve shkakton largimin e kripërave në shtresa më të thella. Kushtet e kullimit të dobët ngrenë nivelin e ujërave nëntokësore që janë dhe burimi kryesor i kripëzimit të tokave. Tokat e kripura mbulojnë përgjithësisht zonat e ulëta përgjatë vijës bregdetare, shpesh nën nivelin e detit. Të dhënat e studimeve të mëparshme tregojnë se tokat e kripura zënë një sipërfaqe prej 12 876 ha, nga të cilat të kripura dhe shumë të kripura (0,6 deri 1%) janë 6500 ha, ndërsa mesatarisht dhe lehtësisht të kripura (0,2-0,4%) janë rreth 6300 ha. Tokat e kripura, ndonëse përfshihen në fondin e tokës bujqësore, nisur nga cilësitë e tyre fiziko-kimike, janë të papërshtatshme për kultivimin e bimëve.

Tokat me kripëzim magnezial përfshihen në një sipërfaqe prej 12 500 ha, kryesisht në rrethet malore të vendit si Pukë, Librazhd, Dibër, Kukës etj.

Tokat acide gjenden kryesisht në zonat malore, në pjesën verilindore dhe juglindore të Shqipërisë. Origjina e aciditetit është e lidhur me natyrën e materialit primar, lëndën organike në tokë si edhe kushtet klimatike të këtyre zonave. Sipas studimeve të mëparshme të kryera në Shqipëri kjo kategori tokash zë një sipërfaqe prej 74 341 ha, nga të cilat 18 300 ha janë me përmbajtje të lartë acidesh (pH 4-5). Niveli i lartë i aciditetit në këto toka luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e prodhimit të bimëve, çfarë e bën të nevojshëm monitorimin e tij dhe përmirësimin nëpërmjet masave të tilla si gëlqerimi etj.

Tokat torfike të Shqipërisë përbëjnë rreth 3% të tokave bujqësore dhe gjenden në Maliq, Karkariq, Roskovec, Velipojë dhe Tërbuf. Prejardhja e tokave torfike është e lidhur me materialet tokëformuese dhe materiale të ndryshme bimore



të përfuara si rezultat i proceseve të dekompozimit të mbetjeve bimore në kushte të caktuara. Të dhënat studimore të tokave torfike tregojnë se këto toka rezultojnë me cilësi fizike, kimike dhe biologjike me kapacitet të lartë prodhues për të gjitha kulturat bujqësore në kushte optimale, sidomos të regjimit hidrik. Të dhënat tregojnë gjithashtu se situata në këto toka po ndryshon dhe kanë filluar të veprojnë faktorë kufizues si pasojë e lagështirës së tepërt apo formave të tjera të degradimit, si në Maliq dhe në Kakarë.

Përmbytjet po bëhen një problem shumë i madh, veçanërisht në pjesën veriperëndimore, por ato ndodhin edhe në zona të tjera të ulëta të vendit. Ka një reaksion zinxhir nga shpyllëzimi, mbikullotja dhe erozioni që kulmon me përmbytjen. Po kështu, inertet në shtretërit e lumenjve pa kritere, dëmtimi i argjinaturave mbrojtëse dhe i sistemeve kulluese janë faktorë të rëndësishëm që çojnë në përmbytje.

Përdorimi i ulët dhe i paekuilibruar i plehrave organike dhe minerale, mosaplikimi i qarkullimeve të duhura bujqësore, masat joefektive për mbrojtjen e bimëve, teknikat e papërshtatshme të bujqësisë për nevojat vetjake, masat joefektive për sigurimin e kullimit, përmbytjet, shtimi i erozionit për shkak të shpyllëzimit pa kriter, të cilat janë evidentuar në shumë raste, ndikojnë në uljen e pjellorisë si dhe në degradimin e tokave bujqësore.

Përmasa e vogël mesatare e fermave, niveli i lartë i fragmentimit, investimet e vogla lidhur me tokën, erozioni, degradimi dhe humbja e tokës bujqësore (për përdorime të tjera) kanë qenë sfida të mëdha në të shkuarën.

Në të ardhmen, prioritet duhet t'i jepet forcimit të tregut të tokës bujqësore, pjesërisht nëpërmjet instrumenteve të qiramarrjes dhe programeve të konsolidimit të tokës.

1.4.5. Ndryshimet klimatike dhe cilësia e ajrit

Që nga vitet 1990, Shqipëria ka ndërmarrë modernizim institucional, përfshi strukturat e qeverisë që adresojnë fushat e financës, energjisë dhe mjedisit. Pjesë e kësaj përpjekjeje ka qenë përditësimi i fushave që lidhen me menaxhimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike. Edhe pse vetëm së fundmi, Shqipëria ka ndërmarrë hapa për krijimin e një kuadri institucional për promovimin dhe miratimin e aktiviteteve të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (MZHP) në vend, që mund të

shërbejnë gjithashtu si një themel për pjesëmarrjen në tregjet alternative të karbonit dhe skemat e kompensimit.

Konventa për ndryshimet klimatike u ratifikua në tetor të vitit 1994 dhe instrumenti i ratifikimit u depozitua në janar 1995, ndërkohë që Protokollin e Kiotos u ratifikua nga Shqipëria në prill të vitit 2005. Legjislacioni për krijimin e një strukture të Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar (AKP) u miratua në vitet 2008 dhe 2009, me prezantimin e kuadrit të duhur ligjor në nivele të ndryshme për të zyrtarizuar kuadrin ligjor të veprimit të AKP-së në vend dhe për shqyrtimin e projekteve MZHP dhe procedurat e miratimit.

Aktorët më të rëndësishëm në MZHP, nga ana e ofertës, dominojnë tregun bazuar në përmasën e madhe të ekonomive dhe operacioneve të tyre të MZHP-së. Shqipëria nuk mund të konkurrojë në këtë sferë me sasi, por i duhet ta bazojë konkurrencën, qoftë për MZHP, qoftë për tregjet e ardhshme të karbonit, në fusha të ndryshme nga ato të volumit dhe pranisë në tregjet masive, përkatësisht, në cilësinë dhe besueshmërinë e projekteve të saj dhe asetëve të karbonit. Si pasojë, vizioni i kësaj strategjie është që Shqipëria do të vendoset në MZHP në mënyrë konkurruese dhe tregjet e ardhshme të karbonit bazuar në cilësinë e lartë të aktiviteteve të projekteve shqiptare dhe në standardin e lartë të reduktimit të emetimeve të përfuara në këto aktivitete. Konkluzioni i këtij vizioni është që Shqipëria do të jetë e pranishme në tregjet e karbonit jo në bazë të shkallës, por të cilësisë së asetëve, dhe që këto do të përfitojnë me një nivel të arsyeshëm kostoje transaksionesh.

Niveli i ndërgjegjesimit për ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre negative po rritet në publik dhe tek qeveritarët. Ndërsa ndryshimet klimatike janë shndërruar në një çështje të rëndësishme, Republika e Shqipërisë zbatoi një Plan Kombëtar Veprimi për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe ka kryer studime për të vlerësuar efektin e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm, përfshi bujqësinë.

Komunikimi i Dytë Kombëtar i Shqipërisë drejtuar KKKBNK-së²⁶ paraqiti një vlerësim të

²⁶ Republika e Shqipërisë, MM, Komunikimi i Dytë Kombëtar i Shqipërisë në Konferencën e Palëve të Konventës Kuadër të KB-së për Ndryshimet Klimatike, 2009.



gjendjes aktuale të Shqipërisë për sa i përket ndryshimeve klimatike. Ai ofroi gjithashtu informacion dhe prova shkencore si të dhëna të vlefshme për politikëbërësit e planifikimit të zhvillimit afatgjatë për sektorët përkatës. Raporti tregoi që emetimi i Gazeve me Efekt Serrë (GES) në Shqipëri gjatë vitit 2000 ishte në total 7619,9 Gg. Sektorët kryesorë kontribuues ishin energjia (44,0%), e ndjekur nga bujqësia (27,1%) dhe ndryshimi në përdorimin e tokës dhe pyjeve (21,6%). Pjesa e ndryshimit në përdorimin e tokës dhe pyjeve po reduktohet në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa pjesa e energjisë dhe mbetjeve po rritet.

Kontributi i sektorit bujqësor në emetimin e GES llogaritet të jetë 35% (të dhëna të vitit 2001). Metani përfaqëson 78% të kësaj shifre kryesisht për shkak të fermentimit enterik të gjësë së gjallë. 95% e këtij metani nga fermat emetohet prej gjedhëve (73%) dhe deleve (16%) dhe pjesa e mbetur nga menaxhimi i plehut organik.

Gjatë 50 viteve të fundit (1951-2001), është regjistruar një rritje temperaturash prej mesatarisht 0,3°C në të gjithë vendin. Me kërcënimin e ndryshimeve klimatike, pritet të ndodhin fenomene klimatike ekstreme më të shpeshta, të tilla si temperatura të larta, thatësira të zgjatura, përmblytje, duke rritur rrezikun për rrëshqitje toke dhe zjarre²⁷.

Sipas rezultateve të inventarit të Komunikimit të Dytë Kombëtar, emetimi total neto i gazeve me efekt serrë në vitet 2005–2006 është rreth 7956–8540 tonë CO₂. Aktualisht, janë një sërë skemash dhe tregjesh kompensimi dhe gjelbërimi, ku Shqipëria mund të gjejë mundësi të tjera tregtimi të kuotave të saj të karbonit të gjeneruar, si alternativa për të përfituar nga çmimet më të larta apo nga kushte të tjera më të favorshme, në rast se MZHP bëhet shumë kufizues dhe i njëanshëm.

Parashikimet klimatike për Shqipërinë tregojnë ndryshime të tilla, si ngritje temperaturash, ulje të sasisë së reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe të tokës së punueshme. Zona më delikate e Shqipërisë është zona bregdetare, ndërkohë që sektorët më delikatë janë burimet ujore, bujqësia, energjia dhe turizmi. Ndryshimet e ardhshme klimatike priten të kenë efekt negativ në prurjet

lumore, të cilat nga ana tjetër do të ndikojnë në kapacitetin gjenerues të hidrocentraleve. Kjo është një çështje, e cila duhet të merret në konsideratë.

Pritet gjithashtu që ndryshimi i klimës të shkaktojë rritje temperaturash nga 0,8 deri në 1,0°C deri në vitin 2025, midis 1,2-1,8°C deri në vitin 2050, dhe nga 2,1 deri në 3,6°C deri në vitin 2100²⁸. Ky ndryshim klimatik do të reduktojë burimet ujore dhe lagështinë dhe do të ketë një ndikim negativ mbi bujqësinë, pyjet dhe biodiversitetin. Një ndryshim i tillë klimatik në Shqipëri do të shkaktojë përdorimin shtesë e të konsiderueshëm të sistemit të ujitjes për bimët gjatë muajve të thatë dhe do të shkaktojë ndryshime në speciet dhe habitatet e bimëve.

1.4.6 Burimet e rinovueshme të energjisë

Prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme në Shqipëri, përveç sektorit hidroenergetik, i cili është burimi më i rëndësishëm dhe më i shfrytëzuar në Shqipëri, mbetet ende i pazhvilluar dhe një sektor jo prioritar në lidhje me investimet publike. Strategjia Kombëtare Shqiptare e Energjisë, e miratuar në vitin 2003, fokusohet pjesërisht në çështjen e burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE). Ajo përmban disa seksione mbi BRE-të, kryesisht mbi HEC-et e vogla, energjinë e erës dhe atë diellore.

Shqipëria ka potencial për shfrytëzimin e biomasës për prodhimin e energjisë nga katër burime kryesore: mbetjet urbane, mbetjet bujqësore, mbetjet e pyjeve, bërsitë e ullirit që përdoren në kaldajat e serave dhe mbetjet e kafshëve. Lloji aktual i biomasës që shfrytëzohet është vetëm druri i zjarrit. Në vitin 2007, përqindja e drurit të zjarrit të përdorur ishte rreth 12% (e barabartë me 215 ktoe) e kërkesës totale për energji. Kërkesa për dru zjarri vjen kryesisht nga familjet në zonat e thella malore. Në Shqipëri mbjellja e sipërfaqeve të reja pyjore po ndodh me ritme të ngadalta. Përveç kësaj, nuk ka treg të zhvilluar për materialet e drurit, siç janë peletat, për të cilat ka vetëm një impiant prodhimi.

Potenciali i mbetjeve bujqësore është përlllogaritur të jetë rreth 2300 GWh/vit. Aktualisht në Shqipëri nuk ka asnjë impiant që të

²⁷ Raporti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, 2008.
Faqe | 8510

²⁸ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave; Raport mbi vetëvlerësimin e kapacitetit kombëtar të Shqipërisë për menaxhimin global të mjedisit, 2007.



përdorë mbetjet bujqësore për qëllime energjetike. Plehu përdoret kryesisht për rritjen e pjellorisë së tokës në bujqësi për shkak se pjesa më e madhe e blegtorisë ndodhet në fermat e vogla dhe mbledhja e plehut nga këto ferma të vogla për prodhim energjie është teknikisht dhe financiarisht i vështirë dhe i kushtueshëm.

Shqipëria ka potencial për zhvillimin e sistemeve diellore të prodhimit të energjisë. Klima e Shqipërisë është tipike mesdhetare, me verë të nxehtë dhe të thatë. Klima është një kusht paraprak i mirë për përdorimin e energjisë diellore (rreth 129,3 kcal/cm² në vit). Rrezatimi vjetor varion midis 3,2 kWh/m²/ditë në pjesën verilindore të Shqipërisë dhe 6 kWh/m²/ditë në Fier, me një mesatare të vendit prej 4,0 kWh/m²/ditë, i cili mund të konsiderohet si një vend me një regjim të mirë të energjisë diellore. Ministria e Energjetikës planifikon të instalojë panele diellore të cilat nëse do të montoheshin do të prodhonin ujë të ngrohtë të barasvlershëm me rreth 360 GWh (ose kapacitet i instaluar prej 75 MW). Këto shifra korrespondojnë me një sipërfaqe totale kolektorësh prej rreth 400 000 m² dhe mund të merren si tregues për potencialin e tregut shqiptar gjatë 20 viteve të ardhshme.

Burimet e energjisë së erës gjithashtu kanë potencial për zhvillim. Sidoqoftë, mungojnë të dhëna të besueshme në lidhje me potencialin e energjisë së erës në Shqipëri dhe nuk ka asnjë atlas të erës të disponueshëm për momentin.

Strategjia Shqiptare e Energjisë përllogarit se 4% e energjisë së prodhuar ose rreth 400 GWh/vit mund të vijnë nga energjia e erës deri në vitin 2020. Janë identifikuar zonat potenciale për shfrytëzimin e energjisë së erës në zonat fushore bregdetare afër hidrovorëve me madhësi afërsisht rreth 30 GWh/vit ose 0,7 për qind e prodhimit aktual të energjisë në vend.

Ka shumë burime dhe puse termike në Shqipëri, të cilat përfaqësojnë një potencial të vërtetë për energjinë gjeotermike. Situata gjeotermike në Shqipëri ofron dy drejtime për shfrytëzimin e energjisë gjeotermike: përdorimet e burimeve dhe puseve të ujërave termikë me temperatura të ulëta mbulojnë një territor të gjerë nga jugu, afër kufirit Shqipëri-Greqi, deri në rrethet verilindore në rajonin e Dibrës. Temperaturat e ujit arrijnë deri në 60°C. Zonat gjeotermike më të rëndësishme janë: Kruja, zona

me burimet më të mëdha gjeotermike në vend; Ardenica: burime ujore me një temperaturë prej 32-38°C dhe prurje të ujit prej 15-18 l/s; Peshkopia: disa burime të përqendruara me temperaturë prej 43,5 °C dhe prurje të ujit prej rreth 14-17 l/s.²⁹

Prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme, sidomos nga sektorët e bujqësisë dhe të pyjeve, është ende i pazhvilluar në Shqipëri, por ekziston potenciali dhe do të eksplorohej më tej. Shqipëria ende nuk ka vendosur ndonjë objektiv tregues kombëtar për konsumin e energjisë elektrike në të ardhmen të prodhuar nga BRE-të për shkak të mungesës së analizave gjithëpërfshirëse, rregulloreve dhe mekanizmave mbështetës.³⁰

1.4.7 Bujqësia organike

Bujqësia organike në Shqipëri është në hapat e saj të parë të zhvillimit. Produktet organike në Shqipëri hynë fillimisht në mes të viteve 1990-të për shkak të kërkesës për bimë mjekësore, që e kishin origjinën nga mbledhja në terren nga tregjet evropiane dhe të Shteteve të Bashkuara.

Në vitin 2011 më tepër se 120 ferma ishin certifikuar si prodhues organikë. Fermat organike funksionojnë në të gjithë vendin. Ato ndodhen kryesisht në zonat me bujqësi të zhvilluar (zonat fushore të Durrësit, Tiranës, Fierit, Lushnjës, Kavajës, Vlorës), por edhe në zonat malore të thella ku prodhohen bimë specifike (Korçë, Skrapar, Pogradec, Krujë). Certifikimi organik është më i zakonshëm për bimët mjekësore dhe aromatike (BAM) (mijëra hektarë të certifikuar) - si kultivimi dhe mbledhja e bimëve të egra - duke qenë se këto produkte janë kryesisht të destinuar për tregjet e eksportit. Përveç BAM-ve, po vërehet një tendencë në rritje e certifikimit/bujqësisë organike në nënsektorët e tjerë. Në vitin 2007, kishte 11 ha me perime, 22 ha me ullishte, 15 ha vreshta dhe 8 ha pemëtore me certifikim organik, ndërsa në vitin 2011 kishte 6 ha me perime, 70 ha me ullishte, 20 ha vreshta dhe 113 ha pemëtore. Pavarësisht kësaj tendence rritjeje, bujqësia organike është shumë mbrapa tendencave të BE-së.

²⁹ Strategjia Kombëtare Shqiptare e Energjisë, 2003.

³⁰ Analiza e energjisë së rinovueshme dhe ndikimit të saj në zhvillimin rural në Shqipëri, Rrjeti i zgjerimit për analizën e politikave bujqësore, 2009.



Që prej vitit 2008, MBZHRAU-ja ofron mbështetje për certifikimin e produkteve bujqësore nga bimët e kultivuara, përkatësisht për produktet e destinuara për tregun vendas. Gjithashtu, donatorë të ndryshëm si USAID, GIZ, Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim kanë ofruar projekte mbështetjeje me synim zhvillimin e bujqësisë organike në vend.

Albinspekt është organi i vetëm certifikues në vend i miratuar nga MBZHRAU-ja për certifikimin e fermerëve organikë në Shqipëri. Në Shqipëri veprojnë shtatë organe certifikuese të huaja, si ICEA, BCS, Oko-Garantie GmbH, BioInspecta AG, CERES GmbH, Control Union Certifications B.V., IMO CH, IMC srl.

Bujqësia organike ka **mundësi** për zhvillim të mëtejshëm. Për sa i përket prodhimit, ka kushte të përshtatshme klimatike dhe të tokës për produkte organike dimërore dhe të hershme. Sistemet aktuale të bujqësisë dhe blegtorisë janë kryesisht sisteme me përdorim të paket input-esh dhe me prodhim jointensiv. Për sa i përket tregut, pozicioni gjeografik strategjik i Shqipërisë kundrejt tregjeve potenciale evropiane përbën një avantazh, ndërkohë që rritja e të ardhurave të konsumatorëve vendas në Shqipëri përfaqëson një mundësi për tregun vendas. Për sa i përket tregut vendas, në përgjithësi ka një preferencë të fortë të konsumatorëve për blerjen/konsumin e ushqimeve organike. Shumica e konsumatorëve janë të gatshëm të paguajnë më shumë për produkte organike, shumë e cila varion sipas llojit të produkteve dhe familjeve³¹. Në këtë kontekst ka një potencial të madh në tregun vendas. Përparim ka pasur edhe në kuadrin ligjor dhe institucional në Shqipëri.

Megjithatë, sektori përballet me disa **sfida**. Ka ende mangësi në legjislacionin e prodhimit organik, i cili do të përditësohet duke marrë në konsideratë ndryshimet në legjislacionin e BE-së për prodhimin organik. Politikat mbështetëse duhet të rriten në të ardhmen për të siguruar ndërtimin e një tregu organik të qëndrueshëm. Nuk ka kapacitet të mjaftueshëm të zyrave lokale të shërbimit ekstensiv për të përballuar këshillimin në

zbatimin e standardeve për prodhimin organik. Mungesa e funksionimit të zinxhirit të tregtimit, mungesa e integritit të zinxhirit të furnizimit dhe lidhjet e dobëta ndërmjet prodhuesve, përpunuesve /ekspor-tuesve dhe konsumatorëve i pengojnë prodhuesit shqiptarë në tregtimin e produkteve organike në Shqipëri. Ekziston një ndërgjegjësim dhe mbështetje e kufizuar për përdorimin e inputeve organike, të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e sektorit organik.

1.5 Arsimi dhe formimi profesional për drejtimit bujqësore

Sistemi i arsimit profesional bujqësor përbëhet nga 9 shkolla të mesme që mbulojnë fushat e prodhimit bimor (8 shkolla), prodhimit shtazor/blegtoral (1 shkollë), veterinarisë (3 shkolla), agrobiznesit (5 shkolla), silvikulturës, të pyjeve dhe prodhimit të mobilieve (1 shkollë) dhe makinerive bujqësore (2 shkolla). Aktualisht, numri i shkollave profesionale bujqësore është shumë i ulët dhe numri i studentëve që diplomohen nga shkollat e mesme profesionale bujqësore është shumë më i vogël krahasuar me dy dekada më parë. Numri i të diplomuarve nga shkollat e arsimit dhe formimit profesional bujqësor tani është disa qindra në vit.

Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit të Korçës ofrojnë arsim të lartë bujqësor. Universiteti Bujqësor i Tiranës është i vetmi universitet i specializuar në studime universitare dhe pasuniversitare, kërkime shkencore, trajnime dhe ekstension në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (agronomi, hortikulturë dhe mbrojtje bimësh, ekonomi dhe politika agrare, agromjedis dhe ekologji, teknologji agroushqimore, zootekniki dhe biznes blegtoral, akuakulturë dhe menaxhim peshkimi, inxhinieri pyjore, mjekësi veterinarë etj.).

Arsimi universitar bujqësor po tërheq interes në rritje. Në vitin 2000, vetëm 3 për qind e numrit total të të diplomuarve nga universitetet publike i përkiste shkencave bujqësore kundrejt 12% në fund të viteve 2000. Në shifra absolute, numri i të diplomuarve në disiplina bujqësore është rritur jashtëzakonisht me rreth 10 herë për të njëjtën periudhë si rezultat i rritjes së numrit të regjistrimeve. Aktualisht (viti akademik 2012-2013), numri i studentëve të regjistruar është rreth 15 000. Pavarësisht tendencave pozitive në shifra, ka shqetësime për cilësinë e të diplomuarve duke qenë

³¹ “Ndërgjegjësimi dhe preferencat e konsumatorëve për produkte organike në Shqipëri” kryer në vitin 2013 nga projekti i EU-FAO “Përgatitja e strategjisë kombëtare për zhvillimin rural dhe bujqësor në Shqipëri”
Faqe | 8512



se ekziston një mendim i përgjithshëm sipas së cilit studimet bujqësore, në përgjithësi, nuk tërheqin studentët më të mirë. Barazia gjinore është më pak e balancuar në preferencën për studime bujqësore. Ndërkohë që ka pasur balancë gjinore për regjistrimet në arsimin universitar, vetëm një e treta e studentëve në fakultetet bujqësore kanë qenë femra.

Përqindja e drejtuesve të fermave me arsim bazë (deri në 8 ose 9 vite) është 62% në vitin 2011 dhe 2007, ndërsa përqindja e drejtuesve të fermave me arsim të mesëm dhe/ose të lartë ka shënuar një rritje të lehtë në 36% nga 35% krahasuar me vitin 2007. Më shumë se 30% e fermerëve kanë arsim të mesëm bujqësor që është përfunduar përpara viteve 1990-të në shumicën e rasteve. Kjo shifër do të ulet ndjeshëm me kalimin e kohës për shkak të niveleve të ulëta të regjistrimit në shkollat profesionale bujqësore në 2 dekadat e fundit dhe në të tashmen.

1.6 Kërkimi bujqësor, inovacioni dhe shërbimet e ekstensionit

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë një reformë tërësore në kërkimin bujqësor që në vitin 2006. Qeveria shqiptare ka si qëllim të zhvillojë më tej në periudhën e strategjisë 2014-2020 sistemin e inovacionit bujqësor për shkak se bujqësia dhe agroindustria janë sektorë qendrorë të ekonomisë, sidomos në zonat rurale. Në një ambient më konkurrueshmëri të lartë kombëtare dhe ndërkombëtare inovacioni është faktor kyç për rritjen e bujqësisë.

Pesë qendra të transferimit të teknologjive Bujqësore (QTTB) u krijuan me misionin e transferimit të teknologjive. Ristrukturimi u shoqërua gjithashtu me ndryshim të objektivave, duke i dhënë rëndësi transferimit të teknologjive në përputhje me nevojat, kushtet dhe prioritetet rajonale ku ndodhet secila QTTB, ndërkohë që kërkimi i mirëfilltë shkencor kaloi si funksion pranë universiteteve.

QTTB-të filluan të luanin një rol aktiv për sa i përket transferimit të teknologjive, duke çuar në nxitjen e konkurrueshmërinë së bujqësisë. Ato janë përfshirë në përgatitjen dhe zbatimin e disa prej programeve të MBUMK-së që lidhen me skemat e mbjelljes së ullinjve, ujitjen dhe kullimin, skemat për mbështetjen e bujqësisë, sigurinë ushqimore, konsolidimin e tokës etj.

Shërbimi i ekstensionit ofron asistencë teknike falas për fermerët me qëllim rritjen e të ardhurave. Shërbimi përbëhet nga tre nivele: niveli qendror, niveli rajonal dhe niveli lokal, me një total prej 285 punonjësish. Në nivel rajonal, 12 drejtoritë rajonale të bujqësisë kanë sektorin e shërbimit këshillimor të përbërë nga 5-6 specialistë të profilizuar për perimet, drurët frutorë dhe mbrojtjen e bimëve, specialistë zooteknikë dhe një numër më të vogël ekonomistësh bujqësorë. Punonjës të tjerë të ekstensionit operojnë në terren, qendrat e informacionit bujqësor (QIB), të cilat janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin e fermerëve. Shërbimi këshillimor publik bashkëpunon ngushtë me aktorë të tjerë, p.sh. OJF, projekte, projekte donatore etj.

Nga shërbimi këshillimor publik dhe QTTB-të marrin informacion deri në 20% e fermerëve dhe agrobizneseve (70 000 fermerë nga rreth 353 000 ferma dhe 2000 agrobiznese/sipërmarrje përpunimi). Më shumë se 8000 fermerëve u ofrohet ndihmë nga stafi i shërbimit të ekstensionit për të zbatuar/përfutur nga skemat mbështetëse.

Përfitimi për fermerët monitorohet nga MBZHRAU dhe shembujt tregojnë një rritje prej rreth 5-10% në vlerat e prodhimit, kjo për shkak të përmirësimit të cilësisë, prodhimitarisë së shtuar dhe organizimit më të mirë të prodhimit dhe tregimit. Në vitet në vijim, nevojitet një mbulim më i madh i fermave të orientuara drejt tregut, shikoni gjithashtu seksionin 1.7 më poshtë.

Efikasiteti i sistemit publik të ekstensionit ka nevojë për përmirësim, si në nivelet sasiore dhe cilësore të burimeve njerëzore në dispozicion, ashtu edhe të infrastrukturës së nevojshme. Këto kufizime kanë rezultuar në ndikim të limituar të shërbimeve të ekstensionit publik mbi përmasën e fermës, performancën dhe inovacionin³².

Më konkretisht, disa nga problemet kryesore me të cilat përballet shërbimi i ekstensionit publik, janë: i) numri i kufizuar i specialistëve të ekstensionit (mesatarisht, ka një specialist ekstensionit për 1700 fermerë) dhe angazhimi i tyre në shumë detyra që janë jashtë fushës së tyre specifike; ii) mbështetja e pamjaftueshme financiare

³² “Vlerësimi i ndikimit të shërbimit të ekstensionit publik”, kryer në vitin 2013 nga projekti i EU-FAO “Përgatitja e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor në Shqipëri”



në formën e investimeve në qendrat e informacionit bujqësor dhe të kostove operacionale për të kryer aktivitetet e ekstensionit; iii) mosha mesatare e lartë e specialistëve të ekstensionit dhe aftësitë e tyre të kufizuara në teknologjinë e informacionit dhe iv) kapacitetet e kufizuara në menaxhimin e fermave, në marketing dhe në planifikimin e biznesit.

Gjithashtu, ka nevojë për rritje të numrit të ekstensionistëve, të shërbimeve të ofruara dhe mbulimit në zonat malore/të varfra me mbulim të pakët.

Inefiçenca operacionale (orientim i ulët ndaj tregut) e shërbimeve publike të ekstensionit ka nevojë për përmirësim, në mënyrë që t'i përshtatet bujqësisë së re të orientuar drejt tregut dhe kërkesës së saj për shërbime. Ekstensionit duhet të vendosë lidhje më të forta me kërkesën vendase dhe kapacitetet kërkimore kombëtare. Kërkimi dhe ekstensionit, arsimit, shteti, sektori privat (fermerët, shoqëritë e agrobiznesit, organizatat e prodhuesve, ofruesit privatë të shërbimeve të ekstensionit) dhe organizatat e shoqërisë civile mund të nevojitet të jenë në një dialog ndërveprues për sa i përket vizionit për zhvillimin e qëndrueshëm rural të Shqipërisë.

Shërbimet e ekstensionit duhet të zgjerojnë agjendën e tyre drejt një ekstensionit rural, duke përfshirë:

- përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit, konsolidimin e tokës dhe burimet gjenetike autoktone;
- standardet (siguria e ushqimit, mjedisi, cilësia, etj), marketingun, bujqësinë organike;
- mbështetjen për bashkëpunim horizontal dhe vertikal dhe aktivitete jashtë fermës (jobujqësore).

Gjithashtu, ka nevojë për përmirësimin e kapaciteteve TIK, që përbën një pjesë të rëndësishme të kërkimit, këshillimit dhe rrjetit të inovacionit.

Për sa i përket QIB-ve është e nevojshme:

- të konsolidohet, përmirësohet e zgjerohet gama e shërbimeve të ofruara nga QIB-të ekzistuese;
- të rritet numri i QIB-ve kryesisht në ato zona ku ai është i kufizuar.

1.7 Zhvillimi institucional, legjislativi dhe zbatimi i tij

Zhvillimi institucional dhe krijimi i kuadrit rregullator në prag të pranimit në BE ka qenë dhe

vazhdon të jetë një prioritet i rëndësishëm për qeverinë shqiptare. Progres i rëndësishëm është bërë në zhvillimin e kapaciteteve administrative të MBZHRAU-së.

Ky progres para së gjithash është bërë i mundur me anë të mbështetjes së konsiderueshme teknike për Shqipërinë nga IPA dhe projekte të financuara nga donatorë të tjerë, të cilët trajtojnë një gamë të gjerë të vështirësive institucionale që Shqipëria ka hasur dhe ende po has në procesin e përgatitjes për futjen në BE.

Gjatë periudhës 2007–2013 u zbatuan reformat madhore rregullatore dhe institucionale të mëposhtme.

1.7.1 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Miratimi i ligjit “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” (këtu e më pas përmendur si “Ligji”) në vitin 2007, i cili rregullon programimin e masave të politikave të lidhura me bujqësinë dhe zhvillimin rural, ofron shërbimet këshilluese publike të bujqësisë, kërkimeve dhe trajnimeve, dhe krijimin e një baze të dhënash informimi. Gjithashtu, ai ofron bazën ligjore për institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave bujqësore duke krijuar Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural për zbatimin e skemave të mbështetjes kombëtare dhe futjen e parimeve të monitorimit dhe vlerësimit të skemave kombëtare të mbështetjes.

Ligji ofron bazën ligjore për politikën kombëtare të mbështetjes, të cilat nxirren në bazë vjetore në Planin Kombëtar të Veprimit dhe për të cilat kërkohet zbatimi me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave. Plani i Veprimit përcakton masat për zbatimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural në vitin përkatës, kryesisht:

- kushtet, kriteret, dhe procedurat për zbatimin e masave;
- planin financiar për zbatimin e masave;
- mekanizmat institucionalë;

Procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit është përgjegjësi e AZHBR-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave në MBZHRAU nën mbikëqyrjen e Komitetit Ndërmintor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. AZHBR ka kryer funksionet e Agjencisë së Pagesave për skemat kombëtare të mbështetjes që prej fillimit të vitit 2009.



Drejtoria e Përgjithshme e Politikave është ristrukturuar me strukturë të re organizative dhe tani përbëhet nga 2 drejtori, respektivisht Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale dhe Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare. Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale është caktuar si Autoriteti Menaxhues (AM) për mbështetjen e zhvillimit rural paraaderimit – IPARD.

Krijimi i institucioneve për programimin dhe zbatimin e ndihmës së paraaderimit për zhvillimin rural -IPARD

Strukturat për menaxhimin dhe sistemin e kontrollit të IPARD janë ngritur në përputhje me rregulloren e zbatimit të IPA-s së BE-së. Ato u caktuan formalisht me vendim të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e funksioneve, të përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit për asistencë paraaderimit për zhvillimin rural (IPARD), Komponenti V”, nr. 846, datë 21.11.2012, dhe u ngritën me urdhra të Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si vijon:

- Autoriteti Menaxhues (AM) në MBZHRAU, i cili është përgjegjës për programimin e masave për zhvillimin rural si dhe për monitorimin dhe raportimin sipas rregullave.

- Agjencia e Pagesave të IPARD në strukturat e AZHBR-së, e cila është struktura përgjegjëse për zbatimin e programit IPARD.

Në periudhën 2009–2011, ndërtimi i kapaciteteve administrative të strukturave operative të IPARD bëri progres të konsiderueshëm në përgatitjen për menaxhimin e mbështetjes paraaderimit. Shqipëria ka përgatitur draftin e programit IPARD për periudhën 2011–2013, i cili u përdor për përgatitjen e skemës aktuale të granteve si IPARD.

Një draft i parë i procedurave të zbatimit për akreditimin e Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë IPARD u përgatit në përputhje me rregullat e menaxhimit dhe kontrollit financiar të IPARD-it dhe u konsultua me shërbimet e KE-së.

AM, aktualisht e përbërë nga 7 persona, ka përgjegjësi të plotë për ekzekutimin efikas dhe të rregullt të programit IPARD në përputhje me politikën kombëtare të qeverisë, bërë në atë mënyrë që të lehtësojë përdorimin maksimal të mundësive

të zhvillimit të hapura për vendin. Për më tepër, AM ka bashkëpunuar si partner në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive me organizatat përkatëse për t’u siguruar që ekspertiza e partnerëve/aktorëve në konsultimin dhe zbatimin e programit të jetë gjithmonë e pranishme. Një pjesë e rëndësishme e AM-së është të sigurojë koherencë të programit IPARD me politikën gjithmonë në zhvillim të skemave kombëtare në mënyrë të tillë që të plotësojnë njëra-tjetrën.

AZHBR përbëhet nga 102 të punësuar dhe është struktura përgjegjëse për zbatimin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural si dhe zbatimin e asistencës paraaderimit – IPARD. Struktura organizative e AZHBR-së u miratua me urdhrin e Kryeministrit nr. 37, datë 26.3.2012 “Për krijimin e strukturës organizative të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.” Struktura organizative e AZHBR-së është krijuar për të përmbushur kriteret e akreditimit të IPARD të BE-së, duke bërë të mundur një ndarje të saktë të funksioneve kryesore dhe rrjedhimisht për menaxhim të saktë financiar.

Stafi shtesë për AZHBR-në është punësuar dhe trajnuar për sa i përket funksioneve të tyre specifike dhe rregullave bazë për funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të IPARD.

Progresi në krijimin e strukturës operative të IPARD-it u njoh nga KE-ja dhe si rrjedhojë çoi në vendimin për të krijuar një skemë grantesh pilot, si IPARD, duke iu ofruar kështu strukturave shqiptare një mundësi për të praktikuar dhe pasur akses në fondet e BE-së në projektin e IPA 2011, “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural,” zbatuar nga GIZ.

Skema e granteve, si IPARD u publikua në dhjetor 2012 me objektiv kryesor rritjen e ndërgjegjësimit dhe kapacitetit të aktorëve të përfshirë në zhvillimin rural dhe lehtësimin e përafrimit të zhvillimit të sektorit agroushqimor dhe cilësisë në fermë me standardet e BE-së. Kjo skemë siguron fonde të mjaftueshme për fermerët dhe përpunuesit e ushqimit dhe do të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit agroushqimor. Nëpërmjet zbatimit të masave në përputhje me procedurat e IPARD, stafi i sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të IPARD, përfituesit e mundshëm, shërbimet këshilluese dhe institucionet huadhënëse do të fitojnë eksperiencën për zbatimin e IPARD II.



AM dhe AZHBR aktualisht janë të përfshira në menaxhimin e skemës së granteve të bazuar në një marrëveshje operationale midis GIZ, MBZHRAU dhe AZHBR. AM dhe AZHBR kanë përgatitur dhe zbatuar një fushatë të gjerë informative për përfituesit e mundshëm, të masave të skemës së granteve, duke përfshirë aktorët përkatës, shërbimet e ekstensionit, sektorin e bankave dhe autoritetet rajonale dhe lokale. Procesi i aplikimit gjatë thirrjes së parë për propozime sipas skemës së granteve të IPARD deri më tani ka treguar interes të madh nga fermerët dhe industria e përpunimit të ushqimit për të aplikuar për mbështetje. Numri total i aplikimeve të marra në thirrjen e parë ishte 84, nga të cilat 50 nga fermerë dhe 34 nga sektori i përpunimit të ushqimit. Thirrja e dytë për aplikime u shpall në prill 2013. Në shtator 2013 u nënshkruan kontratat e para me aplikuesit e suksesshëm. Sipas rezultateve fillestare të zbatimit të skemës së granteve, madhësia mesatare e projekteve të investimit të mbështetura në kuadër të masës 1 “Investime në nivel ferme” është 20 000 euro, ndërsa për masën 2 “Investime në përpunimin dhe tregtimin e produkteve” 100 000 euro. Thirrja e tretë për propozime është duke u përgatitur dhe do të shpallet në gjysmën e parë të vitit 2014.

Zbatimi i skemës së granteve do t'i japë AZHBR-së eksperiencë praktike në menaxhimin e aplikimeve, nënshkrimin e kontratave, menaxhimin e kërkesave për pagesa dhe testimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit. Mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të skemës po përdoren në përgatitjen e programit IPARD për periudhën 2014–2020.

Progres i mirë është arritur në përgatitjen e programit IPARD II. Bazuar në prioritetet dhe masat e zgjedhura të SNZHRB -së për zhvillimin bujqësor në periudhën 2014–2020, drafti i parë i programit IPARD II u përgatit dhe dërgua për konsultim me shërbimet DG Agri në dhjetor të vitit 2013. Gjithashtu, është përgatitur një plan i detajuar veprimi dhe një kalendar për zbatimin e prioriteteve të SNZHRB-së dhe masave për zhvillimin rural, të cilët presin miratimin pas miratimit të SNZHRB-së aktuale.

Megjithatë, nevojiten ende përpjekje të rëndësishme shtesë për të përfunduar përgatitjen për akreditimin e të gjithë Sistemit të Menaxhimit

dhe Kontrollit IPARD, përfshirë Zyrtarin Kombëtar Autorizues, Fondin Kombëtar, Organet Teknike dhe Autoritetin e Auditimit.

Aktivitete të mëtejshme janë planifikuar për të rritur kapacitetet institucionale të MBZHRAU-së dhe AZHBR-së nëpërmjet zhvillimit të Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (SIK) për të përmbushur kërkesat e BE-së.

Komponentët kryesorë të këtyre aktiviteteve janë si vijon:

- Krijimi i sistemit të identifikimit të parcelave të tokës (LPIS);

- Krijimi i regjistrit të plotë të fermave;

- Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave të zbatimit të masave për zhvillimit rural.

Këto aktivitete planifikohet të fillojnë në vitin 2014.

Në fushat e përafrimit të legjislacionit për futjen e mekanizmave dhe rregullave të organizimit të tregut të përbashkët (CMO) është miratuar së fundmi një ligj i rëndësishëm. ligji nr. 87/2013 “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërësive të ullirit” hyri në fuqi në shkurt 2013 me objektiv kryesor krijimin e rregullave për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërësive të ullirit në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të përshtaten kërkesat dhe standardet e tregut ndërkombëtar.

Ky ligj i afrohet rregullores së Këshillit Evropian 1234/2007, datë 22 tetor 2007 dhe rregullores implementuese të Komisionit nr. 29/2012, datë 13 janar 2012.

Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të vazhduar përafrimin e legjislacionit në fushat e CMO-së, politikës së cilësisë, bujqësisë organike dhe në ngritjen e kapaciteteve për të zbatuar legjislacionin e ri. Me ndryshimet e fundit organizative të MBZHRAU-së, është ristruktur edhe Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare. Drejtoria është përgjegjëse për një numër të madh çështjesh të politikave - pagesat direkte/skemat kombëtare të mbështetjes, politika e burimeve të peshkimit, shërbimet e ekstensionit dhe informacioni bujqësor, politika e promovimit të produkteve bujqësore. Brenda drejtorisë një sektor për politikën e marketingut dhe të cilësisë do të jetë përgjegjës për CMO-në, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike. Drejtoria do të jetë



përgjegjëse për përafrimin e legjislacionit në fushat e pagesave direkte, CMO-ve, politikës së cilësisë, bujqësisë organike, si edhe për zbatimin e kërkesave të sapomiratuara ligjore. Gjithashtu, drejtoria është përgjegjëse për funksionimin e duhur të shërbimeve të ekstensionit. Është e qartë se për përmbushjen e funksioneve nevojitet stafi i duhur i drejtorisë.

Procesi i përgatitjes/rishikimit të planit të përafrimit në kapitullin 11 bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve administrative dhe planifikimin e ngritjes së kapaciteteve (punësimi i stafit, trajnimi) në mënyrë që të sigurohet zbatimi i legjislacionit të sapomiruar.

Çështjet e tokës dhe krijimi i kushteve për përdorimin e duhur dhe efikas të tokës në mënyrë që të kapërcehen efektet negative të fragmentimit të tokës, përfshirë miratimin e legjislacionit e ri dhe krijimin e regjistrit të saktë të tokës, janë një prioritet i lartë për qeverinë.

Regjistrimi fillestar i titujve të pronësisë për tokën bujqësore, i cili u realizua nga Zyra Qendrore e Regjistrimit dhe Pasurisë së Paluajtshme (ZQRPP), deri në fund të vitit 2012 u krye në 2511 zona kadastrale rurale ose në 86% të totalit të tyre.

Reformimi dhe përditësimi i kadastrës së tokës ishte i nevojshëm pas privatizimit të tokës bujqësore, i cili shkonte në 80% të sipërfaqes totale, për të reflektuar ndryshimet në llojet e të drejtave të pronësisë.

Për të trajtuar këtë situatë, MBZHRAU filloi zbatimin e programit “Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore” në vitin 2009, financuar nga buxheti i shtetit. Programi ka dy objektiva kryesore:

- Përgatitjen dhe plotësimin e Regjistrit të Tokës Bujqësore si parashikohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 532, datë 31.10.2012. Regjistri plotësohet në përputhje me dispozitat e urdhrit të përbashkët nr. 107, datë 27.03.2009 të ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të ministrit të Brendshëm. Në fund të vitit 2012, 1046 zona kadastrale rurale nga 2920 zona në total i kishin futur të dhënat në këtë regjister.

- Krijimi i sistemit të informimit mbi tokën (LIS) dhe integrimi në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS). Deri në fund të vitit 2013, një total prej rreth 180 000 ha tokë (nga të cilat 90 000 ha tokë bujqësore) janë përfshirë në LIS. Të dhënat nga LIS-ja do të përdoren në procesin e krijimit të

sistemit të identifikimit të parcelave të tokës (LPSI).

Një projekt konsolidimi i tokës po zbatohet me ndihmën e FAO-s me objektiv kryesor krijimin e një Strategjie Kombëtare për Konsolidimin e Tokës. Strategjia është përgatitur dhe pret miratimin pas miratimit të SNZHRB-së aktuale.

Për të mbështetur bashkëpunimin ndërmjet fermerëve për rritjen e përdorimit të tokës bujqësore, u miratua në vitin 2012 ligji “Për bashkëpunimin bujqësor”, i cili paraqet kuadrin ligjor për krijimin e kooperativave bujqësore. Në këtë kontekst, shërbimet këshillimore ndërmorën një fushatë të gjerë informimi dhe ofruan materiale mbështetëse për fermerët për të lehtësuar krijimin e kooperativave.

Deri më tani rezultatet kanë qenë të limituara për shkak të mungesës së interesit dhe shqetësimeve midis fermerëve për rreziqet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në kooperativa të tilla. Baza ligjore do të zhvillohet më tej duke përfshirë dispozita për krijimin e grupeve të prodhuesve.

1.7.2 Siguria ushqimore, çështjet veterinarë dhe fitosanitare

Qeveria shqiptare i konsideron politikat për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit si një prioritet i rëndësishëm. Këto politika janë nën përgjegjësinë e MBZHRAU-së, e cila është përgjegjëse për krijimin e kuadrit ligjor dhe koordinimin e harmonizimit të legjislacionit me kuadrin ligjor të BE-së.

Në fushën e sigurisë së ushqimit, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare, janë adoptuar në legjislacionin kombëtar më shumë se dyqind ligje të BE-së dhe janë ndërmarrë disa hapa madhorë.

- Miratimi i ligjit “Për ushqimin”, nr. 9863, në vitin 2008, i cili është i harmonizuar në mënyrë të konsiderueshme me *acquis* të BE-së në fushat e sigurisë së ushqimit. Mbi këtë ligj është krijuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, i cili u bë funksional më 1 shtator 2010. Bazuar në ligjin “Për ushqimin”, legjislacioni dytësor është përshtatur në linjë me kërkesat e BE-së. Legjislacioni aktual që ka të bëjë me sigurinë ushqimore në Shqipëri është pjesërisht në linjë me dispozitat e BE-së, konkretisht Paketa e Higjienës Ushqimore. Si rrjedhojë, duhet të kryhet një rishikim i legjislacionit kombëtar, duke marrë parasysh mundësinë për t’u bërë një shtet anëtar i BE-së në të ardhmen.



- Miratimi i ligjit nr. 10465 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” në vitin 2011, i cili ia transferoi shërbimit veterinar përgjegjësitë për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve. Bazuar në ligjin “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin “Për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, janë miratuar disa nënakte ligjore, duke paraqitur kërkesat e BE-së në fushën veterinare, të tilla si rregullorja për kontrollin e sëmundjeve të kafshët, rregullorja për kontrollin e sëmundjeve zoonotike, rregulloret për krijimin dhe funksionimin e sistemit të identifikimit të kafshëve, rregulloret për mirëqenien e kafshëve dhe rregullorja për kushtet e tregtimit kombëtar dhe ndërkombëtar të të gjitha kafshëve.

- Aktivitetet fitosanitare bazohen në ligjin nr. 9362 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve” që nga viti 2005, ndryshuar në vitin 2008 me ligjin nr. 9908. Në kuadrin e ligjit të ndryshuar “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, legjislacioni dytësor është miratuar në përputhje me direktivën e BE-së për mbrojtjen e bimëve (kryesisht të dy direktivave bazë 1000/29 dhe 91/414).

Menaxhimi i sigurisë ushqimore, politikave veterinarë dhe fitosanitare

Aktualisht autoritetet kompetente të përfshira në menaxhimin e politikave të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare në Shqipëri janë:

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe institucionet nën vartësinë e saj, përkatësisht:

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit,
- Instituti i Sigurisë së Ushqimit dhe Veterinarisë,
- Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë,
- Ministria e Shëndetësisë,
- Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës,
- Qeverisja vendore.

Në lidhje me fushat e sigurisë ushqimore, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Bujqësore dhe Peshkimit e MBZHRAU-së ushtron përgjegjësinë me anë të drejtorive të mëposhtme:

- Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit (e cila merret me sigurinë ushqimore, çështjet fitosanitare dhe ato të peshkimit);
- Drejtoria e Veterinarisë (e cila merret me çështjet veterinarë).

Për më tepër, në zbatimin e legjislacionit nën kompetencën e MBUMK-së në nivel rajonal/qarku janë përfshirë dymbëdhjetë drejtoritë rajonale të Bujqësisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Bujqësore dhe Peshkimit përbëhet nga 6 persona dhe është e organizuar në dy sektorë:

- Sektori i sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore dhe çështjeve fitosanitare është përgjegjës për politikën, strategjitë dhe legjislacionin për sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore dhe për çështjet e mbrojtjes së bimëve;

- Sektori i peshkimit dhe produkteve ujore është përgjegjës për sektorin e peshkimit, përfshirë miratimin e stabilimenteve të peshkimit, klasifikimin e zonave të prodhimit të molusqeve bivalvore dhe monitorimin e planeve për marrjen e kampionëve të tyre.

Autoriteti veterinar përgjegjës është Drejtoria Veterinarë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Bujqësore dhe Peshkimit, e cila përbëhet nga 5 persona. Përveç përfaqësimit të Shqipërisë në OIE, kjo drejtori është përgjegjës për politikën, strategjitë, legjislacionin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e shërbimeve veterinarë.

Shërbimet veterinarë rajonale janë pjesë e drejtorive rajonale të bujqësisë (DRB) dhe teknikisht i përgjigjen për të gjithë aktivitetin e tyre Drejtorisë së Shërbimeve Veterinarë në MBZHRAU. Shërbimet veterinarë rajonale përbëhen nga 151 veterinerë zyrtarë në 12 rajone, të shpërndarë në përputhje me numrin e kafshëve (varion nga 6 në 20 veterinerë zyrtarë për rajon).

Veterinerët privatë (500) kontraktohen nga DRB për të kryer aktivitete veterinarë si fushatat e vaksinimit për programet kombëtare dhe matrikullimi i kafshëve në përputhje me legjislacionin.

Për më tepër, specialistët e mbrojtjes së bimëve, si pjesë e DRB-së, janë përgjegjës për këshillimin, informimin dhe edukimin e fermerëve mbi çështjet e mbrojtjes së bimëve.

Bazuar në legjislacionin aktual për veterinarinë dhe ushqimin në Shqipëri, detyrat dhe kompetencat e Shërbimeve Veterinarë Shtetërore të MBZHRAU-së kryhen në nivel ferme, duke u fokusuar vetëm në prodhimin primar. Pasi dalin



nga ferma, produktet primare janë nën kompetencën e shërbimeve të inspektimit të AKU-së.

AKU-ja është një organ publik, i cili i raporton Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit që lidhet me sigurinë e ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit. AKU-ja përbëhet nga tre drejtori në nivel qendror dhe 12 drejtori rajonale. AKU-ja ka një total prej 423 punonjësish.

AKU-ja është një nga autoritetet kompetente përgjegjëse për sigurinë ushqimore në Shqipëri dhe operon në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe në nivel rajonal nëpërmjet 12 drejtorive rajonale të AKU-së. 13 Pikat e kontrollit të kufirit (PKK) nën drejtoritë rajonale të AKU-së janë përgjegjëse për kontrollin e bimëve dhe produkteve bimore, gjësë së gjallë, nënprodukteve të kafshëve dhe ushqimit me prejardhje shtazore dhe joshtazore në kufi.

AKU-ja është përgjegjëse për zbatimin në terren me anë të inspektorëve të tij të ushqimit. Në nivel rajonal, AKU-ja ka ngritur një strukturë të kontrollit territorial për sigurinë e ushqimit, e vendosur në 12 rajonet administrative. Inspektorët e ushqimit janë përgjegjës për produktet ushqimore me prejardhje shtazore dhe joshtazore. AKU-ja është gjithashtu përgjegjëse për kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore të importuara, të prodhuara dhe tregtuara në vend dhe të lëndëve të para të përdorura në industrinë e ushqimit. Inspektorët e sigurisë ushqimore janë të vendosur në pikat e kontrollit kufitar dhe pikat e kontrollit doganor.

Përgjegjësitë kryesore të AKU-së janë si vijon:

- Drejton procesin e vlerësimit të rrezikut në fushën e ushqimit dhe ushqimeve të kafshëve, mbrojtjes së bimëve dhe mbrojtjes së shëndetit të kafshëve;

- Kryen studimet shkencore të nevojshme mbi vlerësimin e rrezikut për sigurinë e ushqimit dhe ushqimeve të kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe të shëndetit të kafshëve;

- Përgatit opinione shkencore paraprake për nxjerrjen në treg të OMGJ-ve dhe/ose produkteve të tjera të reja ushqimore;

- Informon publikun mbi sigurinë e ushqimit dhe ushqimeve të kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe të shëndetit të kafshëve;

- Ofron mbështetje teknike, administrative dhe shkencore për të siguruar aktivitetin e komitetit shkencor.

AKU-ja menaxhon 11 laboratorë rajonale, të cilët kryejnë analiza të sigurisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore. Ngritja e kapaciteteve për të përmirësuar zbatimin e standardeve kombëtare dhe për t'u përgatitur për zbatimin e standardeve të BE-së është në proces në AKU.

Administratat bashkiake përfshijnë, si pjesë e stafit të tyre, inspektorë veterinarë të bashkisë dhe komunave të cilët janë të autorizuar të ushtrojnë kompetencat e tyre në terren në përputhje me nenin 54 të ligjit “Për shërbimin veterinar”.

Veterinerët bashkiakë kanë detyrat e mëposhtme:

- Kryerja e kontrolleve veterinarë në pikat e therjes së mishit, thertore dhe kasapë;

- Kryerja e inspektimit para dhe pas therjes;

- Vendosja e vulës shëndetësore në karkasën e kafshës;

- Lëshimi i certifikatave veterinarë që shoqërojnë mishin dhe produktet shtazore;

- Lajmërimi i autoriteteve kompetente për sigurinë ushqimore dhe shërbimet veterinarë mbi shkeljet dhe parregullsitë e akteve ligjore, ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme.

Rreth 63 bashki kanë staf të Shërbimit Veterinar, i cili është në përpjesëtim të drejtë me nevojat dhe madhësinë e bashkisë.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për shëndetin publik, ushqyerjen dhe kontrollin e ujit dhe produkteve ushqimore specifike (qëllime ushqyese).

Zbatimi i legjislacionit për shëndetin publik dhe ushqyerjen kryhet nga inspektorët shëndetësorë, të cilët janë përgjegjës për lëshimin e certifikatave shëndetësore për punëtorët në industri, inspektimin e mjedisit të punës dhe kontrollin e ujit deri te konsumatori përfundimtar (uji në stabilimentet përpunuese është nën kompetencën e AKU-së). Për më tepër, inspektorët sanitarë kryejnë kontrolle brenda kompetencës së tyre në PKK.

Progresi i arritur dhe sfidat e identifikuara për sa i përket sigurisë ushqimore, çështjeve veterinarë dhe fitosanitare

Gjatë vitit 2010, AKU-ja filloi aktivitetet inspektuese në fushën e kontrollit të ushqimit dhe ushqimeve të kafshëve, si dhe në PKK. Rezultatet e inspektimeve, së bashku me të



dhënat e përgjithshme të grumbulluara nga Drejtoritë Rajonale të AKU-së mbi operatorët e industrisë ushqimore në territoret e tyre janë hedhur në bazën e të dhënave “AKU-net”.

Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave në secilin hap të zinxhirit të kontrollit, duke mbuluar të gjithë zinxhirin nga niveli qendror në atë lokal, është thelbësor për organizimin e një sistemi eficient të kontrollit të ushqimit. Aktualisht është krijuar një sistemi IT-je për mbledhjen e të dhënave zyrtare të kontrolleve. Afërsisht 19 890 stabilimente ushqimi janë regjistruar në bazën e të dhënave të AKU-së. Sistemi është funksional, por ende nuk është i plotë. Mungojnë ende disa procedura dhe të dhënat e futura mbi klasifikimin e ndërmarrjeve duhet të rishikohen në përputhje me sistemin e klasifikimit të BE-së. Një problem tjetër është që vetëm një pjesë e inspektorëve në terren është trajnuar mbi përdorimin e sistemit dhe janë bërë përpjekje për të rritur përdorimin e tij dhe cilësinë e të dhënave të futura.

Në fushën e aktiviteteve të kontrollit, pika kryesore e vëmendjes është uniformiteti i inspektimeve – disponueshmëria dhe përdorimi i udhëzimeve për kontrollet zyrtare, si dhe të gjitha aktivitetet e kontrolleve zyrtare duhet të prioritetizohen sipas qasjes së bazuar te rreziku në të gjitha nivelet. Në këtë aspekt, nevojitet logjistikë dhe burime financiare shtesë për inspektorët.

Është bërë progres në fushat e vlerësimit të rrezikut, kryer nga AKU-ja, dhe të menaxhimit të rrezikut, kryer bashkërisht nga AKU-ja dhe drejtoria përgjegjëse e MBZHRAU-së. Megjithatë, në vend duhet ende të përgatitet një plan kontrolli shumëvjeçar dhe planet vjetore të kontrolleve në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjes së shëndetit të kafshëve dhe bimëve duhet të rishikohen në mënyrë që të jenë në përputhje të plotë me dispozitat e BE-së.

Sistemi i regjistrimit dhe miratimit të stabilimenteve ushqimore është pjesë e sistemit të përgjithshëm, përcaktuar nga ligji nr. 1081/2009 “Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”. Ka ende mangësi të cilat duhet të trajtohen. Jo të gjitha stabilimentet ushqimore janë të regjistruara dhe, sipas bazës ligjore, vetëm stabilimentet ushqimore të regjistruara janë subjekt i kontrolleve. Shqetësimi kryesor në këtë aspekt

është sistemi i të ashtuquajturave “pika të therjes” (thertore, shumë shpesh në oborrin e shtëpisë ose pranë rrugëve), shumë prej të cilave punojnë në mënyrë të paligjshme pa asnjë autorizim.

Në fushën e sigurisë ushqimore, menaxhimi i mbetjeve është një shqetësim serioz. Në këtë aspekt, një problem i madh mjedisor në Shqipëri është mungesa e impianteve ricikluese. Ka një nevojë të theksuar për përmirësimin e mbrojtjes mjedisore duke ndërtuar impiante ricikluese, duke investuar në pajisje dhe ambiente për ripërpunimin e produkteve të ndërmjetme dhe mbetjeve, trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve, dhe objekte për ujërat e përdorura në thertore dhe pajisje për ndarjen e yndyrave në stabilimentet e përpunimit të mishit.

Progres i mirë është bërë në fushën e planifikimit të kontigjencave për shëndetin e kafshëve dhe përpunimin e strategjisë së kontrollit për sëmundjet kryesore infektive. Programi kombëtar për profilaksinë veterinare u miratua dhe filloi zbatimin e vaksinimit të kafshëve kundër antraksit, vaksinimit të bagëtive të imëta kundër brucelozës, si dhe vaksinimit kundër gripit të derrave. Programi kombëtar mbulon gjithashtu kontrollin e tuberkulozit të gjedhit duke përdorur metodën në lëkurë, kontrollin serologjik të brucelozës së gjedhit dhe kontrollin për sëmundjen e tërbimit.

Është krijuar një sistem identifikimi për delet dhe dhitë. Është krijuar gjithashtu një rrjet kompjuterik kombëtar në internet, për sistemin RUDA për regjistrimin e kafshëve dhe raportimin e sëmundjeve dhe janë lidhur të gjitha rrethet. Kjo përbën një hap të madh përpara në mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve.

Progres i kënaqshëm është arritur në krijimin e regjistrimit për fermat blegtorale, identifikimin e gjedhëve dhe bagëtive të imëta dhe përditësimin e bazës së të dhënave për kontrollin e lëvizjes së kafshëve.

Deri tani është regjistruar afërsisht 95% e numrit total të fermave blegtorale. Procesi i regjistrimit/përditësimin të fermave vazhdon gjatë aktiviteteve veterinare në terren.

Së fundmi në fushën e mbrojtjes së bimëve ka filluar kryerja e një analize sistematike të produkteve për mbrojtjen e bimëve (p.sh. pesticidet) në laboratorin e referencës në Institutin e Sigurisë së Ushqimit dhe Veterinar.



Të gjithë fidanët dhe farërat i nënshtrohen analizave fitosanitare në laboratorët e mbrojtjes së bimëve, të cilët gjenden në Durrës.

Baza e të dhënave për bimët dhe origjinën e produkteve bimore është funksionale. Megjithatë, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të sistemeve për sa i përket mirëmbajtjes, aksesit dhe qëndrueshmërisë.

Detyrat kryesore në fushën fitosanitare janë të lidhura me finalizimin e regjistrimit dhe krijimin e një regjistri të plotë të të gjitha produkteve dhe tregtarëve të farërave dhe fidanëve. Një tjetër detyrë e rëndësishme është identifikimi dhe krijimi i zonave të pastra për bimët mëmë.

Analiza e fundit e mangësive të sistemit të sigurisë së ushqimit, përgatitur nga MBZHRAU, tregon që ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të sistemit ekzistues – si duke rishikuar dhe ndryshuar bazën ligjore, ashtu edhe duke përmirësuar koordinimin dhe alokimin e detyrave dhe përgjegjësive. Ekziston nevoja për bashkëpunim dhe komunikim më të mirë midis autoriteteve kompetente të sistemit të sigurisë së ushqimit në nivel qendror, si dhe midis autoriteteve qendrore dhe zyrave lokale përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit.

Me ristrukturimin e fundit të MBZHRAU-së, qeveria e re mori një vendim të rëndësishëm në lidhje me sektorin e peshkimit, përkatësisht për të konsoliduar çështjet e peshkimit në MBZHRAU. Më këtë vendim u plotësua një mangësi e madhe në lidhje me produktet e peshkimit dhe akuakulturës. Përpara vitit 2013 përgjegjësitë e sektorit ndaheshin midis dy ministrive – Ministria e Mjedisit (MM) ishte përgjegjëse për prodhimin e peshkut dhe inspektimet e peshkimit dhe MBZHRAU ishte përgjegjëse për çështjet veterinarë dhe kontrollet e sëmundjeve të peshqve, ndërsa AKU-ja mbulonte produktet e peshkimit/akuakulturës. Me strukturën e re organizative të MBZHRAU-së zbatuar në fund të viti 2013, politika e burimeve të peshkimit është një pjesë e pandarë e Drejtorisë së Politikave Bujqësore dhe Çështjeve të Tregtisë. Brenda Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit është krijuar një sektor i specializuar peshkimi. Gjithashtu, inspektimet dhe kontrollet janë pjesë e AKU-së. Me konsolidimin e përgjegjësive për sektorin e peshkimit brenda MBZHRAU-së, lind nevoja e

përgatitjes dhe zbatimit të një strategjie për zhvillimin e sektorit, bazuar në vlerësimin e mangësive të situatës aktuale dhe në prioritetet për zhvillimin e sektorit në periudhën 2014-2020. Hapat e nevojshëm janë ndërmarrë në vitin 2014 për të filluar përgatitjen e strategjisë së sektorit të peshkimit.

Rrjeti laboratorik

Ka dy laboratorë kombëtarë reference që funksionojnë brenda atij të cilit tani i referohen si Rrjeti i Sigurisë së Ushqimit:

- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarë (ISUV) nën vartësinë e MBZHRAU-së;

- Departamenti (Instituti) i Mbrojtjes së Bimëve në Durrës nën vartësinë e Ministrisë së Arsimit.

Përveç kësaj, në nivel rajonal nën autoritetin e AKU-së punojnë 11 laboratorë të sigurisë ushqimore, 11 laboratorë të shëndetit të kafshëve dhe 7 laboratorë të shëndetit të bimëve. MBZHRAU është përgjegjëse për autorizimin e laboratorëve.

MBZHRAU, bazuar në ligjin “Për ushqimin”, ka emëruar laboratorët nën ISUV si laboratorë reference për secilën analizë që do të kryhet për kontrolle zyrtare të sigurisë ushqimore dhe si laboratorë përgjegjës për:

- Kontrollin mikrobiologjik, kimik dhe toksikologjik të produkteve dhe nënprodukteve me origjinë shtazore të prodhuara apo importuara në vend dhe të atyre për eksport;

- Kontrollin e mbetjeve me të substancave efekt anabolik dhe të paautorizuara, të biopreparateve dhe medikamenteve veterinarë në produktet me origjinë shtazore;

- Kontrollin mikrobiologjik dhe kimik për produktet e peshkimit (histaminë, TVB-N);

- Kontrollin për biotoksina detare në molusqet bivalvore të gjalla;

- Mbikëqyrjen e fitoplanktoneve toksike të mundshme (identifikim, kuantifikim) në ujë deti.

ISUV po implementon sistemin e menaxhimit të cilësisë bazuar në standardin ISO 17025:2005 dhe është miratuar për 6 teste nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe nga një organ i huaj akreditimi (Accredia – organi kombëtar i akreditimit në Itali).

Departamenti i Shëndetit të Kafshëve në ISUV përbëhet nga 6 sektorë: bakteriologjia, virologjia, parazitologjia, mykologjia, epidemio-



logjia veterinare dhe sektori i produkteve mjekësore veterinare. Pjesë e këtij instituti është edhe sektori i prodhimit të vaksinave dhe produkteve biologjike.

Rrjeti i laboratorëve zyrtarë të përfshirë në analizën e ushqimeve me origjinë shtazore dhe joshtazore nuk është përcaktuar nga dispozitat specifike të autoriteteve kompetente dhe plani për specializimin e aktiviteteve të laboratorëve rajonalë për të shmangur mbivendosjen nuk ka përfunduar ende. Analiza e kryer për optimizimin e rrjetit laboratorik tregoi që numri aktual i laboratorëve që operojnë në këtë fushë është ende i tepër i lartë dhe riorganizimi i rrjetit konsiderohet i nevojshëm për shkak të kostove të larta për arritjen dhe ruajtjen e numrit aktual të laboratorëve rajonalë që shërbejnë për të njëjtin qëllim. Pavarësisht progresit të kënaqshëm të arritur në fushën e sigurisë ushqimore, çështjeve veterinare dhe fitosanitare gjatë viteve të fundit, shumë çështje mbeten ende për t'u zgjidhur. Këto çështje janë identifikuar, midis të tjerash, në Raportin e Progresit të KE-së.

Disa prej çështjeve kryesore janë:

- Ekziston nevoja për një koordinim dhe bashkëpunim të përmirësuar, përfshirë ndarjen e qartë të përgjegjësisë lidhur me sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve midis autoriteteve përgjegjëse në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

- Zbatimi i standardeve të sapomiratuara të sigurisë së ushqimit, veterinare dhe fitosanitare është i paplotë për shkak të dobësive në kapacitetet e zbatimit të ligjit dhe kapacitetet e pamjaftueshme administrative për të kryer inspektimet dhe kontrollet e nevojshme.

- Ekziston nevoja për të zhvilluar më tej kapacitetet për të inspektuar stabilimentet dhe për të kontrolluar përputhjen me standardet e BE-së në kuadrin e zbatimit të programit IPARD II.

- Ekziston nevoja për t'u siguruar që futja e standardeve të reja të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare t'u japë kohë të mjaftueshme operatorëve privatë për të përmbushur standardet dhe që kapaciteti i nevojshëm për inspektime dhe kontrolle të jetë funksional për të siguruar zbatim efikas.

- Ka nevojë të ndjeshme për zbatimin e legjislacionit për sa i përket grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve të kafshëve.

- Është e nevojshme përgatitja dhe miratimi i strategjisë për zhvillimin e sektorit dhe politikave të peshkimit për periudhën 2014–2020, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve institucionale, rishikimin e planit të përafrimit sipas kapitullit 13 dhe zhvillimin e skemave të mbështetjes

Në kuadër të SNZHBR-së MBZHRAU po përgatit një plan veprimi për përmirësimin e sigurisë ushqimore, çështjeve veterinare dhe fitosanitare. Plani i veprimit bazohet në vlerësimet e mangësive të sistemit aktual të kryera tashmë dhe do të përfshijë propozime për rregullimin/rishikimin e planeve të përafrimit në mënyrë që të arrihet përputhje e plotë me *acquis* e BE-së në vitin 2020, plane për ngritjen e kapaciteteve të menaxhimit dhe inspektimeve të përgjithshme të kontrollit të ushqimit dhe për optimizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të rrjetit laboratorik.

Eksperienca aktuale në MBZHRAU lidhur me përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të *acquis* të BE-së tregon që është e rëndësishme të krijohet një qasje e koordinuar dhe strategjike bazuar te prioritetet në procesin e përafrimit në BE në të gjitha fazat – duke filluar nga shkrimi i planeve ligjore për përafrimin, duke vazhduar gjatë procesit të shkrimit të akteve të reja ligjore dhe përgatitjes së njëkohshme të institucioneve për të zbatuar legjislacionin e ri në mënyrë efektive.

Përpjekja për të vazhduar zhvillimin institucional në linjë me procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së dhe zbatimi i tij do të jetë një prioritet kryesor horizontal për periudhën 2014-2020, në mënyrë që vendi të jetë gati për hyrjen në BE.

Në këtë aspekt, procesi i përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushat e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe politikave të sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare do të përmirësohen duke futur një qasje më të integruar në punën e përafrimit midis dy fushave të politikave, përfshirë një koordinim të përmirësuar brenda dhe ndërmjet ministrive me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës.



2. Vizioni për zhvillimin bujqësor dhe rural deri në vitin 2020

Qeveria shqiptare ka deklaruar qëllimin e saj për t'u bërë shtet anëtar i BE-së. Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor me perspektivën e anëtarësimit në BE përcakton ndërhyrjet strategjike për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri që të jenë të afta të përballen me sfidat e kërkesave të tregut të vetëm evropian dhe për përshtatjen e politikave shqiptare për zhvillimin rural dhe bujqësor sipas PPB-së.

Për këtë arsye, SNZHRB-ja është hartuar në harmoni me parimet kryesore të politikave të ardhshme të BE-së, PPB-në dhe politikën e para-aderimit (IPARD), duke zgjedhur ndërkohë masa politikash që kanë në fokus të tyre trajtimin e problemeve specifike të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri.

Vizioni për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri do të mbështesë dhe zhvillojë kushtet e kuadrit të duhur për një sektor agroushqimor efikas, novator dhe të qëndrueshëm, të aftë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të BE-së përmes një shfrytëzimi të qëndrueshëm të burimeve dhe zonave rurale produktive, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi jetese për banorët në zonat rurale.

Për të arritur këto objektiva të përgjithshme janë përcaktuar këto fusha politikash:

- Ndërhyrje për zhvillimin rural;
- Ndërhyrje kombëtare që lidhen me mbështetjen e të ardhurave të fermerëve, zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe garantimin e shanseve të barabarta;
- Zhvillimi institucional, legjislacioni dhe zbatimi i tij.

Objektivat e matshme kryesore të politikave janë³³:

- Norma e rritjes reale ekonomike e sektorit bujqësor me deri në 5% deri në vitin 2020;
- Rritja e produktivitetit të punës në bujqësi me të paktën 8% në vit për njësi vjetore pune (NJVP)/të punësuar me kohë të plotë në vitin 2020;

- Rritja e produktivitetit të punës në agropërpunim me të paktën 5% në vit për njësi vjetore pune (NJVP)/të punësuar me kohë të plotë në vitin 2020;

- Sjellja e të gjitha fermave dhe e operatorëve agropërpunues të regjistruar në përputhje të plotë me standardet e BE-së deri në vitin 2020;

- Rritja e përmasës mesatare të fermës në të paktën 2,5 ha në vitin 2020; dhe rritja e përmasës mesatare të fermave tregtare në 3,5 ha³⁴.

- Përmirësimi i organizimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet krijimit të 100 shoqatave dhe grupeve të prodhuesve dhe llojeve të ngjashme të bashkëpunimit të fermerëve në vitin 2020;

- Përmirësimi i raportit eksport-import në raport 1:3 në vitin 2020;

- Krijimi i një sistemi institucional të plotë dhe gjithëpërfshirës të MBZHRAU-së, i një kuadri rregullator dhe një sistemi të duhur zbatimi në përputhje me BE-në dhe PPB-në;

- Krijimi i 9000 vendeve pune në aktivitetet e përpunimit agroushqimor në periudhën 2012 - 2020;

- Krijimi i 50-100 mikrondërmarrjeve dhe i 500-1000 vendeve të reja pune në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që sjellin të ardhura;

- Krijimi i 5000 vendeve pune në aktivitete jobujqësore dhe shërbime të tjera.

Tri fushat e politikave paraqiten në kapitullin vijues.

3. Politikën kryesore për zhvillimin bujqësor dhe rural

Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020 ofron kuadrin për ndërhyrjet operacionale që nevojiten për të zhvilluar një sektor të qëndrueshëm dhe konkurrues bujqësor dhe të përpunimit të ushqimit dhe për të nxitur një zhvillim ekonomik të ekuilibruar në zonat rurale, duke shtruar rrugën drejt integritit të sektorit bujqësor dhe të agropërpunimit në BE si një bazë për rritjen e standardeve të jetesës dhe uljes së varfërisë në zonat rurale. SNZHRB është kështu një zhvillim i mëtejshëm i nismave të ndërmarra nga MBUMK në strategjitë aktuale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2007-2013 ndërthurur me sektorë të tjerë që lidhen me zhvillimin rural dhe bujqësor.

³³ Të dhënat bazë gjenden në shtojcën A. Objektivat janë përcaktuar nga MBZHRAU.

³⁴ Në përmasën e fermës përfshihet edhe sipërfaqja e marrë me qira afatgjatë.



Objektivat SNZHRB-së do të arrihen nëpërmjet një numri masash mbështetëse dhe nga disa veprime kombëtare të përzgjedhura kryesisht për plotësimin e masave të financuara nga Programi për Zhvillimin Rural IPARD II dhe për të krijuar kushtet kuadër rregullatore dhe institucionale të nevojshme për përshtatjen e sektorit me konkurrencën e re ndërkombëtare.

SNZHBR-ja ngrihet mbi dy parime themelore:

- Mbështetja financiare vihet në dispozicion të sektorit të bujqësisë dhe të agropërpunimit dhe të operatorëve në zonat rurale, me qëllim që ata të ristrukturojnë dhe modernizojnë prodhimin e tyre, të rrisin konkurrueshmërinë, të garantojnë një shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve dhe të krijojnë mundësi alternative të ardhurash.

- Mbështetja vihet në dispozicion të fermerëve dhe të operatorëve në sektorin agropërpunues që përmbushin kërkesat rregullatore kombëtare. Kjo gjithashtu nënkupton që fermerët dhe operatorët agropërpunues janë të regjistruar në regjistrin e fermave, në regjistrin e kafshëve dhe në regjistrat e tjerë përkatës.

Mbështetur mbi këto dy parime dhe nëpërmjet bashkëfinancimit të ndërhyrjeve thelbësore, zbatimi i strategjisë do të kontribuojë në zhvillimin në Shqipëri të një sektori rural dhe bujqësor konkurrues dhe ekonomikisht të suksesshëm.

Me qëllim që të lehtësohet procesi i integritimit në BE, politika për zhvillimin rural dhe bujqësor në Shqipëri do të hartohet dhe zbatohet në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Masat e reja mbështetëse do të hartohen në përputhje me parimet e kuadrit të politikave të BE-së për PPB-në, e politikës të paraanëtarësimit dhe zhvillimit rural për periudhën 2014-2020.

- Masat mbështetëse kombëtare që nuk janë plotësisht në përputhje me masat e ngjashme mbështetëse të BE-së do të eliminohen në mënyrë graduale, paralelisht me futjen e masave të reja dhe nuk do të ketë më masa të reja mbështetëse kombëtare që nuk përputhen me PPB-në.

Zbatimi i masave do të planifikohet për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe, aty ku është e mundur, për periudhën afatgjatë. Këto afate janë përcaktuar si më poshtë:

- Afatshkurtër: 2014 – 2015
- Afatmesëm: 2016 – 2020
- Afatgjatë: pas vitit 2020

3.1 Politika e zhvillimit rural

Fusha e politikave për zhvillimin rural është hartuar për të trajtuar nevojat për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe atij rural në Shqipëri, për të përmirësuar performancën e tyre ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale dhe në këtë mënyrë për t'i përgatitur këta sektorë për anëtarësimin e ardhshëm në BE.

Masat e zgjedhura konsiderohet se trajtojnë të gjitha sfidat e identifikuar në kapitullin 1. Edhe pse instrumenti IPARD II konsiderohet si instrumenti kryesor për financimin e politikave të zhvillimit rural në Shqipëri, do të ketë disa sfida kyçe për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe të zonave rurale në Shqipëri, të cilat mund të mos përfitojnë ose mund të mos bëhen pjesë e programit për zhvillim rural financiar nga IPARD II.

Qëllimi është që këto sfida të trajtohen ose nga skemat kombëtare ose nëpërmjet financimit nga donatorë të tjerë dhe do të përshkruhet në seksionin 3.2 të strategjisë. Ky dallim do të identifikohet gjerësisht gjatë përshkrimit më poshtë të masave.

Masat që do të zgjidhen për bashkëfinancim me fondet e BE-së të ofruara nga komponenti IPARD II do të zbatohen në përputhje të plotë me rregulloren e IPA II, me programin IPARD që është rënë së fundmi dakord me KE-në, si dhe në përputhje me Vendimin për transferimin e menaxhimit të projekteve në strukturat shqiptare të zbatimit të tyre.

3.1.1 Përmirësimi i produktivitetit të fermës dhe i konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe agropërpunimit, ndërkohë që bëhet harmonizimi progresiv me standardet e Bashkimit Evropian

Objekivi është zhvillimi i një prodhimi ushqimor të qëndrueshëm dhe me cilësi nëpërmjet zhvillimit të një sektori agroushqimor konkurrues dhe novator, të aftë për të përballuar presionin e konkurrencës në tregjet e brendshme dhe të BE-së, si dhe që të përmbushë standardet dhe kërkesat e tregut të BE-së.

Kjo do të arrihet nëpërmjet lehtësimit të ristrukturimit të sektorit bujqësor, përmirësimit të përdorimit të tokës dhe fuqizimit të pjesëmarrjes dhe orientimit në treg, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë te:

- Zhvillimi i pjesës ekonomikisht më produktive të sektorit parësor dhe të sektorit



agropërpunues përmes përmirësimit të metodave dhe ambienteve të prodhimit, përmirësimit të cilësisë së produkteve, si dhe përmbyshjes së standardeve të BE-së. Kjo do të arrihet nëpërmjet investimeve në ferma, në përpunimin ushqimor dhe marketing, si dhe në zhvillimin e një zinxhiri furnizimi efikas;

- Sektorët bujqësorë me potencial për prodhimin e produkteve cilësore konkurruese;

- Optimizimi i përdorimit të burimeve bujqësore nëpërmjet promovimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit dhe shoqatave për shfrytëzimin dhe menaxhimin efikas të tokës dhe burimeve bujqësore. Kjo do të arrihet nëpërmjet lehtësimit të krijimit të grupeve të prodhuesve dhe rritjes së bashkëpunimit midis aktorëve kryesorë në zinxhirin agror ushqimor.

Konkurrueshmëria e sektorit bujqësor dhe e sektorit të agropërpunimit në Shqipëri është rritur gjatë viteve të fundit, por megjithatë ekziston ende një diferencë e madhe krahasuar me ato të shteteve të tjera evropiane. Prioriteti kryesor i kësaj strategjie është rritja e konkurrueshmërisë. Rritja e konkurrueshmërisë³⁵ së sektorit dhe e qëndrueshmërisë së fermave³⁶ do të mbështetet nëpërmjet masave të mëposhtme të përzgjedhura sipas parimeve për masa të ngjashme, të cilat konsiderohen si të pranueshme nga komponenti IPA II dhe rregulloret e BE-së për zhvillimin rural 2014-2020.³⁷

Masa 1: Investimet në asetet fizike të fermave

Objektivi i kësaj mase është:

- Të përmirësojë performancën e përgjithshme të fermave për prodhimin e produkteve bujqësore parësore;

- Të ndihmojë fermerët të adoptojnë standardet e BE-së lidhur me sigurinë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve;

Për çdo sektor do të zhvillohen dhe identifikohen objektiva specifike në programin e zhvillimit rural.

Ata që përfitojnë nga zbatimi i kësaj mase do të jenë fermerët ekonomikisht të qëndrueshëm dhe subjekte të tjera juridike (p.sh. ndërmarrjet private bujqësore, grupet e prodhuesve etj.), përgjegjës për kryerjen dhe financimin e investimeve në ferma (siç përkufizohen nga legjislacioni vendas dhe që përfshihen në regjistrin kombëtar të fermave ose regjistra të tjerë përkatës). Përfituesit duhet të veprojnë në pajtim me kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse kombëtare.

Shpenzimet e pranueshme do të kufizohen në:

- Ndërtimin dhe përmirësimin e pasurisë së paluajtshme;

- Blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshirë programe kompjuterike deri në vlerën e tregut.

Sektorët e mëposhtëm konsiderohen si sektorë prioritarë me mundësi zhvillimi të prodhimit konkurrues të produkteve cilësore për tregun vendas dhe tregjet e eksportit:

- Sektori i frutave dhe perimeve, përfshirë ullinjë, vajin e ullirit, rrushin dhe verën;

- Bimët aromatike-mjekësore dhe arrorët;

- Sektorët e mishit dhe bulmetit, me përparësi për produktet nga bagëtitë e imëta;

- Blegtoria;

- Mjalti.

Ndërhyrjet në zbatim të kësaj mase do të mbështeten kryesisht nga masat e programit IPARD II, por për veprimet që nuk përfitojnë nga programi IPARD II mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet skemave kombëtare, në mënyrë që këto ndërhyrje të jenë të plota.

Masa është për zbatim në periudhën afatshkurtër, praktikisht sapo instrumenti IPARD të jetë gati për zbatim.

Masa 2: Mbështetja për ngritjen e grupeve të prodhuesve

Objektivi është nxitja e zhvillimit të konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sektorit agror ushqimor nëpërmjet nxitjes së krijimit të grupeve të prodhuesve dhe shoqatave të bashkëpunimit bujqësor për të përmirësuar cilësinë dhe planifikimin e prodhimit, trajtimin dhe tregtimin e sasive të mëdha dhe rritjen e aftësive negociuese të prodhuesve në lidhje me çmimin.

³⁵ Konkurrueshmëria matet si përqindje e një produkti të caktuar në një treg të caktuar në një kohë të caktuar.

³⁶ Produktiviteti i fermës përkufizohet si niveli i të ardhurave bruto i të paktën 3 njësisive të madhësisë ekonomike = 3600 Euro në vit për familje për tre vitet e mëparshme. Mund të zgjidhen edhe përkufizime të tjera!

³⁷ Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 dhjetor 2013 për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (FEBZHR) dhe shfuqizimi i Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1698/2005.



Ndihma do të jepet për të lehtësuar ngritjen dhe funksionimin organizativ të grupeve të prodhuesve në sektorin e bujqësisë me qëllim:

- Përshtatjen e prodhimit dhe të produktit të anëtarëve të grupeve të prodhuesve me kërkesat e tregut;

- Tregtimin e përbashkët të produktit, duke përfshirë përgatitjen për shitje, përqendrimin e shitjeve dhe ofertës për blerësit me shumicë;

- Përshtatjen e prodhimit dhe të produktit të prodhuesve për të përmbushur standardet përkatëse të BE-së;

- Përcaktimin e rregullave të përbashkëta për informacionin rreth prodhimit, me fokus të veçantë vjeljen dhe disponueshmërinë e prodhimit;

- Sigurimin e standardizimit efikas në të gjitha hapat e tregimit dhe dorëzimit të produkteve në zinxhirin ushqimor.

Ndërhyrjet në zbatim të kësaj mase do të mbështeten ose nën programin IPARD II, ose nga një skemë kombëtare.

Masa 3: Investimet në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

Objekti i kësaj mase është mbështetja e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe asetëve fizike, rritja e aftësisë së sektorit agror ushqimor për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut, si dhe ndihma që sektori të përmbushë në mënyrë progresive standardet e BE-së. Masa do të ndihmojë gjithashtu në trajtimin e sfidës së ndryshimeve klimatike, duke nxitur eficientë e shfrytëzimit të burimeve të energjisë dhe energjinë e rinovueshme.

Përfitues do të jenë ndërmarrjet ekonomikisht produktive, të regjistruara dhe të certifikuar apo licencuara për mbledhjen, përpunimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore sipas legjislacionit vendas. Fokus i veçantë do t'u jepet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Shpenzimet e pranueshme do të kufizohen në:

- Ndërtimin dhe përmirësimin e pasurisë së paluajtshme;

- Blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshirë programe kompjuterike deri në vlerën e tregut.

Sektorët e mëposhtëm konsiderohen si sektorë me përparësi me potencial për zhvillimin e prodhimit konkurrues të produkteve cilësore për tregun vendas dhe tregjet e eksportit:

Sektori i frutave dhe perimeve, përfshirë ullinjë, vajin e ullirit, rrushin dhe verën;

Bimët aromatike-mjekësore dhe arrorët;

Sektorët e mishit dhe qumështit dhe bulmetit, me përparësi për produktet nga bagëtitë e imëta.

Ndërhyrjet në zbatim të kësaj mase do të mbështeten kryesisht nga masat e programit IPARD II, por për veprimet (aktivitetet) që nuk përfitojnë nga programi IPARD II mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet skemave kombëtare ose donatorëve të tjerë, në mënyrë që këto ndërhyrje të jenë të plota.

Masa 4: Skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimet

Objekti i kësaj mase është nxitja e zhvillimit të konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sektorit agror ushqimor nëpërmjet integritetit të prodhuesve kryesorë në zinxhirin ushqimor përmes skemave të cilësisë dhe promovimit në tregun vendas.

Struktura aktuale e bujqësisë në Shqipëri (ferma të vogla dhe të fragmentuara) e vështirëson arritjen e konkurrueshmërisë përmes prodhimit në sasi të mëdha. Për këtë arsye, kjo masë do të mbështesë promovimin e produkteve cilësore përmes rritjes së perceptimit për produktet cilësore në të gjitha nivelet e zinxhirit të vlerës, duke filluar nga fermeri, te përpunuesi dhe deri te konsumatori.

Mbështetja nën këtë masë do të mbulojë pjesëmarrjen për herë të parë nga fermerët në:

- Skemat e cilësisë për produktet bujqësore ose ushqimore;

- Skemat e cilësisë për produktet bujqësore ose ushqimore të pranuar sipas kërkesave kombëtare dhe atyre të BE-së.

- Skemat përkatëse të cilësisë përfshijnë produktet organike, produktet me emërtim origjine të mbrojtur (EOM), tregues gjeografikë të mbrojtur (TGJM), si dhe produktet tradicionale lokale.

Ndërhyrjet në zbatim të kësaj mase do të mbështeten nga skemat kombëtare ose nga donatorë të tjerë, sepse këto nuk përfitojnë financim nga IPARD II.

Masa do të zbatohet në periudhën afatmesme, duke nënkuptuar praktikisht sapo kuadri institucional dhe ligjor, përfshirë njohjen e produkteve cilësore, të jetë gati dhe financimi të jetë në dispozicion.



Masa 5: Bashkëpunimi

Objektivi i kësaj mase është rritja e integritit të zinxhirëve të vlerës për të mundësuar bashkëpunimin midis aktorëve individualë, përfshirë bashkëpunimin horizontal. Projektet e bashkëpunimit ofrojnë një mundësi për rritjen e integritit.

Kjo masë do të nxisë forma bashkëpunimi që përfshijnë të paktën dy subjekte. Në mënyrë të veçantë ajo do të nxisë bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm në bujqësi dhe zinxhirin ushqimor dhe bashkëpunimin midis aktorëve të tjerë që mbështesin arritjen e objektivave dhe të prioritetëve të politikave për zhvillimin rural, përfshirë shoqatat ndërsektoriale. Ajo do të nxisë gjithashtu krijimin e grupeve dhe rrjeteve.

Bashkëpunimi do të orientohet në veçanti në llojet e mëposhtme të veprimeve:

-Zhvillimi i produkteve, praktikave, proceseve dhe i teknologjive të reja në sektorin e bujqësisë dhe në sektorin ushqimor;

-Bashkëpunimi midis operatorëve të vegjël për organizimin e proceseve të përbashkëta të punës dhe përdorimin e përbashkët të ambienteve dhe të burimeve;

-Bashkëpunimi horizontal dhe vertikal midis aktorëve në zinxhirin e furnizimit për ndërtimin e platformave logjistike për nxitjen e zinxhirëve të shkurtër të furnizimit dhe nxitjen e tregjeve lokale.

Aktivitetet e mëposhtme mund të kualifikohen për të përfituar mbështetje në zbatim të kësaj mase:

-Studimet e zonave të përfshira, studimet e fizibiliteti, plani i biznesit, plani i menaxhimit të pyjeve ose strategjitë lokale të zhvillimit;

-Nxitja e zonës përmes fasilitimit për të zhvilluar projekte territoriale kolektive. Në rastin e grupeve, nxitja mund të kërkojë edhe organizimin e trajnimit, lidhjen në rrjet të anëtarëve dhe rekrutimin e anëtarëve të rinj;

-Kostot operative të bashkëpunimit;

- Kostot e drejtpërdrejta të projekteve specifike që lidhen me zbatimin e një plani biznesi ose të një strategjie të zhvillimit lokal, përfshirë kostot për aktivitetet promovuese.

Ndërhyrjet në zbatim të kësaj mase duhen mbështetur nga skemat kombëtare ose nga donatorë të tjerë, sepse këto nuk përfitojnë financim nga IPARD II.

Masa do të zbatohet në periudhën afatmesme, duke nënkuptuar praktikisht sapo kuadri

institucional dhe ligjor të jetë gati dhe financimi të jetë në dispozicion.

3.1.2 Objektivat specifike për ripërtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve që varen nga bujqësia dhe pylltaria.

Objektivi është arritja e një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmarrja e veprimeve për klimën me anë të menaxhimit të pyjeve dhe burimeve ujore, si dhe zbatimi i metodave të prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin dhe zbusin ndikimin mbi klimën.

Qëllimi është zbatimi gradual i politikave dhe qasjeve të BE-së për menaxhimin e burimeve natyrore dhe veprimeve për klimën, duke u përqendruar konkretisht në përdorimin e qëndrueshëm të tokës, pyjeve, burimeve ujore dhe menaxhimin e mbetjeve për një periudhë afatshkurtër.

Vëmendje e veçantë në periudhën afatshkurtër do t'i kushtohet zhvillimit të bujqësisë organike dhe aktiviteteve bujqësore, duke ulur trysinë mbi mjedisin, erozionin e tokës dhe ndotjen e ujërave.

Në periudhën afatmesme fokusi do të vijë në rritje në drejtim të integritit të politikave të BE-së, duke përfshirë masat për ripërtëritjen dhe ruajtjen e biodiversitetit, respektimin e kërkesave të “Natura 2000”, zhvillimin e bujqësisë me vlera të larta natyrore dhe përmirësimin e administrimit të ujërave dhe të tokës.

Rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor duhet të shoqërohet me vëmendjen e duhur për natyrën dhe mjedisin. Në këtë kuadër, do të vihet në dispozicion mbështetje për investimet dhe adoptimin/fuqizimin e praktikave bujqësore që kontribuojnë në zhvillimin e sektorit në mënyrë të pranueshme për mjedisin. Gjithashtu, do të bëhet i mundur edhe trajnimi i përshtatshëm i fermerëve dhe i operatorëve të agropërpunimit, shihni seksionin 3.1.4.

Masa 6: Agromjedisi dhe bujqësia organike

Objektivi i kësaj mase është të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve për klimën me anë të zbatimit të metodave të prodhimit bujqësor që janë në pajtim me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, të peizazhit dhe karakteristikave të tij, të burimeve natyrore, diversitetit të tokës dhe atij gjenetik, duke i tejkalluar standardet detyruese përkatëse.

Përveç këtyre, qëllimi është të kontribuojë në përgatitjen e vendeve përfituese për zbatimin në të



ardhmen të pagesave agromjedisore në zbatim të Programit për Zhvillimin Rural për Shtetet Anëtare.

Masa do të fokusohet në dy iniciativa kryesore:

Mbështetja për përdorimin e metodave të prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin (bujqësia organike);

Përgatitja dhe zbatimi i një skeme pilot agromjedisore, duke u fokusuar në një numër të kufizuar zonash pilot me probleme specifike të vazhdueshme për mjedisin, me qëllim fitimin e përvojës për hartimin dhe zbatimin e masave agromjedisore të BE-së.

Skema që ofron mbështetje për përdorimin e metodave të prodhimit organik do të vihen në dispozicion të fermerëve ose të grupeve të fermerëve që përpiqen mbi baza vullnetare t'u kthehen ose të ruajnë praktikën dhe metodat e bujqësisë organike, siç përcaktohen në legjislacionin kombëtar. Pagesat do të bëhen në bazë vjetore dhe përfituesit do të kompensohen plotësisht ose pjesërisht për shpenzimet shtesë dhe të ardhurat e munguara si rezultat i angazhimeve të marra për këtë qëllim.

Skema pilot që ofron mbështetjen për zbatimin e veprimeve pilot agromjedisore do të vihet në dispozicion të fermerëve, ose të grupeve të fermerëve dhe të administruesve të tjerë të tokës, të cilët ndërmarrin mbi baza vullnetare operacione që përbëhen nga një ose më shumë masa agromjedisore të identifikuar në përputhje me nevojat dhe përparësitë specifike lokale, rajonale ose kombëtare. Qëllimi i zbatimit të skemës si një veprim pilot është përgatitja për zbatimin e plotë të veprimeve agromjedisore pas anëtarësimit. Pagesat do të bëhen në bazë vjetore sipas angazhimeve të rena dakord për mbrojtjen e tokës bujqësore.

Ndërhyrjet në zbatim të kësaj mase do të mbështeten kryesisht nën programin IPARD II, por për veprimet që nuk mbulohen nga programi IPARD II mbështetja mund të ofrohet nëpërmjet skemave kombëtare ose të donatorëve të tjerë, në mënyrë që këto ndërhyrje të jenë të plota.

Masa do të zbatohet:

Në periudhën afatshkurtër, për sa i përket skemës që mbështet përdorimin e metodave të prodhimit organik, që në praktikë nënkupton sapo kuadri institucional dhe ligjor të jetë gati dhe instrumenti IPARD të jetë gati për zbatim.

Në periudhën afatmesme, për sa i përket skemës që mbështet zbatimin e veprimeve pilot agromjedisore, që në praktikë nënkupton sapo kuadri institucional dhe ligjor të jetë gati, duke përfshirë përcaktimin e zonave dhe identifikimin e veprimeve agromjedisore që do të ndërmerren dhe kur instrumenti IPARD të jetë gati për zbatim.

Masa 7: Pyllëzimi dhe mbrojtja e pyjeve

Objektivi i kësaj mase është mbështetja e veprimeve për ripërtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve që varen nga bujqësia dhe pylltaria, duke trajtuar kështu edhe sfidën e ndryshimeve klimatike.

Në mënyrë më specifike masa do të fokusohet në:

-Zgjerimin dhe përmirësimin e burimeve pyjore përmes pyllëzimit të tokës me qëllim parandalimin e erozionit, mbrojtjen e burimeve ujore, rritjen e biodiversitetit dhe duke ndihmuar në përshtatjen me sfidat e ndryshimeve klimatike.

-Ripërtëritjen e potencialit të pylltarisë në pyjet e dëmtuara nga zjarri dhe zbatimin e masave parandaluese me qëllim mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, si ofruesi kryesor i shërbimeve të ekosistemit.

Mbështetja mund të ofrohet për pronarët dhe administruesit privatë, gjysmë-publikë dhe publikë të tokave dhe pyjeve.

Masa është për zbatim në periudhën afatmesme, që në praktikë nënkupton sapo kuadri institucional dhe ligjor të jetë gati, duke përfshirë strategjitë /programet përkatëse të pyllëzimit dhe planet për mbrojtjen e pyjeve, dhe sapo instrumenti IPARD të jetë gati për zbatim. Ndërhyrje plotësuese mund të zbatohen me mbështetjen financiare të donatorëve të tjerë.

3.1.3 Objektivi specifik për zhvillimin e ekuilibruar territorial të zonave rurale duke nxitur përfshirjen sociale, reduktimin e varfërisë dhe zhvillimin e ekuilibruar ekonomik në zonat rurale

Objektivi është arritja e një zhvillimi të ekuilibruar territorial në zonat rurale duke nxitur diversifikimin e veprimtarive ekonomike, hapjen e vendeve të reja të punës dhe përfshirjen sociale, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Ky objektivi do të ketë prioritet veçanërisht të lartë për shkak të pozicionit të dobët të zonave rurale në ekonominë e përgjithshme, numrit të madh të personave që jetojnë në zonat rurale dhe



për shkak të rëndësisë së zhvillimit të aktiviteteve ekonomike alternative për të nxitur një zhvillim strukturor të sektorit bujqësor.

Fokusi do të jetë në lehtësimin e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike dhe hapjen e vendeve të punës dhe bizneseve të reja të vogla, përmirësimin e shërbimeve lokale, rinovimin e fshatit dhe infrastrukturës rurale dhe rritjen e aksesit për të përdorur sistemet bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit.

Për t'i përmirësuar këto aktivitete do të bëhen përpjekje të veçanta për të nxitur zhvillimin lokal në zonat rurale nëpërmjet promovimit dhe ndërtimit të kapaciteteve për zhvillimin e qasjeve nga poshtë-lart dhe pjesëmarrjes lokale në planifikim dhe zhvillim në nivel lokal duke zhvilluar Grupet Lokale të Veprimit (GLV).

Zhvillimi rural është një plotësues i rëndësishëm i ristrukturimit të sektorit të bujqësisë dhe agropërpunimit, sepse ai do të mbështesë krijimin e aktiviteteve ekonomike alternative dhe mundësitë për vende pune.

Për t'i fuqizuar këto mundësi, do të ofrohet mbështetje për zhvillimin e iniciativave lokale, përfshirë mbështetjen për zhvillimin e llojeve të specializuara të prodhimit.

Masa 8: Përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale për zhvillimin rural – Qasja "Leader"

Objektivi i zbatimit të qasjes "Leader" është rritja e pjesëmarrjes së popullsisë rurale dhe zhvillimi i shoqërisë civile dhe i dialogut social brenda popullsisë rurale, lehtësimi i qeverisjes së mirë përmes partneriteteve lokale dhe nxitja e punësimit dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Burimet e dedikuara për qasjen "Leader" duhet të kontribuojnë gjithashtu në nxitjen e zhvillimit rural nëpërmjet nismave dhe partneriteteve lokale. Masat duhet të kenë si qëllim rritjen e kapaciteteve të banorëve në zonat rurale dhe të anëtarëve të GLV-ve nëpërmjet trajtimit dhe arsimit për të zhvilluar, organizuar dhe drejtuar GLV-të, si dhe për të përgatitur dhe zbatuar Strategji Lokale për Zhvillim nëpërmjet projekteve lokale.

Qasja "Leader" në nivel programi duhet të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:

-Strategjitë lokale të zhvillimit të bazuara sipas zonave dhe të hartuara për territore rurale rajonale që kanë probleme dhe mundësi të përbashkëta;

-Partneritetet publike-private lokale (GLV-të);

-Qasjen nga poshtë-lart me fuqi vendimmarrëse për GLV-të lidhur me shqyrtimin dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit;

-Zbatimin e strategjisë bazuar në bashkëveprimin midis aktorëve dhe projekteve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë lokale;

-Zbatimin e qasjeve novatore;

-Krijimin e rrjeteve të partneriteteve lokale.

Mobilizimi i burimeve lokale nëpërmjet një procesi zhvillimi bazuar në një zonë të përbashkët do të lehtësohet përmes mbështetjes për :

-Ndërtimin e kapaciteteve dhe veprimet përgatitore, përfshirë trajnimin, fitimin e aftësive, mbështetjen për administrimin dhe vënien në funksion të iniciativave lokale;

-Vënien në funksionim të partneriteteve lokale ndërmjet sektorit privat dhe publik (GLV), aktivitetet ndërgjegjësuere dhe promovuese, si dhe për zbatimin e projekteve të bashkëpunimit.

Masa pritët të zbatohet në periudhën afatshkurtër, duke nisur me ndërtimin e kapaciteteve, fitimin e aftësive dhe hartimin e strategjive lokale të zhvillimit për zbatim të plotë në periudhën afatmesme, pasi të jenë ngritur dhe të jenë njohur GLV. Masa përfiton mbështetje nga programi IPARD II, por mund të plotësohet edhe me mbështetje nga donatorë të tjerë.

Masa 9: Investimet publike në infrastrukturën dhe zhvillimin e zonave rurale

Objektivi është mbështetja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial duke pasur si synim krijimin e kuadrit për rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet zhvillimit të kapitalit fizik në zonat rurale.

Kjo do të arrihet duke ofruar investime në infrastrukturë dhe investime jofitimprurëse, të nevojshme për të arritur zhvillimin ekonomik dhe social dhe për të pëmbushur qëllimet mjedisore në zonat rurale. Veprimet e nevojshme do të përfshijnë investimet në rrugët e komunitetit, aksesin lokal në rrugët me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik lokal, aksesin në tokat bujqësore dhe pyjore, në furnizimin me energji, furnizimin me ujë dhe kanalizime, aksesin lokal në teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit.

Përfituesit nga kjo masë do të jenë komunat dhe qytetet e vogla.

Masa do të zbatohet si një masë me përparësi në periudhën afatshkurtër. Edhe pse kjo masë përfiton nga programi IPARD II, parashikohet



që këto veprime të mbështeten së pari nga donatorë të tjerë.

Masa 10: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit

Objekti i kësaj mase është nxitja e punësimit nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës dhe ruajtjes së vendeve ekzistuese të punës përmes zhvillimit të aktiviteteve të reja të biznesit, duke rritur kështu nivelin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale dhe duke përmbysur trendin aktual të shpopullimit të zonave rurale.

Masa ka si qëllim diversifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në zonat rurale. Këtu përfshihet:

Mbështetja për investimet e vogla në ferma:

-për të bërë të mundur diversifikimin nisur nga prodhimi i zakonshëm blegtoral/bujqësor. Këtu mund të përfshihet prodhimi plotësues ose alternativ, si p.sh. prodhimi i bimëve mjekësore ose erëzave, i bimëve dekorative, kërpudhave, kërmijve, kultivimi i krimbit të tokës, midhjeve, bletaria, akuakultura ose prodhimi i produkteve bujqësore specifike për biokarburantet etj.

-për të filluar aktivitete të tjera ekonomike që nuk lidhen direkt me aktivitetin bujqësor, si p.sh. përpunimi në fermë dhe tregtimi i produkteve të tyre në portën e fermës, agroturizmi dhe veprimet (aktivitetet) shoqëruese (kalërimi, peshkimi, gjuetia), si edhe prodhimi i energjisë së rinovueshme etj.

Investimet e tjera të nevojshme në zonat rurale për të rritur aktivitetin ekonomik, si p.sh.:

- Ofrimi i shërbimeve për fermerët ("rrjeti i makinerive", riparimi i makinerive bujqësore etj.).

- Ofrimi i çdo lloji të shërbimeve të përgjithshme për popullsinë rurale dhe ngritja e qendrave në fshatra, të cilat do të ofronin infrastrukturën për shërbime në zonat rurale, si kopshtet për fëmijët, qendrat e IT-së, strehat për të moshuarit, etj.

- Zejtaria lokale dhe përpunimi në shkallë të vogël dhe tregtimi i produkteve lokale të bujqësisë dhe pylltarisë. Këtu mund të përfshihet përpunimi dhe tregtimi i specialiteteve tradicionale ushqimore ose joushqimore.

Përfitues do të jenë fermerët dhe çdo subjekt tjetër juridik privat (mikro-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla, përfshirë ndërmarrjet artizanale) të ngritura në zonat rurale, përgjegjëse për sipërmarrjen e këtij veprimi.

Masa do të zbatohet si një masë me përparësi në periudhën afatshkurtër. Edhe pse kjo masë përfiton nga programi IPARD II, parashikohet që këto veprime të mbështeten gjithashtu edhe nga donatorë të tjerë.

3.1.4 Transferimi i njohurive dhe novacionit në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale, dhe asistenca për zbatimin e politikave të zhvillimit rural

Objekti është rritja e aftësive e të gjithë aktorëve kryesorë në zonat rurale për të kontribuar në zhvillimin e një sektori bujqësor të qëndrueshëm dhe të komuniteteve rurale të qëndrueshme:

-Duke nxitur transferimin e njohurive dhe novacionin në sektorin bujqësor dhe në zonat rurale nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve këshillimore dhe Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore në mbështetje të fermerëve, prodhuesve të produkteve të akua-kulturës, pronarëve të pyjeve dhe të SME-ve në zonat rurale;

-Duke nxitur të mësuarin gjatë gjithë jetës me anë të trajnimeve profesionale dhe përfutimit të aftësive në zonat rurale;

-Duke forcuar lidhjet midis bujqësisë, akua-kulturës, pylltarisë, kërkimit dhe novacionit nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm;

- Duke ofruar asistencë teknike për zhvillimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikave për zhvillim rural.

Rritja e konkurrueshmërisë duhet të bazohet në teknologjinë më të mirë në dispozicion dhe në aftësitë më të mira. Do të përmirësohet sistemi ekzistues i shërbimeve të ekstensionit dhe lidhjet me Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe universitetet me qëllim lehtësimin e përhapjes së njohurive të reja në këta sektorë.

Produktet dhe teknologjitë e reja shpesh krijohen nga bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm në sektor dhe rrallë krijohen nga aktorë individualë. Në mjedisin e ri konkurrues, kërkesat për aftësi dhe burime po bëhen gjithnjë e më të forta dhe kështu që organizimi i projekteve me bashkëpunim vertikal në zinxhirin e vlerës duke filluar nga universiteti deri te fermerët dhe përpunuesit, nëpërmjet qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore, është një mënyrë për rritjen e novatorizmit në sektor.



Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të perceptimit të fermerëve, agropërpunuesve, SME-ve lokale dhe konsumatorëve për rëndësinë e prodhimit dhe të produkteve të cilësisë së lartë.

Masa 11: Përmirësimi i trajnimit

Objektivi i kësaj mase është të kontribuojë në përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale të personave të përfshirë në sektorët e bujqësisë, përpunimit ushqimor dhe pylltarisë, si dhe të aktorëve të tjerë ekonomikë që veprojnë në zonat rurale.

Objektivi i kësaj mase është që të mbështesë gjithashtu formimin e nevojshëm profesional për fitimin e aftësive të nevojshme për pjesëmarrjen e suksesshme në masat në zbatim të programit IPA për zhvillim rural.

Evoluimi dhe specializimi i bujqësisë dhe pylltarisë kërkon një nivel të përshtatshëm të trajnimit teknik dhe ekonomik, përfshirë ekspertizën në teknologjitë e reja të informacionit, si edhe ndërgjegjësimin e duhur në fushën e cilësisë së produkteve, të rezultateve të kërkimit dhe të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe vënien në zbatim të praktikave të prodhimit që janë në pajtim me ruajtjen dhe përmirësimin e peizazhit dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mbështetja do të ofrohet për organizimin dhe ofrimin e kurseve të trajnimit dhe për kostot e pjesëmarrjes për pjesëmarrësit.

Përfituesit fundorë në zbatim të kësaj mase do të jenë organizatat profesionale dhe/ose ndërprofesionale (ofruesit e trajnimit) të afta dhe të përgjegjshme për ofrimin e kurseve të trajnimit.

Pjesëmarrësit në trajnimin e parashikuar nga kjo masë do të jenë persona të angazhuar në sektorin e bujqësisë, të ushqimit dhe të pylltarisë, si dhe aktorë të tjerë ekonomikë që operojnë në zonat rurale.

Masa do të zbatohet në periudhën afatshkurtër. Edhe pse kjo masë përfiton nga programi IPARD II, parashikohet që veprimet plotësuese të mbështeten edhe nga donatorë të tjerë.

Masa 12: Transferimi i njohurive dhe përmirësimi i shërbimeve të këshillimit

Shërbimet këshillimore për fermat (SHKF) ndihmojnë fermerët, pronarët e pyjeve dhe SME-

të në zonat rurale që të përmirësojnë menaxhimin e qëndrueshëm dhe performancën e përgjithshme të fermave ose bizneseve të tyre. Këshillat jepen në të gjitha aspektet e menaxhimit të fermës dhe biznesit, si p.sh. çështjet që lidhen me performancën ekonomike, bujqësore dhe mjedisore të ndërmarrjes ose fermës. Kjo mbështetje është e domosdoshme pasi shërbimi i ekstensionit karakterizohet nga numri i vogël dhe mosha e vjetër mesatare e specialistëve të tij.

Objektivi i kësaj mase është fuqizimi i shërbimeve këshillimore, duke kontribuar kështu në përmirësimin e përgjithshëm të performancës së fermerëve dhe bizneseve rurale.

Kjo masë do të nxitë përdorimin e shërbimeve këshillimore për fermerët, pronarët e pyjeve, administruesit e tokës dhe SME-të në zonat rurale me qëllim përmirësimin e performancës ekonomike dhe mjedisore, qëndrimin të tyre miqësor ndaj mbrojtjes së klimës dhe rritjen e shkallës së vitalitetit të fermave dhe ndërmarrjeve bujqësore dhe pyjore.

Për rrjedhojë, kjo do të kontribuojë në rritjen e aftësisë së sektorit agropërpunues për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut, si dhe për t'u harmonizuar në mënyrë progresive me standardet e BE-së, duke ndjekur objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore për zhvillimin e ekuilibruar territorial të zonave rurale.

Këshillat do të ndihmojnë gjithashtu në trajtimin e sfidave të ndryshmeve klimatike, duke nxitur efikasitetin e burimeve dhe duke mbështetur orientimin drejt një ekonomie me nivele të ulëta karboni në sektorin e bujqësisë, të ushqimit dhe të pylltarisë.

Masa do të stimulojë transferimin e njohurive dhe do të ndihmojë në nxitjen e përfshirjes sociale dhe ekonomike duke mbështetur në veçanti fermerët e vegjël dhe mikro-ndërmarrjet. Në veçanti kjo do t'i ndihmojë fermerët e vegjël dhe mikro-ndërmarrjet që të përdorin programin IPARD II dhe programe të tjera për zhvillimin rural.

Përfitues nga kjo masë do të jenë institucionet që ofrojnë shërbime këshillimi për fermerët dhe mikro-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla, si p.sh. shërbimet publike të këshillimit, organizatat e sektorit me kapacitetet e duhura dhe agjencitë e



zhvillimit. Institucionet e përshtatshme do të përcaktohen në programimin specifik të masës.

Masa do të zbatohet në periudhën afatshkurtër. Edhe pse kjo masë përfiton nga programi IPARD II, parashikohet që veprimet plotësuese të mbështeten edhe nga donatorë të tjerë.

Masa 13: Asistenca teknike

Objekti i kësaj mase është që të ndihmojë në veçanti në zbatimin dhe monitorimin e programit IPARD II dhe në zhvillimin e mëtejshëm të masave në program.

Masa do të mbështesë aktivitetet e përgatitjes, menaxhimit, monitorimit, vlerësimit, të mbështetjes administrative, të informimit dhe komunikimit, të krijimit të rrjeteve dhe aktivitetet e kontrollit dhe auditit.

Masa e asistencës teknike mund të përdoret edhe në mbështetje të veprimeve për uljen e barrës administrative për përfituesit, si dhe të veprimeve për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve kombëtare dhe përfituesve për të administruar dhe për t'i përdorur fondet.

Masa do të zbatohet në periudhën afatshkurtër. Ajo përfiton nga programi IPARD II dhe do të zbatohet sapo instrumenti IPARD II të jetë gati për zbatim. Veprimet plotësuese të asistencës teknike do të mbështeten edhe nga donatorë të tjerë.

3.2 Skemat kombëtare të mbështetjes

Fusha e dytë e politikës ka të bëjë me ndërhyrjet kombëtare që kanë si qëllim parësor mbështetjen financiare për fermerët, mbështetjen për investime në infrastrukturën rurale (ujësjellës, ujitje, kullim dhe rrugë) dhe ndërhyrje të tjera, si p.sh. iniciativat përkatëse për të mbështetur mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimin në zonat rurale që nuk do financohen nga ndonjë prej skemave të BE-së.

3.2.1 Mbështetja e drejtpërdrejtë për fermerët dhe skemat e tjera mbështetëse

Politikat aktuale të mbështetjes së drejtpërdrejtë

Skemat aktuale kombëtare të mbështetjes kombinojnë elementet e mbështetjes me investime dhe pagesat e drejtpërdrejta për rritjen e prodhimit në sektorët më të rëndësishëm bujqësorë. Mbështetja për fermerët ofrohet përmes një shumëllojshmërie skemash vjetore të mbështetjes, kryesisht në formën e llojeve të

ndryshme të skemave të pagesave të drejtpërdrejta me shumë pak skema investimesh. Së fundmi, janë nisur veprime që mbështesin nxitjen e kredive rurale në sektorin e agropërpunimit dhe të mekanizimit të fermave.

Gjatë vitit 2012 mbështetja për bujqësinë dhe zhvillimin rural është zbatuar nëpërmjet 21 masave të mëposhtme, 20 prej të cilave janë forma të ndryshme të pagesave të drejtpërdrejta, ndërkohë që 1 masë mbështet nxitjen e kredive rurale në sektorin e agropërpunimit dhe mekanizimit bujqësor. Zonat malore janë favorizuar nga kritere pranimi më pak kufizuese.

Sektorët që u mbështetën me përparësi ishin:

- Prodhimi i frutave, arrorëve, ullinjve dhe vreshtave nëpërmjet mbështetjes për mbjelljen e drurëve të rinj frutorë, investimet në puse dhe sisteme ujitjeje, sistemet për mbrojtjen e bimëve dhe shtimin e fidanëve të varieteteve autoktone;

- Prodhimi i perimeve në hapësira të mbrojtura (serra/tunele) nëpërmjet mbështetjes për investime për plastmasë për serrat, sistemet e ujitjes me pika, serra të reja bazuar në energjinë diellore;

- Prodhimi i qumështit, bazuar në pagesat për fermat blegtorale për qumështin e dorëzuar nëpër baxho, paguar për litër qumështi; mbështetja për lopët e qumështit dhe për delet të paguara për krerë, mbështetja për shtegtimin e deleve, mbarështimi i lepujve, prodhimi i vajit të ullirit ekstra të virgjër paguar për litër të prodhuar dhe mbështetja për kosheret e bletëve dhe prodhimi i mjaltit;

- Prodhimi i produkteve organike dhe certifikimi i produkteve organike (bio);

- Promovimi i kredive rurale në agropërpunim dhe mekanizimi i bujqësisë nëpërmjet subvencioneve për normën e interesit;

- Nxitja e bashkëpunimit bujqësor;

- Mbarështimi i kërmijve;

- Kultivimi i bimëve mjekësore.

Masat kanë vazhduar edhe në vitin 2013 bashkë me dy masat sipas skemës së granteve si IPARD. Buxheti total për vitet 2012 dhe 2013 ishte përkatësisht 8 milionë euro dhe 7,5 milionë euro (bashkëfinancim kombëtar në skemën e granteve IPARD).

Masat mbështetëse kombëtare sigurojnë mbështetje 18 milionë euro në vitin 2014 dhe do të mbulojnë sektorët e mëposhtëm: Prodhimi i



frutave dhe perimeve, bujqësia organike, prodhimi i rrushit dhe BAM-ve, perimet në serrë (mbulimin e pjesshëm të kostos së ngrohjes), rehabilitimi, kultivimi dhe mbrojtja e ullishtave (nga miza e ullirit), kultivimi i vreshtave, mbarështimi i bagëtive (gjedhi dhe bagëtitë e imëta), prodhimi i mjaltit, kërmijtë dhe akuakultura. Përveç kësaj, janë parashikuar grante që synojnë sistemet e ujitjes në fermë dhe subvencionet për normën e interesit në fermë në lidhje me bashkëfinancimin e investimeve për mekanikën bujqësore në fermë dhe përpunimin agroushqimor.

Mbështetja kontribuon në formalizimin e sektorit bujqësor, duke ofruar subvencione për fermerët që shesin produktet e tyre te tregtarët ose përpunuesit duke faturuar sipas kërkesave fiskale. Gjithashtu, masat lidhur me blegtorinë ofrojnë mbështetje specifike shtesë për fermerët që i thetin kafshët në thertore dhe e çojnë lëkurën për përpunim (duke bërë të mundur pajtueshmërinë me sigurinë ushqimore dhe mjedisore). Në rastin e prodhimit të rrushit dhe vreshtave ofrohet mbështetje shtesë për mbjelljen e kultivarëve lokalë (autoktonë).

Përveç këtyre, një fond garancie për kreditë rurale për financimin e kredive për veprimtaritë në bujqësi dhe për përpunimin po përgatitet dhe financohet nga komponenti IPA 1. Kapitali total i Fondit është 5,5 milionë euro, nga të cilat 5 milionë euro janë nga BE-ja.

Ndryshimet e fundit në politikën fiskale të Shqipërisë kanë shënuar një rritje të lehtë në konsumin e pijeve alkoolike dhe të naftës (ligji nr. 180/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për akcizat”). Megjithatë, nga ana tjetër, janë vendosur reduktime të taksave të materialeve të paketimit për produktet ushqimore, duke rezultuar në reduktim të kostove të prodhimit për agroindustrinë vendase (ligji nr. 178/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për taksat kombëtare”). Një tjetër zhvillim pozitiv ka qenë reduktimi i tatimeve për bizneset e vogla (ligji nr. 181/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për sistemin e taksave vendore”), i cili mund të paraqesë një mundësi për formalizimin e operatorëve të vegjël agroushqimorë.

Në të ardhmen mund të merret parasysh reduktimi i taksave për input-et bujqësore për të

rritur përdorimin/aksesin e fermerëve në input-et dhe rritjen e niveleve të prodhimit. Gjithashtu, mund të merret parasysh rishikimi i taksave për naftën e përdorur në bujqësi dhe (p.sh. mekanizimi) dhe agroindustrinë (p.sh. nafta e përdorur për ngrohje), e megjithatë këto nisma mund të ndërmerren vetëm pasi kuadri i qartë ligjor dhe institucional të garantojë zbatimin efikas. Në të kundërt, mund të ofrohet mbështetje financiare (grante/subvencione) për të kontribuar në reduktimin e kostove për lëndët djegëse për ngrohje (siç është parashikuar për serrat në vitin 2014) nëpërmjet investimeve efikase në energji. Nismat fiskale do të kenë ndikim më të lartë me rritjen e formalizimit të sektorit, çka përbën një prioritet kryesor.

Orientimi i politikës së përbashkët bujqësore për periudhën 2014-2020

Sfida kryesore për Shqipërinë në lidhje me këtë fushë të politikës është nisja e një procesi përafrimi me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së, në veçanti për sa i përket zbatimit të Skemës Bazë të Pagesave të BE-së dhe pagesave përkatëse.

Për periudhën 2014-2020 pagesat e drejtpërdrejta për fermerët në BE sipas PPB-së do të ofrohen duke zbatuar skemat e mëposhtme:

- Skema bazë e pagesave (SBP) ofron një pagesë të drejtpërdrejtë vjetore për fermerët, ose për hektarë ose për krerë (LSU) në mënyrë që t'i orientojnë fermerët drejt tregut.

Skema bazë e pagesave

Skema bazë e pagesave do të aplikohet për fermerët e BE-së pas vitit 2013. SBP nënkupton kalimin drejt një pagese uniforme për hektarë në nivel kombëtar ose rajonal. Si në rastin e skemës së një pagesë të vetme, SBP-ja do vazhdojë të shkëputet – mbështetja do të ndahet nga sasia e prodhuar – pagesa do të bëhet për ha, pavarësisht sasisë së prodhuar.

Qëllimi i SBP-së është të reduktojë ndjeshëm mospërputhjet ndërmjet niveleve të pagesave të marra, pas zbatimit të plotë të legjislacionit aktual, midis fermerëve, midis rajoneve dhe midis shteteve anëtare. Niveli i të gjitha pagesave do të vazhdojë të jetë i lidhur me respektimin e një numri kërkesash bazë në lidhje me mjedisin, mirëqenien e kafshëve dhe standardet e shëndetit të bimëve dhe kafshëve.



Burimi: KE, Reforma e PPB-së—një shpjegim i elementeve kryesore,
http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-11-685_en.htm.

Aksesuar më 2 qershor 2014

Skema bazë e pagesave plotësohet nga skema të tjera, të cilat ofrojnë mbështetje shtesë si më poshtë:

- Për fermerët që ndërmarrin praktika bujqësore në të mirë të klimës dhe mjedisit;
- Për fermerët që punojnë në zona me kufizime natyrore;
- Për fermerët e rinj.

Skemat e mbështetjes ku pagesat lidhen me nivelin e prodhimit, p.sh. mbi bazën e sipërfaqeve dhe rendimenteve fikse ose mbi një numër të caktuar kafshësh. Këto skema përfshijnë mbështetjen për një numër të caktuar të produkteve bimore, produkteve shtazore dhe frutave dhe perimeve.

Këto skema janë të kufizuara në rajone ku lloje specifike të fermave ose ku sektorë specifikë të bujqësisë përballen me vështirësi të caktuara dhe që kanë rëndësi të veçantë për arsye ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Skemat për fermerët e vegjël, të cilat ofrojnë një mundësi për pjesëmarrje në një skemë të thjeshtësuar si alternativë ndaj skemës bazë të pagesave sipas disa kushteve të caktuara.

Politikat e ardhshme të mbështetjes së drejtpërdrejtë

Objekti në periudhën afatshkurtër është që të vazhdojë zbatimimi i skemave aktuale të mbështetjes me rritjen e nivelit të financimit total nga buxheti i shtetit. Skemat do të rishikohen në bazë vjetore dhe do të përshtaten me nevojat prioritare që lindin për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe të përpunimit të ushqimit.

Disa nga skemat aktuale (skemat e investimeve, mbështetja për BAM-të, fermat organike, mbështetja për prodhimin e kërmijve) do të mund të përfitojnë në një shkallë të gjerë nga masat për zhvillimin rural nën programin IPARD II. Këto masa nuk do të financohen më nga programet kombëtare në përputhje me zbatimin e të njëjtit lloj investimesh sipas masave të zhvillimit rural nën IPARD II. Masa të tjera mund të vazhdojnë të zbatohen deri në shkallën e nevojshme për të plotësuar masat e IPARD-it.

Një shqetësim kryesor do të jetë qasja për të mbështetur fermerët të vegjël, të cilët mund të mos jenë ekonomikisht të pranueshëm në kohën e dhënies së mbështetjes. Edhe në të ardhmen këta fermerë do të përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të prodhimit bujqësor.

Problemet me të cilat hasen fermerët e vegjël do të trajtohen nga një qasje me dy nivele, si më poshtë:

- Fermerët e vegjël që prodhojnë për tregun do të vazhdojnë të mbështeten nëpërmjet skemave ekzistuese kombëtare të mbështetjes. Skemat e mbështetjes në të ardhmen, gjithsesi, do të hartohen në përputhje me qasjen strategjike të aplikuar në zbatim të masës për zhvillim rural "Investimet në asetet fizike të fermave", ku mbështetja pikë së pari fokusohet në sektorët me përparësi me potencial për zhvillimin e prodhimit konkurrues të produkteve cilësore për tregjet e brendshme dhe të eksportit.

- Për më tepër, ky grup fermerësh do të jetë një grup me përparësi për sa i përket rritjes së promovimit për pjesëmarrjen në grupet e prodhuesve dhe në format e tjera të bashkëpunimit për të ndihmuar në përmirësimin e tregtimit, planifikimit dhe në rritjen e cilësisë së prodhimit. Shërbimet këshillimore do të luajnë një rol kryesor në mbështetjen e këtyre veprimtarive dhe kapaciteti i tyre do të rritet me njohuri specifike nga ekspertët për të lehtësuar procesin.

Në përfundim, politika e vazhdueshme për të lehtësuar aksesin për kredi të bizneseve rurale, ndër të tjera në zbatim të Fondit të Garancisë së Kredive, do të përmirësohet me perspektivën për të nxitur investimet në prodhimin bujqësor dhe përpunimin ushqimor, edhe nën programin IPARD II.

Në periudhën afatmesme, skemat ekzistuese të mbështetjes së drejtpërdrejtë, aty ku është e përshtatshme, do të përshtaten gradualisht në përputhje me parimet e BE-së për skema të ngjashme sipas PPB-së.

Do të hartohen skema të reja të mbështetjes së drejtpërdrejtë në përputhje me parimet për skema të ngjashme sipas PPB-së, bazuar në zhvillimin e kuadrit institucional dhe legjislativ. Skema të tilla do të zbatohen vetëm në periudhën afatmesme deri në masën që financimet të jenë të disponueshme nga buxheti i shtetit.



3.2.2 Infrastruktura rurale

Menaxhimi i ujërave

Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit është një faktor i rëndësishëm që ndihmon zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit bujqësor në Shqipëri. Edhe pse Shqipëria është e pasur me burime të mjaftueshme ujore, ekziston një nevojë e madhe për ujitje gjatë verës dhe për kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet gjatë dimrit.

MBZHRAU është autoriteti përgjegjës kryesor për menaxhimin e përgjithshëm të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet, si dhe për reformat në këtë sektor.

Ndërhyrja e MBZHRAU-së në këtë fushë ka dy objektiva:

Përbushjen e nevojave të fermerëve për ujë nëpërmjet:

-Rehabilitimit dhe modernizimit të infrastrukturës së ujitjes;

-Menaxhimin të qëndrueshëm të sistemeve të ujitjes duke harmonizuar rolin dhe përgjegjësitë e qeverisë qendrore, autoriteteve lokale dhe fermerëve.

Sigurimin e kullimit, me përparësi për ultësirat perëndimore, nëpërmjet:

- Menaxhimin të qëndrueshëm të sistemeve të kullimit dhe të mbrojtjes nga përmbytjet;

- Rehabilitimit dhe përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese;

- Rritjes së kapaciteteve dhe modernizimit të hidrovoreve të kullimit.

Vizioni është që të mbështetet një qasje e decentralizuar, ku menaxhimi i ujitjes dhe kullimit do të përbëhet nga tre nivele: 1) MBZHRAU-ja dhe strukturat në varësi të saj në nivele të larta të menaxhimit, 2) Bashkitë dhe komunat në nivelin e mesëm të menaxhimit dhe 3) Operatorë të tjerë (Organizatave të Përdoruesve të Ujitjes (OPU) dhe furnizuesit privatë) në nivel më të ulët.

MBZHRAU-ja do të jetë përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kryesore të ujitjes dhe kullimit. Burimet për këtë qëllim janë përcaktuar në buxhet, si dhe do të shtohen me mbështetje financiare të huaj/të jashtme aty ku është e mundur, ndërkohë që do të vazhdojë transferimi të bashkitë dhe komunat i menaxhimin të sistemeve të vogla të ujitjes dhe kullimit. Roli dhe funksioni kryesor i OPU-ve është të lehtësojë përdorimin dhe mirëmbajtjen e

sistemeve ujitëse brenda zonave të tyre gjeografike, si dhe të sigurojë ujitjen për anëtarët e tyre nga komuniteti i fermerëve.

Përmirësimi i strukturës së fermës

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore në Shqipëri është 695 520 ha, nga të cilat 561 000 ha kanë kaluar në pronësi private. Pjesa tjetër (rreth 20% e totalit) është në pronësi shtetërore. Rishpërndarja e tokës bujqësore gjatë reformës së tokës në fillim të viteve 1990 krijoi një strukturë fermash të vogla dhe të fragmentuara. Në vitin 2012 ishin 350 916 ferma me një sipërfaqe mesatare prej 1,20 ha të ndarë në 4,6 parcela me sipërfaqe mesatare 0,26 ha.

Reforma për privatizimin e tokës pati një ndikim pozitiv pasi transferoi pronësinë e një asemi të rëndësishëm të familjet rurale. Megjithatë, niveli i lartë i fragmentizimit që rezultoi nga kjo dhe përmasa e vogël e fermave çuan në një ulje të prodhimit bujqësor, teknologji të papërshtatshme bujqësore dhe degradim të tokës me një ndikim negativ të madh për popullsinë rurale.

Tregu i tokës bujqësore nuk është zhvilluar ende plotësisht. Gjatë vitit 2010, u regjistruan rreth 3600 transaksione të tokës që mbulojnë 830 ha tokë bujqësore. Megjithatë, shumë prej këtyre transaksioneve nuk janë për qëllim të zhvillimit bujqësor, por për konvertimin e mëvonshëm të tokës bujqësore për përdorime të tjera. Gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë mund të parashikohet një ulje në numrin e fermave. Deri në fund të vitit 2020, pritet që të zvogëlohet ndjeshëm numri i fermave aktive bujqësore, duke mundësuar rritjen e përmasës së fermës në 3,5 ha për fermat e orientuara nga tregu.

Me qëllim lehtësimin e këtij procesi, konsolidimi i tokës duhet të mbulohet nga kuadri përkatës ligjor. Përveç kësaj, duhet të zgjidhen një sërë vështirësish të tjera. Ato lidhen me regjimin e të drejtave të pronësisë, të lidhura në mënyrë të veçantë me zbatimin e transaksioneve të pronave, procedurat për regjistrimin e këtyre transaksioneve dhe rritjen e pagesave për transaksionet.

Një projekt pilot për konsolidimin e tokës është zbatuar me mbështetjen e FAO-s. Projekti evidentoi probleme të konsiderueshme regjistrimi që lidhen me pronësinë familjare të tokës bujqësore, e cila ndryshon nga pronësia individuale, për procedurat në rastet e trashëgimisë dhe



mospërputhjet në dokumenteve të tapive dhe regjistrimit fillestar. Problemet e përmendura do të trajtohen në Programin e Punës për Konsolidimin e Tokës për ngritjen e fermave ekonomisht të qëndrueshme dhe konkurruese, të afta për të plotësuar kërkesat e ekonomisë bashkëkohore të tregut.

Objektivi i Programin e Punës për konsolidimin e tokës është që të asistohen fermerët për të përmirësuar strukturat e fermës duke ofruar mundësi për të ulur fragmentimin e tokës dhe për të rritur përmasën e fermave. Programin e Punës ka si qëllim të zhvillojë kushtet për konsolidimin e tokës, përfshirë një program kombëtar për konsolidimin e tokës, miratimin e një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe zbatimin e suksesshëm të projekteve për konsolidimin e tokës.

Programi për konsolidimin e tokës do të përfshijë një sërë hapash:

- Ngritja e kuadrit institucional/organizativ dhe përcaktimi i procedurave;
- Ngritja e kuadrit ligjor të përshtatshëm, duke përfshirë një ligj të ri për konsolidimin e tokës;
- Zhvillimi i kapaciteteve;
- Rritja e ndërgjegjësimit publik.

Ndërhyrja do të financohet nga burime të ndryshme, duke përfshirë buxhetin e MBZHRAU-së, IPA-në, si dhe nga mbështetja e donatorëve.

Përveç konsolidimit të tokës do të merren në konsideratë edhe ndërhyrje dhe masa të tjera mbështetëse. Gjithashtu, mbështetja për grupet e prodhuesve dhe për organizatat e prodhuesve dhe kooperativat do të kontribuojë në përmirësimin e strukturës së fermave, shih seksionin e politikave 3.1.1.

Rrugët rurale

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Brendshme do të ofrojnë mbështetje me investime për zhvillimin e rrugëve rurale. Mbështetja që vihet në funksion nga FSHZH-ja përshkruhet në seksionin 3.4. “Koherenca dhe koordinimi ndërministror”.

3.2.3 Ndërhyrjet horizontale: Mundësitë e barabarta

MBZHRAU-ja e pranon rëndësinë e garantimit të mundësive të barabarta për të gjitha segmentet e popullsisë në zonat rurale, përfshirë gratë dhe vajzat, burrat dhe djemtë.

Për këtë arsye, MBZHRAU-ja do të ndihmojë Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) si edhe ministritë e tjera të lidhura për përgatitjen dhe zbatimin e ndërhyrjeve që mbështesin dhe fuqizojnë mundësitë e barabarta, përfshirë ato gjinore, në zonat rurale. Për më tepër, MBZHRAU-ja do të respektojë parimet e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit në të gjitha ndërhyrjet në kuadrin e SNZHRB-së, shihni gjithashtu seksionin 3.5 më poshtë.

3.2.4 Sistemi i sigurimeve në bujqësi

Bazuar në përvojat e një projekti pilot të mbështetur nga donatorë në sektorin e vreshtarisë, është planifikuar që MBZHRAU-ja të ngrejë një sistem sigurimesh të lehtësuara në Shqipëri. Ky projekt synon që të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Përcaktimin e kuadrit ligjor për sistemin e sigurimeve në bujqësi;
- Krijimin e një baze të dhënash dhe furnizimin e stacioneve meteorologjike;
- Zhvillimin e tregut të sigurimeve për mbështetje në bujqësi.

3.3 Zhvillimi institucional, implementimi dhe zbatimi i kërkesave rregullatore të BE-së

Harmonizimi i plotë me politikën dhe kërkesat rregullatore të BE-së është një parakusht për anëtarësim në BE. Procesi i përafrimit të legjislacionit kombëtar dhe instrumenteve të politikës me Acquis të BE-së dhe zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve për zbatimin e saj është prioriteti horizontal kryesor për periudhën 2014-2020, në mënyrë që të bëhet gati për anëtarësimin në BE sa më shpejt që të jetë e mundur.

Objektivi është përgatitja graduale e sektorëve agroushqimorë dhe zonave rurale për anëtarësimin në BE duke:

-Përshtatur politikën kombëtare për zhvillimin bujqësor dhe rural me PPB-në, duke prezantuar gradualisht masat dhe veprimet në përputhje me masat e PPB-së dhe IPARD-it.

-Eliminuar gradualisht masat dhe veprimet e papajtueshme me PPB-në.

-Aplikuar gradualisht kërkesat e BE-së për rregullimin e tregjeve, standardet shëndetësore dhe të higjienës, për mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e klimës, si dhe

-Duke zhvilluar kapacitetet institucionale njëkohësisht me futjen e kërkesave të reja



rregullatore për të siguruar zbatimin e plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Parimi themelor është që kuadri rregullator kombëtar të përshtatet plotësisht me kërkesat e BE-së dhe të zbatohet në mënyrë efektive në sektorin privat deri në fund të vitit 2020.

Integrimi i politikave dhe kërkesave rregullatore të BE-së do të ndërmerret në mënyrë të balancuar, duke lejuar periudhat e arsyeshme të tranzicionit për t'i mundësuar sektorit privat përshtatje sa më të mirë me kërkesat e BE-së me mbështetje, midis të tjerash, nga programi si IPARD.

Në këtë drejtim mbështetja e vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve (IPA II) dhe investimet në bujqësi dhe agropërpunim (IPARD) konsiderohen si mjetet themelore për të lehtësuar procesin.

3.3.1. Kushtet kuadër për zhvillimin e zonave rurale dhe sektorit bujqësor

Për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale dhe për zbatimin e objektivave dhe prioritetëve të parashtruara në strategji është thelbësor një kuadër ligjor i qëndrueshëm dhe transparent dhe institucionet efektive për zbatimin e legjislacionit.

Ligji “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” përbën themelin e këtij kuadri ligjor. Ligji do të rishikohet me qëllim lehtësimin e zhvillimit strukturor të sektorit të bujqësisë dhe përafrimin me BE-në nëpërmjet iniciativave të mëposhtme:

- Regjistrimi i fermerëve në regjistrin e fermës dhe regjistra të tjerë përkatës (regjistri i kafshëve, LPIS38 etj.). Nismat për regjistrimin e fermerëve dhe për përmbushjen e ligjeve dhe standardeve kombëtare nga ana e tyre do të sigurohen nëpërmjet masave mbështetëse. Vetëm fermerët që përmbushin këto dispozita do të mund të përfitojnë mbështetje.

- Futja e sistemeve të integruara të administrimit dhe kontrollit (IACS).

- Prezantimi i parimeve të menaxhimit kontabël dhe ekonomik në ferma. Nismat që fermerët të fillojnë zbatimin e këtyre parimeve do të sigurohen nëpërmjet shërbimeve këshillimore dhe nëpërmjet trajnimeve/transferimit të njohurive.

Prioriteti kryesor në periudhën afatshkurtër është zbatimi i programit IPARD për periudhën 2014-2020. Kjo kërkon miratimin e programit dhe akreditimin e Strukturës Operative të IPARD-it - AM dhe AZHBR - në përputhje me kriteret e

akreditimit të BE-së për të filluar zbatimin e programit sa më shpejt të jetë e mundur pas vitit 2014.

Në perspektivën afatmesme prioritet është zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të AZHBR-së për t'u bërë agjencia paguese për pagesat e PPB-së pas anëtarësimit.

Përafrimi i plotë i legjislacionit dhe përputhja institucionale për zbatimin e PPB-së do të kryhen në përputhje me një plan të përditësuar përafrimi për përputhjen graduale me legjislacionin në fuqi të BE-së për periudhën 2014-2020.

Ligji “Për kooperativat” ofron kuadrin ligjor për sigurimin e nismave për rritjen e bashkëpunimit në sektorin bujqësor dhe krijimin e kooperativave.

Do të ndërmerren nismat e mëposhtme:

- Ligji do të rishikohet për të përmirësuar kuadrin për bashkëpunim dhe krijimin e kooperativave.

- Baza ligjore do të zhvillohet më tej për të përfshirë dispozita për krijimin e grupeve të prodhuesve.

- Do të futen masa mbështetëse për promovimin e kooperativave dhe krijimin e grupeve të prodhuesve.

Këto iniciativa janë konsideruar të jenë të gjitha prioritetet afatshkurtra.

Kuadri ligjor për menaxhimin e tokës do të përmirësohet dhe strategjia e konsolidimit të tokës do të zbatohet me qëllim përmirësimin e strukturave bujqësore dhe rritjen e përmasës së fermave.

Zbatimi i ligjit “Për konsolidimin e tokës” brenda vitit 2014, bazuar në strategjinë për konsolidimin e tokës, është një bazë themelore për zbatimin, në një shkallë të parë, e një projekti pilot për konsolidimin e tokës në 3 komuna në periudhën 2015-2017 dhe në periudhën afatmesme një rritjeje të përmasës së parcelave dhe rrjedhimisht një përdorimi më efikas të tokës bujqësore.

Për të promovuar tregun e tokës do të miratohen ndryshime të mëtejshme ligjore. Për të lehtësuar këtë proces janë parashikuar nismat e mëposhtme:

- Përmirësimi i funksionimit të tregut të tokës përmes një kuadri të përmirësuar ligjor, riorganizimit të procedurave administrative dhe reduktimit të kostove të transaksioneve.



- Ofrimi i mbështetjes për konsolidimin e tokës dhe riparcelizimin.

Kuadri ligjor për produktet cilësore do të zhvillohet në përputhje me kërkesat e BE-së (produktet organike, EOM/TGJM³⁸, produktet tradicionale).

Njohja në treg e produkteve është thelbësore që konsumatorët të blejnë produkte me cilësi të garantuar. Sistemet e BE-së për produktet organike, EOM dhe TGJM të garantuar për produkte individuale janë shumë të rëndësishme në kontekstin e Shqipërisë dhe kuadri rregullator përkatës do të hartohet në mënyrë që fermerët dhe agropërpunuesit shqiptarë të përfitojnë nga sistemet.

Përveç kësaj, kuadri ligjor për krijimin dhe drejtimin e SME-ve në zonat rurale do të rishikohet dhe përmirësohet në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Së fundi, legjislacioni specifik me rëndësi të veçantë për sektorin e bujqësisë do të rishikohet dhe zgjerohet nëpërmjet SNZHBR-së.

Menaxhimi i ujit, ligji “Për ujitjen dhe kullimin”. Aksesimi në ujë për ujitje, si dhe aksesimi në kullim dhe mbrojtjen nga përmytjet kanë rëndësi të madhe për sektorin dhe rëndësia do të rritet edhe më tej për shkak të ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Investimet në sistemet e duhura të ujitjes dhe kullimit do të zbatohen nga MBZHRAU, ndërsa investimet lidhur me mbrojtjen nga përmytjet do të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit (MM) dhe organet e pushtetit vendor, duke iu referuar strategjisë për ujitjen dhe kullimin.

Koncepti i skemës së re institucionale të administrimit të ujitjes dhe kullimit do të përfshijë komunat/bashkitë si një hallkë e rëndësishme institucionale. Sistemi i ri institucional duhet të bazohet në tre nivele: i) qeverisja qendrore, me MBZHRAU-në dhe strukturat e saj si niveli i lartë i administrimit, ii) komunat/bashkitë si nivele të ndërmjetme të administrimit, iii) OPU dhe shoqatat e tyre si niveli më i ulët i administrimit, për sa kohë ato janë krijuar dhe funksionojnë.

Me anë të strukturave të saj MBZHRAU-ja do të jetë përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e rezervuarëve të mëdhenj ujitës, të hidrovorëve të kullimit dhe të stacioneve të mëdha të pompimit për ujitje, të veprave marrëse/prurëse dhe për kanalet kryesore të ujitjes dhe kullimit, të kanaleve ujëmbledhëse, si dhe për argjinaturat lumore dhe detare.

3.3.2 Kërkesat dhe standardet e BE

Acquis në bujqësi është një nga pjesët më të vështira dhe më të kushtueshme të harmonizimit me kërkesat dhe legjislacionin e BE-së. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me *acquis* evropian dhe përputhja me standardet e Komunitetit në fushën e sigurisë ushqimore, standardet veterinarë, fitosanitare dhe të mjedisit kërkon investime të konsiderueshme në modernizimin e ambienteve, përmirësimin e njohurive dhe aftësive të fuqisë punëtore.

Procesi i përafrimit të legjislacionit dhe zbatimi i standardeve të Komunitetit në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, sigurisë ushqimore dhe standardeve veterinarë dhe fitosanitare do të intensifikohet dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë dhe institucionet përkatëse, duke përfshirë të gjithë aktorët.

Procesi do të jetë i vazhdueshëm dhe do të përmirësohet me nismat e mëposhtme:

- Kuadri aktual rregullator do të rishikohet dhe do të përshtatet aty ku është e përshtatshme për të siguruar periudha tranzicioni mjaftueshëm të gjata që t'i mundësojnë sektorit privat që të kryejë investimet e nevojshme. Nismat e reja rregullatore do të bazohen në të njëjtin parim.

- Kërkesat rregullatore në fuqi do të implementohen dhe zbatohen në mënyrë rigorozë.

- Prioritet do t'i jepet rishikimit, implementimit dhe zbatimit të kërkesave rregullatore, të cilat do të jenë të detyrueshme në zbatim të IPARD-it. Kjo do të përfshijë përgatitjen e autoriteteve përkatëse për rolin e tyre si organe teknike.

Bazuar në objektivat strategjike të përcaktuara për periudhën 2014-2020 do të miratohet një plan i hollësishëm veprimi për sigurinë ushqimore, çështjet veterinarë dhe fitosanitare. Plani i veprimit do të përfshijë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme, në mënyrë që të arrihet përshtatja graduale dhe harmonizimi i plotë, duke përfshirë edhe kapacitetin e zbatimit,

³⁸EOM=Emërtim Origjine të Mbrojtur; TGJM=Treguesit Gjeografikë të Mbrojtur. Sisteme të bazuar në BE për të siguruar njohjen e prodhuesve në treg nëpërmjet sistemeve të certifikuar të etiketimit



deri në fund të vitit 2020 dhe më specifiku:

- Në periudhën afatshkurtër, identifikimi i legjislacionit dhe zhvillimi i kapacitetit inspektues dhe zbatues që nevojitet në mënyrë specifike për zbatimin e Programit IPARD, duke përfshirë kapacitetin për të vlerësuar dhe klasifikuar stabilimentet e përpunimit të ushqimit që mund të përfitojnë nga IPARD në përputhje me kërkesat e BE-së.

- Në periudhën afatmesme, zbatimi i objektivave strategjikë të sigurisë ushqimore, çështjeve vete-rinare dhe fitosanitare në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Planin e Veprimit.

Aktivitetet kryesore në fushën e sigurisë ushqimore janë:

- Intensifikimi i procesit të përafrimit të legjislacionit - ligji “Për ushqimin” dhe rregulloret përkatëse, duke përfshirë:

- Ndryshimet në ligjin “Për ushqimin” duhet të përgatiten në mënyrë që të sigurojnë aplikimin e plotë të paketës së higjienës ushqimore, dedikuar kontrollit zyrtar në fushën e ushqimit dhe ushqimeve për kafshët, rregullave për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve dhe për të vendosur bazën ligjore për përgatitjen e akteve dytësore legjislative.

Harmonizimi i legjislacionit dytësor sipas planit dhe zonave prioritare të ndërhyrjes.

Menaxhimi i përgjithshëm i kontrollit të ushqimit duke siguruar një menaxhim të mirë të sigurisë ushqimore, përfshirë:

- Përgatitjen e Planit të integruar Shumëvjeçar të Kontrollit (PSHK) në përputhje të plotë me kërkesat e BE-së, duke përfshirë edhe tregues të përgjithshëm rreth objektivave specifike që duhen arritur dhe sektorët ku duhet të fuqizohet kontrolli zyrtar.

- Bazuar në PSHK-në planet vjetore të kontrollit do të zhvillohen më tej për sigurinë ushqimore, sigurinë e ushqimeve të kafshëve, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve.

- Finalizimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të IT-së për mbledhjen e të dhënave zyrtare të kontrollit.

- Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

Sigurimi i shërbimit kompetent të inspektimit të ushqimit për zbatimin e kërkesave të sigurisë ushqimore në të gjithë vendin, duke përfshirë:

- Futjen dhe zbatimin e gamës së plotë të procedurave për kontrollet zyrtare.

- Aplikimin e një qasjeje të bazuar në analizën e riskut për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit.

- Krijimin e regjistrit publik të stabilimenteve të prodhimit të ushqimit në përputhje me kërkesat e BE-së, duke përfshirë edhe procedurën e miratimit dhe regjistrimit të operatorëve të bizneseve të ushqimit dhe ushqimeve për kafshët.

- Autorizimin, regjistrimin dhe kontrollin e pikave të therjes së kafshëve.

Sigurimi i një rrjeti laboratorik funksional të sigurisë ushqimore si pjesë e sistemit të kontrollit të ushqimit, i cili është i mirëorganizuar dhe i përgjigjet kërkesave të BE-së në lidhje me cilësinë në kryerjen e analizave të kampionëve të ushqimit të marrë në kuadrin e planeve të kontrollit të sigurisë ushqimore, duke përfshirë:

- Akreditimin – sigurimin e cilësisë së rrjetit laboratorik;

- Riorganizimin e sistemit në mënyrë që të krijohet një rrjet laboratorësh të sigurisë ushqimore, të shpërndarë në të gjithë Shqipërinë duke marrë në konsideratë dallimet gjeografike dhe duke shmangur mbivendosjen e aktiviteteve.

Garantimi që operatorët e biznesit të ushqimit (OBU) të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për sigurinë ushqimore të produkteve të hedhura në treg dhe për zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për të arritur këtë qëllim, duke përfshirë:

- Futjen e sistemeve të kontrollit të bazuara në parimet e HACCP-së, duke përfshirë përgatitjen e udhëzimeve dhe listave të kontrollit.

- Përmirësimin gradual të stabilimenteve të prodhimit të ushqimit duke kryer një vlerësim paraprak në një numër përfaqësues stabilimentesh për të identifikuar mangësitë dhe prioritetet për përmirësimin e tyre në nivelet e standardeve të BE-së, me kategorizimin e stabilimenteve, me përgatitjen e një plani veprimi për përmirësimin e OBU-së në mënyrë që të përputhet me standardet e BE-së dhe me rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me mundësitë për të aplikuar për mbështetje sipas programit IPARD II.

- Sigurimin e gjurmueshmërisë në të gjitha fazat gjatë prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit.

- Shtimin e stafit, ngritjen e kapaciteteve të organeve përgjegjëse dhe trajnimet për stafin rregullator dhe OBU-në.



-Informacionin dhe komunikimin me publikun.

Aktivitetet kryesore në fushën e çështjeve veterinarë, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve janë:

-Intensifikimi i procesit të përafrimit të legjislacionit në fushën e veterinarisë.

-Vendosja e kontrollit të plotë të situatës epizootike, duke mbrojtur shëndetin e kafshëve nga sëmundjet ngjyëse dhe të dëmshme si afta epizootike, murtaja klasike e kafshëve etj.

-Mbrojtja e shëndetit të njerëzve duke mbajtur nën kontroll sëmundjet zoonotike si bruceleza, tuberkulozi, tërbimi etj.

-Sigurimi që deri në vitin 2018 vendi të ketë një brez kafshësh të mbrojtura në mënyrë që të hapen rrugët për eksportin e mishit të dhisë dhe deles në tregjet e BE-së.

-Garantimi i sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore për konsumatorin, duke realizuar programin kombëtar për monitorimin e produkteve me origjinë shtazore dhe monitorimin e molusqeve bivalvare dhe ujërave të brendshme.

-Sigurimi i finalizimit dhe menaxhimit efektiv të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale.

-Ngritja e kapaciteteve, duke përfshirë shtimin e stafit dhe trajnimin e tij në të gjitha nivelet.

Aktivitetet kryesore për periudhën 2014-2020 në fushën e çështjeve fitosanitare dhe të mbrojtjes së bimëve janë:

-Intensifikimi i procesit të përafrimit të legjislacionit bazuar në planin e detajuar të veprimit, duke përfshirë miratimin e një ligji të ri për mbrojtjen e bimëve që synon përafrimin e kuadrit ligjor me Acquis të BE-së.

-Përmirësimi i strukturës organizative dhe shtimi i stafit të administratës fitosanitare në nivel qendror, i laboratorëve fitosanitarë të zhvilluar dhe të akredituar dhe krijimi i një regjistri të prodhuesve dhe tregtuesve të bimëve dhe produkteve me origjinë bimore.

-Krijimi i një zone të pastër nga sëmundjet virale dhe bakteriale për prodhimin e fidanëve dhe farave pa baktere në rrethin e Korçës, si qendra më e rëndësishme për prodhimin dhe shpërndarjen e materialit për mbjelljen e pemëve frutore.

-Krijimi i pemëtoreve “mëmë” me qëllim garantimin e materialit për mbjelljet, të cilat nuk kanë sëmundje.

Faqe | 8540

-Luftimi i parazitëve të rrezikshëm të kulturave bimore, të tillë si karkalecat, minjtë e arave dhe miza e ullirit.

Është përgatitur një masterplan veprimi për zbatimin e prioriteteve të IPARD-it, i cili lidh në mënyrë koherente të gjitha aktivitetet që duhet të kryhen dhe kuadrin kohor për realizimin e tyre që të arrihen këto prioritete. Masterplani i veprimit është strukturuar në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë përfshihet në fushat e politikave, ndërsa pjesa e dytë i dedikohet zhvillimit institucional dhe zbatimit të kuadrit rregullator.

3.4 Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërministror

Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural mund të zbatohet me efikasitet vetëm nëse garantohet koordinimi dhe koherenca e nevojshme me ministritë e tjera të linjës përgjegjëse për fushat specifike të politikës që i referohen zhvillimit rural. Ndërlidhjet kryesore janë parashtruar në këtë seksion³⁹.

3.4.1 Menaxhimi i burimeve natyrore

MM është përgjegjëse për politikën e përgjithshme në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore. Vizioni i ministrisë është që të kontribuojë në zhvillimin e Shqipërisë me zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik, ku mbrojtja e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi është në fokus nëpërmjet një menaxhimi të integruar të burimeve dhe nëpërmjet promovimit të vlerave mjedisore në shërbim të rritjes ekonomike.

Vizioni është i bazuar në parimin e zhvillimit të integruar, ku përmirësimi i kushteve mjedisore garanton rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale. Qëllimet e politikave mjedisore gjatë periudhës 2014-2020 do të përqendrohen në menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit nëpërmjet:

a) përmirësimin të cilësisë së kushteve të jetesës duke ulur ndotjen e ajrit dhe ndotjen akustike në zonat kryesore urbane;

b) kontrollin të integruar dhe parandalimit të ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale

³⁹ Grupi ndërministror i punës i ngritur me qëllim për të koordinuar përgatitjen e kësaj strategjie ka dhënë kontribute dhe MBUMK-ja e vlerëson këtë përpjekje. Prezantimi i temave mund të mos jetë gjithëpërfshirës, dhe nëse është kështu, mirëpritën kontribute të tjera shtesë.



në përputhje me normat dhe standardet për emetimet në ajër;

c) përmbushjes së standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke u përqendruar në trajtimin e duhur të tyre dhe duke rritur vetëdijen sociale për ndikimet e tyre të dëmshme në mjedis;

d) përmirësimit të menaxhimit të kimikateve;

e) mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të biodiversitetit, duke rritur sipërfaqen e zonave të mbrojtura, menaxhimit të tyre të integruar dhe krijimit të rrjetit Natyra 2000;

f) përshtatjes me ndryshimet klimatike dhe reduktimit të gazeve me efekt serrë;

g) administrimit të burimeve ujore nëpërmjet një kuadri monitorimi dhe kontrolli për të reduktuar ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

h) menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve të gjalla të ujërave të detit dhe baseneve ujore të brendshme;

i) zhvillimit të qëndrueshëm dhe multifunksional të pyjeve dhe kullotave, duke siguruar rritjen e sipërfaqes së pyjeve dhe rendimentit të tyre.

Interes të veçantë për SNZHBR-në kanë fushat e mëposhtme:

Menaxhimi i ujërave

Aksesi në ujë për qëllimet e ujitjes si edhe aksesi në kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet ka rëndësi të madhe për sektorin bujqësor dhe rural dhe rëndësia do të rritet edhe më tej për shkak të ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Investimet në sistemet e përshtatshme të menaxhimit të ujërave (ujitje, kullim, mbrojtje nga përmbytjet, trajtim i ujërave të zeza) do të zbatohen si bashkëpunim ndërministror ndërmjet MBZHRAU-së, MM-së, FSHZH-së dhe autoriteteve lokale.

Gjatë periudhës 2007-2012 qeveria shqiptare ka arritur progres të konsiderueshëm në përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe në trajtimin e ujërave të zeza.

Objektivi i MM-së është zgjerimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së shërbimeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza. Ndërhyrjet nga MM-ja janë të rëndësishme që sektori bujqësor dhe ai rural të kenë aksesin e nevojshëm në furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të zeza.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm nëpërmjet Projektit të Ujësllësve Ruralë. Një program i ri investimi me mbështetjen e donatorëve po përgatitet për furnizimin me ujë të zonave rurale dhe pritet që nga ky investim të përfitojnë rreth 135 000 banorë në 160 fshatra, ku do të ndërtohen 100 skema të furnizimit me ujë.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës është institucioni që ka për objektivi të vendosë mbi bazën e një zhvillimi të qëndrueshëm menaxhimin e integruar në sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimin e ujërave të ndotura, duke shfrytëzuar avantazhet e ekonomive të shkallës të kombinuara me efektet e decentralizimit. Qëllimi është të realizohet një situatë optimale në garantimin e furnizimit të vijueshëm me ujë të pijshëm dhe në përmirësimin e ndjeshëm të funksionimit të sistemit të kanalizimeve

Pylltaria

Menaxhimi i pyjeve në Shqipëri është përgjegjësi e MM-së. Pyjet janë një nga burimet natyrore më të rëndësishme në Shqipëri. Ata janë një element i domosdoshëm i përdorimit të tokës dhe ekulibrit ekologjik duke ofruar diversitet biologjik, produktivitet me një vlerë ekonomike për shoqërinë. Pyjet sigurojnë akses për të mirat publike duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e jetës. Pyjet gjithashtu kontribuojnë në uljen e varfërisë në zonat rurale sepse ky sektor ofron të ardhura të drejtpërdrejta dhe vende pune në këto zona nëpërmjet prodhimit të lëndës drusore, produkteve të drurit dhe frutave të pyllit si edhe ndikon në mënyrë jo të drejtpërdrejtë te bujqësia.

Objektivi i përgjithshëm i politikës për pyjet në Shqipëri është të sigurohet kultivimi dhe përdorimi i pyjeve dhe sipërfaqeve pyjore në një mënyrë dhe masë që ruan diversitetin e tyre biologjik dhe produktivitetin, aftësinë e tyre për t'u rigjeneruar si edhe potencialin e tyre për të përmbushur funksionet përkatëse ekologjike, ekonomike dhe sociale në nivel lokal dhe kombëtar. Kjo do të sigurohet tani dhe në të ardhmen pa i shkaktuar dëme ekosistemeve. Politika për pyjet ndërlihet ngushtë me zhvillimin bujqësor dhe rural dhe është parashikuar një koordinim intensiv i ndërhyrjeve ndërmjet Drejtorisë së Pyjeve në MM dhe MBZHRAU-së me qëllim që të sigurohet koherenca ndërmjet politikave dhe ndërhyrjeve të këtyre sektorëve.



3.4.2 Rrugët rurale

Aksesi në treg nëpërmjet një rrjeti të përshtatshëm rrugësh kombëtare, rajonale dhe lokale është thelbësor për këtë sektor. Mbështetja për zhvillimin e prodhimit mund të mos jetë efiçente nëse nuk bëhen investimet përkatëse në zhvillimin e infrastrukturës, në veçanti të rrugëve që lidhin zonat rurale me tregjet. Kjo do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit ndërministror midis MBZHRAU-së dhe aktorëve përkatës në sektor.

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit ka qenë një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare me qëllim që të krijohen kushtet paraprake për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë, për lëvizjen e njerëzve dhe mallrave dhe rritjen e aksesit në tregje.

Transporti rrugor mbetet fokusi kryesor i investimeve publike në sektorin e transporteve nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si një aktor kryesor. Në këtë kënd kuadër do të realizohen investime për lidhjet me rrugët rajonale të fshatrave dhe qyteteve, me qëllim lidhjen më të mirë të tregut me qendrat e prodhimit duke gërrshetur kriterin ekonomik me atë të impaktit social. Një domosdoshmëri përben mirëmbajtja e rrugëve duke shtuar fondet dhe përmirësimi i administrimit të tyre.

Objektivi kryesor për këtë sektor është rritja e dendësisë së rrugëve kombëtare (km rrugë/sipërfaqe në km²) me 45% deri në vitin 2020 dhe ulja e kohës mesatare të udhëtimit ndërmjet qyteteve kryesore deri në 20% deri në vitin 2020. Më shumë se 3500 km rrugë kombëtare do të përmirësohen dhe/ose ndërtohen dhe do të arrihet një mirëmbajtje më e mirë e rrugëve ekzistuese.

FSHZH është përgjegjës për zhvillimin e sektorit të rrugëve rurale. Zhvillimi i rrjetit të rrugëve dytësore dhe rurale është një objektiv madhor i qeverisë shqiptare dhe një program investimi po zbatohet me mbështetjen e donatorëve. Qëllimi i programit është rehabilitimi i 1000 deri në 1500 kilometrave rrjeti rrugor. Deri në vitin 2012, si pjesë e këtij programi, është financuar ndërtimi i një totali prej 1000 km rrugë. Programi do të vazhdojë të paktën deri në fund të vitit 2015 me 500 km rrugë të reja. Me mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë shqiptare dhe donatorëve të tjerë,

objektivi deri në vitin 2020 është ndërtimi i 1000 km të tjera rrugë.

3.4.3 Zhvillimi i biznesit

Zhvillimi i SME-ve dhe mbështetja e industrisë

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) është aktori kryesor për sa i përket zhvillimit të përgjithshëm të industrisë dhe biznesit. Objektivat strategjike të MZHETS-së që lidhen me zhvillimin e ekonomisë rurale janë përmbledhur më poshtë.

Nën temën Një Shqipëri Konkurruese qëllimi i MZHETS -s është të zhvillojë një ekonomi sa vjen e më konkurruese dhe dinamike, të tërheqë më tepër investime të huaja, të rrisë diversifikimin e eksporteve dhe të mbështesë krijimin e bizneseve të reja. Nevoja për të përmirësuar vazhdimisht pozicionin konkurrues të Shqipërisë tani është një ambicie kombëtare. Vëmendje do t'i kushtohet avantazheve konkurruese natyrore të Shqipërisë, përmirësimit të produktivitetit të burimeve të disponueshme njerëzore dhe natyrore, mobilizimit të potencialit të pashfrytëzuar sa duhet të Shqipërisë në lidhje me burimet e disponueshme natyrore, zhvillimin e tokës bujqësore dhe turizmit, pozicionit gjeostrategjik për tregti dhe transport dhe zhvillimit të energjisë si një parakusht për rritjen e prodhimit industrial.

Drejtimet kryesore të politikave për zhvillimin e eksportit do të jenë mbështetja e bizneseve të orientuara nga eksporti në bujqësi, industri dhe shërbime nëpërmjet zhvillimit të grupeve, promovimit të eksportit të produkteve me vlerë të shtuar të përpunuara brenda vendit, produkteve agroushqimore dhe industriale etj; zgjerimi dhe rritja e kompanive ekzistuese të orientuara drejt eksportit me futjen e produkteve dhe teknologjive të reja me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë; promovimi i produkteve vendase që zëvendësojnë produktet e importuara; promovimi i kërkimit dhe zhvillimit (K&ZH) për të përmbushur standardet e cilësisë së eksportit; promovimi i veprave të artit dhe artizanatit, në veçanti të zejtarisë, poçarisë dhe përpunimit të drurit, të cilat janë produktet që mund të përmbushin kërkesën ekzistuese për produkte shqiptare në tregun evropian.

Politika industriale e Shqipërisë është e fokusuar në mbështetjen e faktorëve horizontalë



duke përmirësuar konkurrueshmërinë dhe burimet njerëzore, kërkimet, novacionin, sipërmarrjen dhe mbrojtjen e mjedisit – të gjitha këto elemente bazë të zhvillimit të qëndrueshëm. Programi për zhvillimin e novacioneve dhe transferimin e teknologjive për SME-të përbën një politikë të re në përputhje me politikën e BE-së. Objektivi kryesor i programit është rritja e kapacitetit të bizneseve shqiptare për të zhvilluar, përdorur, zbatuar dhe komercializuar teknologjinë.

Me qëllim promovimin e zhvillimit të sipërmarrjeve krijuese për gratë që synojnë rritjen e veprimtarive të qëndrueshme ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në sektorin e artizanatit, qeveria do të ofrojë mbështetje financiare për këto sipërmarrëse si edhe mbështetje nga donatorët. Objektivi kryesor është promovimi i zhvillimit të produkteve, marketingut, si edhe ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimit.

Turizmi

Ministria e Zhvillimit të Territorit dhe Turizmit është aktori kryesor që mbështet zhvillimin e sektorit të turizmit. Si rezultat i klimës së favorshme për investime, marketingut aktiv, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në hotele dhe mjeteve të tjera, gjatë viteve të fundit sektori i turizmit ka rritur kontributin e tij në ekonomi. Për këtë arsye, sektori i turizmit është një nga sektorët kyç të ekonomisë kombëtare.

Numri i turistëve të huaj në vitin 2011 është rritur me 2,5 herë krahasuar me vitin 2007, nga 1,1 milionë turistë në vitin 2007 në 2,7 milionë. Trashëgimia kulturore tani është bërë pjesë e rëndësishme e turizmit kulturor.

Vizioni për zhvillimin e sektorit është që Shqipëria të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialëve natyrore, kulturore dhe historike, dhe lehtësisht të aksesueshme duke pasur parasysh vendndodhjen. Turizmi luan një rol thelbësor në ekonominë e Shqipërisë, kontribuon në rritjen e cilësisë së jetës dhe në krijimin e një mjedisi tërheqës për investime.

Qëllimet e politikës për sa i përket turizmit përfshijnë krijimin e identitetit të Shqipërisë si një destinacion turistik për të rritur zhvillimin ekonomik dhe social të vendit nëpërmjet promovimit dhe marketingut të turizmit cilësor,

zhvillimit të turizmit të integruar, nxitjes së investimeve të huaja dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore. Qëllimet kryesore janë rritja e kontributit të drejtpërdrejtë të turizmit në PBB, punësimin në turizëm dhe punësimin e grave në këtë sektor.

Arritja e qëllimeve të lartpërmendura do të bëhet e mundur nëpërmjet promovimit dhe marketingut të imazhit turistik të vendit si destinacion turistik me interes të veçantë; diversifikimit të produktit turistik duke e zgjeruar në të gjithë territorin për të siguruar zhvillimin e integruar të turizmit; zhvillimit të sistemeve të certifikimit dhe standardizimit në turizëm me qëllim për të kontribuar në cilësinë e përmirësuar të shërbimeve dhe produkteve në sektor. Do të sigurohet koordinimi ndërmjet ndërhyrjeve të MBZHRAU-së të përshkruara në këtë strategji për zhvillimin e turizmit rural dhe të agroturizmit dhe ndërhyrjeve të Ministria e Zhvillimit të Territorit dhe Turizmit.

Strategjia parasysh konsideron Partneritetin Urban -Rural si një qasje e integruar për të arritur një zhvillim të balancuar. Ministria e Zhvillimit të Territorit dhe Turizmit po harton Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe Planin e Integruar për Rajonin Tiranë – Durrës. Zhvillimi i bujqësisë urbane përfshin; zhvillimin e bujqësisë urbane në zonat me urbanizim mesatar dhe të lokalizuara përgjithësisht në periferi të qendrave të banuara dhe do të jetë një nga politikat e të ardhmes. Agroturizmi do të jetë një ndër mjetet jo vetëm të promovimit turistik, zhvillimit ekonomik, por dhe të rritjes së qëndrueshmërisë së turizmit dhe ruajtjes dhe promovimit të identitetit kulturor edhe lokal.

3.4.4 Zhvillimi në nivel lokal

Autoritetet lokale

Strategjia ndërsektoriale duhet të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale, organizatat përkatëse që operojnë në nivel lokal dhe me bizneset lokale. Koordinimi dhe koherenca duhet të sigurohen me prioritetet e zhvillimit kombëtar, të strategjive të zhvillimit rajonal dhe strategjive të komunave dhe bashkive.

Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes vendore” siguron që autoritetet lokale të kenë përgjegjësitë konkrete për zhvillimet ekonomike lokale. Zhvillimi i bujqësisë është jetësor për disa rajone,



bashki dhe komuna, ndaj dhe këto janë të detyruara të mbështesin sektorin nëpërmjet përgatitjes së programeve për zhvillimin ekonomik lokal; ngritjes dhe funksionimit të tregjeve publike; zhvillimit të biznesit të vogël si edhe promovimit të veprimtarive private të sipërmarrjes, ofrimit të shërbimeve që mbështesin zhvillimin ekonomik lokal, infrastrukturës së nevojshme; mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore lokale.

Ligji nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin territorial” përkrahur përgjegjësinë e autoriteteve lokale për planifikimin territorial në të gjitha zonat urbane dhe rurale brenda juridiksionit të tyre. Ato kanë gjithashtu të drejtë të paraqesin propozimet e ndarjes së zonave për zonat që janë subjekt transformimi nga përdorimi rural në atë urban.

Autoritetet rajonale kanë përgatitur dhe miratuar strategjitë e tyre për zhvillimin rajonal. Objektivat kryesore të këtyre strategjive janë zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i jetës së komuniteteve, si ulja e varfërisë, përmirësimi i arsimit, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe nxitja e zhvillimit të SME-ve, mjedisi i qëndrueshëm dhe qeverisja e mirë. Koordinimi i strategjisë ndërsektoriale të MBZHRAU-së me strategjitë e zhvillimit rajonal, strategjitë e bashkive dhe komunave bazuar në Prioritetet Kombëtare të Zhvillimit mbetet një prioritet. MBZHRAU-ja do të ndër marrë hapat e nevojshëm për të siguruar që ky koordinim të ndodhë.

Punësimi, çështjet sociale dhe shanset e barabarta

Prioritetet kryesore për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) kanë qenë politikat për stimulimin e punësimit; hapjen e vendeve të reja të punës; konsolidimin e mbrojtjes dhe mbështetjes sociale; modernizimin dhe përmirësimin e cilësisë në sektorët e arsimit dhe shëndetit.

Tregu i punës dominohet nga sektori bujqësor, i cili punëson pjesën më të madhe të punonjësve. Objektivat për këtë sektor janë: rritja e nivelit të punësimit dhe krijimi i mundësive të qëndrueshme për punësim nëpërmjet politikave të zhvillimit dhe subvencionimit të iniciativave që rrisin punësimin; ulja e mëtejshme e nivelit të varfërisë me anë të politikave të mbështetjes

sociale për shtresat sociale në nevojë; përfshirja sociale e individëve dhe shtresave sociale në nevojë nëpërmjet rritjes së aksesit në tregun e punës dhe integrimi i tyre i plotë në jetën sociale dhe ekonomike të vendit; sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit dhe fuqizimi ekonomik i grave.

Një grup tjetër objektivash lidhet me shëndetin: zhvillimi i një sistemi shëndetësor që mbron dhe përmirëson shëndetin e popullsisë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore të aksesueshme për të gjithë.

Në përfundim, zhvillimi i shoqërisë bazuar në njohuri, novacion dhe teknologjinë dixhitale është një prioritet. Kjo përfshin një sistem arsimor të konsoliduar, gjithëpërfshirës dhe cilësor që zhvillon vlerat e një shoqërie demokratike dhe kontribuon në zhvillimin e vendit nëpërmjet formimit të një krahu pune të kualifikuar; zhvillimi i sistemit më të lartë arsimor, cilësor në mësimdhënie dhe kërkime shkencore dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë, zhvillimi i një sistemi për kërkimin shkencor që u përgjigjet sfidave të së ardhmes për zhvillimin e vendit, duke siguruar integrimin e tij në Zonën Evropiane të Kërkimit.

Koherenca ndërmjet objektivave të SNZHRB-së dhe objektivave strategjike të MMSR-së është thelbësore dhe ndërhyrjet do të koordinohen në masën më të madhe të mundshme, aty ku është nevoja.

Edhe FSHZH kontribuon në zhvillimin rural në përgjithësi. Programi “Punë të Komunitetit III” u zbatua në periudhën 2008-2012. Qëllimi i projektit lidhej ngushtë me përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë rurale nëpërmjet asistencës teknike në zhvillimin lokal dhe investimet në infrastrukturën lokale rrugore, sistemet e furnizimit me ujë, sistemet e kullimit, turizmin dhe në rigjallërimin e qendrave të komunave. Programi paraqet një qasje të integruar të zhvillimit rural dhe një qasje të qëndrueshme që FSHZH-ja të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve lokale.

Programi do të pasohet nga një program tjetër me një qasje të ngjashme të integruar për zhvillimin rural në vend. Programi i ardhshëm do



të fokusohet në tre zona gjeografike të vendit. Zonat potenciale që do të përfshihen në program do të jenë një grup komunash të lidhura me anë të një identiteti të fortë territorial. Këto zona do të kenë specifika territoriale dhe kulturore dhe zhvillimi i tyre do të bazohet në identitetin territorial. Programi do të përfshijë asistencën teknike në planifikim dhe mbështetje me investime për projektet e infrastrukturës. Aktivitetet nën zbatimin e FSHZH-së koordinohen ngushtë me MBZHRAU-në.

3.4.5 Informacioni dhe komunikimi

SNZHRB-ja përfaqëson një përpjekje të MBZHRAU-së për të vazhduar zhvillimin institucional në pajtim me procesin e përafrimit të legjislacionit me legjislacionin e *acquis* të BE-së dhe zbatimin e tij dhe kjo përpjekje do të shprehet si një fushë e rëndësishme politikash për periudhën 2014-2020 për të qenë gati për anëtarësimin në BE.

Direktiva INSPIRE e BE-së e datës 14 mars 2007, tashmë e adoptuar në legjislacionin e Shqipërisë me anë të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, identifikon mbi 10 fusha që trajtojnë informacionin për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit, të cilat duhet të shërbejnë për zbatimin e SNZHRB-së. Këto tema janë sistemi kadastral, hidrografia, zonat e mbrojtura, mbulesa bimore, përdorimi dhe përbërja e tokës, monitorimi mjedisor, infrastruktura bujqësore dhe e akuakulturës, habitatet dhe biotopet, si dhe demografia.

Aktualisht janë ngritur sistemet e GIS-it. Këto sisteme mundësojnë mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e informacionit për tokën, vreshtat dhe ullishtat në përputhje me standardet e BE-së.

Sistemi i informacionit të tokës (LIS)

Aktivitetet e planifikimit bujqësor kërkojnë gjithnjë e më shumë të dhëna për tokën për të bërë të mundur një menaxhim të qëndrueshëm të saj. Përmirësimin e strukturës së mbledhjes së të dhënave mund ta ofrojë Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS), duke e kthyer atë në një mjet të dobishëm për MBZHRAU-në në sigurimin e një baze kombëtare të dhënash bazuar në Sistemin e Informacionit të Tokës (LIS). Deri tani LIS mbulon 33 komuna e bashki dhe rreth 180 000 hektarë, prej të cilëve 90 000 hektarë janë tokë

bujqësore (në fund të vitit 2013). Ky informacion kontribuon në përmirësimin e kërkesave për mbledhjen, përpunimin, organizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të të dhënave; proceseve të monitorimit të politikave, strategjive dhe projekteve si dhe në përgatitjen e politikave të zhvillimit të sektorit të bujqësisë.

Regjistri dixhital i tokës bujqësore

Modelimi i regjistrimit të tokës është një hap i rëndësishëm përpara në drejtim të krijimit të një dokumenti standard për Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qarqe dhe Zyrat e Menaxhimit të Mbrojtjes së Tokës në komuna. Programi për dixhitalizimin e regjistrimit të tokës është një mjet menaxhimi në përgjigje të rritjes së kërkesave për shkëmbimin e shpejtë të informacionit mbi tokën midis institucioneve përgjegjëse. Aktualisht në shkallë vendi regjistri i tokës në formë manuale është plotësuar në 65 komuna, ndërsa në 7 prej tyre ky regjistër ka kaluar në formë dixhitale.

Kadastra e vreshtarisë

Kadastra e vreshtarisë është krijuar në përputhje me Rregullat e Këshillit 2392/86/EEC dhe Rregullat e Komisionit 649/87/EC për të orientuar zhvillimin e vreshtave dhe të industrisë së verës në Shqipëri në funksion të politikave efikase të zhvillimit, me synim prodhimin e verërave cilësore me garanci të origjinës, si edhe përafrimin e rregullave që drejtojnë këtë sektor me ato të Bashkimit Evropian. Deri në fund të vitit 2012 janë regjistruar në GIS 10 823 njësi vreshti ose rreth 60% e njësisve totale në shkallë vendi. Procesi i regjistrimit të njësisve të vreshtave për gjithë territorin e vendit pritet të përfundojë në fund të vitit 2017.

Kadastra e ullirit

Rëndësia aktuale dhe rritja e shpejtë e sektorit të prodhimit të vajit të ullirit ka kërkuar vëmendje të veçantë lidhur me menaxhimin e tij modern, duke iu përgjigjur disa kërkesave. Kjo shtroi nevojën e ngritjes së infrastrukturës për menaxhimin e sektorit sipas modeleve të përparuara. Prandaj, për të mundur përshtatjen ekonomike dhe harmonizimin e praktikave legjislative dhe institucionale në Shqipëri me ato të BE-së në vitin 2012 u krijua Kadastra e ullirit. Nëpërmjet krijimit të GIS-it për ullirin synohej të kryhej një regjistrim i përgjithshëm i potencialeve prodhuese të kësaj kulture. Ky sistem mundëson kontrollin e



menaxhimit të subvencioneve (për mbjelljet, ripërtëritjet e ullishtave, shërbimet etj.), kontrollin e kufijve të prodhimit dhe përcaktimin e zonave të prodhimit cilësor të vajit të ullirit. Procesi i regjistrimit të ullinjve për gjithë territorin është parashikuar të mbyllet brenda vitit 2017.

3.5 Parimet e përgjithshme të shanseve të barabarta

Në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të SNZHHRB-së në Shqipëri, do të respektohen plotësisht të gjitha dispozitat strategjike dhe legjislative kombëtare dhe të BE-së për barazinë gjinore. MBZHRAU-ja do të sigurojë pajtueshmërinë me legjislacionin kombëtar për shanset e barabarta dhe mosdiskriminimin, pra Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin “Për barazi gjinore në shoqëri” dhe ligjin “Për mbrojtjen ndaj diskriminimit”.

3.5.1 Barazia gjinore

Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” (nr. 9970/24.07.2008) krijon kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen ndaj të gjitha llojeve të diskriminimit me bazë gjinore dhe promovimin e shanseve të barabarta. Këshilli i Ministrave ka miratuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për të arritur barazinë gjinore në Shqipëri. Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore, i krijuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 230, datë 2.12.2013, është organi këshillimor për politikën gjinore. MMSR është autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe programeve shtetërore për çështjet gjinore. Është ngritur dhe fuqizuar rrjeti i nëpunësve gjinore në nivel qendror dhe vendor, me qëllim realizimin e integritimit gjinor në këto nivele qeverisëse

Parimet e barazisë gjinore janë marrë në konsideratë gjatë procesit të përgatitjes së Strategjisë. Për të siguruar pasqyrimin e përshtatshëm të çështjeve gjinore, gjatë përgatitjes së strategjisë do të kryhet konsultimi me autoritetet publike dhe OJQ-të aktive në fushën e shanseve të barabarta.

Situata gjinore do të merret parasysh në procesin e hartimit të masave individuale të

mbështetjes duke i dhënë prioritet grave sipërmarrëse, aty ku është nevoja, në sistemet e vlerësimit të masave.

Gjatë zbatimit të SNZHHRB-së do të monitorohet në mënyrë specifike përthithja e mbështetjes në zbatim të masave nga ndërmarrjet dhe fermat që menaxhohen nga gratë. Të gjithë treguesit e monitorimit dhe vlerësimit do të detajohen sipas gjinisë. Të gjithë raportet e monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijnë një seksion për shanset e barabarta ku do të shqyrtohen ndikimet e SNZHHRB-së për barazinë gjinore.

Informacioni dhe veprimtaritë e publicitetit do të synojnë gjithashtu pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave. Nëpunësit gjinorë në nivel qendror dhe vendor dhe OJF që punojnë për çështjet e barazisë gjinore do të përdoren si përforcues. MBZHRAU do të bashkëpunojë ngushtë për këto çështje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3.5.2 Mosdiskriminimi

Ligji “Për mbrojtjen ndaj diskriminimit” nr. 10221/4.02.2010 paraqet parimin e barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, përkatësinë politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore dhe sociale, shtatzëninë, lidhjen/përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, kushtet e shëndetit, aftësitë e kufizuara, lidhjen me grupime të veçanta dhe në lidhje me ndonjë arsye tjetër. Gjatë programimit, monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor do të respektohen parimet dhe dispozitat e këtij ligji.

4. Burimet financiare

4.1 Kostot për ndërhyrjet kryesore të politikës: Shpenzimet dhe investimet aktuale

Kostot për ndërhyrjet kryesore të politikës në MBZHRAU-së paraqiten në shifra të agreguara në buxhetin e MBZHRAU-së për vitin 2013. Buxheti tregohet më poshtë:



Tabela 7: Buxheti i MBZHRAU-së 2013, milionë lekë dhe milionë euro

Kodet në buxhet Elementet		Vlera milionë (lekë)	Vlera milionë (euro) 41
Kodet	Buxheti total	6675	48,4
I 600	Stafi (paga+sigurime)	1700	12,22
II 602	Shpenzime operative	270	1,94
III	Shpenzime për politikat e mbështetjes	1910	13,73
602-606	Veterinaria	217	1,56
	Siguria ushqimore	345	2,48
	Mbrojtje bimësh	18	0,13
	Kullim e ujitje	195	1,40
	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	30	0,22
	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës	21	0,15
	Skemat mbështetëse të bujqësisë: nga të cilat bashkëfinancim i IPA 2011	1052	7,56
	Panaire marketingu	17	0,12
	Kadastrat e vreshtarisë dhe ullirit	8	0,06
	Ruajtja e racave autoktone në blegtori	7	0,05

Burimi: Sektori i buxhetit në MBUMK

Buxheti total është 48,4 milionë euro, nga të cilat 25,3 milionë përbëhen nga shpenzimet operative (stafi, kostot operative) dhe investime të brendshme për sigurinë ushqimore, ujitjen dhe kullimin dhe zhvillimin rural. 7,5 milionë euro investohen në skemat kombëtare të mbështetjes, përfshirë bashkëfinancimin kombëtar të skemës së granteve si IPARD (2 milionë euro). BE-ja ofron fonde në një total prej 9,6 milionë eurosh

dhe donatorë të tjerë kontribuojnë me 5,9 milionë euro.

Mbështetja e BE-së përdoret për skemën e granteve si IPARD (6,3 milionë euro) dhe për projekte të ndryshme për zhvillimin e kapaciteteve (3,3 milionë euro).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur buxheti i MBZHRAU-së për vitin 2013 i shpërndarë sipas fushave të politikës:

Tabela 8: Buxheti i MBZHRAU-së 2013, i shpërndarë sipas fushave të politikës, milionë lekë dhe milionë euro

Buxheti 2013	Milionë lekë			Milionë euro ⁴⁰		
	QSH	Donatorë	Total	QSH	Donatorë	Total
Fusha e programit						
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	251	0	251	1,8	0	1,8
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1470	517	1987	10,5	3,7	14,2
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	1229	500	1729	8,8	3,6	12,4
Skemat e mbështetjes së zhvillimit rural që mbështesin bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun	1405	1168	2573	10,0	8,3	18,4
Shërbimi i ekstensionit dhe informacioni bujqësor	214	0	214	1,5	0	1,5
Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	21	0	21	0,2	0	0,2
Totali i MBZHRAU	4590	2185	6775	32,8	15,6	48,4

Burimi: MBUMK, Sektori i buxhetit 2013

⁴⁰ 1 Euro=139,11 lekë sipas datës 18 mars 2013



Tabela 9: Buxheti i MBZHRAU-së 2013–2020, i shpërndarë sipas fushave të politikës, milionë lekë

Viti	Fusha e programit	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	Skemat e mbështetjes së zhvillimit rural që mbështesin bujqësinë, blegtorinë, agroindustrinë dhe marketingun	Shërbimi i ekstensionit dhe informacioni bujqësor	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	Mbeshtetja për peshkimin
2013	QSH	251	1470	1229	1405	214	21	0
	Donatorë	0	517	500	1168	0	0	0
	Total	251	1987	1729	2573	214	21	0
2014	QSH	283	1495	1312	2024	220	21	239
	Donatorë	0	448	769	643	0	0	500
	Total	283	1943	2081	2667	220	21	739
2015	QSH	235	1466	1492	2315	213	22	116
	Donatorë	0	158	1000	770	0	0	72
	Total	235	1624	2492	3085	213	22	188
2016	QSH	230	1479	1487	2481	214	22	116
	Donatorë	0	600	700	700	0	0	0
	Total	230	2079	2187	3181	214	22	116
2017	QSH	230	1409	1187	2369	216	22	96
	Donatorë	0	700	500	800	0	0	0
	Total	230	2109	1687	3169	216	22	96
2018	QSH	311	1662	1462	1689	285	25	
	Donatorë	0	850	1000	850	0	0	
	Total	311	2512	2462	2539	285	25	
2019	QSH	307	1797	1551	1789	302	25	
	Donatorë	0	900	1000	900	0	0	
	Total	307	2697	2551	2689	302	25	
2020	QSH	327	2049	1885	1955	321	25	
	Donatorë	0	1200	700	1100	0	0	
	Total	327	3249	2585	3055	321	25	

Burimi: MBUMK, Sektori i buxhetit 2013



Fusha kryesore e politikës për sa i përket investimeve është zhvillimi rural, i pasqyruar nga zbatimi i skemave të granteve si IPARD në vitin 2013, si dhe skema të tjera kombëtare mbështetjeje. Siguria ushqimore dhe ujitja e

kullimi janë dy fushat e tjera kryesore të politikës së ministrisë.

MBZHRAU ka përgatitur buxhetin e mëposhtëm për periudhën 2014-2020

Tabela 10: Buxheti i MBZHRAU-së 2014-2020, milionë lekë dhe euro

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Buxheti total, milionë lekë	8071	8486	10 805	11 529	12 168	12 922	14 777
Stafi	1830	1898	1995	2169	2345	2446	2548
Kostot operative	2341	2388	2510	2560	2623	2676	2729
Investimet e brendshme kapitale	1900	2000	3800	4200	4500	5000	6500
Investimet e jashtme kapitale*	2000	2200	2500	2600	2700	2800	3000

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Buxheti total, milionë euro	58,0	61,0	77,7	82,9	87,5	92,9	106,2
Stafi	13,2	13,6	14,3	15,6	16,9	17,6	18,3
Kostot operative	16,8	17,2	18,0	18,4	18,9	19,2	19,6
Investimet e brendshme kapitale	13,7	14,4	27,3	30,2	32,3	35,9	46,7
Investimet e jashtme kapitale*	14,4	15,8	18,0	18,7	19,4	20,1	21,6

Burimi: Sektori i buxhetit MBUMK, MIFF 2011-2013. *: Financim nga donatorë të jashtëm dypalësh dhe shumëpalësh, Kursi i këmbimit euro në lekë: 1 euro = 139,112 lekë, sipas datës 18 mars 2013.

4.2 Kostot për ndërhyrjet e parashikuara që do të financohen nga donatorë të ndryshëm dhe IPA

MBUMK ka përfituar në nivel të konsiderueshëm nga mbështetja e donatorëve gjatë periudhës së mëparshme të planifikimit 2007-2013 dhe bashkëpunimi me donatorët do të vazhdojë edhe gjatë periudhës në vazhdim 2014-2020. MBZHRAU dëshiron që me anë të kësaj strategjie të re ndërsektoriale të rrisë koordinimin e mbështetjes nga donatorët, si dhe sinergjinë dhe përputhjen midis ndërhyrjeve të MBZHRAU-së dhe të donatorëve.

Tre fushat kryesore të mbuluara nga strategjia (a): zhvillimi rural, b): ndërhyrjet kombëtare dhe c: zhvillimi institucional, rregulloret dhe zbatimi) do të plotësohen në periudhën 2014-2020 me një shumë të parashikuar minimale prej 6 milionë eurosh në vit gjatë periudhës përveç kontributit nga

BE-ja për zhvillimin rural (IPARD) dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Mbështetja e donatorëve do të synojë masat për zhvillimin rural në zbatim të tre objektivave kryesore (konkurrueshmëria dhe fermat e qëndrueshme, përdorimi i qëndrueshëm i burimeve dhe ndryshimet klimatike, përfshirja sociale dhe ulja e varfërisë, përfshirë “Leader”) si edhe ndërhyrjet kombëtare (ujitja dhe kullimi, konsolidimi i tokës) dhe zhvillimi institucional (siguria ushqimore, zhvillimi rural dhe të tjera).

Në kategorinë e investimeve të jashtme kapitale përfshihet mbështetja e BE-së përmes IPA-s. MBZHRAU do të bashkëfinancojë programin IPARD nga buxheti kombëtar nga viti 2016. Buxheti i vlerësuar i IPARD II për 2016-2020 paraqitet në tabelën e mëposhtme.



Tabela 11: Buxheti i vlerësuar i IPARD II 2015–2020

Buxheti IPARD, milionë euro	201	2016	2017	2018	2019	2020
	5					
IPARD nga BE	0	13	14	12	16	16
Bashkëfinancimi kombëtar i IPARD	0	4	4	4	5	5
Totali për IPARD	0	17	18	16	21	21

Burimi: Sektori i buxhetit i MBUMK-së dhe llogaritjet e veta

5. Monitorimi dhe vlerësimi

Një sistem koherent monitorimi dhe vlerësimi (M&E) do të krijohet me qëllim sigurimin e një përdorimi eficient dhe efikas të fondeve të MBZHRAU-së dhe donatorëve duke siguruar informacione të besueshme për produktet/output-et, rezultatet dhe ndikimin e ndërhyrjeve të ndryshme të SZHRB. Sistemi ngrihet në zbatim të urdhrorit të Kryeministrit nr. 139, datë 1.7.2010 për “Zbatimin e procesit të monitorimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale”.

MBZHRAU aplikon sistemin e Matricës së Vlerësimit të Rezultateve (MVR) si një instrument monitorimi të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale në kuadër të Sistemit të Integruar të Planifikimit. Duke përdorur sistemin (MVR) MBZHRAU-ja përgatit tabelat e planifikimit dhe monitorimit me tregues SMART⁴¹ të bazuar në objektivat e strategjisë mbështetur nga programet buxhetore të ministrisë.

MBZHRAU përgatit tabelat e planifikimit brenda qershorit të çdo viti, përpara përgatitjes së buxhetit vjetor. Ajo plotëson tabelat e monitorimit brenda qershorit të çdo viti, përpara inkuadrimit të politikave prioritare.

Stafi/grupet e menaxhimit të programit të buxhetit të MBZHRAU-së janë strukturat përgjegjëse për përgatitjen e Matricës së Vlerësimit të Rezultateve.

Sekretari i Përgjithshëm i MBZHRAU-së koordinon përgatitjen e Matricës së Vlerësimit të Rezultateve dhe, me miratimin me shkrim të ministrit përkatës, e përfshin në MVR-në e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

5.1 Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit e përzgjedhur për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë ndërsektoriale janë përfshirë në shtojcën A dhe

karakteristikat e tyre përshkruhen më në detaje në seksionin 5.2 më poshtë.

5.2 Sistemi i mbledhjes së informacionit dhe raportimit për qëllimet e monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit e referencës ofrojnë informacione për temat kryesore për situatën në Shqipëri në kohën e përgatitjes së strategjisë (shih shtojcën A). Ata janë përdorur për analizën e sektorëve dhe zonave rurale dhe për përcaktimin e objektivave të strategjisë.

Treguesit financiarë matin thithjen e fondeve të caktuara për zbatimin e ndërhyrjeve të ndryshme dhe përfshijnë, për shembull, të dhëna për kërkesat nga përfitues të mundshëm të mbështetjes në zbatim të masave për zhvillimin rural, si dhe në zbatim të ndërhyrjeve të tjera.

Treguesit e output-it matin rezultatet e prekshme të aktiviteteve të zbatuara. Për monitorim dhe raportim do të mblidhen informacione për treguesit përkatës në varësi të llojit të ndërhyrjes.

Treguesit e rezultateve matin efektet e drejtpërdrejta dhe të menjëhershme të ndërhyrjeve të përfituesit, për shembull në aksesin në ujë dhe kullim, pajtueshmërinë me standardet e Komunitetit dhe përmirësimin e performancës së fermave dhe sipërmarrjeve bujqësore që janë mbështetur.

Treguesit e impaktit fokusohen në efektet e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin bujqësor dhe rural, ndër të tjera për modernizimin e sektorit agroushqimor dhe pajtueshmërinë e tij me standardet e Komunitetit.

Të dhënat e monitorimit do të futen në një bazë të dhënash që do të përditësohet nga AZHBR-ja. Të dhënat e mbledhura do të konfirmohen dhe transferohen në një format të pajtueshëm e të rënë dakord nga AM, ku të dhënat do të përpunohen dhe sistemohen në tabela me tregues monitorimi.

⁴¹ SMART = Specific, measurable, accurate, relevant and timely



Vlerësimet paraprake (ex-ante) të strategjisë ndërsektoriale kanë si qëllim vlerësimin e cilësisë së strategjisë dhe zbatimit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë për veprimet. Zbatimi i strategjisë do t'i nënshtrohet një vlerësimi të vazhdueshëm nëpërmjet veprimtarive të vazhdueshme për vlerësimin në nivel ndërhyrjeje me raportime vjetore për këto veprimtari. Vlerësimet operative do të fokusohen në aspekte specifike të zbatimit të strategjisë.

Gjithashtu, gjatë periudhës së zbatimit të saj strategjia do të jetë subjekt vlerësimi dhe vëzhgimi nga grupi ndërministror, për sa i përket përmbushjes së objektivave lidhur me aspektin cilësor dhe sasior, duke përfshirë të gjitha ministratë e linjës. Ky grup ndërministror mbledhet rregullisht të paktën një herë në vit me ftesë të ministrit të MBZHRAU-së dhe, nëse është e nevojshme, edhe më shumë se një herë në vit. Në këtë grup ndërministror do të bëjnë pjesë ministratë, organizatat dhe institucionet që kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e kësaj strategjie, si edhe institucione dhe organizata të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ministri i MBZHRAU-së.

Në përfundim, vlerësimi retrospektiv (*ex-post*) do të fokusohet në vlerësimin e përgjithshëm të përshtatshmërisë, efikasitetit, impaktit dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve të strategjisë ndërsektoriale dhe i analizës së faktorëve që ndikojnë në efektivitetin dhe impaktin e strategjisë, si dhe mësimet e nxjerra. Rezultatet e vlerësimit retrospektiv do të përdoren për planifikimin e ndërhyrjeve të ardhshme për zhvillimin rural dhe bujqësor.

5.3 Strukturat e përfshira dhe procesi i raportimit dhe konsultimit

Në linjë me nenin 59 dhe nenin 192 të rregullores për zbatimin e IPA-s, nr. 718/2007, pas konsultimeve me Komisionin do të ngrihet një Komitet Monitorimi për programin IPARD. Ky KM do të monitorojë zbatimin e plotë të strategjisë ndërsektoriale. KM do të ngrihet me urdhër të ministrit të MBZHRAU-së.

KM do të kontribuojë në cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit të strategjisë. Ai do të ekzaminojë periodikisht progresin dhe rezultatet e strategjisë, veçanërisht arritjen e objektivave të vendosura për fushat e ndryshme të politikës dhe ndërhyrjet, si dhe progresin e përdorimit të fondeve financiare të caktuara për ndërhyrjet. KM do të rishikojë raportet e monitorimit dhe vlerësimet.

AM do të sigurohet se i gjithë informacioni përkatës për progresin e ndërhyrjeve është vënë në dispozicion të KM-së. Ky i fundit përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve dhe organeve publike përkatëse, partnerët e duhur ekonomikë, socialë dhe mjedisorë.

Përfaqësuesit e organizatave donatore dypalëshe dhe shumëpalëshe, sektori bankar, nga fusha akademike dhe organizata të tjera lidhur me zbatimin e strategjisë do të ftohen si vëzhgues të Komitetit të Monitorimit.

AM do të veprojë si sekretariat i KM-së dhe do të asistojë punën e tij duke ofruar informacione dhe analiza dhe do të ndjekë vendimet e tij.

Shtojca A: Treguesit e monitorimit të strategjisë

Tabela A1: Treguesit e monitorimit të strategjisë (1)

Treguesi	2011	2012	Objektivi 2017	Objektivi 2020
Tokë bujqësore, ha	696 000	696 000	696 000	696 000
Sipërfaqe e shfrytëzuar bujqësore, ha	484 000		525 000	560 000
Tokë e shfrytëzuar bujqësore, % e totalit të tokës bujqësore	70		75	80
Përmasa mesatare e fermës, ha	1,26	1,20	2,0	2,5
Përmasa e fermës, ha	0,27	0,26	0,3	0,5
Norma e rritjes reale ekonomike të sektorit bujqësor, %	3,3	7,2	5	5
Produktiviteti i punës në sektorin bujqësor, rritja vjetore % (vlera nominale)	7,2	10,1	8	8
Të punësuar në agropërpunim	11 282	11 407	15 000	20 000
Produktiviteti i punës në agropërpunim (GVA/AWWU), rritja vjetore % (vlera nominale)	3	3	4.5	5
Eksporti i produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit, milionë lekë	12 098	12 982	33 000	50 000
Importi i produkteve bujqësore dhe agropërpunuese, milionë lekë	84 794	87 492	120 000	150 000



Raporti eksport – import	1:8	1:7	1:4	1:3
Fermtat organike, numri	123		600	1000
Sipërfaqe toke me prodhim organik, ha	5848		14 000	20 000
Sipërfaqja totale potencialisht e ujitshme, ha	360 000	360 000	360 000	360 000
Tokë bujqësore me infrastrukturë ujëtare të rehabilituar dhe përmirësuar, ha	210 000	220 000	250 000	290 000
Përqindja e sipërfaqes së tokës bujqësore me infrastrukturë të rehabilituar dhe përmirësuar krahasuar me totalin (360 000 ha), %	58,3	61	69,4	80
Sipërfaqja e mbetur për t'u ujitur (infrastrukturë e rehabilituar ujëtare), ha	150 000	140 000	110 000	70 000
Treguesi lidhur me gjininë - përqindja e përfitueseve femra nga shërbimi i ekstensionit	10	10	15	20
Treguesi lidhur me gjininë - përqindja e përfitueseve femra nga skemat kombëtare të mbështetjes	n.a.	n.a.	15	20
Treguesi lidhur me gjininë - përqindja e përfitueseve femra nga skemat e mbështetjes së IPARD	n.a.	n.a.	15	20

Tabela A1: Treguesit e monitorimit të strategjisë (2)

Treguesi	Njësia	Viti		
		2012	2017	2020
Rendimenti				
Perime	ton/ha	26,6	27	28
Fruta	kg/rrënjë	23,4	27	30
Vreshta	kv/ha	123	125	130
Ullinj	kg/rrënjë	26	21	22
Patate	ton/ha	23,9	24	25
Qumësht lope	litër/krerë	2684	2900	3100
Qumësht dele	litër/krerë	60	75	90
Qumësht dhie	litër/krerë	114	125	140

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 76 lekë